

Karakterit i muslimanit

FRAGMENTE TË SHKËPUTURA NGA KURANI DHE SUNETI

Muhammed el-Gazali

Muhammed GAZALI

*KARAKTERI
I MUSLIMANIT*

Prishtinë, 2004

Titulli në origjinal:
Hulukul-muslim

Titulli:
Karakter i muslimanit

Përkthyes:
Bashkim ALIU

Redaktor gjuhësor:
Arian Koçi

Recenzent:
Rufat SHERIFI

Faqosja dhe kopertina:
PLAKU DeSiGn - Bashkim Svirca

Shtypi:

Tirazhi:

Boton:
KOMITETI I BASHKUAR SAUDIT - NDIHMË KOSOVËS
Prishtinë

HYRJE

Këto fragmente të shkëputura nga Kur'ani dhe Suneti e udhëzojnë muslimanin në vlerat të cilat ia plotësojnë atij fenë dhe ia rregullojnë jetën në të dy botërat.

Këtyre u bëra një hyrje të shkurtër dhe ua dhashë disa sqarime koncize, të cilat i prekin devijimet dhe rëniet që i kanë përshkuar muslimanët në këto kohë si rezultat i nyjave dhe sëmundjeve që e kanë goditur moralin e tyre... U ndala vetëm në ajetet dhe hadithet që i përmenda, e nuk u zgjerova në përmendjen e fakteve të tjera prej prononcimeve të eruditëve, urtësive të dijetarëve dhe këshillave të njerëzve të devotshëm e pedagogëve, edhe përskej asaj se ato janë të bollshme në trashëgiminë tonë kulturore klasike, ngase për qëllim pata që të kthehem i ekskluzivisht në dy burimet primare të fesë (shariat) e ta prezantojmë aspektin pedagogjik nga ato që janë udhëzim hyjnor të cilit duhet t'i përmbahet muslimani, dhe në rast të shmangies nga ato, ai konsiderohet jo i përpiktë.

Mirëpo, ka dallim në mes të asaj që të kërkosh që njeriu t'i përmbahet një rregulle me motiv, se ajo është sjellje e përgjithshme, dhe ta ngarkosh me atë rregull, me bindje se ajo është sikur të gjitha normativat obligative në këtë fe.

Gjatë shkollimit tonë kemi mësuar filozofinë e moralit dhe metodologjitë e filozofëve, si dhe parametrat e tyre për precizimin e sjelljes së njerëzve...

Prandaj edhe u mahnitëm nga idetë e thella, nuhatja e realitetit dhe pasimi i shembujve të lartë, gjëra këto të cilat i hasëm te ta, dhe nuk tentojmë ta injorojmë vlerën e askujt që ua do të mirën njerëzve dhe që u orvat në ndriçimin e rrugëve përpara tyre, por ua bëjmë me dije metodat e edukatës perfekte dhe sjelljes së shkëlqyeshme, të cilat i solli bartësi i mi-

sionit Hyjnor përfundimtar, dhe me të cilat e transferoi botën prej humnerës në rrugë të mbarë. Me këtë, ata do ta shohin se Islami zotëron një thesar të madh të vlerave, të cilave as për së afërmi nuk mund t'u afrohen ato që kanë trashëguar njerëzit prej filozofisë greke dhe romake.

Një dijetari islam i kanë thënë: “A e ke lexuar **“Edukatën e shpirtit” të Aristotelit?**” Ai tha: “Jo, por e kam lexuar edukatën e shpirtit të Muhammed Ibën Abdull-llahut [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem]... !”

Po, e kemi lexuar edukatën e shpirtit të Aristotelit dhe filozofëve të tjerë të llojit të tij, por po ashtu e kemi lexuar edhe edukatën e shpirtit të Muhammed Ibën Abdull-llahut [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem], dhe pamë se ato që imagjinuan dhe pasuan të parët janë tablo, disa prej të cilave janë komplete e disa të mangëta, kurse Ai i shndërroi në të vërteta të gjalla, në të cilat u mishërua përsosmëria dhe u ndriçua karakteri i një njeriu, kultura e një populli dhe ritualet e një feje madhështore.

Kjo pra ishte edukata shpirtërore e Muhammed Ibën Abdull-llahut [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem].

E falënderojmë Allahun, i Cili na mundësoi t'i mësojmë disa nga veçoritë e tij dhe që na dha rast t'i ekspozojmë në një rrafsh të ri.

Ky libër konsiderohet seria e dytë, pas librit tonë **“Besimi i muslimanit.”**

E filluam me një parathënie për moralin në Islam dhe lidhjet e tij me mësimet dhe ritualet e tjera, për natyrën e shpirtit dhe gjurmët e mjedisit...

Pastaj i përmendëm vlerat me të cilat urdhëroi Islami, por nuk patëm për qëllim ndonjë klasifikim special në renditjen e këtyre vlerave.

Në këtë libër, i dhamë rëndësi përmendjes së burimeve të teksteve, për dallim nga ajo që është mësuar lexuesi të shohë prej nesh në librat e mëparshëm.

Për bazë i marrim hadithet e Pejgamberit [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem], nëse janë të gradës së vërtetë **“sahih”**, qoftë vetvetiu (li dhatihi) apo nga faktorë të tjerë (li gajrihi), dhe të mirë **“hasen”** vetvetiu (li dhatihi) ose nga faktorët e tjerë (li

gajrihi), ashtu siç e potencojnë këtë shkencëtarët e terminologjisë së hadithit.

Hadithet e përmendura këtu i kemi shënuar ashtu siç i kemi marrë prej dy librave “*Tejsirul-vusul*” dhe “*Et-Tergib ve Et-Terhib*”. Nëse hadithi ka pasur më tepër burime, ne jemi ndalur në përmendjen e vetëm një burimi.

Në këtë vepër nuk kemi dhënë kushedi çfarë mudi të madh për t’u përmendur, por vetëm se e kemi shfrytëzuar shkrimin e të mirës dhe ia kemi lehtësuar atë lexuesit.

Mbetet mudi më i madh të cilin e bartin bashkërisht autori dhe lexuesi, e ai është dashuria e së mirës dhe pasimi i së vërtetës.

MUHAMMED GAZALI

SHTYLLAT E ISLAMIT DHE PARIMET E MORALIT

Pejgamberi i Islamit e ka përcaktuar qëllimin parësor të dërgimit të tij dhe metodologjinë e qartë të misionit të tij me fjalët: *“Me të vërtetë jam dërguar t’i plotësoj virtytet e moralit.”* /Transmeton Maliku/

Kjo, sikur edhe misioni i cili e shënoi rrjedhën e vet në historinë e jetës dhe bartësi i të cilit dha mund të madh në përhapjen e rrezeve të tij dhe tubimin e njerëzve rreth tij, nuk pretendon më tepër se mbështetjen e vlerave të tyre dhe ndriçimin e horizonteve të përsosmërisë para syve të tyre, ashtu që të ecin në të me dituri.

Ritualet fetare të miratuara në Islam, të cilat u konsideruan kondita të besimit në të, nuk janë ceremoni dogmatike të llojit i cili e lidh njeriun me metafizikën e padukshme dhe e obligon atë të kryejë vepra dhe lëvizje të cilat nuk kanë kuptim. Jo, assesi, por detyrat obligative, me të cilat Islami e obligoi çdo pjesëtar të vet, janë stërvitje e përsëritur me qëllim të adaptimit të njeriut që të pajiset me vlera të shëndosha dhe të jetë konsekuent në këto vlera, kushedi sa të ndërrohen para tij rrethanat. Këto më së shumti u ngjajnë stërvitjeve fizike, të cilave njeriu iu qaset me dëshirë të madhe, duke pretenduar nga praktika e tyre e vazhdueshme shëndetin e trupit dhe jetën stabile.

Kur’ani Famëlartë dhe Suneti i pastër i shpalojnë qartë këto të vërteta. Allahu i Madhërishëm kur na detyroi me namazin obligativ, e tregoi edhe urtësinë e kryerjes së tij, duke thënë: *“... fal namazin, vërtetë namazi largon nga të shëmtuarat dhe të irituarat...”* (El-Ankebut: 45)

Pra, largimi nga mbrapshtitë dhe pastrimi nga fjala e keqe dhe vepra e keqe janë esenca e namazit. Në hadithin e trans-

metuar nga Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] nga Allahu i Madhërishëm përmendet: *“Unë e pranoj namazin e Atij që me të më është nënshtruar Mua, nuk u sjell të këqija krijesave të Mia, nuk është transparent në mëkate, tërë ditën më përmend Mua dhe e mëshiron të ngratin, udhëtarin, të vejat dhe nevojtarin.”* /Transmeton Bezzari/

Zekati i obliguar nuk është tatim i cili rrëmbehet prej xhe-pave, por ai në radhë të parë është mbjellje e ndjenjave të mëshirës dhe butësisë dhe forcim i lidhjeve të njohjes reciproke dhe dashurisë në mes shtresave të ndryshme. Qëllimin e nxjerrjes së zekatit Kur’ani e ka theksuar me fjalët: *“Merr prej pasurisë së tyre (të atyre që pranuan gabimin) lëmoshë që t’i pastrosh me të dhe t’u shtosh (të mirat) ...”* (Et-Teube: 103)

Urtësia parësore, pra, qenka pastrimi i shpirtit nga njollat e mospërsosmërisë dhe ngritja e shoqërisë në piedestale më të larta.

Për këtë Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] i dha një kuptim më të gjerë domethënies së fjalës lëmoshë, të cilën duhet ta japë muslimani, dhe thotë: *“Buzëqeshja në fytyrën e vëllait tënd është lëmoshë, urdhërimi në të mirë dhe ndalimi nga e keqja është sadaka (lëmoshë), ta udhëzosh një njeri që e ka humbur rrugën është lëmoshë, ta largosh një pengesë, ferrë dhe asht nga rruga është lëmoshë, t’i ndihmosh një vëllai të nxjerrë ujë është lëmoshë dhe t’i ndihmosh një njeriu me të parë të dobët është lëmoshë.”* /Transmeton Buhariu/

Këto instruksione në mjedisin shkretinor, i cili me shekuj jeto-i në hasmëri dhe mendjelehtësi, tregojnë për qëllimet të cilat i trasoi Islami dhe në të cilat i priu arabët në injorancën e errët.

Po ashtu, Islami e obligoi edhe agjërimin. Islami këtë nuk e konsideron abstenim të përkohshëm nga disa ushqime dhe pije, por e konsideron një hap kah ndalimi i njeriut nga epshet e ndaluara dhe pasionet e shëmtuara.

Si konfirmim të këtij kuptimi, Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] thotë: *“Kush nuk i lë fjalët e kota dhe veprimet sipas tyre, le ta dijë se Allahu nuk ka nevojë që ai ta lërë hajen dhe pijen.”* /Transmeton Buhariu/ Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] po ashtu thotë: *“Agjërimi i vërtetë nuk është të ndaluarit prej hajes dhe pijes, por agjërimi i vërtetë është të*

ndaluarit nga fjalët e kota dhe punët e ndyta; nëse të shan dikush, apo tregohet ndaj teje injorant, thuaj: Unë jam agjërueshëm.” /Transmeton Ibën Huzejme/

Kur’ani Famëlartë e përmend frytin e agjërimit në ajetin: **“... agjërimi ju është bërë obligim sikurse që ishte obligim edhe i atyre që ishin para jush, kështu që të bëheni të devotshëm.”** (El-Bekare: 183)

Ndoshta njeriu mund të kujtojë se shkuarja në vendet e shenjta, me të cilën është obliguar ai që ka mundësi dhe konsiderohet prej detyrave islame për disa pjesëtarë të tij, është thjesht një udhëtim i zbrazët nga kuptimet etike dhe shembull i ritualeve metafizike të cilat ndonjëherë i përmbajnë fetë. Kjo është gabim, pasi që Allahu i Madhërishëm lidhur me këtë ritual thotë: **“Haxhi është në muajt e caktuar, e kush bën (ia fillon të zbatojë) haxhin në këta muaj, nuk duhet t’i afrohet gruas, nuk bën të marrë nëpër këmbë dispozitat e sheriatit, as nuk duhet shkaktuar grindje. Çka punoni nga e mira, Allahu di për to. Dhe përgatituni me furnizim (për rrugë), e furnizimi më i mirë është devotshmëria, e ju të zotët e mendjes keni dronë Time.”** (El-Bekare: 197)

Nga ky prezantim i përgjithësuar i disa ritualeve me të cilat u identifikua Islami, dhe të cilat u njohën se janë shtyllat e tij themelore, e kuptojmë qartë fuqinë e raporteve të cilat e lidhin fenë me karakterin. Po, këto janë rituale të ndryshme në formën dhe mënyrën e vet, por të gjitha bashkohen në qëllimin të cilin e theksoi Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] me fjalët: **“Unë jam dërguar t’i plotësoj vlerat e moralit.”**

Namazi, agjërimi, zekati, haxhi dhe mësimet e tjera islame të ngjashme me këto rituale fetare janë pidestalet e përsosmërisë së dëshiruar dhe bartësit e pastërtisë që mbrojnë jetën dhe lartësojnë vlerën e saj. Ndërkaq, këtyre vetive fisnike, të cilat lidhen me to apo zhvillohen prej tyre, u është dhënë pozitë e lartë në fenë e Allahut.

Për atë, nëse njeriu nuk i shfrytëzon ato që ta pastrojnë zemrën, ta kullojë qenien dhe t’i kalitë lidhjet e tij me Allahun dhe njerëzit, ai ka devijuar. Allahu i Madhërishëm thotë: **“Ai që i paraqitet Zotit të vet si kriminel, e ka Xhehenemin, në të cilin as nuk vdes as nuk jeton. Ndërsa ai që i paraqitet Atij**

besimtar, e që ka bërë vepra të mira, të tillët i presin merita të larta. (do ta presin) Xhenete të Adnit, nëpër të cilët rrjedhin lumenj dhe aty do të jenë përjetë. Ky është shpërblim i atij që është pastruar nga mosbesimi.” (Ta Ha: 74-76)

DOBËSIA E KARAKTERIT, ARGUMENT PËR DOBËSINË E BESIMIT

Besimi është fuqi mbrojtëse nga poshtërsitë dhe shtytës drejt vlerave fisnike, andaj edhe kur Allahu i Madhërishëm i thërret robërit e Vet në atë që është produktive, ose kur i largon nga gjërat destruktive, këtë e paraqet si kërkesë të imanit stabil në zemrat e tyre. Ai shpesh në Librin e Tij thotë: ***“O ju të cilët keni besuar”***, pastaj e përmend obligimin me të cilin i detyron, si p.sh.: ***“... Ta keni në kujdes Allahun dhe të jeni me ata të drejtit.”*** (Et-Teube: 119)

Pejgamberi i Allahut ka sqaruar qartë se besimi i fortë pa dyshim prodhon karakter të fortë dhe se rënia rapide e moralit përfundimin e ka në dobësimin e besimit, në bazë të madhësisë së të keqes apo dobësisë së saj. Lidhur me njeriun e pandërgjegjshëm me sjellje brutale, i cili bën punë të ndyta pa u bren-gosur prej askujt, Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] thotë: ***“Turpi dhe besimi janë të dyja të përbashkëta, nëse ngritet njëra, ngritet edhe tjetra.”*** /Transmetojnë Hakimi dhe Taberaniu/

Po ashtu, për njeriun që shqetëson fqinjët e vet dhe i dëm-ton feja ka qëndrim të ashpër, dhe për të Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] ka thënë: ***“Për Allahun, nuk beson, për Allahun, nuk beson, për Allahun, nuk beson!”*** I thanë: ***“Kush, o Pejgamber i Allahut?”*** Tha: ***“Ai, nga të këqijat e të ci-lit nuk janë të sigurtë fqinjtë e vet!”*** /Transmeton Buhariu/

Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] kur i mëson ithta-rët e vet që t’u shmangen punëve të kota, fjalëve të pamatura dhe të pavend thotë: ***“Kush i beson Allahut dhe Ditës së Fundit, le të flasë mirë ose le të heshtë.”*** /Transmeton Buhariu/

Kështu vazhdon në mbjelljen e vlerave dhe mbikëqyrjen e tyre, derisa t'i japin frytet e veta duke u bazuar në sinqeritetin dhe përsosmërinë e besimit.

Mirëpo, duhet ditur se disa pjesëtarë të fesë e shohin si të lehtë kryerjen e ritualeve fetare obligative; ata para masës tregohen se janë aq të përpiktë në kryerjen e tyre, por një-kohësisht bëjnë vepra të cilat i injoron karakteri fisnik dhe besimi i vërtetë. Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] iu kërcënuua atyre njerëzve të dyfishtë dhe ia tërhoqi vërejtjen umetit për ta. Për atë se imitimimin e formës së ritualeve fetare mund ta bëjë ai i cili nuk e ka absorbuar shpirtin e tyre apo nuk është ngritur në nivelin e tyre.

Ndoshta edhe fëmija i vogël mund t'i imitojë veprimet e namazit dhe përsërit fjalët që thuhet në të. Ndoshta edhe një artist mund të ekspozojë nënshtrimin dhe të aktrojë ceremonitë më të rëndësishme, mirëpo as kjo e as ajo e para nuk i ndihmojnë me asgjë besimit të shëndoshë dhe qëllimit fisnik.

Gjykimi për shkallën e të mirës dhe shkëlqyeshmërinë e sjelljes i takon një peshoje e cila asnjëherë nuk gabon, e ajo është: karakteri i lartë.

Në këtë kontekst transmetohet se një njeri i ka thënë Pejgamberit [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem]: *“Filania përmend se shumë falet, agjëron dhe jep lëmoshë, mirëpo ajo i dëmton me fjalë fqinjtë e saj.”* Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] tha: *“Ajo është në zjarr.”* Pastaj njeriu tha: *“O Pejgamber i Allahut, filania përmend se pak falet, agjëron dhe se jep lëmoshë disa copa djathi, por nuk i dëmton fqinjtë e saj.”* Ai tha: *“Ajo është në Xhenet.”* /Transmeton Ahmed i/

Në këtë përgjigje çmohet vlera e karakterit të lartë, e po ashtu ngrihet lëmosha si ritual me karakter shoqëror, dobia e së cilës transferohet te të tjerët, andaj edhe nuk është kushtëzuar pakësimi i saj siç është kushtëzuar pakësimi i namazit dhe agjërimit, të cilat, nga aspekti ezoterik, janë rituale personale.

Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] nuk u ndal vetëm në përgjigjen e kësaj pyetjeje në ndriçimin e lidhshmërisë së karakterit me besimin e vërtetë dhe adhurimin e sinqertë, por atë e bëri bazë të prosperimit në këtë botë dhe të shpëtimit në botën tjetër.

Çështja e karakterit është më e ndërlikuar se kjo dhe patjetër duhet të ketë udhëzim kontinuitiv dhe këshilla të njëpasnjëshme që të thellohet në zemra dhe ide, dhe se besimi, mirëqenia dhe morali janë elemente unike të pandara dhe asgjë nuk mund ta copëtojë litarin e tyre.

Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] një ditë i pyeti shokët e vet: *“A e dini cili është i falimentuar?”* Thanë: *“Te ne, i falimentuar është ai i cili nuk ka para dhe pasuri.”* (Pejgamberi) Tha: *“Njeri i falimentuar prej umetit tim është ai i cili në Ditën e Gjykimit do të vijë me namaz, zekat dhe agjërim, por dikë e ka sharë, për dikë ka shpifur, dikujt ia ka rrëmbyer pasurinë, dikë e ka vrarë e dikë e ka goditur, dhe çdonjërit prej tyre do t’i japë prej të mirave të veta, e nëse i harxhohen të mirat, para se t’i paguajë borxhet, merren prej mëkateve të tyre e i hidhen atij, e pastaj ai hidhet në zjarr.”* /Transmeton Muslimi/

Ky pra është i falimentuari. Sikur tregtari i cili në shitoren e vet ka artikuj në vlerë prej një mijë e ndërkaq ka borxhe, vlera e të cilave është dy mijë; atëherë si ky i ngrati mund të konsiderohet pasanik? Po ashtu, edhe njeriu i cili i kryen disa rituale fetare, por përsëri pas tyre mbetet i gatshëm për të keq, fytyrëmërrorur e i disponuar për armiqësi, si mund të konsiderohet i devotshëm? Transmetohet se Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] për këto situata ka përmendur një shembull mjaft të përshtatshëm, edhe atë duke thënë: *“Moral i vyeshëm i shkrin mëkatet siç e shkrin uji borën, ndërkaq morali i prishur i deformon veprat ashtu siç e prish uthulla mjaltin.”* /Transmeton Bejhekiu/

Prandaj, kur zhvillohen ndytësiat në shpirt, përhapet e keqja e tyre dhe shtresohet rreziku i tyre, njeriu del prej fesë së vet ashtu siç del lakuriqi prej rrobave të veta, e me këtë pretendimi i tij në besim është trillim, sepse çfarë vlere ka feja pa moral? Dhe ç’do të thotë plangprishësia krahas thirrjes sate se i takon Allahut?

Duke i konfirmuar këto parime të qarta të lidhshmërisë së besimit me karakterin e drejtë, Pejgamberi i ndershëm thotë: *“Personi tek i cili gjenden tri gjëra është munafik (hipokrit), edhe nëse agjëron, falet dhe e kryen haxhin e umren, dhe tho-*

të: 'Unë jam musliman'. Ato janë: kur flet, rren, kur premtan, mashtron, dhe kur i besohet diçka, tradhton." /Transmeton Muslimi/ Sipas një versioni tjetër thotë: "Shenjat e munafikut (hipokritit) janë tre: kur flet rren, kur premtan e then premtimin dhe kur të jep besë tradhton, edhe pse falet, agjëron dhe kujton se është musliman." Po ashtu thotë: "Personi tek i cili gjenden katër veti, është munafik i plotë, kurse personi tek i cili gjendet një prej atyre vetive, tek ai gjendet një shenjë e hipokrizisë, derisa nuk e lë: Kur i besohet diçka tradhton, kur flet rren, kur ia jep besën dikujt nuk e mban dhe kur armiqësohet me dikë e tepron." /Transmeton Buhariu/

DREJT NJË BOTE MË TË VYESHME

Prej këtyre udhëzimeve u pa se Islami erdhi që ta transferojë njerëzimin me hapa të mëdhenj në një jetë të ndritshme me vlera dhe rregulla dhe këto faza, të cilat çojnë në këtë qëllim fisnik, i konsideroi thelb të misionit të vet, ashtu siç e konsideroi mospërfilljen e këtyre metodave kundërshtim dhe largim nga ai.

Morali nuk është luks pa të cilin mund të jetohet, por është esenca e jetës të cilën feja e pranon dhe i respekton bartësit e tij. Pastaj, Islami i përmbloodhi vlerat dhe i nixti ithtarët e tij që t'u përmbahen atyre një nga një. Sikur t'i kishim përmbledhur fjalët e Pejgamberit për zbukurimin me veti fisnike të moralit, do të përpilonim një libër të cilin nuk mbahet mend ta ketë shkruar asnjë prej eruditëve reformues.

Por, para se t'i përmendim hollësitë e këtyre vlerave, dhe atë që është përmendur për secilën prej tyre në veçanti, do t'i prezantojmë disa prej thirrjeve të tij të flakta në moralin e vyeshtëm dhe karakterin e fortë.

Transmetohet prej Usame Ibën Sherikut, i cili thotë: *“Ishim ulur te Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] sikur mbi kokat tona kishte shpend. Asnjë prej nesh nuk fliste dhe erdhën disa njerëz dhe thanë: “Cilët prej robërve janë më të dashur tek Allahu?” (Pejgamberi) Tha: “Ata që kanë karakter më të vyeshtëm.” /Transmeton Taberaniu/*

Në një transmetim tjetër përmendet se i është thënë: *“Cila është gjëja më e vlefshme që i është dhënë njeriut?”* Tha: *“Morali i vyeshtëm.” /Transmeton Ibën Hibbani/*

Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] po ashtu thotë: *“Me të vërtetë, mbrapshtia dhe paturpësia nuk kanë asgjë të përbashkët me Islamin; njeriu më i denjë në Islam është ai i cili*

ka moral më të vyeshëm.” /Transmeton Tirmidhiu/ Po ashtu është pyetur: “Cilët besimtarë kanë besim më të kompletuar?” Tha: “Ata që kanë moral më të vyeshëm.” /Transmeton Taberaniu/

Transmetohet prej Abdull-llah Ibën Amrit i cili thotë: “E kam dëgjuar Pejgamberin [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] duke thënë: “A t’ju tregoj se cili prej jush është më i dashur për mua dhe cili do të jetë më afër meje në Ditën e Gjykimit?” Këtë e përsëriti nja dy a tri herë. Thanë: “Po, o i Dërguar i Allahut.” Ai tha: “Ata prej jush që kanë moral më të vyeshëm.” /Transmeton Ahmedi/

Po ashtu thotë: “Në Ditën e Gjykimit nuk ka asgjë më të rëndë se morali i vyeshëm në peshojën e besimtarit, Allahu e urren mbrapshtanin e pafytyrë. Njeriu i cili ka moral të vyeshëm, me të do ta arrijë gradën e agjëruetit dhe namazxhiut.” /Transmeton Ahmedi/

Po të kishin dalë këto deklaratat nga një filozof që merret vetëm me çështjet e reformimit moral, nuk do të ishte habi, por habia vjen nga ajo se kjo del nga bartësi i një feje madhështore, ndërkaq fetë, si zakonisht, qëllimin e tyre parësor e kanë të përqendruar (fokusuar) ekskluzivisht në adhurim.

Pejgamberi i Islamit thirri në adhurime të ndryshme dhe ngriti një shtet që u përqendrua në xhihad të gjatë kundër shumë armiqve. Nëse, edhe krahas gjerësisë së fesë dhe fushave të shumta të veprimit para pjesëtarëve të saj, Pejgamberi i lajmëron se gjëja më e rëndë në peshojat e tyre në Ditën e Llogarisë është morali i vyeshëm, atëherë të dëshmuarit e kësaj për pozitën e moralit në Islam është mjaft transparent.

Është realitet se, nëse feja është sjellje e mirë në mes vetë njerëzve, ajo në natyrën e vet qiellore është lidhje e mirë mes njeriut dhe Zotit, ndërkaq të dyja kthehen në një esencë të përbashkët.

Ka disa fe të cilat përgëzojnë se përqafimi i një besimi i anulon mëkatet dhe se kryerja e ritualeve të caktuara i fshin gabimet.

Ndërkaq, Islami nuk e thotë këtë pa qenë besimi bosht i veprimit të së mirës dhe i kryerjes së obligimit, si dhe pa qenë

rituali i paraparë pastrim nga e keqja dhe përgatitje për përsosurinë e dëshiruar, gjegjësisht, veprat e këqija mund të fshihen vetëm nga veprat e mira që kryen njeriu dhe me to ai ngjitet në një pedestal më të lartë.

Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] ishte konsekuent në konfirmimin e këtyre parimeve të drejta, ashtu që t'i kuptojë qartë umeti i tij dhe që të mos e zhvlerësojnë besimtarët peshën e moralit e ta ngrenë peshën e dokeve.

Transmeton Enesi [radijAllahu anhu]: *“Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] ka thënë: “Njeriu me moralin e mirë do t'i arrijë gradat e mëdha të botës tjetër dhe piedestalet më të larta, edhe po të jetë i dobët në rituale; ndërkaq, me sjelljen e tij të keqe, ai do ta arrijë shkallën më të ulët në Xhehenem.”* /Transmeton Taberaniu/

Transmetohet prej Aishes [radijAllahu anha], e cila thotë: *“E kam dëgjuar Pejgamberin e Allahut [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] duke thënë: “Besimtari me sjelljen e mirë të tij do ta arrijë gradën e agjëruesit namazli.”* Në një version tjetër qëndron: *“Besimtari me sjelljen e mirë do t'i arrijë gradat e atij i cili natën falet e ditën agjëron.”* /Transmeton Ebu Davudi/

Transmetohet prej Ibën Omerit [radijAllahu anhu], i cili thotë: *“E kam dëgjuar Pejgamberin e Allahut duke thënë: “Muslimani mesatar në adhurim, me moralin e vyeshëm dhe natyrën fisnike, do ta arrijë gradën e atyre që agjërojnë dhe falen shumë.”* /Transmeton Ahmedi/

Ebu Hurejra [radijAllahu anhu] transmeton nga Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] se ka thënë: *“Nderi i besimtarit është feja, burrëria e tij është mendja, ndërkaq i mjafton morali.”* /Transmeton Hakimi/

Ebu Dherri [radijAllahu anhu] transmeton prej tij se ka thënë: *“Ka shpëtuar ai që e ka pranuar sinqerisht besimin në zemër, e ka zemrën e shëndoshë, gjuhën korrekte, shpirtin të qetë dhe karakterin e drejtë.”* /Transmeton Ibën Hibbani/

Por, karakteri i vyeshëm në shoqëri nuk ndërtohet me instruksione të predikuara ose vetëm me urdhra dhe ndalesa, pasi që për t'iu përshtatur vlerave njerëzve nuk u mjafton që vetëm mësuesi t'u thotë: “Bëje këtë, apo mos e bëj këtë.” Edukata fryt-

dhënëse ka nevojë për punë të gjatë edukuese dhe kërkon mbikëqyrje të vazhdueshme.

Asnjë edukatë nuk mund të jetë efikase pa u mbështetur në shembullin e mirë, sepse njeriu i keq nuk lë përshtypje të mira në shpirtrat e atyre që i ka përreth. Por përshtypje të mira priten prej atij në karakterin e të cilit shikojnë njerëzit dhe magjepsen me edukatën e tij, e i robëron shkëlqyeshmëria e tij, kurse thjesht nga mahnitja kopjojnë nga natyra dhe shkojnë me dashuri të sinqertë pas hapave të tij.

Por, është e domosdoshme që të arrijë pasuesi deri te një këst i madh i mirësisë, të ketë në të pasuarin sasi më të madhe dhe këst edhe më të lartë.

Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] në mesin e shokëve të tij ka qenë shembulli më i lartë për moralin në të cilin i thirrte: Ai, pra, e mbillte në mesin e shokëve të tij këtë moral të lartë përmes biografisë së tij të këndshme, para se ta mbillte me urtësitë dhe këshillat që ua kumtonte. Transmetohet prej Abdull-llah Ibën Amrit, i cili thotë: *“Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] nuk ka qenë mbrapshtan, e as i paturpshëm, dhe thoshte: “Njerëzit më të dalluar prej jush janë ata që kanë moral më të vyeshëm.”* /Transmeton Buhariu/

Transmetohet prej Enesit, i cili thotë: *“I kam shërbyer Pejgamberit [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] dhjetë vjet dhe, për Allahun, asnjëherë nuk më ka thënë mua ‘Oh’, e as që më ka thënë për diçka: “Pse e bërë kështu? Ose, pse nuk e bërë kështu!”* /Transmeton Muslimi/

Po ashtu, transmetohet prej tij se ka thënë: *“Robëresha e kapte për dore Pejgamberin [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] dhe me të shkante ku të dëshirojë; kur takohej me ndonjë njeri dhe ia jepte dorën, nuk e hiqte dorën prej tij, derisa njeriu nuk e hiqte vetë, nuk e kthente shikimin prej tij në anë tjetër, derisa ai ta kthejë vetë i pari dhe nuk është parë t’i nxjerrë gjunjët para atij me të cilin është ulur.”* /Transmeton Tirmidhiu/, që do të thotë se ka qenë i kujdesshëm dhe nuk është treguar kryelartë.

Transmetohet prej Aishes [radijAllahu anha], se ka thënë: *“Sa herë që i është ofruar Pejgamberit [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] të zgjedhë në mes dy gjërave, ai e ka zgjedhur më të*

lehtë, nëse nuk ka qenë mëkat, e nëse ka qenë mëkat, ka qenë më larg se çdonjëri prej saj. Pejgamberi asnjëherë nuk është hakmarrë (ka ndëshkuar) për shkak të vetes, përveçse kur janë shkelur normat e Allahut, atëherë ka ndëshkuar. Pejgamberi asnjëherë askujt nuk i ka mëshuar me dorën e vet, qoftë grua apo shërbëtor, përveç se kur ka bërë xhihad në rrugë të Allahut.” /Transmeton Muslimi/

Transmetohet prej Enesit i cili thotë: “Isha duke ecur me Pejgamberin [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem], i cili kishte të veshur një gunë me skaje të ashpra. Atë e arriti një beduin dhe e hoqi fortë për të, dhe kur shikova mbi shpatullën e Pejgamberit [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem], në të kishin lënë gjurmë skajet e gunës nga tërheqja e fortë, pastaj tha: “O Muhammed, më jep mua prej pasurisë së Allahut që ke në disponim!” Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] u kthye kah ai, buzëqeshi dhe urdhëroi t’i jepet diçka.” /Transmeton Buhariu/

Transmetohet prej Aishes, e cila thotë: “Pejgamberi i Allahut ka thënë: “Allahu është i butë dhe e do butësinë; Ai jep për butësinë atë që nuk e jep për vrazhdësinë dhe çka nuk jep për të tjerat.” /Transmeton Muslimi/ Në një version tjetër qëndron: “Në çdo gjë ku gjendet butësia, e zbukuron, dhe prej çdo gjëje që ajo privohet, e shëmton.”

Transmetohet prej Xheririt, se Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] ka thënë: “Allahu i Lartësuar e jep për butësinë atë që nuk e jep për kokëtrashësinë. Allahu kur e do një njeri, i jep butësi; ajo familje që privohet nga butësia, është privuar nga të gjitha të mirat.” /Transmeton Taberaniu/

Është pyetur Aishja [radijAllahu anhu]: “Çka bënte Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] në shtëpinë e vet?” Tha: “I shërbente familjes së vet, e kur vinte koha e namazit, merrte abdest dhe dilte në namaz.” /Transmeton Muslimi/

Transmetohet prej Abdull-llah Ibën Harithit i cili thotë: “Nuk kam parë asnjë njeri më të buzëqeshur se Pejgamberi i Allahut!” /Transmeton Tirmidhiu/

Transmetohet prej Enesit i cili thotë: “Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] ka qenë njeriu me karakter më të vyeshëm. Unë kisha një vëlla të vogël që quhej Ebu Umejr, e i cili kishte një bilbil të sëmurë që quhej Nugejr, e Pejgamberi

[sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] e përkëdhelte këtë fëmijë të vogël dhe i thoshte: “O Ebu Umejr, ç’u bë me Nugejrin?” /Transmeton Buhariu/

Prej tipareve të Pejgamberit *[sal-lAllahu alejhi ve sel-lem]* dihet se ka qenë njeri bujar, asnjëherë nuk ka qenë koprrac për diçka; ka qenë trim, asnjëherë nuk ka hequr dorë nga ndonjë e drejtë; ka qenë i drejtë, nuk ka bërë padrejtësi në gjykim asnjëherë; ka qenë i sinqertë dhe besnik në të gjitha etapat e jetës së vet.

Allahu i Madhërishëm i urdhëron muslimanët që ta ndjekin Pejgamberin *[sal-lAllahu alejhi ve sel-lem]* në cilësitë e mrekullueshme dhe natyrën e tij të thellë dhe thotë: ***“Ju e kishit shembullin më të lartë në të Dërguarin e Allahut, kuptohet, ai që shpreson në shpërblimin e Allahut në botën tjetër, ai që atë shpresë e shoqëron duke e përmendur shumë shpesh Allahun.”*** (El-Ahzab: 21)

Kadi Ijadi thotë: *“Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] ka qenë njeriu më i mirë, më bujar, më trim. Një natë, një zë i trishtoi medinasit dhe njerëzit u nisën në drejtim të zërit, por ata i takoi Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem], i cili ishte duke u kthyer. Kishte shkuar atje para të gjithëve dhe ua kumtoi lajmin se kishte qenë kali i Ebu Talhës duke u valvitur në tokë me një shpatë të ngulur në qafë, dhe u tha: Mos u shqetësoni.”*

Aliu [radijAllahu anhu] thotë: *“Ne, kur ashpërsohej lufta, mbroheshim me Pejgamberin [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem]; asnjë nuk ishte më afër armikut se ai.”*

Transmetohet prej Xhabir Ibën Abdull-llahut [radijAllahu anhu] i cili thotë: *“Asnjëherë, kur i është kërkuar Pejgamberit [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem], nuk ka thënë: “Jo!”*

Hadixheja i ka thënë atij: *“Ti kujdesesh për të varfrit, e kompenson të humburën dhe e ndihmon të drejtën.”*

I arritën atij 70 mijë dirhemë dhe iu vunë mbi një hastër e ai u ngrit t’i ndajë dhe nuk ktheu asnjë lypës derisa i harxhoi të tëra.

I erdhi një njeri t’i lypë diçka, e ai i tha: *“Momentalisht nuk kam kurrgjë, por huazo në emrin tim, e kur do të na arrijë diçka, ne do ta kompensojmë.”* Omeri i tha: *“Allahu nuk të ka*

ngarkuar me një gjë që s'ke mundësi ta realizosh!" Pejgamberit nuk i pëlqeu kjo, kurse një prej ensarëve (banorëve vendas të Medines) i tha: *"O Pejgamber i Allahut, shpërndaj dhe mos u frikëso që Pronari i Arshit do ta pakësojë."* Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] buzëqeshi, u pa sihariqi në fytyrën e tij, dhe tha: *"Me këtë jam urdhëruar."*

Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] i bashkonte shokët e vet, e nuk i përçante; të parin e çdo populli e nderonte dhe e caktonte udhëheqës të tyre.

I përcillte shokët e vet dhe çdonjërit që e shoqëronte ia jepte hisen e vet; shoqëruesi i tij nuk mendonte se ndonjëri prej të tjerëve është më i ndershëm te Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] se ai.

Kush ulej me të, apo i afrohej për ndonjë nevojë, ai treguhej durimtar ndaj tij dhe nuk largohej derisa të largohej vetë ai njeri.

Kush i lypte diçka, nuk e kthente pa i dhënë apo pa i thënë fjalë miradije.

Modestia dhe morali i tij i përfshiu njerëzit, u bë prind i tyre, tek ai të gjithë kishin të drejta të barabarta.

Çdoherë ka qenë i gëzuar, ka pas natyrë të lehtë, ka qenë i butë, nuk ka qenë i ashpër apo i vrazhdë, nuk ka qenë zhurmues, as mbrapshtan, nuk ka qenë qortues i madh e as lavdërues i madh, ai që i drejtohej, atij nuk ia humbte shpresat.

Transmetohet prej Aishes [radijAllahu anhu], e cila thotë: *"Asnjëri nuk ka qenë më i karaktershëm se Pejgamberi i Allahut. Sa herë që e ka thirrur ndonjëri prej shokëve apo familjes së vet, thoshte: "Urdhëro."*

Xherir Ibën Abdull-llahu [radijAllahu anhu] thotë: *"Qëkur e kam përqaftuar Islamin, Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] asnjëherë nuk më ka penguar dhe nuk më ka treguar gjë tjetër, përveç buzëqeshjes."*

Ai bënte shaka me shokët e vet, përzihej me ta dhe bënte gara me ta, luante me fëmijët e tyre dhe i ulte në prehrin e vet.

I përgjigjej ftesës së robit dhe të zotëriut, robëreshës dhe të ngratit, e vizitonte të sëmurin në skajin më të largët të Medines, dhe i pranonte arsyetimet e njerëzve.

Enesi thotë: *“Asnjëri nuk i është drejtuar me ndonjë bisedë Pejgamberit [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem], e që ai ta largonte kokën, vetëm atëherë kur vetë bashkëbiseduesi është larguar. Kur e ka kapur dikush për dore, ai nuk ia ka lëshuar dorën, derisa ta lëshojë dorën vetëm tjetri. Cilin e takonte, i jepte selam, e shokëve të vet ua jepte dorën.”*

Asnjëherë nuk është parë t'i shtrijë këmbët në mes shokëve të vet, e me këtë ta ngushtojë dikë.

Shokëve të vet u jepte ofiqe dhe i thirrte me emrat e tyre më të dashur, në shenjë respekti, askujt nuk ia ndërpriste bisedën, derisa nuk gabonte.

Transmetohet prej Enesit, i cili thotë: *“Kur i dhuronin diçka Pejgamberit [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem], ai thoshte: “Dërgojeni këtë te shtëpia e filan gruas, sepse ajo ishte shoqja e Hadi-xhes, ajo e donte Hadixhen.”*

Transmetohet prej Aishes [radijAllahu anha], e cila thotë: *“Asnjë grua nuk e kam xhelozuar, siç e kam xhelozuar Hadi-xhen, kur e dëgjoja se e përmendte. Pejgamberi therrte ndonjë dele dhe ua dhuronte shoqeve të saj. Motra e saj kërkoi që të hyjë tek ai dhe ai u gëzua për këtë. Tek ai hyri një grua, e ai i tregoi mikpritje dhe pyeti mjaft për të, e kur doli tha: “Kjo vinte kur ishte Hadixheja gjallë; të qenit korrekt ndaj besës është nga imani.”*

E respektonte farefisën e vet, por nuk u jepte përparësi atyre, ndaj atyre që janë më meritore se ata.

Transmetohet prej Ebu Katades, i cili thotë: *“Kur arriti delegacioni i Nexhashiut, Pejgamberi u ngrit t'u shërbejë vetë. Në këtë shokët e vet i thanë: “Ne do ta kryejmë këtë punë” dhe ai u tha: “Këta na i nderuan shokët tanë dhe unë dëshiroj t'ua kthej.”*

Transmetohet prej Ebu Umames, i cili thotë: *“Doli në mesin tonë Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] i mbështetur në një shkop, e ne iu ngritëm atij, por ai tha: “Mos u ngritni siç veprojnë jomuslimanët, e adhurojnë njëri-tjetrin.”*

Po ashtu thotë: *“Unë jam njeri, ha sikur ha njeriu dhe ulem sikur ulet njeriu.”* I hipte gomarit, i shkante pas atij, i vizitonte

të ngratët, i shoqëronte të varfërit, ulej në mes shokëve të vet i përzier me ta, ku të gjente vend ulej.

Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] e kreu haxhin me një kafshë të plogësht me të cilën udhëtoi. Mbi të kishte një mburojë që nuk kushtonte as katër dirhemë dhe tha: *“O Allah, ky është haxh që nuk është bërë për sy e faqe.”*

Kur u çlirua Mekka dhe hyri në të me ushtritë muslimane, vari kokën për kafshën e vet dhe gati sa nuk e preku qafën e saj. Tërë këtë e bëri nga përvullësia ndaj Allahut të Madhërisëm.

Shumë heshte, nuk fliste pa nevojë, distancohej nga ai i cili nuk fliste si duhet.

Të qeshurit e tij ishte buzëqeshje, fjalët e tij ishin të rrjedhshme, nuk kishte fjalë të tepërta e as të mangëta.

Të qeshurit e shokëve të tij tek ai ishin buzëqeshje, në she-një respekti dhe pasimit të tij.

Tubimi i tij ishte tubim i butësisë, mirësisë dhe besës, në të nuk ngriheshin zërat, nuk prekeshin nderet; kur fliste, i heshte shoqëruesit e vet, sikur mbi kokë të kenë shpendë.

Ishte stabil në ecje; në ecje shihej se nuk është i ngushtëm e as përtac.

Ibën Ebi Hale thotë: *“Ai heshte në katër momente: në butësi, në vërejtje, në vlerësim dhe në rezonim.”*

Aishja [radijAllahu] anha thotë: *“Ai kur fliste, po të donte, dikush do t’ia numëronte fjalët.”*

Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] e donte miskun dhe erën e këndshme, andaj edhe e përdorte shumë.

Atij iu nënshtua bota me tërë pasuritë e saj, çlirimet i vinin njëri pas tjetrit, por ai u distancua nga luksi i saj, vdiq duke e patur këmbësorë të tij të hekurt te një çifut, të cilit ia kishte lënë garanci për borxhin e marrë për furnizimin e familjes.

NJERIU NDËRMJET SË MIRËS DHE SË KEQES

Islami, ashtu sikur shpalljet e tjera qiellore, në reformën e saj të përgjithshme, para së gjithash, mbështetet në kalitjen e shpirtit njerëzor; ai jep mund të madh që të depërtojë në thellësitë e tij dhe t'i mbjellë mësimet e veta në esencën e tij, ashtu që të transformojë një pjesë të tij.

Shpalljet e Pejgamberëve u bënë të amshueshme dhe rreth tyre u tubuan masa të mëdha muslimanësh, vetëm në sajë të asaj se shpirti njerëzor ka qenë lëndë e punës dhe bosht i aktivitetit të tyre. Mësimet e tyre nuk kanë qenë lëvore të ngjitura, të cilat kanë rënë gjatë turbulencave të jetës së lëvizshme, e as ngjyra të improvizuara, të cilat janë zhdukur me kalimin e kohës... Jo! Ata i sintetizuan parimet e tyre me thellësinë e shpirtit, ashtu që këto parime u bënë fuqi dominuese mbi cytjet e natyrës njerëzore dhe dirigjojnë me drejtimet e saj.

Ndoshta shpalljet hyjnore kanë folur për shoqërinë dhe gjendjen e saj, pushtetin dhe llojet e tij, dhe ofruan barna për sëmundjet të cilat i goditin këto rrafshe.

Mirëpo, edhe përskaj kësaj, fetë nuk kanë dalë nga natyra e tyre në trajtimin e shpirtit të shëndoshë si program i avancuar i çdo reforme, ndërsa karakterin e fortë si garanci e amshueshme të çdo civilizimi.

Kjo nuk është degradim e as hedhje e veprimtarisë së veprimtarëve për ngritjen e shoqërisë dhe shtetit, por është lartësim i vlerës së reformës shpirtërore në mbrojtjen e jetës dhe lumturinë e njerëzve.

Shpirti i hutuar shkakton çrregullime në sistemet më të përsosura dhe mund të depërtojë përmes tij në lakmitë e ulëta të shpirtit, ndërkaq shpirti fisnik i konsolidon plasaritjet në situa-

tat e hutuara dhe e ndriçon fisnikërinë e tij nga brenda, kështu e rregullon sjelljen dhe marshimin në mes shtrëngatave dhe stuhive.

Gjykatësi objektiv me drejtësinë e tij e plotëson boshllëkun e ligjit me të cilin gjykon, ndërkaq gjykatësi tiran mund t'i keqpërdorë ligjet e drejta. Kështu është edhe me shpirtin e njeriut kur ballafaqohet me rrymat, idetë, dëshirat dhe interesat që ekzistojnë në botë.

Konsolidimi shpirtëror është shtylla e parë për dominimin e së mirës në këtë jetë.

Nëse nuk konsolidohen shpirtrat, errësohen horizontet dhe trazirat e zotërojnë të tashmen dhe ardhmërinë e njerëzve. Për këtë Allahu i Madhërishëm thotë: ***“... Allahu nuk e prish gjendjen e një populli (nuk ua largon të mirat), derisa ata ta ndryshojnë veten e tyre. Po, kur Allahu vendos ta ndëshkojë një popull, atë nuk ka kush që ta zmbropsë. Ata (njerëzit) nuk kanë mbrojtës tjetër pos Tij.”*** (Er-Rra’d: 11) Po ashtu, duke e arsyetuar shkatërrimin e popujve të prishur, thotë: ***“Edhe idhujtarët, siç e kishin traditë populli i faraonit, e edhe ata që ishin para tyre, i mohuan argumentet e Allahut, e për shkak të mëkateve Allahu i shkatërroi. Allahu është i plotfuqishëm, ndëshkues i ashpër. Këtë (masë ndëshkuese) e bëri ngase Allahu nuk ishte ndryshues i një begatie, të cilën ia ka dhuruar një populli, derisa të ndryshojë ai vetë në vetvete (të bëhet përbuzës i së mirës) dhe ngase Allahu dëgjon (çka thonë) dhe di (çka punojnë).”*** (El-Enfal: 52-53)

Islami, në shërimin e tij të shpirtit, duke tentuar ta konsolidojë atë, shikon nga dy rrafshe:

a. se në të ekziston natyra e së mirës, e cila anon kah e mira dhe gëzohet me arritjen e saj, ndërkaq shmanget nga e keqja dhe zemërohet nga kryerja e saj; në të vërtetë e sheh zgjatjen e ekzistencës dhe vlefshmërinë e jetës së vet;

b. se në shpirt, përsëri kësaj, ekzistojnë pasione të tërbuara, që e largojnë shpirtin nga rruga e drejtë, ia zbkurojnë vepërën që atij i sjell dëm dhe e shpjen atë në një greminë të pafund.

Neve nuk na intereson t'i gjurmojmë rrënjët e këtyre pasioneve destruktive nga aspekti historik, që ta dimë se a thua

ato rastësisht e përshkajnë natyrën e njeriut apo janë të krijuara me të, por ajo që na intereson është se që të dyja gjenden te njeriu, garojnë mes vete në marrjen e komandës mbi të, ndërkaq ardhmënia e tij është e varur nga rrafshi të cilit ai do t'i nënshtrohet. Allahu i Madhërishëm thotë: ***“Pasha njeriun dhe Atë që e krijoi atë! Dhe ia mësoi se cilat janë të këqijat dhe të mirat e tij. Pra, ka shpëtuar ai që e pastroi vetveten. E ka dështuar ai që e poshtëroi vetveten.”*** (Esh-Shems: 7-10)

Puna e Islamit është që njeriut t'i ofrojë përkrahje të plotë, me qëllim që ta ndihmojë natyrën e tij dhe t'i shpërndajë rrezet e saj e të ecë në rrugën e saj. Po ashtu, t'i shporrë cytjet e mëkatit të cilat e sulmojnë atë dhe tentojnë ta mposhtin.

Islami e cilësoi veten se është fe e natyrës së pastër nga këto njolla të tëra. Allahu i Madhërishëm në librin e Tij thotë: ***“Përqendro në vetveten tënde sinqerisht në fenë, i larguar prej çdo të kote, (e ajo fe), feja e Allahut në të cilën i krijoi njerëzit, s'ka ndryshim (mos ndryshoni) të asaj natyrshmërie të krijuar nga Allahu, ajo është feja e drejtë, por shumica e njerëzve nuk e dinë.”*** (Er-Rum: 30)

Funksioni i syrit është të shikojë, derisa nuk verbohët; funksioni i veshit është të dëgjojë, derisa nuk shurdhohët; ndërkaq funksioni i natyrës është të përqendrohet në të vërtetën dhe të lëshohet në të, ashtu siç lëshohet uji kur derdhet, e kjo ndodh derisa nuk e godet njollosja, ta kthejë dhe zmbrapsë nga orientimi i saj i parë në përsosmëri, mirësi dhe prestigj.

Këto elemente destruktive për natyrën e pastër njerëzore ndodh që të formohen nga mbeturinat e shekujve të kaluar ose nga traditat e shoqërive të rrënuara, apo nga të dyjat. Këto janë mjaft të rrezikshme për sëmundjet që ia sjellin natyrës njerëzore, andaj përpjekja reale e reformatorëve është e drejtuar në luftimin dhe mposhtjen e tyre, si dhe shpëtimin e natyrës nga të këqijat e saj, kështu derisa të kthehet në pastërtinë e saj esenciale dhe ta kryejë funksionin e saj real. Islami e sqaroi këtë rrugë.

Pasi të lexosh në Kur'anin Famëlartë ajetin e sipërpërmenur, se feja është natyra, e lexon ajetin: ***“(Përqendrohuni në atë fe) Të kthyer sinqerisht tek Ai, kini frikë prej Atij dhe falnie namazin e mos u bëni nga idhujtarët, të cilët e për-***

**çanë fenë e tyre dhe u ndanë në grupe, ku secili grup i gëzo-
het idesë së vet.” (Er-Rum: 31-32)**

Imani (besimi), e jo ateizmi, devotshmëria e jo plangprishë-
sia, bashkimi i fetarëve të Zotit e jo shkapërderdhja e tyre tek
Ai, janë kreu i kthimit të njeriut në natyrën e tij të drejtë. Kur’-
ani e ka përsëritur këtë kuptim në ajetin: **“Vërtet, Ne e kriju-
am njeriun në formën më të bukur. Pastaj e zbritëm atë në
më të ultin e të ultëve. Përveç atyre që besuan dhe bënë
vepra të mira; ata kanë shpërblim të pandërprerë.” (Et-Tin
4-6)**

Ky krijim i bukur, është njohja e së vërtetës, përqendrimi
në të dhe ndjekja e saj, mahnitje me vlera dhe prestigj, si dhe
kultivimin e tyre në sjelljen e njeriut ndaj vetvetes dhe ndaj
njerëzve. Po ashtu, ky është kërkim i përsosmërisë në harmo-
ninë e tij të lartë dhe dominimi i tij mbi çdo gjë në jetë.

Megjithatë, përsëri shumë njerëz i ngarkojnë pasionet e
tyre nën këtë pedestal të lartë; kështu ata hidhen në tokë,
pastaj i devijojnë epsheet e tyre dhe me këtë futen në një gre-
minë të thellë, e kjo është më e ulëta e të ultve në të cilën i
zbrat Allah.

Kjo zbritje hyjnore i është e nënshtruar ligjeve të udhëzi-
mit dhe devijimit, të cilat janë ligje të drejta precize, e që i
përmend Kur’ani: **“Allahu nuk e humb një popull pasi që ta
ketë udhëzuar atë para se t’u sqarohet atyre se prej çka du-
het ruajtur. Allahu është i Gjithëdijshëm për secilin send.”**
(Et-Teube: 115)

**“Unë do t’i zmbrajs nga argumentet e Mia ata të cilët
pa pasur të drejtë bëjnë kryelartësi në tokë, të cilët, edhe
nëse shohin çdo argument, nuk besojnë, dhe nëse shohin
udhën e shpëtimit, nuk e marrin atë rrugë, nëse e shohin rru-
gën e gabuar atë e marrin rrugë. Këtë (këtë verbërim të
tyre), ngase ata i konsideruan të rreme faktet Tona dhe
ngase i lanë pas dore ato.” (El-A’raf: 146)**

E cili është ai që mbetet në formën e tij të bukur dhe shpë-
ton nga ngulfatja në botën e ulët? Përgjigja e kësaj gjendet në
ajetin: **“Përveç atyre të cilët besuan dhe bënë vepra të
mira...” (Et-Tin: 6)**

E kuptove pra, se karakteri i vyeshëm është fryti i afërt i besimit të qartë dhe veprës së mirë.

Ky ishte qëndrimi i Islamit ndaj natyrës së mirë të njeriut dhe metodologjia e tij në ndihmimin e saj.

Ndërkaq puna e tij, me tiparet e tjera destruktive të njeriut, është që t'i vetëdijësojë njerëzit për ato, t'i disiplinojë dhe ta nënshtrojë njeriun prirjes së mendjes së shëndoshë dhe logjikës së natyrës së mirë.

Në disa prej këtyre tipareve Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] tregoi me fjalët e veta:

“Njeriu plakët, e me të edhe dy veti: lakmia dhe shpresa e gjatë.” /Transmeton Muslimi/

“Gjëja më e keqe te njeriu është frika trishtuese dhe lakmia tërbuese.” /Transmeton Ebu Davudi/

“Sikur t'i jepej njeriut një kodër me ar, do ta donte të dytën; sikur t'i jepej e dyta, do ta donte të tretën, por barkun e njeriut e mbush vetëm toka, e Allahu ia fal atij që pendohet.” /Transmeton Buhariu/

Në disa prej këtyre vetive tregoi Kur'ani Famëlartë në ajetin: ***“Njerëzve u është zbukuruar dashuria ndaj të këndshmeve, ndaj grave, ndaj djemve e ndaj pasurisë së grumbulluar nga ari e argjendi, ndaj kuajve të stolisur, bagëtisë e bujqësisë. Këto janë kënaqësi të kësaj bote, po tek Allahu është e ardhmja më e mirë.”*** (Ali Imran: 14)

Gjëja e parë për të cilën Islami ia tërheq vërejtjen njeriut është se pasimi i epshit dhe dalldisja pas cytjeve të tij, të cilat nuk kanë të sosur, nuk do ta ngopë shpirtin dhe nuk do ta kënaqë të vërtetën.

Ashtu është shpirti: sa e ambienton një vend për epshet e tij, dëshiron të transferohet prej tij në një vend tjetër. Ai, në përjetimet e tij të përhershme, nuk brengoset për kryerjen e mëkateve dhe për bërjen e padrejtësive. Për këtë, Kur'ani na tërhoqi vërejtjen për pasimin e këtyre pasioneve të ndaluara: ***“... e mos shko pas dëshirave, se ato të shmangin prej rrugës së Allahut. Ata që largohen prej rrugës së Allahut i pret dënim i rëndë për shkak se e harruan ditën e përgjegjësisë.”*** (Sad: 26)

Lidhur me rrugët e mosbesimtarëve dhe domosdoshmërisë së kundërshtimit të tyre thotë: ***“E sikur të përputhej e vërteta me dëshirat e tyre, do të shkatërroheshin qiejt e toka dhe çdo gjë që gjendet në to. E megjithatë që Ne atyre u sollëm (me këtë Kur'an) famën e tyre, ata u zmbarsën ndaj përkujtimit të vet.”*** (El-Mu'minun: 71)

Mirëpo është e domosdoshme të bëjmë dallim mes dëshirave të ndaluara të shpirtit dhe kërkesave të tij të logjikshme e të miratuara, sepse shumë njerëz të devotshëm këto dy gjëra i përziejnë shumë keq.

Ngase, nëse njeriu ka kërkesa për të mirat e kësaj bote, dhe lukset e saj që nuk janë të ndaluara, kuptohen gabimisht, se kinse janë prej mbrapshtive të ndaluara, rezultati do të jetë që t'u qaset këtyre kërkesave të imponuara me vetëdijen e atij i cili i lejon krimet dhe kënaqet t'u afrohet atyre, ndërkaq vetëdija e tij në fakt është sakrificë e një gabimi trashanik.

Mirëpo, pasi e kupton se ka gabuar dhe se e keqja është një pjesë e jetës së tij, do të transferohet në kryerjen e kundërvajtjeve edhe më të rënda, gjegjësisht kësaj radhe do të bëjë kundërvajtje reale.

Kur'ani Famëllartë i ka kushtuar kujdes këtij rrafshi, andaj qartë e ka potencuar lejimin e dëshirave të shëndosha të shpirtit; i la atij mundësi të përjetimit të këndshëm, dhe e konsideroi ndërhyrjen me ndalim apo privim për shpirtin, në këtë domen fisnik, shoqëruar të veprës së keqe dhe të mbrapshtë! Sepse kjo çon në veprat e këqija dhe të liga. Allahu i Madhërishëm thotë: ***“O ju njerëz, hani nga ajo që është në tokë e që është e lejuar dhe e mirë, e mos shkoni hapave të djallit se ai është armik i hapët i juaji. Ai ju urdhëron vetëm me të këqija e turpësi dhe ju shtyn të thoni për Allahun atë që nuk e dini.”*** (El-Bekare: 168-169)

Po, gjithsesi, ndalimi i së lejuarës së këndshme është thënie për Allahun pa dituri; ky është vëllai i së ligës dhe turpësisë të cilat urdhëron shejtani.

Islami nuk dëshiron që të shuhen instinktet me ndërprerje të ashpër, dhe të nivelizohen me harxhim maksimal, por ai për këtë miratoi metodologji mesatare ndëmjete dy ekstremizmave.

Ashtu siç janë parimet e natyrës së dalluar në besim dhe konsolidim, e jo në ateizëm dhe anarki, po ashtu edhe parimet e këtyre instinkteve janë të luhatshme.

Në të dy rastet thurra nuk do të jetë e fortë, përveç se në moralin stabil.

Kur'ani, kur e përshkruan njeriun me dobësi, luhatje dhe egoizëm, përmend se pastrimi nga këto ligësi përmes fesë dhe porosive të saj mjafton: *“Është e vërtetë se njeriu është i prirur të jetë i padurueshëm. Pse kur e godet ndonjë e keqe, ai ankohet së tepërmi. Ndërkaq, kur e gjen e mira, ai bëhet tepër koprac. Përveç atyre që falen, të cilët janë të rregullt në faljen e namazit të tyre. Dhe ata që në pasurinë e vet kanë ndarë një pjesë të caktuar. Për lypësin dhe për nevojtarin që nuk lyp. Edhe ata që e besojnë bindshëm Ditën e Gjykimit. Edhe ata që i frikësohen dënimit nga Zoti i tyre. Sepse është e vërtetë se nuk ka shpëtim prej dënimit të Zotit të tyre. Edhe ata që janë ruajtur prej punëve të ndyra (amorale). ”* (El-Mearixh: 19-29)

Dihet se morali nuk formohet te njeriu befas dhe nuk lind i fortë e i kompletuar, por formohet me kalimin e kohës dhe kompletohet në disa periudha. Ky është sekreti i lidhjes së tij me veprime të vazhdueshme dhe rituale të cilat kanë karakter konjektiv, si; namazi, zekati, besimi i Ditës së Llogarisë, frika nga dënimi i Allahut etj.

Nëse vëset e liga çdo herë tentojnë kah njeriu dhe përpiqen t'i devijojnë sjelljet e tij kohë pas kohe, për ta nuk mjafton bari i përkohshëm.

Ato mund t'i shuajë një faktor i cili jo më i dobët se ato dhe do ta kthejë shpejt baraspeshën kur ajo të çrregullohet.

Si përfundim del se Islami e nderon natyrën e pastër, mësimet e tij i sheh si mbrojtje të saj, na tërheq vëmendjen nga epshet e përdhosura dhe vë barriera para tyre. Ritualet, të cilat i bëri obligative, janë ndihmim i natyrës dhe mposhtje e epshit, por këto rituale nuk do të kompletohen dhe nuk do ta kryejnë rolin e vet, vetëm nëse të gjitha janë bartëse të formimit të karakterit të lartë dhe rrugës së drejtë.

NDËSHKIMET PËR KRIMET ETIKE

Imponimi i së mirës nuk e bën njeriun të vyeshëm, ashtu siç nuk e bën njeriun besimtar imponimi i besimit, andaj liria shpirtërore dhe mendore është bazë e përgjegjësisë. Ndërkaq, Islami e çmon këtë të vërtetë dhe e respekton duke e ndërtuar pirgun e moralit.

Pse të përdorë imponim në të kuptuarit e njeriut, domethënien e të mirës apo orientimin e sjelljes së tij në të mirë, kur ai ka konsideratë ndaj natyrës njerëzore dhe supozon se, eliminimi i barrierave para tij mjafton për formimin e një brezi të vyeshëm?

Natyra e njeriut është e mirë, por kjo nuk do të thotë se ai është engjëll që di të bëjë vetëm mirë. Kjo do të thotë se e mira përputhet me natyrën e tij esenciale dhe se ai e do më tepër përqafimin dhe veprimin e saj, ashtu siç e do më tepër shpendi fluturimin, kur lirohet nga prangat dhe barrat.

Puna e shëndoshë, sipas Islamit, është që së pari të flaken prangat dhe të eliminohen barrat, e kur njeriu të lëshohet pastaj në tokë dhe nuk mund të ngrihet, atë e konsideron të sëmurë dhe ia mundëson medikamentet shëruese.

Islami nuk do të marrë vendim të izolimit të këtij njeriu nga shoqëria, por këtë e bën vetëm atëherë kur ekzistimi i tij do të jetë nxitës i së keqes ndaj të tjerëve.

Në korniza të kësaj fushe Islami i lufton krimet etike; ai së pari kushtëzon që njeriu duhet të jetojë në mënyrë të ndershme dhe të jetojë me frytet e punës dhe mundit të tij personal, gjegjësisht, ai nuk e ndërton ekzistencën e vet në vjedhje.

Çka e shtyn atë të vjedhë? Nevoja për të ngritur konakun? Le t'i ofrohen atij prej gjërave të domosdoshme jetësore dhe lukseve, ashtu që të mos ketë nevojë për vjedhje.

Kjo është obligim për shoqërinë, e nëse ajo nuk e kryen këtë detyrë si duhet dhe e detyron ndonjë njeri të vjedhë, mëkati i këtij krimi bie mbi shoqërinë e pakujdesshme e jo mbi individin e humbur.

Nëse individit i sigurohen gjërat e domosdoshme jetësore, e ai përsëri e zgjat dorën e vet (vjedh), para se t'i shqiptohet atij dënimi duhet të studiohet mirë gjendja e tij; ndoshta ka ndonjë shkëndijë shprese se tek ai gjendet ndonjë damar i cili rreh për mirësi. Mosnxitimi në shqiptimin e dënimit është kërkesë fetare, deri në atë masë saqë Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] thotë: *“Për gjykatësin më mirë është të gabojë në falje, se sa të gabojë në ndëshkim.”*

Nëse pas gjurmimit të personalitetit dhe rrethanave të tij shihet qartë se natyra e tij e pastër është ndotur, e ai është bërë burim i armiqësisë për mjedisin i cili e mbikëqyri dhe e strehoi, dhe se butësinë e kujdesin ua ka kthyer me turbullimin e asaj kthjelltësie dhe trazimin e sigurisë. Atëherë ky mjedis nuk qortohet nëse mbrohet nga armiqësia e ndonjërit prej pjesëtarëve të vet dhe ia thyen armët me të cilat ai i dëmton të tjerët.

Vjedhjen, e cila meriton prerjen e dorës, Kur’ani e cilëson si dhunë dhe çrregullim dhe për vjedhësin e ndëshkuar thotë: ***“E kush pendohet pas punës së keqe (vjedhjes) dhe përmirësohet, s’ka dyshim, Allahu ia pranon atij pendimin, Allahu është që fal shumë, është Mëshirues.”*** (El-Maide: 39)

Masa ndëshkuese, të cilën e përcaktoi Islami, është mbrojtje e shoqërisë së shëndoshë e të konsoliduar nga orekset e përdhosura të ndonjë anëtari të saj, i cili drejtësinë do t’ua kthejë me dhunë dhe konsolidimin me çrregullim.

Këtë shembull e përmendim që ta sqarojmë sepse, normat ndëshkuese për krimet etike nuk janë përcaktuar për ta imponuar të vyeshten dhe të detyrohen njerëzit që përmes dhunës t’i ndjekin rrugët e mira.

Rruga më e përshtatshme për Islamin është komunikimi me zemrën e njeriut, ngritja e aspiratave të tij të fshehta drejt ekselencës dhe përsosmërisë, dhe kthimin e tij tek Allahu, Krijuesi i tij më i madh, me metodë adekuate të bindjes, dashurisë dhe lidhjes së tij për vlerat e larta me bindje se ato janë fryt natyror i tërë kësaj.

Patjetër duhet të dirigjohen rrethanat e mjedisit të cilat e rrethojnë njeriun, ashtu që të ndihmohet ai në formimin e plotë të prirjeve dhe tipareve të vyeshme.

Nuk është dëm nëse i hedhim parazitët prej të cilëve nuk ka dobi, pasi ne në arat tona ua mundësojmë zhvillimin kulturave kryesore duke shkukur shumë kullosa dhe barishte të panevojshme.

Mbrojtja e interesit të përgjithshëm të njerëzimit nuk është hiç më pak e rrezikshme se kjo, andaj, nuk ka kuptim mohimi i normave ndëshkuese që i miratoi Islami, e me to parapriu Teurati, dhe të u konsideruan ligje të shpalljeve qiellore në përgjithësi.

Islami ia ngarkon mjedisit një pjesë të madhe të përgjegjësisë së udhëzimit në të mirë apo në të keqe, si dhe përhapjes së veseve të këqija apo vlerave të vyeshme.

Orientimi i tij në marrjen e frenave të pushtetit, duke i pasur parasysh shkaqet e tërë kësaj, ka të bëjë me dëshirën për formimin e shoqërisë, në atë mënyrë që të ndihmojë në mbrojtjen e nderit dhe dinjitetit.

Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] e ka transmetuar rrëfimin e vrasësit i cili kërkonte pendim për krimet e bëra, që pyeti për njeriun më të mençur në botë dhe i treguan një dijetar. Ai i tha atij se ka vrarë njëqind njerëz, andaj, a ka pendim për të? Dijetari tha: *“Po, çka mund të të pengojë ty nga pendimi? Shko në filan vend, sepse atje ka njerëz të cilët e adhurojnë Allahun, e ti bashkangjitju atyre në adhurim, dhe mos u kthe në vendin tënd, se ai është vend i keq.”* /Transmeton Buhariu/

Në një transmetim tjetër qëndron se ai ka shkuar te një dijetar dhe e ka pyetur: *“A ka për mua pendim?”* Ai i ka thënë: *“Nuk e di, e ke tepruar, por këtu afër ka dy fshatra, njëri fshat quhet Nasre, ndërkaq tjetri Kefre. Banorët e Nasres veprojnë sikur Xhenetlinjtë, në të nuk mund të qëndrojnë tjetërkush përveç tyre, ndërkaq banorët e Kefres veprojnë sikur Xhehenemlinjtë, në të nuk mund të qëndrojnë tjetërkush përveç tyre, e ti shko te banorët e Nasres, e nëse qëndron në të dhe punon sikur edhe popullata e atjeshme, atëherë nuk ka dyshim se pendimi yt është pranuar.”* /Transmeton Taberaniu/

Prej këtu edhe Islami e trajton kujdesin ndaj mjedisit dhe rëndësinë e gjurmëve të tij në formimin e karakterit, faktor i cili i bashkohet asaj që miratua më parë për mbrojtjen e natyrës së pastër dhe për kalitjen e epsheve të përdhosura.

Mendojmë se kujdesi ndaj gjithë këtyre aspekteve është garanci për formimin e një shoqërie të pastër, e cila do të jetë e pajisur me tiparet më të çiltra dhe me sjelljet më stabile.

RRAFSHI I MORALIT I PËRFSHIN TË GJITHA

Çdo religjion i ka ritet e tij të veçanta të cilat konsiderohen karakteristika të tij dalluese.

Nuk ka dyshim se në Islam ka rite të caktuara fetare, me të cilat janë të obliguar ithtarët e tij, dhe këto në mes tyre konsiderohen çështje të miratuara me të cilat nuk kanë lidhje të therët.

Mirëpo, instruksionet etike nuk janë të këtij lloji, sepse muslimani është i obliguar të jetë i vyeshëm ndaj gjithë njerëzve dhe në këtë të mos ketë asnjëfarë dileme. Kështu, muslimani është i obliguar të jetë korrekt edhe me muslimanin edhe me jomuslimanin, po ashtu edhe fleksibil, besnik, i njerëzishëm, bashkëpunues dhe i ndershëm.

Kur'ani i Ndershëm na urdhëron që të mos lëshohemi me çifutët dhe krishterët në debate të cilat ngjallin armiqësi dhe nuk u sjellin asnjë të mirë feve. Allahu i Madhërishëm thotë: ***“Ithtarët e librit mos i polemizoni ndryshe (kur i thirrni në fenë tuaj), vetëm ashtu si është më së miri, përveç atyre që janë mizorë dhe thuajuni: Ne i besuam asaj që na u zbrit neve dhe që u zbriti juve dhe se Zoti ynë dhe Zoti juaj është një, dhe se ne i jemi dorëzuar Atij.”*** (El-Ankebut: 46)

Po ashtu, ua zuri për të madhe ithtarëve të Musait [alejhis-selam] dhe Isait [alejhis-selam] pse u ngatërruan me muslimanët në këso polemikash të ashpra: ***“Thuaj:”A doni të grindeni me ne për Allahun, e Ai është Zoti ynë dhe Zoti juaj dhe ne kemi veprat (shpërblimin e veprave) tona, e ju keni veprat tuaja. Por ne jemi (besimtarë) të sinqertë ndaj Tij.”*** (El-Bekare: 139)

Njëherë, Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] i kishte borxh një çifuti, e ky erdhi t'ia kërkojë borxhin dhe i tha: *“Ju o bijtë e AbdulMutalibit, jeni njerëz që i zvarritni punët!!”* Omeri [radijAllahu anhu] menjëherë e nxori shpatën dhe deshi ta vrasë, sepse e pa të arsyeshme të edukohet ky njeri që ishte i pasjellshëm ndaj Pejgamberit [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem]. Mirëpo, Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] e heshti Omerin [radijAllahu anhu] duke i thënë: *“Unë dhe ky meritojmë që t'i të na drejtohesh më ndryshe: ta urdhërosh këtë që ta lypë borxhin në mënyrë të njerëzishme, ndërsa që të më këshillosh mua që t'ia kthej në mënyrë të denjë.”*

Islami ka urdhëruar për drejtësi, madje edhe me një njeri të prishur apo jobesimtar.

Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] thotë: *“Lutja e atij që i është bërë e padrejtë pranohet, edhe po të jetë i dëmtuari i prishur; ngase ajo (prishja) do ta dëmtojë vetë atë.”* /Transmeton Ahmedi/ dhe *“Para lutjes së atij që i është bërë e padrejtë, edhe po të jetë jobesimtar, nuk ka perde. Lëre atë në të cilën je i dyshimtë, dhe kapu për atë në të cilën nuk ke dyshim.”* /Transmeton Ahmedi/

Me këto imperative të qarta, Islami i ndaloi bijtë e vet që t'u sjellin çfarëdo të keqe pjesëtarëve të feve të tjera.

Prej dëshmive të sjelljes së mirë me pjesëtarët e feve të tjera, është edhe transmetimi i përcjellë prej Ibën Omerit [radijAllahu anhu], se atij iu pre një dele në familje dhe kur erdhi tha: *“A i dhuruat fqinjit tonë çifut? A i dhuruat fqinjit tonë çifut? E kam dëgjuar Pejgamberin [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] duke thënë: “Xhibrili vazhdimisht më porosiste për fqinj, saqë mendova se do t'i jap hise në trashëgimi.”* /Transmeton Buhariu/

Po ashtu, Islami urdhëron që të respektohet farefisi, edhe pse ata mund të jenë jashtë fesë të cilën e përfaqon njeriu, ngase përqendrimi i njeriut në të vërtetën nuk nënkupton braktisjen e familjes: *“... po në çështjet e jetës së kësaj bote, të kesh mirëkuptim ndaj tyre, e ti ndiqe rrugën e atij që është i kthyer kah Unë, mandej kthimi juaj është tek Unë, e Unë do t'ju njoftojë për atë që keni punuar.”* (Lukman: 15)

Kjo ka të bëjë me aspektin personal, ndërkaq në aspektin e përgjithshëm Islami konfirmon se ekzistimi i popujve, lulëzimi i civilizimit të tyre dhe vazhdimësia e mbrojtjes së tij sigurohet nëse garantohet jeta morale në to, e nëse rrënohet morali, rrënohet edhe shteti bashkë me të.

Popujt mund të ekzistojnë derisa kanë moral.

E nëse humbet morali i tyre, humben edhe ata.

Këtë të vërtetë e konfirmojnë edhe fjalët e Pejgamberit [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] drejtuar popullit dhe fisit të tij, të cilët pozita e tyre në Gadishullin Arabik i avanconte në dominimin në të dhe marrjen e pushtetit mbi të. Mirëpo Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] ua bëri të qartë se mbretëria e tyre nuk mund të ekzistojë ndryshe, vetëm se me moral.

Transmetohet prej Enesit, i cili thotë: *“Ishim në një shtëpi ku kishte disa muhaxhirë (mekas të shpërngulur) dhe ensarë (medinas), kur ia behu Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] dhe çdonjëri prej nesh filloi t’i bëjë vend me shpresë se do të ulet pranë tij. Pastaj u ngrit te dera, u kap për të dy skajet e saj dhe tha: “Udhëheqësit janë prej Kurejshëve, juve u është dhënë një obligim i madh; ata e meritojnë këtë nëse i bëjnë tri gjëra: kur t’u kërkohet mëshirë, të jenë të mëshirshëm; kur të gjykojnë, të jenë të drejtë; e kur të japin premtim, ta plotësojnë atë. E kush nuk i bën këto, mbi të është mallkimi i Allahut, i melekëve dhe njerëzve në përgjithësi.”* /Transmeton Taberaniu/

Ky hadith është decid se një popull, shtet dhe familje do të ketë aq pozitë, sa përfaqëson në botë vlera të larta dhe sa qëllime fisnike ka realizuar.

Nëse një qeveri bart vulën e Islamit dhe Kur’anit, mirëpo nuk është e drejtë në asnjë çështje, nuk është e mëshirshme në asnjë nevojë dhe nuk plotëson asnjë premtim, ajo në emër të Islamit dhe Kur’anit është zhveshur nga vlerat e tij të larta dhe e ka merituar të mallkohet në thellësitë e tokës dhe horizontet e qiellit.

Transmetohet prej El-Hasenit, i cili thotë: “Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] ka thënë: *“Kur ia do Allahu të mirën një populli, udhëheqësinë e tij ua jep të urtëve, e pasu-*

rinë njerëzve bujar; por kur ia do Allahu një populli të keqen, udhëheqësinë e tij ua jep mendjelehtëve, e pasurinë koprracëve.” /Transmeton Ebu Davudi/

Ibën Tejmije thotë: “Allahu e mban një shtet të drejtë, edhe po të jetë jobesimtar, e nuk e mban një shtet tiran, edhe po të jetë musliman.”

Morali, në burimet parësore të Islamit, Kur'an dhe Sunet, është e tërë feja, e po ashtu edhe e tërë bota. Nëse një popull ka hise të mangët në lartësinë e lidhjes së tij me Allahun, apo në pozitën e tij në mes njerëzve, kjo është në sajë të mungesës së vlerave të tij dhe rënies së moralit.

KORREKTËSIA

Allahu i Madhërishëm i ka krijuar qiejt dhe tokën me drejtësi, e po ashtu kërkoi prej njerëzve që ta ndërtojnë jetën e tyre mbi drejtësi, ashtu që të flasin vetëm drejtë dhe të punojnë vetëm drejtë.

Shqetësimi dhe dëshpërimi i njerëzve është rezultat i mospërfilljes së tyre të këtij fundamenti të qartë, si dhe i dominimit të gënjeshtreve dhe paragjytimeve mbi shpirtat dhe idetë e tyre, të cilat i larguan nga rruga e drejtë dhe i rrëmbyen nga të vërtetat të cilat patjetër duhet të ndiqen.

Korrektësia në çdo çështje, problematikë dhe gjykim, është shtyllë e fortë në karakterin e muslimanit dhe ngjyrë konstante në sjelljet e tij. Po ashtu, ndërtimi i shoqërisë në Islam ngritet mbi luftimin e paragjytimeve, flakjen e dezinformatave dhe braktisjen e dyshimit. Vetëm të vërtetat e qëndrueshme janë ato që duhet të jenë transparente, dominuese dhe mbështetje në konfirmimin e relacioneve të ndryshme.

Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] thotë: *“Ruajuni paragjykimit, se paragjykimi është gënjeshtër më e madhe.”* /Transmeton Buhariu/, dhe *“Lëre atë që të vë në dyshim dhe kapu për atë që nuk ke dyshim; korrektësia është qetësim, kurse gënjeshtër dyshim.”* /Transmeton Tirmidhiu/

Kur’ani ua zuri për të madhe disa popujve që i pasuan paragjykimet, të cilat i mbushën mendjet e tyre me gënjeshtër, e me këtë ua shkatërruan të tashmen dhe të ardhshmen me trillime, dhe thotë: ***“... Po ata (idhujtarët), nuk ndjekin tjetër vetëm se paragjytime dhe çka duan vetë, megjithatë prej Zotit të tyre u pat ardhur udhëzimi.”*** (En-Nexhm: 23); ***“Ata nuk dinë asgjë për atë (emërtim), ata nuk ndjekin tjetër***

vetëm paragjykime, e paragjykimi nuk është asgjë ndaj së vërtetës.” (En-Nexhm: 28)

Islami, nisur nga respekti i tij i lartë ndaj të vërtetës, i braktisi gënjeshtarët dhe qe shumë injorues ndaj tyre.

Transmetohet prej Aishes [radijAllahu anha], nënës së besimtarëve, e cila thotë: *“Asnjë veti nuk ka qenë më e urrejtur për Pejgamberin [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem], sesa gënjeshtria; sa e merrte vesh se dikush posedon diç prej saj, e nxirrte prej zemre, derisa e merrte vesh se ishte penduar.”* /Transmeton Ahmedi/

Në një transmetim tjetër qëndron: *“Asnjë veti nuk ka qenë e urrejtur për Pejgamberin [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem], sikur rrena. Njeriu rrente tek ai ndonjë gënjeshtër, e kjo mbetej në shpirtin e tij, derisa ta merrte vesh se është penduar nga ajo.”* /Transmeton Ibën Hibbani/

Nuk ka çudi në këtë, pasi që gjenerata e parë bashkoheshin në këto vlera të larta dhe njiheshin me to; nëse dikush fillonte të sillej keq dhe tentonte të ndahet me ndonjë rrugë të gabuar me veprën e tij, dukej si zhugani në mes të shëndoshëve, e ai nuk gjente vend në mes tyre derisa nuk shërohej nga sëmundja.

Shenjat e para të shoqërisë muslimane kanë qenë: korrektesia e fjalëve, preciziteti i shprehjes dhe verifikimi i bisedës.

Ndërkaq, gënjeshtria dhe trillimi, pështjellimi dhe shpifja janë simptoma të hipokrizisë dhe ndërprerje e lidhjes me fenë, apo janë lidhje me fenë në mënyrën e pështjelluesve dhe shpifësve! Gjegjësisht, në stilin e gënjeshtarëve në kundërshtimin e realitetit.

Gënjeshtria është fëlliqësi e ekskluzive që sinjalizon për depërtimin e ligësisë në shpirtin e bartësit të saj dhe për karakterin i cili menjëherë e pjell të keqen dhe shpie në mëkat pa nevojë shqetësuese apo natyrë imponuese.

Ka disa ligësi që e njollosin njeriun, të cilat u përngjajnë sëmundjeve që e godasin trupin dhe nuk mund të shërohet ai prej tyre vetëm se pas një terapie të gjatë, si frika e cila i zvarrit të frikësuarit apo lakmia e cila i shtrëngon duart.

Disa njerëzve, kur përgatiten për xhihadin e obliguar, u rrënoqethet lëkura e po ashtu disa të tjerë, kur e nxjerrin zeka-

tin e detyruar e numërojnë, ndërkaq gishtat e tyre dridhen; këto karaktere, që ndikohen nga frika dhe koprracia, nuk janë ato karaktere të cilat marshojnë drejt vdekjes me hov dhe e shpërndajnë pasurinë pa llogari.

Ndoshta ata të cilët i ndjejnë cytjet e frikës dhe lakmisë kanë arsye kur qëndrojnë në fushën e sakrifikimit!! Mirëpo, assesi nuk kanë arsye ata të cilët e marrin rrenën tipar të vetin dhe jetojnë me të në mashtrimin e njerëzve. Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] thotë: *“Njeriu është prirur për të gjitha tiparet, përveç tradhtisë dhe gënjeshtërsë.”* /Transmeton Ahmedi/ Po ashtu, Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] është pyetur: *“A mund të jetë besimtari frikacak?”* Tha: *“Po!”* I thanë: *“A mund të jetë besimtari koprrac?”* Tha: *“Po!”* I thanë: *“A mund të jetë besimtari gënjeshtar?”* Tha: *“Jo!”* /Transmeton Maliku/

Këto përgjigje tregojnë për atë që e sqaruam më parë për tendencat e dobësisë dhe vlerës së ulët, të cilat i mashtrojnë disa njerëz e pastaj dominojnë mbi ta për çdo gjë, kur këta ballafaqohen me një obligim të përkryer apo tatim definitiv. Kjo assesi nuk do të thotë legjitimim i koprracisë apo lehtësim i frikës; si të mendohet kjo, kur ndalimi i zekatit dhe lënia e xhiha-dit janë dyer për në kufër (mosbesim)?

Sa më tepër që zgjerohet rrethi i dëmit pas gënjeshtërsë së një rrenacaku të vrazhdë, mëkati tek Allahu është më i madh. Kështu, gazetari i cili ua shpërndan mijëra njerëzve një lajm të rrejshëm, politikani i cili u paraqet njerëzve një pasqyrë të shtrembëruar për çështjet madhore dhe njeriu me prapavijë, i cili me qëllim u ngjet etiketa njerëzve të mëdhenj, qofshin burra ose gra, bëjnë krime më të rënda ndaj njerëzve përkatës dhe me pasoja më të këqija.

Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] thotë: *“Natën pashë dy njerëz të cilët më erdhën dhe më thanë: “Atë që e pe duke i copëtuar buzët e veta është gënjeshtar i cili e lëshon një rrenë, që transmetohet prej tij, derisa të mbushet krejt bota; me të veprohet kështu deri në Ditën e Gjykimit...”* /Transmeton Buhariu/

Të kësaj kategorie janë gënjeshtarët e pushtetarëve ndaj popullatës, sepse gënjeshtria e folësve është e larmishme dhe e

njohur. Në hadith përmendet: *“Tre lloj njerëzish nuk do të hyjnë në Xhenet: plaku i cili bën amoralitet, udhëheqësi gënjeshtar dhe varfanjaku mendjemadh.”* /Transmeton Bezzari/

Gënjeshtria në fenë e Allahut është prej të këqijave më të shëmtuara, kurse e para prej tyre është që t'i mveshet diçka Allahut ose Pejgamberit të Tij pa e thënë. Kjo lloj shpifje, në esencë është e ligë dhe me rezultate katastrofale. Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] thotë: *“Gënjeshtria ndaj meje nuk është sikur gënjeshtria ndaj ndonjërit prej jush. Andaj, kush trillon me qëllim diçka ndaj meje, le ta përgatitë një ulëse prej zjarri.”* /Transmeton Buhariu/

Në këtë fushë hyjnë edhe gjërat e tjera të cilat i kanë shpikur injorantët dhe ia imponuan fesë së Allahut risitë që nuk kanë bazë, ndërkaq masa e gjerë i konsideroi ato se janë prej fesë, kurse ato nuk i takojnë fesë, por janë tallje dhe lojë!

Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] ia tërhoqi vërejtjen umetit të vet për burimet e këtyre risive irituese dhe që të mos i nënshtrohen rrymës së tyre, por i përqendroi fortë në ajetet e Kur'anit dhe rrugën e të parëve, dhe tha: *“Në fund të umetit tim do të ketë njerëz të djallëzuar, gënjeshtar të mëdhenj; do t'u flasin për atë që nuk e keni dëgjuar as ju e as prindërit tuaj! Ruajuni prej tyre që mos t'ju mashtrojnë dhe sprovojnë.”* /Transmeton Maliku/

Islami porositi që të mbijillet korrektësia në shpirtin e fëmijëve, ashtu që të rriten me të e ta bëjnë shprehi në të gjitha fjalët dhe gjendjet e tyre.

Transmetohet prej Abdull-llah Ibën Amirit, i cili thotë: *“Më thirri një ditë nëna ime, ndërkaq Pejgamberi ishte ulur në shtëpinë tonë, dhe më tha: “Eja të të jap diçka.”* Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] i tha: *“Çka deshe t'i japësh?”* Tha: *“Desha t'i jap hurme.”* Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] i tha: *“Sikur mos ti kishe dhënë asgjë, do të shkruhej një gënjeshtëri!”* /Transmeton Ebu Davudi/ Transmeton Ebu Hurejre prej Pejgamberit [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem], se ka thënë: *“Kush i thotë një fëmije: “eja, merre këtë e pastaj nuk ia jep, kjo është gënjeshtëri.”* /Transmeton Ahmed/

Shih pra, se si i mëson Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] prindërit që t'i edukojnë fëmijët e vet në atë mënyrë që ta

shenjtërojnë korrektësinë dhe të pastrohen nga gënjeshtria. E sikur ai t'i kishte tejkaluar këto gjëra dhe t'i kishte konsideruar prej imtësive të lehta, kanoset rreziku që fëmijët të rriten e ta konsiderojnë gënjeshtrenë mëkat të vogël, ndërkaq tek Allahu është mëkat i madh. Ai ka qenë i vendosur në kërkimin e të vërtetës dhe kultivimin e korrektësisë, saqë i ka përfshirë edhe çështjet e vogla shtëpiake.

Transmetohet prej Esma binti Jezidit, e cila ka thënë: *“O Pejgamber i Allahut, nëse ndonjëra prej nesh i thotë ndonjë sendi që e ka qejf, nuk e kam qejf, a konsiderohet kjo rrenë?”* Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] tha: *“Gënjeshtria shkruhet gënjeshtër, bile edhe gënjeshtria e vogël shkruhet gënjeshtër e vogël.”* /Transmeton Muslimi/

Ligjdhënasi i ka treguar rreziqet e gënjeshtres dhe i ka sqaruar pasojat e saj të liga, ashtu që mos t'i mbetet askujt ndonjë vrimë që të ikë nga realiteti, apo ta minimizojë miratimin e saj.

Ndoshta njeriut i duket e lehtë gënjeshtria kur bën shaka! Duke menduar kështu se në shaka nuk ka rrezik për lajmërim apo shpifje. Mirëpo, Islami, i cili e lejoji relaksim e zemrave, nuk e ka paraparë asnjë mënyrë jashtë kufijve të korrektësisë së pastër, ngase në hallall ka alternativë në vend të haramit, dhe me të vërtetën nuk ke nevojë për të pavërtetën. Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] thotë: *“Mjerë për atë i cili flet diçka që i bën për të qeshur njerëzit dhe gënjen, mjerë për atë, mjerë për atë!”* /Transmeton Tirmidhiu/ *“Unë ia garantoj një shtëpi në mes të Xhenetit atij që edhe në shaka e lë rrenën.”* /Transmeton Bejhekiu/ *“Nuk do ta ketë njeriu besimin e plotë, derisa nuk e lë rrenën në shaka dhe në zënka, edhe nëse është korrekt.”* /Transmeton Ahmedi/

Mirëpo, sot është realitet se njerëzit ia lëshojnë frenat fantazisë në shpikjen e gjërave qesharake dhe nuk e zënë për të madhe trillimin e fjalëve për armiqte apo shokët e tyre, me qëllim që të dëfrehen apo t'i nënçmojnë ata ndërkaq feja e ka ndaluar plotësisht këtë mënyrë, sepse është realitet se loja me gënjeshtria shumë herë mbaron në pikëllime dhe armiqësi.

Lavdërimi i tepërt i njerëzve është rrugë për në gënjeshtër. Muslimani duhet të ketë kujdes kur i lavdëron të tjerët, duhet ta përmendë vetëm atë mirësi që e di, e nuk duhet të jepet në

teprim duke i stërzmadhuar anët pozitive i duke fshehur anët negative. Sado që të jetë i lavdëruari meritë për këtë, teprimi në ngritjen e tij është një lloj i gënjeshtres së ndaluar. Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] u ka thënë lavdëruesve të vet: *“Mos e teproni (në lavdëratë) me mua, siç e tepruan të krishterët me birin e Merjemës! Sepse unë jam njeri; dhe thoni, rob i Allahut dhe Pejgamberi i Tij.”* /Transmeton Rezini/

Ka disa njerëz të cilët i marrin lëvdatat e zbrazëta, artikuj me të cilët i miklojnë të mëdhenjtë, dhe për ta thurin poezi të gjata e fjalime të rrjedhshme. Kështu, lavdimin e masin në mënyrë jo të drejtë dhe trumbetojnë atë që nuk e dinë, e ndoshta ua atribuojnë drejtësinë edhe prijësve tiranë dhe trimërinë të marrëve frikacakë duke dashur të arrijnë ndonjë interes të kësaj bote të dy palët.

Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] na ka porositur që t'i braktisim këta lloj servilash gënjeshtarë, derisa të kthehen nga trillimet e tyre me fytyra të cilat ua ka shëmtuar turpi dhe privimi. Transmetohet prej Ebu Hurejres, i cili thotë: *“Na ka urdhëruar Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem], që në fytyrat e lavdëruesve që e teprojnë të hedhim pluhur.”* /Transmeton Tirmidhiu/

Komentuesit e hadithit përmendin se këtu janë për qëllim ata lavdërues të cilët e kanë bërë traditë lavdërimin e njerëzve, me të cilin e shkatërrojnë të lavdëruarin. Ndërkaq, ai i cili lavdëron për një punë të mirë dhe vepër të lavdëruar, me qëllim që të nxisë për to, dhe të stimulojë njerëzit që ta pasojnë atë nuk është lavdërues i tepërt.

Kufijtë në të cilët ndalet muslimani dhe me të cilat del nga barra e miklimit dhe teprimit, e i ndihmon të lavdëruarit duke mos e shpjerë në vetëmahnitje dhe mendjemadhësi, i ka treguar Pejgamberi i urtë.

Transmetohet prej Ebu Bekrit, i cili thotë: *“Një njeri e lavdëroi një tjetër të Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem], e ai i tha: “Mjerë për ty, e çove kot mikun tend!”* E përsëriti këtë tri herë, pastaj tha: *“Kush e ka patjetër ta lavdërojë vëllain e vet, le të thotë: “Mendoj se filani, e Allahu është llogaritës i tij dhe nuk idealizohet asnjë tek Allahu, është kësh-*

tu e kështu, nëse e di se me të vërtetë është ashtu.” /Transmeton Buhariu/

Tregtari mund të gënjejë në prezantimin e mallit të vet dhe çmimit të tij; tregtitë te ne ngrihen mbi lakmi të larta. Shitësi dëshiron çmim të lartë, ndërkaq konsumatori do çmim të ulët, pra egoizmi është ai i cili dominon mbi transaksionet në tregje. Islami e urren këtë transaksion të etshëm, si dhe gënjeshttrat e dyshimet që e karakterizojnë.

Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] thotë: *“Shitësi dhe blerësi kanë të drejtë të zgjedhin derisa nuk janë ndarë, nëse ata të dy janë korrektë dhe ia sqarojnë njëri-tjetrit, u bekohet shitblerja, e nëse gënjejnë dhe fshehin, ndoshta mund të arrijnë ndonjë profit material, por fshihet bereketi i shitblerjes së tyre.”* Në një transmetim tjetër qëndron: *“Është fshirë bereketi i shitblerjes së tyre... Betimet e rrejshme shpejt e shesin mallin, por e fshijnë fitimin.”* /Transmeton Ahmed/

Ka blerës të cilët e marrin mallin, ndërkaq kanë pak përvorje, dhe shpejt e besojnë atë që u thuhet atyre; andaj, prej besimit është që mos të shfrytëzohet dobësia e tyre në profit të shtuar apo kamuflim të ndonjë mangësie. Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] thotë: *“Tradhti e madhe është që t’i tregosh diçka vëllait tënd, ai të beson, e ti e gënjen.”* /Transmeton Buhariu/ *“Nuk i lejohet një muslimani ta shesë një artikull i cili ka ndonjë mangësi, pa lajmëruar për të.”* /Transmeton Buhariu/

Transmetohet prej Ibën Ebu Eufas, se një njeri e nxori një mall në treg dhe u betua në Allahun, që ta mashtrojë me të një musliman, me çka arriti çmim sa me asnjë tjetër, andaj zbriti ajeti: ***“Ata që për një vlerë të paktë e shesin besën e dhënë Allahut, ndryshojnë edhe zotimet e tyre, të tillët nuk kanë pjesë (mëshirë) në botën tjetër, dhe në Ditën e Kijametit Allahu nuk u flet atyre, nuk i shikon ata dhe nuk i pastron (prej barrës së gabimeve), ata kanë një dënim të dhembshëm.”*** (Ali Imran: 77)

Shtrembërimi i dëshmisë është prej gënjeshtrave më flagrante. Muslimani nuk brengoset kur jep ndonjë dëshmi që ta konfirmojë të vërtetën, edhe po të jetë ajo në disfavor të njeriut më të afërt dhe më të dashur të tij; atë nuk e luhat afërsia,

e as farefisnia dhe nuk mund ta devijojë ndonjë dëshirë apo frikë.

Karakteristikat e mira të kandidatëve për në këshillin konsultativ apo funksionet publike janë një lloj dëshmie, andaj, kush zgjedh njeri jokompetent profesionalisht dhe jobesnik, ai ka gënjyer, ka falsifikuar dhe nuk ka punuar me drejtësi. Allahu i Madhërishëm thotë: ***“O ju që besuat, vazhdimisht të jeni dëshmues të drejtë për hir të Allahut edhe nëse është kundër (interesit) vetvetes suaj, kundër prindërve ose kundër të afërmve, le të jetë ai (për të cilin dëshmohet) pasanik ose varfanjak, pse Allahu di më mirë për ta. Mos ndiqni pra emocionin e t’i shmangeni drejtësisë. Nëse shtrembëroni ose tërhiqeni, Allahu hollësisht di çka punoni.”*** (En-Nisa: 135)

Transmetohet prej Ebi Bekrete, se Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] ka thënë: ***“A t’ju lajmëroj për më të mëdhenjtë e mëkateve të mëdha?”*** Këtë e tha tri herë. Thamë: ***“Gjithsesi.”*** Tha: ***“Të bërit Zotit shok, mosrespektimi i prindërve, vrasja e njeriut...”*** Ishte i mbështetur, pastaj u drejtua, dhe tha: ***“Po, edhe fjala e rrejshme dhe dëshmia e rrejshme.”*** Dhe vazhdimisht e përsëriste këtë, saqë ne thamë; ***“A thua, kur do të heshtë?”*** /Transmeton Buhariu/

Falsifikimi është gënjeshtër me errësi të dendur. Ai jo vetëm që e mbulon të vërtetën, por edhe e fshin krejtësisht, që në vend të saj të qëndrojë e pavërteta. Po ashtu, edhe rreziku i tij për individët, në çështjet e veçanta, dhe për popujt, në çështjet e përgjithshme, është i madh dhe shkatërrues. Për këtë edhe frika e Pejgamberit [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] prej tij që në këtë formë të zëshme.

Zejtaret dhe prodhuesit duhet që prej fjalës së tyre të bëjnë ligj i cili do të respektohet, do të ndalen në të dhe do të kapen për të; është tragjike që të jenë premtimet e shkelura dhe vendimet rrjedhëse traditë e trashëguar nga shumë muslimanë, edhe pse feja e tyre i ka bërë premtimet e rrejshme si shenja të hipokrizisë.

Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] e shenjtëronte fjalën e thënë, e respektonte fjalën që e dëgjonte. Kjo ka qenë simbol i burrërisë së plotë të tij, qysh para se të dërgohet Pejgamber te njerëzit.

Transmetohet prej Abdull-llah Ibën Ebil-Hamsaa, i cili thotë: *“I premtova Pejgamberit [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] para pejgamberisë, se do t’i shes diçka, dhe ai mbeti pa marrë edhe diçka, premtova që t’ia sjell në vendin ku qëndronte, por harrova. Pastaj pas tri ditësh, mu kujtua dhe shkova, kur ai qëndronte te vendi i vet. Ai tha: “O djalosh, më mundove! Unë që tri ditë jam duke pritur këtu.” Ai paraqitej në kohën e caktuar.”* /Transmeton Ebu Davudi/

Njëherë Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] i premtoi Xhabir Ibën Abdil-lahit se do t’i jepte diçka prej pasurisë së Bahreinit, por vdiq para se ta realizojë atë që kishte premtuar. E kur arriti pasuria e Bahreinit, halifja i tij, Ebu Bekri, e dërgoi një njeri të thërrasë në popull duke thënë: *“Cilit i ka premtuar Pejgamberi diçka apo ka ndonjë borxh, le të vijë.”* /Transmeton Buhariu/

Shih si peshohet fjala dhe obligohet realizimi i saj, ashtu që mos të shkojë kot, si rrena e humbur. Duhet ditur se premtimet e rrejshme nuk janë vetëm fjalë të cilat shkojnë kot, por ato janë shkelje e interesave, dëmtim i njerëzve, humbje e kohës. Korrektësia e premtimit nuk është karakteristikë pa peshë, por është veti e lavdëruar të cilën e përmendi Allahu i Madhërishtëm në vetitë e pejgamberisë: ***“Përkujtoju në këtë Libër Ismailin! Ai ka qenë shumë besnik në premtim (premtoi të bëhej kurban) dhe i Dërguar, Pejgamber. Ai urdhëronte familjen e vet me faljen e namazit dhe me zekat, dhe ishte shumë i pranishëm te Zoti i tij.”*** (Merjem: 54-55)

Renditja e vetive të vyeshme në këtë mënyrë tregon se çfarë pozite ka besnikëria në premtim. Ismaili [alejhis-selam] ka qenë njeriu më besnik në premtim, kur i tha babait të vet: ***“... e ti do të më gjesh mua, nëse do Allahu, prej të durueshmëve!”*** (Es-Safat: 102), kur i tha atij babai i vet: ***“... O djali im, unë kam parë (jam urdhëruar) në ëndërr të pres ty. Shiko pra, çka mendon ti?...”*** (Es-Safat: 102)

Ndoshta njeriu shpejton të gënjejë, kur dëshiron të arsyetohet nga ndonjë gabim që ka bërë dhe kur tenton të ikë prej pasojave. Kjo është marri dhe diskreditim, kjo është ikje nga e liga, në të ngjashme me të, apo më të keqe. Është obligim i njeriut që ta pranojë gabimin e vet, e ndoshta korrektësia e tij

në përkujtimin e realitetit dhe keqardhja e tij për atë që ka vepruar në të kaluarën do ta fshijnë gabimin dhe do t'ia falin mëkatin.

Kushedi sa të pëshpëritë në shpirt frika kur thuhet e vërteta; për muslimanin është më mirë që të jetë guximtar dhe të mbrohet nga mashtrimet e gënjeshtërs. Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] thotë: *“Jini korrekt, po edhe në qoftë se e shihni se në të është shkatërrimi, sepse në të është shpëtimi.”* /Transmeton Ibën Ebi Dunja/, si dhe *“Rrena e njeriut e largon nga ai melekun një milje, nga qelbësia e asaj që ka bërë.”* /Transmeton Tirmidhiu/

Korrektësia në fjalë e shpie njeriun në vepra korrekte dhe konsolidim të gjendjes, sepse kureshtja e njeriut për korrektësi në atë që e publikon, bën që drita e të vërtetës të shkëlqejë mbi zemrën dhe mendimin e tij. Për këtë edhe Allahu i Madhë-rishëm thotë: ***“O ju besimtarë, përmbajuni mësimëve të Alla-hut dhe thuani fjalë të drejta. Ai (Allahu) iu mundëson të bëni vepra të mira, ju shlyen juve mëkatet tua, e kush res-pekton Allahun dhe të dërguarin e Tij, ai ka arritur një sukses të madh.”*** (El-Ahzab: 70-71)

Vepra korrekte është ajo vepër në të cilën nuk ka dyshim, sepse ajo është rezultat i bindjes; me të nuk mund të ketë epshe, sepse ajo është simotër e sinqeritetit; ajo nuk ka asnjë shtrembërim, sepse ka buruar nga e vërteta.

Suksesi i popujve në kryerjen e misionit të tyre është rezul-tat i asaj që kanë bërë bijtë e tyre prej veprave korrekte. Nëse potenciali i veprave korrekte është i madh, atëherë ata do të shkojnë shumë para, e përndryshe do të bien në rrugë, sepse hoket dhe devijimet, dezinformatat dhe talljet askujt nuk i ndihmojnë kurrëgjë. Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] thotë: *“Ju duhet të jeni korrektë, sepse korrektësia udhëzon në punë të mira, e punët e mira udhëzojnë në Xhenet; dhe njeriu vazhdimisht do të jetë korrekt dhe do ta favorizojë korrektë-sinë, derisa të shkruhet tek Allahu korrekt... Dhe ruajuni gë-njeshtërs! Sepse gënjeshtria shpie në ligësi e ligësia shpie në zjarr. Te njeriu vazhdimisht do të gënjejë dhe do ta favorizojë rrenën, derisa të shkruhet tek Allahu gënjeshtar.”* /Transmeton Buhariu/

Ligësia, në të cilën udhëzoi konsumimi i gënjeshtres, është shkalla e fundit e dobësisë shpirtërore dhe humbjes së besimit.

Maliku transmeton prej Ibën Mesudit, i cili thotë: *“Njeriu vazhdimisht do të gënjejë dhe do ta favorizojë gënjeshtren, ashtu që do t’i vëhet në zemrën e tij një pikë e zezë, derisa të nxihet e tërë zemra, dhe kështu do të shkruhet tek Allahu prej gënjeshtarëve.”* Për të vlen fjala e Allahut në librin e Tij: *“Gënjeshtren e trillojnë vetëm ata që nuk i besojnë argumentet e Allahut; të tillët janë ata gënjeshtarët.”* (En-Nahl: 105)

Ndërkaq, mirësia në të cilën udhëzoi korrektësia, është kulminacioni i së mirës, në të cilën mund të ngjiten vetëm njerëzit e dalluar. Për këtë mjafton të përmendet ky ajet gjithëpërfshirës: *“Nuk është e tërë e mira (e kufizuar) të ktheni fytyrat tuaja kah lindja ose perëndimi, por mirësi e vërtetë është ajo e atij që i beson Allahut, Ditës së Gjykimit, engjëjve, librit, pejgamberëve, dhe pasurinë që e do ua jep të afërmeve, bonjakëve, të varfërve, udhëtarëve, lypësve dhe për lirim të robërve, dhe ai që e fal namazin, e jep zekatin, dhe ata që kur premtojnë e zbatojnë, dhe të durueshmit në skamje, në sëmundje dhe në flakën e luftës. Të tillët janë ata të singertët dhe të tillët janë ata të devotshmit.”* (El-Bekare: 177)

BESNIKËRIA

Islami kërkon prej ithtarit të vet që ai të ketë ndërgjegje të zgjuar me të cilën do t'i mbrojë të drejtat ndaj Allahut dhe do t'i ruajë veprat nga motivet e skajshmërive të tepërimit dhe neglizhencës. Prej këtui, edhe e obligoi muslimanin të jetë besnik.

Besnikëria, në këndvështrimin e Ligjdhënësit, ka domethënie të gjerë. Ajo simbolizon shumë kuptime, kurse rezultati i gjithë kësaj është që njeriu të ndjehet se është përgjegjës për gjithë atë që i besohet, si dhe të jetë i vetëdijshëm plotësisht se ai do të përgjigjet për të para Zotit të vet, në mënyrën të cilën e ka sqaruar hadithi fisnik: *“Çdonjëri prej jush është bari, dhe çdonjëri do të përgjigjet për kopenë e vet; prijësi është bari dhe përgjegjës për kopenë e vet, burri është bari në familjen e vet dhe është përgjegjës për kopenë e vet, po ashtu edhe gruaja në shtëpinë e burrit të vet është bareshë dhe ajo është përgjegjëse për kopenë e saj, rob i është bari në pasurinë e zotëriut të vet dhe ai është përgjegjës për kopenë e vet.”* /Transmeton Buhariu/

Ibën Omeri, transmentuesi i hadithit, thotë: Këtë që përmenda, e dëgjova prej Pejgamberit [sal-lAllahu alejhi ve sellem]. Mendoj se e tha edhe këtë: *“Njeriu është bari në pasurinë e babait të vet, dhe ai është përgjegjës për kopenë e vet.”*

Njerëzit e thjeshtë e kufizojnë besnikërinë në kuptimet e saja më të ngushta dhe të fundit në tabelë, e kjo është ruajtja e gjërave të lëna në mbrojtje, edhe pse esenca e saj është më grandioze dhe më e rëndë në fenë e Allahut.

Besnikëria është obligimi për kultivimin e së cilës porositen muslimanët dhe kërkojnë ndihmë prej Allahut për ruajtjen e saj, saqë kur është dikush në prag të udhëtimit, vëllai i vet i

thotë: *“Allahu ta mbrojtë fenë, besën dhe përfundimin e punëve tuaja.”* /Transmeton Tirmidhiu/

Transmetohet prej Enesit, se ka thënë: *“Sa herë që na është drejtuar Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem], na ka thënë: “Nuk ka besim (të plotë sh.p.), ai i cili nuk ka besë, dhe nuk ka fe, ai që nuk e mban premtimin.”* /Transmeton Ahmedi/

Pasi lumturia kulminante është që njeriu të mbrohet nga jetesa e rëndë në këtë botë dhe fundi i ligë në botën tjetër, Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] në kërkimin e mbrojtjes i ka bashkuar të dy rastet, kur thotë: *“O Zot, unë kërkoj mbrojtje nga uria, sepse ajo është shoqëruese e keqe, dhe më ruaj nga tradhtia, se kjo është këshilltare e ligë.”* /Transmeton Ebu Davudi/ Uria është humbje e kësaj bote, e tradhtia është humbje e fesë.

Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem], në rininë e tij, para pejgamberisë, në mesin e popullit të vet njihej me pseudonimin Emin-Besniku.

Po ashtu, u panë shenjat e besnikërisë në Musain [alejhis-selam], kur ua mundësoi dy vajzave të njeriut të devotshëm t’i japin ujë kopesë së tyre dhe i shoqëroi ato, i respektoi se ishin femra dhe ishte me to i ndershëm dhe fisnik: *“Atëherë ai u dha ujë (kafshëve) të atyre, pastaj u largua anash nën një hije, e tha: O Zoti im, unë kam nevojë për çkado që të më japësh! E njëra prej tyre erdhi tek ai, ecte e turpërueshme, e tha: Babai im të thërret që të të paguajë shpërblimin për atë që na u dha (bagëtisë) ujë! E kur shkoi (Musai) tek ai dhe ia tregoi atij ngjarjen, ai i tha: Mos ke frikë, paske shpëtuar nga populli zullumqar! Njëra prej atyre dyjave tha: O babai im, merre këtë në shërbim me pagë, pse më i miri i atij që do ta marrësh në shërbim është ai i fuqishmi, e besniku!”* (El-Kasas: 24-26) Kjo ndodhi para se t’i vijë pejgamberia Musait [alejhis-selam] dhe të dërgohet te Faraoni.

Kjo nuk duhet të habisë, sepse për Pejgamberë të Zotit zgjidhen njerëzit që kanë karakter më të lartë, gjenezë më të pastër; shpirti i cili është i kapur për vlerat, krahas varfërisë së rëndë dhe pezmit të kurbetit, është i njeriut të fortë besnik. Respektimi i obligimeve ndaj Allahut dhe ndaj njerëzve kërkon

karakter i cili nuk ndryshon me ndryshimin e ditëve në mes bollëkut dhe skamjes; kjo, pra, është thelbi i besnikërisë.

Prej kuptimeve të besnikërisë është vënia e çdo sendi në vendin meritot dhe adekuat. Kështu, nuk i jepet post dikujt thetër por vetëm se njeriut i cili është kompetent për të, dhe nuk i besohet një funksion dikujt, por vetëm se njeriut të cilin aftësia e tij e lartëson deri tek ai.

Konsiderimi i funksioneve dhe punëve publike, gjëra të besueshme me përgjegjësi konfirmohet nga shumë aspekte:

Transmetohet prej Ebu Dherrit, i cili thotë: “I thashë Pejgamberit: *“O Pejgamber i Allahut, a nuk më jep ndonjë funksion?”* Më ra me dorë shpatullave, pastaj tha: *“O Ebu Dherr, ti je i dobët, e funksioni është amanet, ndërkaq Ditën e Gjykimit do të jetë turpërim dhe pendim, përveç atij i cili e meriton dhe e kryen obligimin e vet që ka në të.”* /Transmeton Muslimi/

Përgatitja profesionale apo praktike nuk është e domosdoshme për konsolidimin shpirtëror. Një njeri mund të ketë sjellje solide dhe besim të mirë, mirëpo mos të ketë aftësi të duhura të cilat e bëjnë produktiv në një funksion të caktuar.

A nuk e sheh Jusufin e singertë? Ai nuk e propozoi veten për udhëheqjen e çështjeve ekonomike vetëm me pejgamberinë dhe devotshmërinë e vet, por, gjithashtu edhe me besnikërinë dhe diturinë e tij: *“... Më cakto mua përgjegjës të depove të vendit, unë jam besnik i dijshtëm.”* (Jusuf: 55) Po ashtu, edhe Ebu Dherri, kur kërkoi funksion, Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] nuk e pa të aftë për të dhe i tha të tërhiqet.

Besueshmëria kërkon që për funksione t’i zgjedhim njerëzit të cilët më së miri e kryejnë atë, e nëse zgjedhim njeri tjetër, për shkak të epshit, korrupsionit apo afërsisë, atëherë, me eliminimin e të aftit dhe zgjedhjen e të paaftit, kemi bërë tradhti flagrante.

Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] ka thënë: *“Kush e cakton një njeri udhëheqës të një grupi, e në mesin e tyre ka njeri me të cilin është më i kënaqur Allahu, ai e ka tradhtuar Allahun, Pejgamberin e Tij dhe besimtarët.”* /Transmeton Haki-mi/

Transmetohet prej Jezid Ibën Ebi Sufjanit, i cili thotë: “Ebu Bekri [radijAllahu anhu], kur më dërgoi në Sham, më tha: “O Jezid, ti ke të afërt, ndoshta mund t’u japësh përparësi në udhëheqje, kjo është gjëja për të cilën më së shumti frikohem për ty, pasi ka thënë Pejgamberi i Allahut: “Kujt i jepet ndonjë kompetencë në çështjet e muslimanëve, e ai e cakton udhëheqës të tyre ndonjë nga simpatia, mbi të do të jetë mallkimi i Allahut. Allahu prej tij nuk pranon kthim e as kompensim, derisa ta fusë në Xhehenem.” /Transmeton Hakimi/

Populli në të cilin nuk ka besë është populli në të cilin në përkëmben ndërmjetësimet me interesat e miratuara. Aty ngul-faten aftësitë e njerëzve të aftë, me qëllim që mos t’i përfillin ata dhe t’u japin përparësi atyre që janë nën ta. Suneti na ka treguar qartë se kjo është prej simptomave të plangprishësisë që do të ndodh në fund të botës.

Erdhi një njeri dhe e pyeti Pejgamberin e Allahut: “Kur do të bëhet Kijameti?” Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] i tha: “Kur do të humbet besa, prite Kijametin!” (Pyetësi) Tha: “Si do të humbet?” (Pejgamberi) Tha: “Kur do t’u besohen çështjet njerëzve jokompetentë, prite Kijametin.” /Transmeton Buhariu/

Prej kuptimeve të besueshmërisë është edhe ajo që të përpiket seriozisht njeriu ta kryejë plotësisht obligimin e vet në punën e cila i besohet dhe ta japë mundin maksimal në perfeksionin e plotë të tij. Gjithsesi, kjo është besueshmëria të cilën e lavdëron Islami: që të jetë i sinqertë njeriu në punën e vet dhe të interesohet në perfeksionimin e saj, t’i mbrojë të drejtat e njerëzve të cilat i ka para vetes, sepse moskujdesi i njeriut ndaj asaj me të cilën është ngarkuar, edhe nëse është jo e rëndësishme, shkakton përhapjen e mospërfilljes në tërë jetën e bashkësisë, pastaj përhapjen e anarkisë dhe sfidave të saj në tërë qenien e umetit.

Shkelja e këtyre detyrave dallon në madhësinë e mëkatit dhe urrejtjes, e më e rënda e tyre është ajo e cila e prek fenë, bashkësinë e muslimanëve dhe kur shteti i nënshtrohet dëmit të tij.

Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] ka thënë: “Kur do t’i tubojë Allahu njerëzit e parë dhe të fundit në Ditën e Gjyki-

mit, çdo mashtruesi do t'i ngrihet një flamur me të cilin do të njihet! Dhe do të thuhet: “Ky është mashtrimi i filanit...” /Transmeton Buhariu/

Sipas një versioni tjetër: “Çdo mashtrues do të ketë nga një flamur në prapanicë, do t'i ngrihet në bazë të mashtrimit të tij. Por, nuk ka mashtrues më të madh se udhëheqësi i njerëzve të thjeshtë.” /Transmeton Muslimi/

Gjegjësisht, nuk ka tradhtar më të madh dhe me epilog më të zi se njeriu i cili u prin njerëzve, por nga mospërfillja i ka humbur të gjithë.

Prej besueshmërisë është që njeriu mos ta shfrytëzojë funksionin, i cili i është besuar, me qëllim të interesit personal apo të të afërmve të tij, sepse keqpërdorimi i pronës shoqërore është krim.

Dihet se qeveritë dhe kompanitë u japin shfrytëzuesve të tyre paga të caktuara, andaj orvatja e shtimit të saj përmes manipulimeve të ndryshme është fitim i fëlliqur.

Pejgamberi i Allahut thotë: “*Cilit ia besojmë ndonjë punë dhe i japim kompensim për atë, e çka merr përkaj këtij kompensimi, ajo është e pandershme.*” /Transmeton Ebu Davudi/ Sepse kjo atëherë është manipulim me pasurinë shoqërore, e cila jepet për nevojat e të dobhtëve dhe të varfërve dhe u dedikohet interesave të mëdha: “*... dhe kush bën hile (në ndarjen e plaçkës së luftës), ai në Ditën e Kijametit vjen i ngarkuar me atë që ka bërë, pastaj secilit njeri i jepet ajo që e ka fituar, duke mos iu bërë e padrejtë.*” (Ali Imran: 161)

Ai i cili u përmbahet urdhrave të Allahut në funksionin e tij dhe ndjen neveri nga tradhtia ndaj obligimit që i është ngarkuar, ai tek Allahu është prej muxhahidëve për ndihmimin e fesë së Tij dhe lartësimin e Fjalës së Tij.

Pejgamberi i Allahut thotë: “*Kur i jepet udhëheqësia ndonjë njeriu dhe e mbron të drejtën e ua jep edhe të tjerëve të drejtën, ai është sikur muxhahidi në rrugë të Allahut derisa të kthehet në shtëpinë e tij.*” /Transmeton Taberaniu/

Islami me të madhe është përqendruar në domosdoshmërinë e përmbajtjes nga shfrytëzimi i pushtetit, e po ashtu është mjaft i ashpër edhe në refuzimin e përfitimeve të dyshimta.

Transmetohet prej Adij Ibën Umejres, i cili thotë: e kam dëgjuar Pejgamberin [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] duke thënë: *“Cilit prej jush ia besojmë një detyrë dhe ai e fsheh prej nesh një pjesë e më tepër, kjo është hile me të cilën do të vijë në Ditën e Gjykimit.”* Atëherë u ngrit një njeri i zi prej ensarëve (medinasve), dhe më bëhet sikur e shoh tash atë, dhe tha: *“O Pejgamber i Allahut, largoje prej mua punën që ma ke dhënë!”* Tha: *“E ti, çka pate?”* Tha: *“Të dëgjova duke thënë kështu e kështu.”* Tha: *“Po, unë e them edhe tash: “Cilit ia besojmë ndonjë detyrë, le të na sjellë çdo gjë, qoftë e madhe apo e vogël, ajo që do t’i jepet, do ta marrë, e ajo që do t’i ndalo-het, do t’i largohet.”* /Transmeton Muslimi/

Njëherë, Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] e caktoi një person prej fisit Ezd, i quajtur Ibën El-Lutbijje, përgjegjës për zekatin. Kur e solli atë, ai tha: *“Kjo është për ju, e kjo më është dhuruar mua!”* Transmetuesi i hadithit thotë: Pejgamberi i Allahut u ngrit, e falënderoi Allahun e lavdëroi Atë, pastaj tha: *“Unë i caktoj njerëzit për punët të cilat mi la në përgjegjësi Allahu, e ai vjen e më thotë: Kjo është për ju, e kjo është dhuratë për mua. Po mirë, sikur të kishte qëndruar në shtëpinë e vet, a do t’i vinin dhuratat, nëse është i sinqertë? Për Allahun, ai i cili prej jush do të marrë diçka pa të drejtë, do ta takojë Allahun duke e bartur atë send në Ditën e Gjykimit! Assesi nuk dua ta shoh ndonjë prej jush ta takojë Allahun duke bartur mbi vete deve që ulërin, apo lopë që pëllet, apo dele që blegëron.”* Pastaj i ngriti duart, derisa iu panë nënsqetullat, dhe tha: *“O Allah, a e çova në vend obligimin?”* /Transmeton Muslimi/

Prej kuptimeve të besueshmërisë është edhe ajo që të shikosh në shqisat me të cilat të begatoi Allahu i Madhërishëm, në aftësitë me të cilat të veçoi Allahu i Madhërishëm, dhe në pasurinë dhe fëmijët të cilët të janë dhuruar dhe të kuptosh se këto janë gjëra të shtrenjta të cilat t’i la në besë Allahu i Madhërishëm, andaj duhet t’ua nënshtrosh ato bamirësive dhe t’i shfrytëzosh në atë me të cilën është i kënaqur Allahu. Nëse sprovohesh me pakësimin e ndonjërës prej tyre, atëherë le mos të mashtrojë dëshpërimi duke të indoktrinuar se pasuria jote personale të është rrëmbyer. Allahu të do ty, më tepër sesa ti e do vetveten, dhe Ai është më meritör për atë që ta fali ty; Atij i

takon ajo që ta ka marrë dhe Atij i takon ajo që ta ka falur. Nëse sprovohesh me ekzistimin e këtyre të mirave, atëherë nuk duhet t'i ikësh xhihadi për shkak tyre, apo të të dalldisin e të largojnë ato nga adhurimet, apo t'i konsiderosh forcë ndihmëse për mëkate. Allahu i Madhërishëm thotë: ***“O ju që besuat, mos e tradhtoni Allahun dhe të dërguarin, e ashtu të tradhtoni amanetet tuaja, derisa e dini sa e keqe është kjo. Dhe, dijeni mirë se pasuria e juaj dhe fëmijët tuaj janë vetëm një sprovë, dhe se te Allahu është shpërblimi i madh.”*** (El-Enfal: 27-28)

Po ashtu, prej domethënieve të besueshmërisë është edhe ruajtja e obligimeve ndaj tubimeve në të cilat ti je i pranishëm, andaj, mos e lejo gojën tënde t'i zbulojë sekretet dhe t'i kumtojë lajmet e tyre.

Sa raporte janë keqësuar dhe sa interese janë prishur për shkak të mospërfilljes së disa njerëzve ndaj besueshmërisë së tubimit dhe nga përmendja e bisedave të cilat janë bërë në të duke ua atribuar folësve ose jo. Pejgamberi [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] thotë: ***“Kur ia thotë ndonjë njeri ndonjë fjalë tjetrit dhe shkon, ajo është amanet.”*** /Transmeton Ebu Davudi/

Amanetet e tubimeve duhet të ruhen, derisa ajo që ndodh në të është e normuar me ligjet e etikës dhe parimeve fetare, e përndryshe nuk ka paprekshmëri.

Çdo musliman, i cili shkon në një tubim në të cilin kriminelët bëjnë lajka me të tjerët që ta dëmtojnë atë, duhet të shpejtojë në ndërprerjen e trazirave sa të ketë mundësi. Pejgamberi i Allahut thotë: ***“Tubimi është me amanet, përveç tre tubimeve: tubimi ku derdhet një gjak i ndaluar, ku preket një nder i ndaluar, apo ku rrëmbehet një pasuri pa të drejtë.”*** /Transmeton Ebu Davudi/

Marrëdhëniet bashkëshortore, sipas Islamit, janë të shenjta: të gjitha gjërat që ndodhin në shtëpi, ndërmjet burrit dhe gruas, duhet të mbështillen mirë dhe mos t'i shohë askush, po sado që të jetë i afërt. Njerëzit e thjeshtë e mendjelehtë sorro-llaten për atë që ndodh në mes tyre dhe familjes së tyre, ndërkaq kjo është paturpësi të cilën e ka ndaluar Allahu i Madhërishëm.

Transmetohet prej Esmâ bint Jezidit, se ajo ka qenë te Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem], e tek ai ishin ulur edhe burra edhe gra, dhe tha: *“Ndoshta ndonjë burrë tregon çka ka bërë me bashkëshorten e tij, e ndoshta edhe ndonjë grua tregon se çka ka bërë me burrin e vet!”* Njerëzit u mblodhën, hesh-tën të rrëqethur, kurse Esmâ tha: *“Po, për Allahun, o Pejgamber i Allahut, të dy palët e bëjnë këtë!!”* Tha: *“Mos veproni kështu, sepse shembulli i kësaj është si shembulli i një shejtani i cili takon një shejtan dhe e mbulon duke e shikuar njerëzit.”* /Transmeton Ahmedî/

Po ashtu, Pejgamberi i Allahut thotë: *“Prej tradhtive më të mëdha të amanetit (besës,) tek Allahu Ditën e Gjykimit, është një burrë i cili ka kontakt me bashkëshorten e vet e pastaj përhapet ky sekret.”* /Transmeton Ahmedî/

Po ashtu, edhe gjërat të cilat neve na lihen në besim dhe pastaj ua kthejmë pronarëve të tyre, kur ata i kërkojnë, janë prej amaneteve për të cilat do të pyetemi.

Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem], me rastin e shpërnguljes së tij në vend të vet, e la Aliun [radijAllahu anhu], djalin e axhës së tij, që t’ua kthejë idhujtarëve gjërat të cilat ia kishin lënë në mbrojtje. Edhe pse ata idhujtarë ishin disa anëtarë të popullit i cili e persekutonte dhe e detyroi ta lërë vendlindjen e vet për hir të besimit. Mejmun Ibën Mehrani thotë: *“Tre gjëra duhet të respektohen edhe me të mirin edhe me të keqin: besa, premtimi dhe respekti farefisnor.”*

Konsiderimi i gjësë së lënë në besim si plaçkë e ftohtë lufte është një formë e vjedhjes flagrante.

Transmetohet prej Abdull-llah Ibën Mes’udit [radijAllahu anhu], i cili thotë: *“Vdekja në rrugë të Allahut i fshin të gjitha mëkatet, përveç amanetit”.* Tha: *“Do të silltet njeriu në Ditën e Gjykimit, edhe nëse ka vdekur në rrugë të Allahut, dhe do t’i thuhet: “Kryeje amanetin tënd!” Ai do të thotë: “Si ta bëj këtë, kur kaloi dunjaja!” Do t’i thuhet: “Dërgojeni këtë në Xhehenem, dhe amaneti do t’i shndërrohet në formën e tij në momentin kur i është dorëzuar, e ai do ta shohë dhe do ta njohë, do të vrapojë pas tij, derisa ta arrijë, do ta vë mbi supet e veta, dhe kur do të mendojë se do të dalë prej atje, ai do t’i ikë prej supeve, e ai do të vrapojë pas tij përgjithmonë.”* Pastaj tha:

Namazi është amanet, abdesti është amanet, peshoja është amanet, matja është amanet, si dhe shumë gjëra të tjera të cilat i numëroi. Më të rënda prej tyre ishin gjërat e lëna në besim, për mbrojtje”. /Transmeton Ahmedi/

Transmentuesi i hadithit thotë: “Shkova te Bera Ibën Azib, dhe i thashë: “*A nuk e ke dëgjuar atë që e tha Ibën Mes’udi?*” Tha: “*Kështu!*” (Bera’ja) Tha: “*E ka thënë të vërtetën, a nuk e ke dëgjuar Fjalën e Allahut: “Allahu ju urdhëron që t’u jepni amanetin të zotëve të tyre dhe kur të gjykoni, ju urdhëron të gjykoni me të drejtë mes njerëzve. Sa e mirë është kjo që ju këshillon. Allahu dëgjon dhe sheh si veproni.”* (En-Nisa: 58)

Amaneti, i cili thërret në mbikëqyrjen e obligimeve dhe të mbron nga të ligat, nuk mund ta ketë këtë pozitë pa u ngulitur në shpirtin e njeriut dhe pa u thelluar në brendësitë e tij e të dominojë mbi të gjitha ndjenjat e tij, të larta dhe të ulëta! Ky është kuptimi i hadithit të Hudhejfe Ibën Jemanit, të përcjellur prej Pejgamberit të Allahut: “*Amaneti ka zbritur në thelbin e zemrave të burrave, pastaj zbriti Kur’ani, për atë mësuan prej Kur’anit dhe mësuan prej Sunetit.*” /Transmeton Muslimi/

Të njohurit e fesë nuk justifikon mosaplikimin e dispozitave të saj, e amaneti është ndërgjegje e gjallë pranë kuptimit objektiv të Kur’anit dhe Sunetit. Nëse vdes ndërgjegja, atëherë hiqet amaneti, dhe njeriut atëherë nuk i bën dobi leximi i ajeteve e as studimi i Sunetit. Pretedentët e Islamit ua besojnë njerëzve, madje edhe vetes mund t’ia atribuojnë, se janë të besueshëm, por shumë larg është të përqendrohet besa në një zemër e cila e injoron të vërtetën.

Për këtë edhe vazhdoi Hudhejfe me përshkrimin e vet, për shkak të tërheqjes së amanetit nga zemrat në të cilat u luhat bindja, dhe transmeton prej Pejgamberit: “*Pastaj na tregoi për ngritjen e amanetit dhe tha: “Njeriu do të bie të flejë, e nga zemra e tij do të ngrihet amaneti, por do të mbetet vetëm gjurma e tij, sikur pikat; pastaj përsëri do të flejë njeriu dhe do të ngritet amaneti prej zemrës së tij, e gjurma e tij do të mbetet sikur gjurma e kallos.”* Pastaj tha: “*Njerëzit do të japin besë në mes vete, e asnjëri prej tyre nuk do ta çojë në vend këtë, derisa do të thuhet: “Te filan familje ka një njeri besnik.” Bile derisa do t’i thuhet njeriut: “Sa i qëndrueshëm që*

*është! Sa mendjemprehtë që është! Sa i mençur që është!
Ndërkaq në zemrën e tij nuk ka as sa një kokërr gruri besim.”*
Hadithi e përshkruan ngritjen e amanetit nga zemrat tradhtare në mënyrë trishtuese; këto janë si memoare të mirësisë në shpirtrat e ligë, kalojnë pranë tyre, por nuk u takojnë atyre, bile mund të lënë në kalimin e tyre gjurmë të flaktë, edhe pse ato nuk ngjallin ndërgjegje të vdekura dhe njeriu i tillë ka filluar t’i peshojë njerëzit në bazë të egoizmit dhe emocioneve, duke qenë indiferent ndaj mosbesimit ose besimit!

Besnikëria është virtyt grandioz të cilin nuk mund ta mbaj në njerëzit e plogësht. Allahu i Madhërishëm e ka ilustruar madhështinë e saj me shembull dhe tregoi se ajo e rëndon tërë mbështetjen e ekzistencës, që do të thotë se njeriu nuk duhet ta përbuzë atë apo të mos e kryejë si duhet. Allahu i Madhërishëm thotë: *“Ne u ofruam amanetin (obligimet) qiejve, tokës dhe maleve, e ata nuk deshën ta marrin përsipër atë dhe u frikësuan prej tij, ndërsa njeriu atë e mori mbi vete, vërtetë ai i bëri padrejtë vetes, dhe ishte i padijshëm.”* (El-Ahzab: 72)

Padrejtësia dhe injoranca janë dy mangësi, të cilat iu paraqitën natyrës së parë, e njeriu u sprovua me luftimin e tyre; sepse nuk mund të ketë besim të sigurtë pa e pastruar atë prej padrejtësisë: *“Ata që besuan dhe besimin e tyre nuk e ngatërruan me besim të kotë, atyre u takon të jenë të sigurt...”* (El-En’am: 82) Njeriu, po ashtu, nuk mund të ketë devotshmëri të sigurtë pa e pastruar prej injorancës: *“... Po Allahut ia kanë frikën nga robërit e Tij, vetëm dijetarët...”* (Fatir: 28)

Për këtë, pasi ta lexosh ajetin që ia ngarkoi njeriut amanetin, do ta shohësh se ata të cilët i munda padrejtësia dhe injoranca kanë tradhtuar, kanë bërë hipokrizi dhe kanë bërë idhujtari; për këtë edhe e merituan dënimin, ndërkaq shpëtimi u takon vetëm besimtarëve dhe besnikëve: *“(Njeriu e mori përsipër) Ashtu që Allahu të ndëshkojë hipokritët, idhujtarët dhe idhujtaret, e t’u falë besimtarëve dhe besimtareve. Allahu është Ai që fal shumë dhe është Mëshirues.”* (El-ahzab: 73)

ZBATIMI I PREMTIMIT

Muslimani, kur e lidh një kontratë, duhet ta respektojë atë; kur e jep premtimin, duhet ta zbatojë atë. Prej besimit është, të qëndrojë njeriu në fjalën të cilën e ka thënë dhe të mbarojë në të, ashtu siç mbaron uji në bregun e vet; kështu në mes njerëzve do të njihet se fjala e tij është besë e fortë, dhe nuk duhet patur frikë nga shkelja e saj, e as aspirata në gjuajtjen e saj.

Premtimi patjetër duhet të plotësohet, e, po ashtu, edhe betimi patjetër duhet të zbatohet. Plotësimi dhe zbatimi e meritojnë këtë vetëm atëherë kur kanë të bëjnë me realitetin dhe mirësinë, sepse, në të kundërtën, nuk duhet dhënë premtim për çështje që janë mëkat dhe nuk duhet dhënë betim për punë të pahijshme. Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] thotë: *“Kush betohet për diçka, por pastaj sheh se gjërat e tjera janë më të mira se ajo, le ta kompensojë betimin e vet dhe le ta bëjë atë që është më mirë.”* /Transmeton Muslimi/

Nuk lejohet që njeriu të jetë këmbëngulës në zbatimin e një betimi, kur moszbatimi i tij është më i preferuar. Në një hadith përmendet: *“Më e rëndë tek Allahu i Madhërishëm është që të hyjë dikush prej jush me betimin e vet në familje, sesa ta japë kompensimin të cilin ia obligoi Allahu i Madhërishëm.”* /Transmeton Buhariu/

Andaj, nuk bën të jepet premtim për diç tjetër por vetëm se për punë të mbara; e kur e jep njeriu fjalën, dhe premtim seriozisht për një punë të mbarë, atëherë le t'i përkushtohet plotësisht realizimit të asaj që ka premtuar derisa t'i lëvizë edhe një qerpik, dhe le ta dijë se logjika e burrërisë dhe udhëzimi i bindjes nuk i lënë atij terren për dilemë dhe zmbarsje.

Enes Ibën Maliku transmeton duke thënë: “Xhaxhai im, Enes Ibën En-Nedri, nuk mori pjesë në luftën e Bedrit dhe tha: “O

Pejgamber i Allahut, nuk mora pjesë në luftën e parë që u ballafaqove me idhujtarët! Nëse ma mundëson Allahu të marrë pjesë me Pejgamberin në luftimin e idhujtarëve, gjithsesi do ta shohësh se çka do të bëj!!!”

Në luftën e Uhudit, muslimanët u zbrapsën, e ai tha: “O Zot, unë kërkoj falje prej Teje për atë që bënë këta (për qëllim ka shokët e vet), dhe jam larg asaj që bënë ata (për qëllim ka idhujtarët)”, - pastaj marshoi. E takoi Sead Ibën Muadh, dhe tha: “O Sead Ibën Muadh, e dua Xhenetin, për Allahun e Nedrit! Unë e nuhat erën e tij afër Uhudit!!!”

Seadi tha: “O Pejgamber i Allahut, nuk munda ta bëja atë që bëri ai, pastaj marshoi..”

Enesi thotë: “Në trupin e tij gjetëm mbi tetëdhjetë plagë të shkaktuara nga shpatat, shtizat dhe shigjetat; atë e kishin masakruar idhujtarët. Atë arriti ta identifikojë vetëm motra e vet, përmes një njolle që kishte, apo përmes majave të gishta-ve.”

Po ashtu, Enesi thotë: “Mendonim se ajeti vijues i është dedikuar atij, dhe të ngjashmëve me të: ***“Prej besimtarëve kish-te burra që vërtetuan besën e dhënë Allahut, e disa prej tyre e realizuan premtimin duke dhënë jetën, dhe ka prej tyre që janë duke pritur (ta zbatojnë) dhe ashtu nuk bënë kurrfarë ndryshimi.”*** (El-Ahzab: 23) /Transmeton Buhariu/

Zbatimi i fjalës së dhënë ka nevojë për dy sende të cilat, kur plotësohen te njeriu, ai e ka më lehtë ta realizojë atë me të cilën është ngarkuar. Allahu i Madhërishëm mori prej Ademit, babait të njerëzimit, premtim të fortë se nuk do t’i afrohet pemës së ndaluar, por Ademi pas pak harroi dhe u dobësua, dhe e shkeli premtimin e dhënë: ***“Na i patëm urdhëruar edhe Ademit (të mos i afrohej pemës), po ai harroi, pra tek ai nuk gjetëm vendosmëri.”*** (Ta Ha: 115)

Memoria e dobët dhe vendosmëria e dobët, janë dy pengesa serioze të kryerjes së obligimit. Njeriu, për shkak të risisë së ndodhive para vetes dhe preokupimeve të shumta që e ndjekin atë, i nënshtrohet ndikimit të kohës, e cila çuditshëm reflektohet tek ai; kështu, i fshin shenjat e qarta, dhe ajo që ka qenë transparente në të humb gati sa nuk shihet.

Për këtë, njeriu ka nevojë për përkujtues të përhershëm, i cili do të dominojë mbi valët e harresës dhe do ta mbajë para vetes atë që ka mundësi t'i ikë. Shumë ajete kur'anore janë përmendur për ta mbrojtur këtë memorizim:

“Përvetësoni atë që ju është zbritur nga Zoti juaj, e mos zini miq (përkrahës) pos Tij. Pak është ajo që po merrni përvojë.” (El-A'raf: 3)

“Kjo është rruga e Zotit tënd, është e drejtë, Ne shpjeguam argumentet për njerëz që përkujtojnë.” (El-En'am: 126)

“... Po petku i devotshmërisë, ai është më i miri. Këto janë nga argumentet e Allahut, ashtu që ata të përkujtojnë.” (El-A'raf: 26)

“... Kështu i nxjerrim (i ngjallim) të vdekurit, ashtu që të përkujtoni (fuqinë e Zotit).” (El-A'raf: 57)

Përkujtimi aktiv dhe i vazhdueshëm është domosdoshmëri e patjetërsueshme e zbatimit, sepse si mundet ai që e ka harruar premtimin ta zbatojë atë? Për këtë, ajeti i premtimit përfundoi me elementin e përkujtimit: ***“... dhe zotimin e dhënë Allahut plotësojeni. Këto janë me çka Ai ju porosit kështu që të përkujtoni.”*** (El-En'am: 152)

Pasi njeriut t'i kujtohet zotimi që e ka dhënë, këtij përkujtimi duhet t'ia bashkangjesë edhe vendosmërinë e fortë për zbatimin e tij, vendosmëri e cila do t'i nënshtrojë pasionet e përdhosura, dhe do t'i thyejë pengesat që i dalin para, vendosmëri e cila do të marshojë në rrugën e zbatimit, sado që t'u ekspozohet vështirësive dhe sado sakrifica t'i kushtojnë.

Mundësitë e njerëzve ndryshojnë shumë mes vete në këtë plan. Çmimi i zbatimit mund të jetë i kobshëm, mund të kushtojë pasuri, jetë ose shoqëri. Edhe pse duhet ditur se këto janë çmimet e lavdisë së dëshiruar në këtë botë dhe në tjetrën.

*Po mos të ishte vështirësia, të gjithë njerëzit do të dominonin
Bujaria varfëron, e guximi është vdekjeprurës*

Kur'ani i ka përgënjeshtuar disa mendime sipas të cilave njeriu mund të kërkojë ngritje me rehati dhe të presë të mira të

shumta me pak mund: ***“Po ju menduat se do të hyni në Xhenet pa u provuar edhe ju me shembullin e atyre që ishin para jush, të cilët i patën goditur skamjet e vuajtjet, dhe qenë tronditur, saqë i Dërguari thoshte, e me të edhe ata që kishin besuar: Kur do të jetë ndihma e Allahut?! Ja (u erdhi ndihma) vërtetë ndihma e Allahut është afër!”*** (El-Bekare: 214)

Kur ta bashkojë njeriu në vetvete vetëdijen e lartë dhe zemrën e madhe, atëherë do të jetë i aftë për ta zbatuar premtimin.

Zotimet, me të cilat obligohet muslimani, janë shkallë-shkallë. Më i larti dhe më i shenjti prej tyre është zotimi më i madh, i cili është në mes njeriut dhe Zotit të botëve.

Allahu e krijoi njeriun me fuqinë e Tij dhe e mbikëqyri me begatinë e Tij, andaj kërkoi prej njeriut që ta njohë këtë të vërtetë dhe të jetë mirënjohës për të, ashtu që mos ta rrëmbejnë atë të ligat: ***“O bijtë e Ademit (kriminelë), po a nuk u dërgova porosinë që të mos e dëgjoni djallin, se me të vërtetë ai është armiku juaj i hapët!?”*** (Ju porosita) ***Të më adhuron! Mua, se kjo është rruga e sigurt!”*** (Ja Sin: 60-61)

Nëse ekzistojnë njerëz të cilët nuk i kanë dëgjuar të Dërguarit e Zotit dhe nuk kanë patur rast ta njohin misionin me të cilin ata u dërguan, ata në natyrën e vet kanë prijes, që i udhëheq ata te Zoti i tyre, dhe i njofton ata me Krijuesin e tyre, sado që të jetë i kapluar ambienti me lloj-lloj dukurish negative e marrëzi të ndryshme.

Kjo është domethënia e zotimit, të cilin e mori Allahu prej të gjithë njerëzve. ***“Përkujto kur Zoti Yt nxori nga shipna e bijve të Ademit pasardhësit e tyre dhe i bëri dëshmues të vetes së tyre (duke u thënë): A nuk jam Zoti juaj? Ata thanë: Po, dëshmuam! Të mos thoni në Ditën e Kijametit: Ne nga ky (dëshmim) ishim të panjohur. Ose të mos thoni: Prindërit tanë më parë ishin idhujtarë, e ne ishim pasardhës të tyre. A do të na shkatërrosh ne për atë që bënë ata asgjësues të së vërtetës? Po kështu u sqarojmë argumentet, që ata të kthehen nga e gabuarja në të vërtetën.”*** (El-A’raf: 172-174)

Këtu nuk ka dialog, siç mund të kuptohet nga konteksti i shprehjeve, por është ilustrim i udhëzimit të natyrës së shëndoshë kah Allahu dhe njohjes së Tij, e po ashtu, shfrytëzimi i

argumenteve të shpërndara në galaktikë për ta besuar njëshmërinë e Tij dhe për ta madhëruar Atë si dhe lirimi nga botëkuptimet prapanike, të cilat e largojnë nga Zoti apo e shtynjë të bëjë idhujtari ndaj Tij. Kjo mënyrë e shprehjes është e njohur në gjuhën arabe. Në këtë kontekst është edhe pro-verbi: *“Muri i tha pykës: ‘Pse më shpon?’ Tha: ‘Pyete atë i cili më godet mua!’ Sepse ai që është pas meje, nuk më la të lirë të mendoj vetë!”*

Zbatimi i premtimit, për njeriun, është thelbi i dinjitetit të tij në këtë botë dhe lumturia e tij në botën tjetër. Bindja e keqe për Zotin është që të jesh i denjë ndaj Tij, e pastaj të presësh ndonjë të keqe nga Ai: *“... kujtoni (jini mirënjohës për) të mirat e Mia, të cilat ua dhurova juve dhe zbatoni premtimin që më keni dhënë Mua. Unë zbatoj atë që u premtova dhe të më keni frikë vetëm Mua.”* (El-Bekare: 40)

Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem], duke i thirrur njerëzit në Islam, delegacioneve që vinin tek ai u merrte besë për ato norma fetare, të cilat i zgjidhte nga normat e shumta fetare që i përfshin kjo fe, për të cilat mendonte se ata kanë aftësi shpirtërore dhe intelektuale.

Transmetohet prej Auf Ibën Malikut, i cili thotë: “Ishim te Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] nëntë, tetë, ose shtatë vetë dhe ai tha: *“A nuk i jepni besë Pejgamberit të Allahut?”* Ne i shtrimë duart dhe thamë: *“Ta japim besën, o Pejgamber i Allahut!”* Tha: *“Të më zotoheni se do ta adhuroni Allahun dhe nuk do t’i bëni Atij shok, se do t’i falni pesë namazet, se do të dëgjoni dhe respektoni.”* Dhe tha: *“Dhe mos lypni kurr gjë prej njerëzve.”*

Auf Ibën Maliku thotë: *“I pashë disa prej atyre personave, tek u binte barra, e nuk e lusnin asnjërin t’ua vendosë atë në krah.”* /Transmeton Muslimi/

Shih si e kanë zbatuar premtimin dhe si e kanë realizuar me precizitet. E kjo nuk është tjetër, vetëm se këshillë drejtuar çdo pale, për atë që konsiderohet se i është më se e nevojshme. Udhëheqësi këshillohet të mos bëjë padrejtësi, tregtari mos të mashtrojë, funksionari të mos korruptohet... etj. Sepse, përndryshe, çdo musliman është i obliguar t’i zbatojë të gjitha normat fetare. Në botën islame janë paraqitur disa grupe, të cilat

japin zotime të veçanta të cilave nuk u duhet vënë veshin. Ata janë si pretenduesit e mjekësisë, të cilët japin medikamente të falsifikuara të cilat edhe më tepër ua shtojnë sëmundjet të sëmurëve.

Mësimet islame janë një tërësi e pandarë. Zbatimi i tyre është detyrë obligative në çdo kohë dhe vend.

Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] e mori zotimin e ensarëve (medinasve), se do t'i përgatisin veten dhe pasurinë e tyre për mbrojtjen e thirrjes dhe përkrahjen e misionit të tij, ashtu që të mund t'ua kumtojë atë arabëve dhe tjerëve.

Zotimi që dhanë ensarët (medinasit) konsiderohet prej zotimeve më të shkëlqyeshme në historinë e besimeve dhe dëshmitar më i madh për përkushtimin e tyre ndaj Allahut dhe shndërrimin e tyre në kandil të së vërtetës.

E gjithë kjo u realizua në një natë magjepëse të ceremonia-lit të haxhit, e pas saj njerëzit filluan t'i shqyrtojnë çështjet e tyre të ndryshme; mirëpo barra e këtij zotimi ra mbi pro-tagonistët e tij, e ata e pranuan me zemërgjerësi dhe me vull-net të mirë.

Nisur nga kjo, ata i ofruan gjaqet e tyre pa ngurim në luftën e Bedrit dhe në luftërat e tjera pasuese në mes Islamit dhe idhujtarisë. Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] në krizat e thella bazohej në këtë zotim për mbrojtjen e fesë dhe lartë-simin e Fjalës së Allahut. Me rastin e zmbrapsjes së muslima-nëve në sulmin e parë të betejës së Hunejnit, Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] i la grupet e mëdha të cilat hynë më vonë në Islam, por i thirri me zë të lartë ata të cilët i dhanë zotim në Akabe atë natë haxhi që ta shpëtojnë situatën. Transmetohet prej Enesit, i cili thotë: Në betejën e Hunejnit arritën fisi Hevazin dhe Gatafan, si dhe disa tjerë me fëmijët dhe bagëtinë e tyre. Atëbotë, me Pejgamberin [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] ishin dhjetë mijë njerëz, e me vete i kishte edhe pengjët idhujtarë mekas, të liruar. Mirëpo, të gjithë u kthyen dhe e lanë atë vetëm. Atëherë, Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] thirri dy herë, pa futur ndërmjet tyre kurrgjë. U kthye në të djathtë dhe tha: *“O ju ensarë.”* Ata iu përgjigjën: *“Urdhë-ro, o Pejgamber i Allahut, ne jemi me ty, përgëzo.”* Pastaj u kthye në anën e majtë dhe tha: *“O ju ensarë.”* Ata i thanë:

“Urdhëro, o Pejgamber i Allahut, përgëzo, ne jemi me ty...”
Gjatë kësaj kohe ishte i hipur në një mushkë të bardhë, pastaj zbriti dhe tha: *“Unë jam rob i Allahut dhe Pejgamber i Tij.”*

Idhujtarët pësuan disfatë, e muslimanët triumfuan dhe fituan plaçkë të madhe lufte. Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] këtë e ndau në mes muhaxhirëve (mekasve muslimanë të shpërngulur) dhe pengjeve mekas të liruar, ndërkaq ensarëve nuk u dha asgjë prej kësaj plaçke të fituar. Ata thanë: *“Në ashpërsinë e luftës, ne u thirrëm, kurse tash, si mund t’u jepet plaçka të tjerëve?”* Kjo fjalë i arritën Pejgamberit [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem], dhe ai menjëherë i tuboi, e u tha: *“O ju ensarë, ç’është ajo që po dëgjoj prej jush?”* Ata të gjithë heshën. Atëherë tha: *“O ju ensarë, a nuk jeni të kënaqur të shkojnë njerëzit tjerë me të mirat materiale të kësaj bote, ndërkaq të shkonin ju me Muhammedin, ta merrni me vete në shtëpitë tuaja?”* Ata thanë: *“Gjithsesi, o Pejgamber i Allahut, pajtohem.”* Atëherë Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] tha: *“Sikur të gjithë njerëzit tjerë të shkonin në një rrugë të gjerë, ndërkaq ensarët të shkonin në një grykë mali, unë do të shkoja në grykën e ensarëve.”* /Transmeton Buhariu/

Është e vërtetë e pakontestueshme se misionet e mëdha kanë shumë nevojë për njerëz të kalibrit të ensarëve, të cilët e mbrojnë fjalën e vet me shpirtrat e tyre dhe me tërë atë që e posedojnë; ata nuk i preokupon një interes i vogël, dhe ata asnjëherë nuk ndjekin hije të cilat humben (përfitime afatshkurtra sh. p.).

Metoda e Pejgamberit [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] lidhur me ta, me rastin e ndarjes së plaçkës, ishte vlerësimi i besimit dhe i sinqeritetit të tyre. Edhe beduinët u përfituan me pasurinë, të cilën e kishin lakmi, që mos t’i hidhnin obligimet e fesë të cilën e përqaftuan, ndërkaq me ensarët veproi në bazë të bindjes së thellë që e njihte prej tyre. Për raste të këtilla, Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] tha: *“Unë u jap disa njerëzve nga pasuria, nga frika se mos e meritoj nga Allahu dënimin me zjarr.”* /Transmeton Buhariu/

Prej zbatimit të lavdëruar të premtimit është që ta përkujtojë njeriu të kaluarën e tij, me qëllim që ta shfrytëzojë atë për të tashmen dhe ardhmërinë e vet. Nëse ka qenë i varfër, e

Allahu pastaj i ka dhënë pasuri, apo ka qenë i sëmure, e Allahu e ka shëruar, nuk është e hijshme për atë që ta ndajë të djeshmen prej të sotmes me një mur të madh, e pastaj të mendojë se asnjëherë nuk ka qenë me skamje, e as me sëmundje. Kështu, do të ndërtojë mbi iluzionet e veta, me aktualitetin e vet, një filozofi, që në tërësi do të jetë ashpërsi dhe injorim. Ky është një lloj mashtrimi, që e shpie njeriun në hipokrizi, e ndoshta me këtë edhe largohet prej mëshirës së Allahut dhe pas kësaj më nuk është i disponuar për të.

Kanë thënë se një medinas, i cili quhej Tha'lebe, një ditë erdhi në një tubim të ensarëve dhe kërkoi t'i bëhen dëshmitarë për atë që thotë: *“Nëse Allahu më jep të mira, do t'ia jap çdo njeriu atë që e meriton; po ashtu, do të jap lëmoshë dhe do t'i ndihmoj farefisit.”* Kur vdiq një djalë i axhës së tij, ky trashëgoi nga ai pasuri, por nuk plotësoi kurrgjë nga ajo që premtoi; andaj edhe zbriti ajeti: *“E prej tyre (hipokritëve) pati sish që i patën dhënë besën Allahut që: Nëse na jep (Allahu) nga mirësia e Tij, ne do të ndajmë lëmoshë dhe do të bëhemi prej punëmirëve. Kur ju dha (Allahu) nga të mirat e Veta, ata bënë koprraci me atë (që u dha), e thyen besën dhe u zmbropsën nga respekti ndaj Allahut. Dhe për shkak se e thyen besën që i patën dhënë Allahut, dhe për shkak të asaj se gënjenin, Allahu u ngjeshi hipokrizinë në zemrat e tyre deri në ditën që e takojnë Atë. A nuk e dinë ata se Allahu e di fshehtësinë e tyre (në zemra), bisedën e tyre, dhe se Ai (Allahu) i di të gjitha të fshehtat.”* (Et-Teube: 75-78)

Prej rrëfimeve të cilat e konfirmojnë fatkeqësinë e tradhtisë dhe mosrespektimit të begatisë është ai që e transmeton Ebu Hurejra prej Pejgamberit të Allahut, se ka thënë: *“Allahu i Madhërishëm deshi t'i sprovtojë tre persona prej Beni Israilëve: njëri ishte i sëmure prej leprozës, njërit i kishin rënë flokët, ndërkaq i treti ishte i verbër; andaj atyre u dërgoi një melek. Meleku shkoi tek ai që ishte i sëmure prej leprozës dhe i tha: “Çka dëshiron ti më shumë?” Ai tha: “Ngjyrë të bukur, lëkurë të bukur dhe të shërohem prej asaj që më bën të neveritshëm te njerëzit.” Meleku e preku, e prej tij shkoi fëlliqësia dhe iu dha atij ngjyrë e lëkurë e bukur! Meleku i tha: “Cilën pasuri e do më tepër?” Tha: “Devetë.” E meleku i dha një deve me*

barrë në muajin e dhjetë dhe i tha: “Allahu të dhëntë begati në të.”

Pastaj meleku shkoi te personi pa flokë dhe i tha: “Çka dëshiron më tepër?” Tha: “Flokë të mira dhe të më mënjanohet kjo që më bëri të neveritshëm te njerëzit.” Meleku e preku, e ai u shërua, dhe atij iu dhanë flokë të mira. Tha: “Cilën pasuri do më së tepërmi?” Tha: “Lopët.” Dhe iu dha atij një lopë me barrë dhe i tha: “Allahu të dhëntë begati në të.”

Pastaj shkoi tek i verbëri dhe i tha: “Çka dëshiron më tepër?” Tha: “Të ma kthejë Allahu shikimin.” Meleku e preku, dhe Allahu ia ktheu shikimin. Tha: “Cilën pasuri e do më tepër?” Tha: “Dhëntë.” E iu dha një dele me barrë.

Të gjitha këto kafshë pastaj u shtuan. Kështu, i pari bëri një kope me deve, i dyti një kope me lopë, e i treti një kope me dele.

Pastaj meleku i shkoi të sëmurit prej leprozës, në pamjen dhe formën e tij, dhe i tha: “Unë jam njeri i ngratë, mbeta i vetëm në udhëtim, sot nuk kam tjetër mbështetje, përveç në Allahun e pastaj në ty. Të betohem në emër të Atij i Cili ta dha ngjyrën e bukur dhe lëkurën e bukur, ma jep një deve ta vazhdoj udhëtimin tim.” Ai tha: “Kam shumë obligime.” Pastaj ky ia ktheu: “Sikur unë të njoh ty. A nuk vuaje prej leprozës e ishe i neveritshëm te njerëzit dhe ishe i varfër, e të begatoi Allahu?” Tha: “Assesi, po këtë pasuri e kam trashëguar nga stërgjyshërit e mi, brez pas brezi!!” Meleku tha: “Nëse gënjen, Allahu të ktheftë në gjendjen tënde të parë.”

Po ashtu, i shkoi edhe personit pa flokë, në formën e tij, dhe ia tha të njëjtat gjëra, e edhe ky ia ktheu sikur i pari. Atëherë meleku i tha: “Nëse gënjen, Allahu të ktheftë në gjendjen e parë.”

Pastaj shkoi edhe te njeriu i verbër, në formën dhe pamjen e tij, edhe atij ia tha gjërat e njëjta. Ky iu përgjigj: “Po, kam qenë i verbër, e Allahu ma ktheu shikimin, prandaj, merr çka të duash, e lë çka të duash. Për Allahun, sot nuk të rëndo për kurrëgjë që e mer me urdhrin e Allahut!!” Meleku i tha: “Mbaje pasurinë tënde, sepse ju u sprovuat. Zoti është i kënaqur me ty, e i hidhëruar me shokët e tu!” /Transmeton Buhariu/

Islami porosit që të respektohen kontratat në të cilat regjistruhen obligimet financiare dhe të ngjashme; po ashtu, Islami urdhëron në mënyrë imperative të zbatohen kushtet të cilat i përmban kontrata përkatëse. Në hadith përmendet: *“Muslimanët duhet t’u përmbahen kushteve.”* /Transmeton Buhariu/

Nuk ka dyshim se thelbi i formimit të besimit në fushën e tregtisë dhe në transaksionet e ndryshme ekonomike është kush-tëzimi i zbatimit të çdo marrëveshjeje, duke pasur parasysh atë që kushtet e shkruara duhet të jenë kompatible me normat e sheriatit islam, sepse, përndryshe, ato janë të pavlefshme dhe muslimani nuk obligohet t’u përmbahet atyre.

Islami pak më tepër kujdes i kushtoi kontratës së martesës, andaj edhe Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] thotë: *“Kushtet më meritore për t’iu përmbajtur, janë ato që ua bënë të lejuara bashkëshortet tuaja.”*

Duke u nisur nga kjo, nuk i lejohet një personi, i cili është martuar me një grua, të bëjë hile në ndonjë pjesë të pasurisë që është e drejtë e saj apo ta nënçmojë lidhjen e cila i bashkoi ata të dy. Në hadith qëndron: *“Ai njeri, i cili martohet me një grua, sado që të jetë dhurata e kurorës, pak ose shumë, dhe nuk dëshiron t’ia japë asaj hakun që i takon, e ka tradhtuar, dhe nëse vdes pa ia dhënë asaj atë që i takon, në Ditën e Gjykimit do ta takojë Allahun si njeri i cili ka bërë prostitucion! Po ashtu, ai person, i cili merr borxh prej dikujt dhe nuk dëshiron t’ia kthejë pronarit borxhin e marrë, duke e mashtruar derisa t’ia marrë të hollat, e vdes pa ia kthyer atij borxhin, do ta takojë Allahun si vjedhës!”* /Transmeton Taberaniu/

Nuk është çudi, sepse ka shumë ajete kur’anore të cilat nxisin në zbatimin e premtimeve dhe frikësojnë nga mashtrimi: *“... Premtimin zbatojeni, pse për premtim ka përgjegjësi.”* (El-Isra: 34); *“Meqë keni premtuar, pra zbatojeni premtimin e dhënë ndaj Allahut, e mos i prishni betimet pasi i keni vërtetuar ato, duke qenë se Allahun e bëtë garant tuajin. Vërtet, Allahu e di se çka punoni.”* (En-Nahl: 91)

Allahu i Madhërishëm qartë ka sqaruar se mashtrimi e humb besimin, shkakton trazira, i prish raportet e mira, e të fortit i bën të dobët dhe të plogësht, për këtë edhe thotë: *“Mos u bëni (në çështjet e betimit) si ajo (grua) që e prish tjerin e saj*

pasi ta ketë dredhur fort, e t'i bëni betimet tua ja dredhi (mashtrim) mes jush, për shkak se një popull është më i madh se tjetri. Allahu vetëm ju sprovon me këtë, e në Ditën e Gjykimit Ai gjithsesi do t'ju sqarojë atë gjë rreth të cilës kundërshtoheshit.” (En-Nahl: 92)

Njeriu mund ta prishë një kontratë që ka lidhur me dikë duke menduar se prej një kontrate tjetër do të ketë profit më të madh; po ashtu, edhe një popull mund ta prishë një marrëveshje që ka me një popull tjetër duke synuar me këtë një interes më të madh për vete; ndërkaq, feja urren që të nëpërkëmben vlerat në tregun e interesave të përkohshme, e po ashtu urren të mbyllet ndërgjegjja e njerëzve në këto qëllime të errëta dhe, njëkohësisht, ia obligon ndershmërinë individit dhe bashkësisë, me qëllim që të mbrohen kontratat në skamje dhe bollëk, fitore dhe disfatë.

Për këtë, pas imperativit për respektimin e premtimeve, Allahu i Madhërishëm thotë: ***“Mos i përdorni betimet tua ja për dredhi mes jush, e të rrëshqitni pas forcimit, e të shijoni të keqen (e dredhisë) për shkak se penguat (të tjerët) nga rruga e Allahut, e ju do të keni dënim të madh. Mos e shitni besën e dhënë Allahut për një vlerë të paktë, pse atë që do ta keni tek Allahu është shumë më e dobishme për ju nëse jeni që e dini.***” (En-Nahl: 94-95)

Zbatimi i premtimeve është obligim, edhe kur është në pyetje besimtari edhe jobesimtari, sepse vlerat nuk copëzohen, ashtu që njeriu të jetë i ulët me disa njerëz, kurse fisnik me disa tjerë. Pra, punët sillen krejt rreth mbajtjes së premtimit; nëse përmbajtja e tij është për të mirë, atëherë miratimi i tij është akt i kryer për çdo individ dhe në çdo kohë. Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem], për paktin e të vyeshmëve (që u realizua në xhahilijet - para Islamit), deklaroi: ***“Sikur të më thirrte dikush në emër të tij në Islam, do t'i përgjigjesha.”***

Transmetohet prej Amr Ibën Hamikas, i cili thotë: ***“E kam dëgjuar Pejgamberin e Allahut duke thënë: “Cilido njeri që i jep garanci dikujt, se nuk do ta vrasë, e pastaj kthehet dhe e vret, unë jam larg vrasësit, edhe po të jetë i vrari mosbesimtar.”***
/Transmeton Ibën Hibbani/

Kjo deklaratë shpalos natyrën e Islamit në trajtimin e atyre të cilët nuk i përkasin atij. Ndërkaq, nga ana tjetër, çifutët e mohojnë domosdoshmërinë e zbatimit të premtimit ndaj joçifutëve dhe ua ndërpresin atyre sjelljen njerëzore, duke supozuar se vetëm ata janë “bijtë e Zotit dhe të dashurit e Tij”, dhe se Allahu mëshirën dhe sigurinë e Vet ua fali vetëm izraelitëve. Kurse, Islami, me këmbëngulje të madhe i mbron ata të cilëve u ka dhënë mbrojtje dhe të cilët i ka futur nën ombrellën e vet, andaj edhe u flet muslimanëve për mosbesimtarët me fjalë të cilat kanë qëllimin e vet.

“O ju që besuat! Mos i shkelni simbolet e Allahut, e as muajin e shenjtë (mos lejonit luftën), as kurbanin (mos e pengoni), e as atë me qafore (të caktuar për kurban), as (mos pengoni) ata që duke kërkuar begati nga Zoti i tyre dhe kënaqësinë e Tij, kanë mësyre (për vizitë) shtëpinë e shenjtë (Qaben). E kur të hiqni ihramin, atëherë gjahtoni. Urrejtja ndaj një populli, që iu pat penguar nga xhamia e shenjtë, të mos ju shtyjë të silleni në mënyrë të padrejtë kundër tyre. Ndhimohuni mes vete me të mira dhe në të mbara, e mosni në mëkate e në armiqësi. Kini dro dënimit të Allahut, se me të vërtetë Allahu është ndëshkues i fortë.” (El-Maide: 2)

Shih pra, si e ilustroi ajeti kur’anor pikëpamjen e idhujtarëve; ai eci me iluzionet e tyre, edhe pse ishin idhujtarë, dhe i konsideroi kërkuar të begatisë nga Zoti dhe kënaqësisë së Tij dhe po ashtu, kërkoi prej muslimanëve që, sado që të forcohen, të ndihmohen mes vete me të mira dhe në të mbara e jo në mëkate e në armiqësi.

Në disa vende të tjera¹ kemi folur për marrëveshjet ndërmjet muslimanëve dhe të tjerëve, e po ashtu edhe për rregullat të cilat i zbriti Allahu përkitazi me këtë; andaj, kush dëshiron, le t’i konsultojë.

Prej çështjeve të cilave Islami u kushtoi kujdes të duhur dhe ia lartësoi vlerën e zbatimit janë borxhet, sepse pastrimi i tyre është prej obligimeve më të forta tek Allahu. Në këtë aspekt feja kategorikisht i ka mposhtur cytjet e shpresës, të

¹ Në librat tona: “Te’emulat fid-dini vel hajat” dhe “Et-teasub ve et-tesamuh”.

cilat e zvarrisin borxhliun dhe e mashtrojnë me zvarritje në pagimin e borxhit apo shtimin e afatit të kthimit.²

Masa e parë të cilën e mori Islami në këtë drejtim është ajo se e ndaloi marrjen e borxhit, me përjashtim të nevojës së patjetërsueshme. Ndërkaq, prej situatave kritike është që njeriu të marrë borxh për çështje të panevojshme; bile është transmetuar se kjo është prej mëkateve të cilat meritojnë masë ndëshkuese: *“Borxhi do t’ia shqiptojë dënimin huamarrësit, kur do të vdesë në Ditën e Gjykimit, me përjashtim të atij i cili merr borxh për tre raste: Personi i cili dobësohet në rrugë të Allahut dhe merr borxh me qëllim që të forcohet për t’i bërë ballë armikut të Allahut dhe armikut të tij; personi tek i cili vdes një musliman, e ky nuk ka mundësi ta mbështjellë me qefin dhe ta varrosë ndryshe, por vetëm se me borxh; dhe një person i cili nuk është sigurtë të mbetet si beqar, andaj martohet me qëllim që mos t’i shkelë normat fetare. Allahu do t’ua heqë barrën e tyre Ditën e Gjykimit.”* /Transmeton Ibën Maxhe/

Në një transmetim tjetër qëndron: Pejgamberi [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] ka thënë: *“Allahu do ta thërrasë borxhliun në Ditën e Gjykimit dhe kur do të qëndrojë ai para Tij, do t’i thuhet: ‘O bir i Ademit, për çka e more këtë borxh? Për çka ua ha njerëzve hakun e tyre?’* Ai do të thotë: *‘O Zot, Ti e di se unë e mora borxhin, por nuk hëngra, nuk piva, nuk vesha, dhe nuk mora nëpër këmbë kurrgjë prej tij, por mua më goditi, ose djegia, ose vjedhja, ose konfiskimi!’* Allahu do të thotë: *‘Ishte korrekt në fjalë rob i Im, Unë jam më meritori që ta laj borxhin ty.’* Allahu do të urdhërojë t’i sillet një gjë dhe do ta ven në njërën anë të peshojës, kur ajo do ta bëjë që veprat e mira t’i rëndojnë veprat e këqija. Me këtë do të hyjë në Xhenet, falë mëshirës së Allahut.” /Transmeton Ahmed/

Prej kësaj shihet qartë se Allahu e pranon arsyetimin e atij i cili detyrohet të marrë borxh për kriza të rënda dhe nuk mund ta kthejë për shkak të katastrofave të papritura që e godasin.

Ndërkaq ai të cilin e përshkojnë lloj-lloj pasionesh, dhe është i pafuqishëm që me mjete personale t’i kënaqë ato, andaj

² Po aty

nxiton të marrë borxh prej tjerëve, pa shikuar në pasojat e tij dhe pa u interesuar për mënyrën e larjes së borxhit të marrë, ky, siç e karakterizojnë transmetimet, është vjedhës i tërbuar. Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] thotë: *“Kush u merr njerëzve pasuri, me qëllim që t’ua kthejë, këtë në vend të tij e kryen Allahu, ndërkaq, kush ua merr këtë, me qëllim të shkatërrimit të saj, atë do ta shkatërrojë Allahu.”* /Transmeton Buhariu/

Islami orvatet që borxheve t’u jepen garanca të ndryshme, të trajtohen ato si pasuri të gjalla, ashtu që larja e tyre të shihet si grusht i rëndë dhe të mos tentojë asnjëri që t’i ikë kryerjes së obligimit të marrë, bile edhe me pretekst të kryerjes së ritualeve të tjera me shpërblim të madh.

Transmetohet prej Ebu Katades [radijAllahu anhu], se një njeri ka thënë: *“O Pejgamber i Allahut, nëse vritem në rrugë të Allahut, a do të më falen gabimet e bëra?”* Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] tha: *“Po, gjithsesi, nëse vritesh duke qenë durimtar dhe duke shpresuar në shpërblimin e Zotit, duke marshuar përpara e jo duke u zmbrapsur pas!”* Pastaj tha: *“Si the?”* E ai e përsëriti, dhe vazhdoi: *“Veç borxhit, sepse këtë ma tregoi Xhibrili.”* /Transmeton Muslimi/

Në një transmetim tjetër qëndron: *“Shehidit i falet çdo mëkat, përveç borxhit.”* /Transmeton Muslimi/

Posa e kuptuan njerëzit e mençur rrezikun e borxhit për përgjegjësinë e muslimanit në botën tjetër dhe peshën e tij, këshillonin që njeriu të pastrohet prej tij para se t’i ekspozohet ndonjë rreziku që mund ta rrëmbejë jetën e tij.

Transmetohet prej Ebu Derdasë, se ai qëndronte në rrugën në të cilën kalonin njerëzit për të shkuar në xhihad dhe bërtiste me zë të lartë që ta dëgjojnë: *“O ju njerëz, cili prej jush ka ndonjë borxh dhe mendon se nëse goditet në fytyrë kjo nuk do t’ia lërë obligimin e pagesës së tij, le të kthehet e le të mos më pasojë, sepse ai nuk kthehet i pastër.”* /Transmeton Rezini/

Disa prej muslimanëve janë treguar shumë të pakujdesshëm ndaj borxheve, i kanë huazuar për t’i kënaqur epshtet e liga në barqe dhe organe gjenitale; po ashtu, borxhet i kanë marrë prej çifutëve dhe krishterëve me kamatë, të cilën në mënyrë decide

e ka ndaluar Allahu, prej gjurmëve të së cilës qenë katastrofat tragjike që ua sollën vendeve dhe pasurive të tyre.

Larja e borxheve ende po ngec dhe, po të mos ishte fuqia e ligjit, do të nëpërkëmbeshin shumë obligime.

Allahu i do robërit e Tij të cilët i zbatojnë premtimet, ndërsa popujt tiranë i shkatërroi vetëm pasi tha për ta: ***“Ne te shumica e tyre nuk gjetëm zbatimin e premtimit, e gjetëm shumicën e tyre jashtë bindjes (respektit).”*** (El-A’raf: 102)

SINQERITETI

Motivet të cilat e tërheqin njeriun në punë, të cilat e shtyjnë që ta kryejë atë në mënyrë të përkryer dhe e stimulojnë t'i përballojë mundimit në të apo të investojë shumë për të, janë të shumta dhe të ndryshme. Disa prej atyre motiveve janë të afërta, gati mund të shihen edhe me punën, ndërkaq disa të tjera janë të mbyllura, të cilat fshihen në thellësitë e shpirtit. Ndoshta njeriu mund të mos e vërejë faktorin nga i cili është ndikuar, edhe pse ai, në fakt, është sekreti i shtytjes për veprimin e asaj që e ka bërë apo që nuk e ka bërë.

Instinktet e njohura njerëzore janë kriteret e sjelljes së përgjithshme. Lehtë është ta identifikosh, në lëvizjet e njeriut para teje, dashurinë e tij ndaj vetes, kërkimin e shpëtimit, lakminë e tij ndaj pasurisë, animin e tij kah mburrja, apo oreksin e tij për dominim.

Në të shumtën e rasteve ndjenjat e pëlqimit, urrejtjes, imitimit apo menjemadhësisë janë burim i bisedave që zhvillohen në mes njerëzve dhe veprimeve që ndodhin në mes tyre.

Islami me vëmendje të madhe i ndjek qëllimet të cilat i përcjellin veprat e njerëzve, si dhe ndjenjat e reagimet të cilat i shoqërojnë ato.

Vlera e punës në Islam, para së gjithash, kthehet në natyrën e motiveve të cilat e nxitën atë.

Njeriu mund të japë dhuratë të mrekullueshme sepse ai dëshiron me artin e bamirësisë t'i përfitojë zemrat, ndërsa disa herë mund të japë sepse dëshiron t'ua kthejë me mirësi atyre që i paraprinë dhe i bënë të mira.

Të dy metodat janë nder për të cilin stimulon ndjenja e njeriut, pozitive apo negative, në veten e vet, siç e shprehin këtë psikologët. Mirëpo, Islami e merr parasysh sadakanë (lëmo-

shën) vetëm nëse ajo është e pastër nga njollat e pasioneve, dhe nëse është e sigurtë, vetëm për hir të Allahut, siç e përshkruan këtë Kur'ani fisnik:

“Ne po ju ushqejmë vetëm për hir të Allahut dhe prej jush nuk kërkojmë ndonjë shpërblim e as falënderim.” (El-Insan: 9)

“Ai që jep pasurinë e vet e pastrohet. E jo për ta shpërblyer ndokë që i ka bërë mirë më parë. Por vetëm për të fituar kënaqësinë e Zotit të vet, më të lartit. Për Zotin, ai do të gëzojë atë kënaqësi!” (El-Lejl: 18-21)

Me qëllim të konsolidimit të orientimeve të zemrës dhe sigurimit të zhveshjes së saj nga pasionet e ulëta, Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] thotë: *“Veprat shpërblehen sipas qëllimeve, dhe çdokujt i takon ajo që e ka për qëllim. Prandaj, kush shpërngulet për hir të Allahut dhe të Dërguarit të Tij, shpërngulja e tij mbetet tek Allahu dhe i Dërguari i Tij. Ndërsa shpërngulja për disa të mira të kësaj bote, ose që të marthohet me ndonjë femër mbetet për atë çka ka pasur për qëllim.”*
/Transmetojnë Buhariu dhe Muslimi/

Mijëra udhëtarë e kalojnë rrugën prej Mekkes në Medine për aspirata të ndryshme, mirëpo qëllimi i ngadhnjimit të fesë dhe jetësimi i saj është ajo që e dallon muhaxhirin (atë që shpërngulet me motive fetare sh.p.) nga udhëtari i thjeshtë, edhe pse forma e veprimit është e njëjtë për të dytë.

Për atë, kush e lë Mekken dhe shkon në Medine duke ikur e ruajtur besimin e vet nga sprovimet dhe me qëllim të ngritjes së kalasë së shtetit të ri në truallin e vet të ri, personi i këtillë është muhaxhir; ndërkaq ai që udhëton për çështje të tjera ai nuk ka asgjë të përbashkët me hixhretin (shpërnguljen).

Qëllimi i shëndoshë dhe zemra e sigurtë për Zotin e botëve e lartësonë pozitën e një pune të thjeshtë të kësaj bote dhe e shndërron në adhurim të pranuar.

Në të kundërtën, i shkatërron edhe qëllimet e errta dhe adhurimet ekskluzive dhe i shndërron në mëkate të shëmtuara, ashtu që njeriu nuk fiton prej tyre asgjë përveç lodhjes në kryerjen e tyre veç dështimit dhe humbjes.

Njeriu ndodh që të ndërtojë një pallat me mure të larta e të gjera; po ashtu, mund të mbjellë një kopsht me degë të kthyer dhe fryte të lëshuara. Ai ndërmjet pallatit të tij të lartë dhe kopshtit të rregulluar bukur konsiderohet prej mbretërve të botës; mirëpo, nëse ai, përmes pallatit dhe mbjelljes, ka patur për qëllim të ndihmojë njerëzit, ai prej tyre do të ketë sevap të pandalshëm.

Pejgamberi [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] thotë: *“Kush e ndërton një ndërtesë, pa i bërë tjetrit padrejtësi dhe armiqësi, apo, kush mbjell diçka, pa i bërë tjetrit padrejtësi dhe armiqësi, atij do t’i vazhdojë shpërblimi derisa atë do ta shfrytëzojë ndonjë prej krijesave të Allahut të Lartësuar.”* /Transmeton Ahmed/

“Çdo musliman, që mbjell ndonjë pemë apo bimë, dhe prej saj ha ndonjë shpezë apo njeri, ajo do të jetë për atë sadaka.” /Transmeton Muslim/

Bile edhe kënaqësitë të cilat i ka lakmi njeriu, nëse janë me qëllim të mirë dhe cak fisnik, marrin karakter adhurimi fetar. Kështu, kur njeriu ka marrëdhënie intime me bashkëshorten e vet, e me këtë ka për qëllim që ta mbrojë nderin dhe mos t’i shkelë normat fetare, ai në këtë ka shpërblim; “edhe në marrëdhëniet tuaja legjitime ka lëmoshë.”

Po ashtu, ajo me të cilën e ushqen veten, si dhe fëmijët e bashkëshorten e tij, ka shpërblim në bazë të qëllimit të mirë i cili e shoqëron.

Transmetohet nga Sa’d Ibën Ebi Vekasi, se Pejgamberi i Allahut i ka thënë atij: *“Çdo gjë që e jep lëmoshë, duke e kërkuar me të kënaqësinë e Allahut, shpërblehesh për të, bile edhe për atë me të cilën e ushqen gruan.”* /Transmeton Buhari/

Pejgamberi i Allahut thotë: *“Ajo me të cilën e ushqen veten është lëmoshë për ty, ajo me të cilën e ushqen fëmijën tënd është lëmoshë për ty, ajo me të cilën e ushqen gruan tënde është lëmoshë për ty, ajo me të cilën e ushqen robin tënd është lëmoshë për ty.”* /Transmeton Buhari/

Është realitet se, pasi njeriu i është nënshtruar Allahut dhe e ka pastruar qëllimin e tij, lëvizjet dhe qëndrimet e tij, gjumi dhe zgjuarja e tij konsiderohen hapa për të arritur te kënaqësia

e Allahut. Dikush ndoshta mund të mos ketë mundësi ta kryejë një vepër të mirë të cilën e dëshiron, për shkak të mungesës së pasurisë apo dobësisë së shëndetit, mirëpo Allahu i di fshehtësitë e shpirtave dhe, atë që e dëshiron reformën, e ngren në pozitë e reformatorëve, atë që lakmon xhihadin, e ngre në gradat e muxhahidëve (luftëtarëve), sepse karakteri i dëshirës së tyre tek Allahu i Madhërishëm rëndon më tepër sesa pamundësia e mjeteve.

Në betejën e Tebukut, te Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] erdhën disa burra të cilët dëshironin t'i luftojnë mosbesimtarët bashkë me të dhe ta sakrifikojnë veten në rrugë të Allahut, mirëpo Pejgamberi i Allahut nuk mundi t'i pajisë me armë. Ata u kthyen, por u ishte tharrë pështyma nga brengosja pse nuk morën pjesë në betejë. Për këta ka zbritur ajeti kur'anor: *“(nuk ka qortim) Dhe as për ata që kur erdhën te ti për t'i bartur me kafshë, u the: Nuk kam me çka t'ju bartë. Ata u kthyen, e prej pikëllimit pse nuk kishin me çka te përgatiteshin nga sytë e tyre rridhnin lotë.”* (Et-Teube: 92)

A mendon se Allahu do ta çojë kotë këtë bindje të fortë dhe këtë dëshirë të madhe për sakrifikim? Assesi! Për këtë edhe Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] e çmoi lartë besimin dhe sineritetin e atyre njerëzve. Për këtë i tha ushtirisë marshuese: *“Në Medine lamë disa njerëz të cilët ishin me ne gjatë tërë udhëtimit, ata u ndaluan me shkak.”* /Transmeton Buharriu/ Qëllimi i sinqertë ua regjistroi atyre shpërblimin e muxhahidëve, sepse ata u ndalën përkundër dëshirës së tyre. Nëse qëllimi i shëndoshë ia atribuon bartësit të saj këtë pranim të gjerë, edhe qëllimi jo i sinqertë i bashkangjitet punës së mirë në formën e saj dhe bashkë me të shndërrohet në mëkat që meriton shkatërrim: *“Pra shkatërrim është për ata që falen. Të cilët ndaj namazit të tyre janë të pakujdesshëm. Ata që vetëm shtiren (sa për sy e faqe). Dhe nuk japin as sendin më të vogël (as hua).”* (El-Maun: 4-7)

Namazi me hipokrizi është krim dhe, pasi e ka humbur shpirtin e sineritetit, është shndërruar në formë të vdekur në të cilën nuk ka dobi. Po ashtu, edhe zekati nëse ai jepet me zemër bujare, për hir të Allahut, do të pranohet tek Ai, përndryshe është vepër e pavlerë *“O ju që besuat, mos i prishni*

lëmoshat tuaja me të krenuar e me ofendim, siç bën ai që jep pasurinë e vet sa për sy e faqe të njerëzve, e nuk e beson Allahun as botën tjetër. Shembulli i tij është si një guri i madh e i lëmuar që mbi të ka pak dhé, e kur e godet atë një shi i madh e lë të zhveshur (lakuriq). Ata (formalistët) nuk arrijnë asgjë nga ajo që punuan. Allahu nuk e udhëzon popullin jobesimtarë.” (El-Bekare: 264)

Zemra e zbrazët nga sinqeriteti nuk mbin pranim, ashtu siç nuk nxjerr fryte guri i mbuluar me dhé. Lëvoret mashtruese nuk i sjellin asnjë dobi thelbit të prishur.

Sa i shkëlqyeshëm është sinqeriteti dhe sa i madh është bereketi i tij! Kur gjendet te një punë, sado që të jetë ajo e vogël, e zhvillon dhe e rrit, derisa të peshojë sa mali; ndërkaq, ka punë të mëdha në dukje, por që janë të zbrazëta nga sinqeriteti, e të cilat tek Allahu nuk peshojnë asgjë. Për këtë Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] thotë: *“Bëhu i sinqertë në fenë tënde, do të të mjaftojë edhe puna e vogël.”* /Transmeton Hakimi/

Nga kjo shihet se ndryshimi i shpërblimeve, që janë paraparë për punët e mira, prej dhjetë fish deri në shtatëdhjetë fish e më tepër, është i lidhur me sekretin e sinqeritetit, i fshehur në brendinë e shpirtit, e të cilin nuk mund ta dijë askush tjetër, përveç Njohësit të së padukshmes (gajbit) dhe të dukshmes. Pra, në bazë të kthjelltësisë së ndërgjegjes dhe gjerësisë së dobisë shkruhen shumëfishimet.

Nuk është ana e jashtme e njeriut dhe ana e jashtme e jetës së kësaj bote ajo të cilës Allahu i Madhërishëm ia dhuron Kënaqësinë e Vet, sepse Allahu i Madhërishëm përkujdeset për robërit e Vet të qetë dhe të sinqertë, dhe e pranon prej tyre atë me të cilën ata i afrohen Atij, ndërkaq, për sa u përket gjërave të tjera prej luksit të kësaj bote dhe lakmive të tepërta të njerëzve, kjo nuk ka vlerë dhe kësaj nuk i kushtohet vëmendje. Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] thotë: *“Me të vërtetë Allahu nuk shikon në trupat dhe format tua, por shikon në zemrat dhe veprat tua.”* /Transmeton Muslimi/

Po ashtu, në hadith përmendet: *“Ditën e Gjykimit do të sillet dunjaja, e prej saj do të veçohet ajo që ka qenë për hir të*

Allahut, ndërkaq ajo që nuk ka qenë për hir të Allahut, do të hidhet në zjarr të Xhehenemit.” /Transmeton Bejhekiu/

Kush e lidh jetën e vet me këto të vërteta, ai do të jetë i qetë në jetesën e vet, nuk do ta dëmtojë ajo që ka humbur e as që do ta dëshpërojë ajo që ka ofruar.

Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] thotë: *“Kush ndahet nga kjo botë me sinqeritet ndaj Allahut të Vetëm e të Pashoq, e fal namazin dhe e jep zekatin, e lë këtë botë e Allahu me të është i kënaqur.” /Transmeton Ibën Maxhe/*

Kjo është në pajtim me Fjalën e Allahut të Madhërishëm: ***“E duke qenë se ata nuk ishin të urdhëruar me tjetër, pos që ta adhuronin Allahun me një adhurim të sinqertë ndaj Tij, që të largohen prej çdo besimi të kotë, ta falin namazin, të japin zekatin, se ajo është feja e drejtë.” (El-Bejjine: 5)***

Rrezet e sinqeritetit ndriçojnë në shpirt, kurse më tepër shkëlqejnë në vështirësitë e rënda; në rastet e tilla njeriu zhveshet nga epshet e veta, distancohet nga mëkatet e veta dhe qëndron në oborrin e Allahut i penduar, shpreson në mëshirën e Tij dhe frikohet prej dënimit të Tij.

Kur’ani Famëlartë e ka ilustruar trishtimin e njeriut në huti dhe strehimin e tij te Zoti duke i kërkuar Atij ndihmë, që ta nxjerrë nga kurthi në të cilën ka rënë: ***“Thua: “Kush ju shpëton prej errësirave (trishtuese) të tokës e të detit e (nga trishtimi) ju e lutni atë haptas e fshehtas (duke thënë), nëse Ai na shpëton prej kësaj, ne do të jemi (besimtarë) mirenjohës? Thua: “Allahu ju shpëton nga ajo dhe nga çdo brengosje. Megjithëkëtë ju Atij i përshkruani shok.” (El-En’am: 63-64)***

Ky sinqeritet është i rastësishëm, ndërkaq ngjarjet të cilat e godasin dhe largohen nga njeriu nuk janë karakter konstante, kurse Allahu i Madhërishëm dëshiron që njerëzit ta njohin drejt Atë, ta respektojnë si duhet, çdo herë, edhe në gëzim edhe në vështirësi, ta bëjnë sinqeritetin konstant në sjelljen e tyre, ashtu që të mos përfundojë lidhja e tyre me të dhe mos të kenë për qëllim me punën e tyre dikë tjetër, përveç Allahut.

Por zjarri i sinqeritetit shuhet dalëngadalë, saherë që në shpirt zgjohen tendencat e egoizmit dhe dëshira për lavdërim, arritja e autoritetit dhe e famës, aspiratat për ngritje dhe kre-

nari, sepse Allahu e do punën e kulluar nga njollat ndytëse:
“Vini re! Adhurim i sinqertë është vetëm ai për Allahun!”
(Ez-Zumer: 3)

Natyra e vlerës është sikur natyra e frytit të pjekur me qëllim të mbrojtjes së tij dhe pastërtisë e ëmbëlsisë së tij, ai duhet të jetë i pa prishur dhe pa sëmundje.

Islami e proklamoi urrejtjen e tij të ashpër ndaj formalizmit në veprat e mira, dhe e konsideroi përshkruarje shok Zotit, Mbikëqyrësit të botëve.

Nuk ka dyshim se formalizmi është prej sëmundjeve më të rrezikshme për veprat. Nëse i plotëson ciklet e veta dhe e përfundon ciklin e vet në shpirt, ashtu siç i plotësojnë viruset e kolerës periudhat dhe ciklet e veta, bëhet një prej formave të idhujtarisë, e cila e hedh bartësin e saj në zjarrin më të keq.

Pejgamberi i Allahut thotë: *“Formalizmi i lehtë është idhujtari (shirk). Ai i cili i kundërshton miqtë e Allahut (njerëzit e devotshëm sh.p.), i ka shpallur luftë Allahut. Me të vërtetë, Allahu i do njerëzit e mirë, të devotshëm dhe të fshehtë të cilët, nëse mungojnë, nuk humben, e nëse prezantojnë, nuk njihen; zemrat e tyre janë kandila të udhëzimit.”* /Transmeton Hakimi/

Transmetohet prej Ibën Abbasit, se një njeri tha: *“O Pejgamber i Allahut, unë kryej një punë duke pasur për qëllim kënaqësinë e Allahut, e po ashtu dëshiroj të shihet edhe munda im.”* Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] nuk ia ktheu atij, derisa zbriti ajeti: ***“... e kush është që shpreson takimin e Zotit të vet, le të bëjë vepër të mirë, e në adhurimin ndaj Zotit të tij të mos e përziejë askë.”*** (El-Kehf: 110)

Fushatat e Islamit ishin kaq të ashpra ndaj formalizmit dhe sëmundjeve të tjera, të cilat rezultojnë nga humbja e sinqeritetit, për shkak se ato janë plangprishësi e ndërlikuar dhe metodë e kamufluar në spastrimin e epsheve të ngulfatura.

E keqja e hapur lind krim, dhe kështu në shoqëri bëhet krim. Ajo, pra, është e urryer dhe e përbuzur, e ndoshta kryesi i saj, për shkak të ndjenjës së irritimit të saj, do të pendohet herët a vonë.

Ndërkaq, vepra e shëmtuar, e cila paraqitet në petkun e një rituali fetar obligativ, është e keqe e llahtarshme për kryesin e saj dhe për shoqërinë. Ngase kryesi i saj e kryen atë duke i plotësuar dëshirat e veta, e njëkohësisht mendon se me të e ka kënaqur Allahun. Si do ta vërejë ai se ka bërë një mëkat? Dhe si të pendohet nga ajo që pohon se është për të mirë?

Ndërkaq, të këqijat që e godasin shoqërinë e përgjithshme nga autoritativët hipokrit janë më të dhembshme se të këqijat të cilat e godasin atë nga krimet e rëndomta të huliganëve.

Sinqeriteti i dobët te shumë të talentuar e bëri popullin të vuajë dhe nga talenti i tyre edhe të zmbrapset.

Po ashtu, ndotja e vlerave fisnike me ndytësitë e epshit, është agresion ndaj pozitës së tyre dhe orvatje sistematike për rrënimin e prestigjit të tyre; ndërkaq, ky është një mëkat tjetër i cili lind nga humbja e sinqeritetit. Andaj, njeriu që me punët e veta ka për qëllim ekspozimin para njerëzve dhe e lë pas shpine kënaqësinë e Zotit, është njeri i cili nuk di se çka bën nga mendjelehtësia. Ai e braktis të Plotfuqishmin, të Pasurin, të Lartësuarin, e të Nderuarin dhe u drejtohet varfanjakëve të dobët, të cilët nuk kanë fuqi dhe mbështetje. Për këtë edhe Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] thotë: *“Kur do t’i tubojë Allahu të gjithë njerëzit për Ditën e Kijametit, për ditën në të cilën nuk ka dyshim, një thirrës do të tërrasë: “Kush ka shoqëruar me Zotin edhe dikë tjetër në punën e tij, le ta kërkojë shpërblimin e vet tek ai, sepse Allahu nuk ka aspak nevojë që t’i shoqërohet dikush.”* /Transmeton Tirmidhiu/

Luftëtarët, qofshin ushtarë apo komandantë, e kanë për detyrë që xhihadin e vet ta pastrojnë nga njollat, sepse ata jetën dhe vdekjen e tyre e kanë lidhur për një obligim të shenjtë; pranë tij minimizohen ofiqet, gradat dhe simbolet, dhe le t’i japin përparësi asaj që për ta ka përgatitur Allahu, e le t’i ndalin aspiratat e tyre në sakrificën e pritur dhe të çmuar.

Transmetohet nga Abdull-llah Ibën Amr Ibën El-Asi, i cili thotë: Thashë: *“O Pejgamber i Allahut, më lajmëro për xhihadin dhe luftën”, ai tha: “O Abdull-llah Ibën Amr, nëse lufton me durim dhe duke llogaritur në shpërblimin e Zotit, t’i do të ringjallesh durimtar dhe duke llogaritur në shpërblimin e Zotit. E nëse lufton për sy e faqe, e për mburrje, Allahu do të të*

ringjallë formalist dhe kryelartë. O Abdull-llah Ibën Amr, në çfarë gjendje di të luftosh apo të vrites, Allahu do të ringjallë në atë gjendje!” /Transmeton Ebu Davudi/

Po ashtu, edhe funksionari në punën e tij duhet ta konsiderojë atë që e shkruan, atë që e llogarit, atë të cilën e mendon, dhe atë në të cilën i lodhet dora e tij vepër me të cilën ka për synim interesin e popullatës dhe kënaqësinë e Allahut.

Shtaza mund të lodhet gjatë tërë ditës për ta arritur ushqimin e vet, ndërkaq njeriu mund të bjerë me vlerën e mundit të vet në pozitën e kafshës, e të jetë puna e tij vetëm për të marrë pagë. Mirëpo, njeriu i mençur e konsideron të shtrenjtë të menduarit dhe aktivitetin e vet dhe i përgatit ato për një gjë më të lartë.

Por, për fat të keq, ka shumë funksionarë të cilët nuk kuptojnë gjë tjetër përveç logjikës së pasurisë, gradës dhe ngritjes, andaj edhe e vlerësojnë fenë dhe këtë botë vetëm brenda këtyre kornizave dhe e lidhin kënaqësinë e hidhërimit, lodhjen dhe aktivitetin e tyre, me këto standarde të deformuara.

Pejgamberi i Allahut ka thënë: *“Në fund të botës populli im do të ndahet në tre grupe: Një grup sinqerisht do ta adhurojnë Allahun, një grup do ta adhurojnë Allahun formalisht (për sy e faqe), ndërkaq grupi i tretë do ta adhurojnë Allahun me qëllim që t’i plaçkisin njerëzit. Kur Allahu do t’i tubojë në Ditën e Gjykimit, do t’i thotë atij që i ka plaçkitur njerëzit: ‘**Të betohem në Fuqinë dhe Madhërinë Time, çka ke patur për qëllim me adhurimin ndaj Meje?**’ Ai do të thotë: ‘Pasha Fuqinë dhe Madhërinë Tënde, me atë adhurim i plaçkita njerëzit.’ (Zoti) Thotë: **“Nuk do të bëjë dobi ajo që e ke tubuar, hidheni atë në zjarr!”** Pastaj do t’i thotë atij i cili ka adhuruar formalisht (për sy e faqe): **“Të betohem në Fuqinë dhe Madhërinë Time, çka ke patur për qëllim me adhurimin ndaj Meje?”** Do të thotë: **“Pasha Fuqinë dhe Madhërinë Tënde, e bëra që të më shohin njerëzit!”** Do të thotë: **“Tek Unë nuk ka arritur asgjë prej tij, hidheni në zjarr!”** Pastaj do t’i thotë atij i cili ka qenë i sinqertë në adhurimin e vet: **“Të betohem në Fuqinë dhe Madhërinë Time, çka ke patur për qëllim me adhurimin ndaj Meje?”** Do të thotë: **“Pasha Fuqinë dhe Madhërinë Tënde, Ti e di më mirë se çka kam patur për qëllim me adhurimin tim;***

me të pata për qëllim përmendjen dhe kënaqësinë Tënde.”
(Zoti) *Do të thotë: “Ishte korrekt rob i Im, dërgojeni në Xhenet këtë.”* /Transmeton Taberaniu/

Sinqeriteti i thellë më së shumti u duhet fushave të shkencës dhe kulturës, sepse dituria është gjëja më e lartë me të cilën i dalloj Allahu të ndershmit prej krijesave të Veta, andaj edhe është nënçmim i turpshëm për të që t’u nënshtrohet faktorëve destruktiv, si dhe të përzihen me të epshet dhe trazirat. Botën nuk e kanë goditur plagët vdekjeprurëse të tjetërkujt, përveçse nga dijetarët të cilët i kanë humbur virtytet e vyeshme dhe objektivitetin e lavdëruar...

Islami ua ka bërë obligim, sikur mësuesit ashtu edhe nxënësit, që t’u qasen sinqerisht shkencës dhe para së gjithash t’i kenë parasysh shembujt magjepsës dhe interesin e përgjithshëm. Arsimimi i njerëzve dhe kërkimi i diturisë vetëm për hir të pasurisë, duke synuar interesin personal, siç është kjo shprehje e mijëra njerëzve në kohën tonë, në fakt është nëpërkëmbje e vlerës së diturisë dhe humbje e misionit madhështor. Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] thotë: *“Kush mëson diçka me të cilën synohet kënaqësia e Allahut, e ai këtë e bën vetëm që të arrijë ndonjë interes të kësaj bote, në Ditën e Gjykimit nuk do ta nuhasë erën e Xhenetit.”* /Transmeton Ebu Davudi/

Islami, po ashtu, e urren që një njeri të kërkojë dituri dhe, kur të arrijë në shkencë ndonjë gradë, t’u tregohet me të njerëzve mendjemadh dhe ta përdorë atë si mjet për aventurë dhe ekspozim.

Në hadith qëndron: *“Mos mësoni dituri që t’u konkuron dijetarëve, e as t’u shiteni mendjelehtëve, si dhe as t’i zgjidhni tubimet. E kush e bën këtë, dijeni se e pret zjarri, zjarri!”* /Transmeton Ibën Maxhe/

Shkenca, me të gjitha degët e saj të kësaj bote dhe botës tjetër, nuk ka lulëzuar e as që ka arritur në këtë shkallë ndryshe por vetëm se me qasje të sinqertë dhe me lartësim nga qëllimet e ulëta.

Mirëpo, kjo assesi nuk do të thotë që të ngarkohen dijetarët dhe kërkuesit e diturisë që të jetojnë jetë të vështirë dhe t’u ekspozohen krizave të mëdha, sepse qëllimi i sinqertë nuk kush-tëzon vuajtjen e të sinqertit dhe dëmtimin e tij.

Mangësitë e lindura nga humbja e sinqeritetit janë të shumta dhe nëse shumohen, e zhdukin besimin, e nëse janë të pakta, atëherë lënë në të boshllëqe nga të cilat depërton djalli.

Allahu i Madhërishëm hidhërohet me ata që kanë qëllime personale, me ata që ekspozohen dhe me robërit e pasurisë dhe autoritetit, sepse muslimani duhet t'i sakrifikojë interesat, raportet dhe epshet për hir të Allahut, e jo t'ia kthejë shpinën Zotit për shkak të tyre.

Magjistarët e faraonit ishin dëshmi e bindjes së vërtetë dhe e sinqeritetit të lartë kur i refuzuan ofertat, e përbuzën kano-sjen e ashpër, dhe e hodhën poshtë dëshirën e pasurisë dhe autoritetit kur i thanë mbretit tiran: ***“... e ti bëje atë që mendon ta bësh, dhe mund të zbatosh vetëm atë që i takon jetës së kësaj bote! Ne i besuam Zotit tonë që Ai të na i fal gabimet tona dhe magjinë, me të cilën ti na detyrove. Allahu është më i miri (në të shpërblyerit) dhe më i përjetshmi (në të dënuar)!”*** (Ta Ha: 72-73)

Nuk mund të krahasohen ata të cilët e bëjnë kurban këtë botë për hir të Zotit dhe ata të cilët e përdorin fenë si mjet për t'u afruar te ndonjë njeri i madh apo të arrijnë ndonjë interes të vogël.

KULTURA E TË BISEDUARIT

Begatia e të shprehurit është prej dhuntive më të mëdha që ia fali Allahu njeriut, dhe e dalloi me këtë nga krijesat e tjera: ***“Rrahmani - Mëshiruesi (Zoti ynë). Ai ia mësoi Kur’anin. E krijoi njeriun. Ia mësoi atij të folurit (të shprehurit, të shqiptuarit).” (Er-Rrahman: 1-4)***

Në bazë të vlerës së dhuntisë madhërohet edhe obligimi ndaj saj, kërkohet falënderimi i saj dhe mohohet injorimi i saj.

Islami shumë bukur ka sqaruar se si duhet ta shfrytëzojnë njerëzit këtë dhunti të çmuar dhe si t’i bëjnë fjalët e tyre, të cilat i flasin gjatë ditës, rrugë që shpie në mirësinë e dëshiruar; sepse, pjesës dërrmuese të njerëzve u ndalen bisedat dhe nuk u pushon gjuha. E nëse e llogarit atë që e kanë thënë, do ta shohësh se pjesa më e madhe janë fjalë boshe, apo llomotitje të dëmshme, ndërkaq Allahu i Madhërishëm nuk i ka krijuar gjuhët e njerëzve për këtë, dhe as që vlerësohet me këtë dhuntia e shfrytëzuar: ***“Në shumë biseda të tyre të fshehta nuk ka kurrfarë dobie, përveç (bisedës) kush këshillon për lëmoshë, për ndonjë të mirë ose pajtim mes njerëzve. E kush i bën këto duke pasur për qëllim vetëm kënaqësinë e Allahut, Ne do t’i japim më vonë (në botën tjetër) shpërblim të madh.” (En-Nisa: 114)***

Islami i ka kushtuar kujdes të madh çështjes së fjalës dhe mënyrës së artikulimit të tyre, sepse fjalët që dalin nga një person tregojnë esencën e mendjes së tij dhe natyrën e karakterit të tij. Po ashtu, edhe për atë se, metodat e të biseduarit në një bashkësi flasin për shkallën e ngritjes së saj të përgjithshme dhe nivelin e depërtimit të vlerave në mjedisin e asaj bashkësie.

Njeriu, para se të flasë, duhet ta pyesë veten: “A ka shkak që të flas?” Nëse gjen shkak për këtë, le të flasë, përndryshe, heshtja është më e preferuar dhe largimi i tij nga fjalët, ku nuk ka nevojë, është vepër e mirë, që ka shpërblim të madh. Abdull-llah Ibën Mes’udi thotë: “Pasha Atë, përveç të Cilit nuk ka zot tjetër, nuk ka mbi sipërfaqe të tokës gjë më të nevojshme për burgim të gjatë se sa gjuha!” /Transmeton Taberaniu/

Abdull-llah Ibën Abbasi [radijAllahu anhu] thotë: “Pesë sende janë më të vlefshme sesa një turrmë kafshësh të shtrenjta: Mos fol për atë që nuk të intereson, sepse kjo është e tepërt dhe nuk je i sigurtë nga mosbërja e mëkatit!

Po ashtu, mos fol për atë që të intereson pa ia gjetur fjalës vendin, sepse është turp të flasësh për një çështje që të intereson nëse nuk ia gjen asaj vendin e vet!

Mos u fjalos as me një njeri të urtë e as me një mendjelehtë, sepse i urti nuk do të të çmojë, ndërkaq mendjelehti do të të ofendojë!

Në mosprani të vëllait tënd, përmende atë për atë gjë për të cilën ti dëshiron që ai të të përmendë ty, dhe mbuloja atij ato, të cilat ti dëshiron që ai të t’i mbulojë ty..!

Bëje punën e atij, që shihet se shpërblehet për mirësi e dënohet për mëkat.” /Transmeton Ibën Ebi Dunja/

Muslimani këtë mund ta arrijë vetëm nëse e zotëron gjuhën e vet dhe dominon mbi frenat e saj me fuqi. Kështu, do ta ndalë atë atje ku duhet të heshtet dhe do ta korrigjojë atje ku duhet folur. Ndërkaq, ata të cilëve u prijnë gjuhët e tyre, ato i çojnë në vendshkatërrimin e tyre.

Njemend, llomotitja e tepërt ka një zhurmë e cila e largon pjekurinë. Pjesa më e madhe e atyre që u prinë tubimeve, prej të cilëve dalin fjalët pa u ndalur, e bindin dëgjuesin se fjalët e tyre nuk i mbështesin në vetëdije të zgjuar apo ide të thellë, madje dëgjuesi edhe mund të mendojë se nuk ka kurrfarë lidhje në mes mendjes dhe këtij vargu fjalësh.

Njeriu që dëshiron t’i tubojë idetë e veta dhe t’i kontrollojë punët e veta anon kah heshtja, bile, kur ai dëshiron ta njoftojë veten dhe t’i koordinojë idetë, largohet nga ambienti i zhurmshëm në një vend të heshtur apo anë të qetë. Për atë,

edhe nuk është e rastit që Islami e preferon heshtjen dhe e konsideron atë metodë efikase të edukimit të suksesshëm.

Prej këshillave të Pejgamberit [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] drejtuar Ebu Dherrit është edhe kjo: *“Duhet që më tepër të heshtësh, sepse kjo e largon shejtanin dhe të ndihmon në fe.”* /Transmeton Ahmedi/

Po, gjuha e pa masë është litar i lëshuar në dorën e shejtanit, i cili e kthen njeriun kah të dojë. Andaj, nëse njeriu nuk mund ta kontrollojë veten, goja e tij do të jetë derë për depërtimin e hedhurinave, të cilat do ta ndotin zemrën e tij dhe do të hedhin mbi të perden e letargjisë. Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] thotë: *“Nuk do të jetë si duhet besimi i njeriut, derisa nuk është si duhet zemra e tij; e nuk do të jetë si duhet zemra e tij, derisa nuk është si duhet gjuha e tij.”* /Transmeton Ahmedi/

Periudha e parë e këtij rregullimi është që t’i largojë njeriu duart e veta nga ajo që nuk është punë e tij, si dhe mos ta involvojë veten në atë për të cilën nuk pyetet: *“Prej shenjave të besimtarit të mirë është që të mos merret me atë që nuk i hyn në punë.”* /Transmeton Tirmidhiu/

Largimi nga gjërat e kota është prej konditave të shpëtimit dhe fakteve të përkryeshmërisë. Këtë (largimin nga gjërat e kota) Kur’ani e ka përmendur në mes dy detyrave obligative islame; namazit dhe zekatit: ***“Është e sigurt se kanë shpëtuar besimtarët: Ata të cilët janë të përlurur dhe të kujdesshëm gjatë faljes së namazit. Dhe ata të cilët i shmangen të kotës (fjalë a punë). Dhe ata të cilët rregullisht e japin zekatin.”*** (El-Mu’minun: 1-4)

Nëse e tërë bota do t’i llogariste gjërat e kota, të cilat e preokupojnë kohën e tyre të lirë, qofshin fjalë apo punë, do të befasohej nëse aty i gjen pjesën më të madhe të rrëfimeve të publikuara, revistave të njohura, fjalimeve e radiotelevizioneve, gënjeshtrave sistematike në të cilat janë ngjitur sytë dhe kah të cilat anojnë veshët, ndërkaq ato nuk i sjellin asnjë dobi njeriut. Islami e urren gjënë e kotë, sepse ai i urren çështjet boshe dhe të pakuptimta. Pastaj, po ashtu, këto ta humbin jetën në gjëra të kota, për të cilat nuk është krijuar njeriu, e jo

në seriozitet dhe prodhim. Në bazë të pastrimit të njeriut nga gjërat e kota, do të jetë grada e tij tek Allahu.

Transmetohet prej Enes Ibën Malikut, i cili thotë: “Vdiq një njeri, ndërkaq një njeri tjetër, përderisa Pejgamberi [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] dëgjonte, tha: “Përgëzo me Xhenet.” Atëherë Pejgamberi i Allahut i tha: “*Apo nuk e di? Ndoshta ai ka folur për gjërat që nuk i hyjnë në punë, apo ka qenë koprrac për gjërat që s’i kanë munguar!*” /Transmeton Tirmidhiu/

Ai i cili flet kot, për shkak të lidhjes së dobët në mes të menduarit dhe shprehjes, i lëshon fjalët pa frena. Ndoshta mund ta thotë ndonjë fjalë, që do ta vërë në sprovë të rëndë dhe do t’ia shkatërrojë ardhmërinë. Është thënë: “*Kush flet shumë, edhe gabon shumë.*”

Poeti thotë:

I riu vdes nga vuajtja në gjuhë

E nuk vdes njeriu nga vuajtja në këmbë

Në hadith përmendet: “*Njeriu e thotë një fjalë, me qëllim që t’i bëjë të qeshin njerëzit, e me të rrëmbehet më larg se në mes qiellit dhe tokës! Njeriu rrëshqet me gjuhën e vet më keq sesa me këmbët e veta!*” /Transmeton Bejhekiu/

Kur të flasë njeriu, le të flasë për të mirë dhe le t’ia bëjë shprehi gjuhës së vet fjalët e bukura, sepse të shprehurit e mirë, për atë që bren në shpirt, është kulturë e lartë të cilën Allahu ua bëri obligim të gjithë pjesëtarëve të feve. Kur’ani Famëlartë tregon qartë se fjala e bukur është prej esencës së besës së marrë nga Beni Israilët në kohën e Musait. “*(përkujtoni) Kur ne morëm zotimin e bijve të israilit; mos adhuronit tjetërkë, përveç Allahun, të silleni mirë ndaj prindërve, ndaj të afërmve, ndaj jetimëve, ndaj të varfërve dhe njerëzve u thuani fjalë të mira; faleni namazin dhe jepni zekatin...*” (El-Bekare: 83)

Fjalët e mira dhe të matura u përshtaten të gjithëve, edhe miqve edhe armiqve, dhe japin fryte të këndshme.

Për sa u përket miqve, fjalët e mira e ruajnë dashurinë e tyre dhe e zgjasin miqësinë e tyre, si dhe e pengojnë shejtanin që t'i shkatërrojë lidhjet e tyre dhe t'ua prishë moralin: ***“E ti robve të Mi thua ju: Le ta thonë atë që është më e mira, pse djalli ndërsen mes tyre, e është e ditur se djalli është armik i hapët i njeriut.”*** (El-Isra: 53)

Djalli u rri njerëzve në pusi; ai dëshiron të fusë në mes tyre armiqësi dhe urrejtje, dhe prej një problemi të vogël të bëjë konflikt të përgjakshëm; nuk do ta ndalte rrugën përpara tij asgjë, sikurse fjala e mirë.

Ndërkaq, fjalët e mira me armiqtë e shuajnë armiqësinë e tyre, e thyjnë mllëfin e tyre, apo më së paku, fjalët e mira e ndalin zhvillimin e së keqes dhe rritjen e pasojave të saj: ***“Nuk është e barabartë e mira dhe e keqja. Andaj, (të keqen) ktheje në mënyrën më të mirë, se atëherë ai, me të cilin kishit njëfarë armiqësie, do të bëhet mik i afërt.”*** (Fussilet: 34)

Lidhur me të bërit shprehi njerëzve fjalët e buta, sado që të ndryshojë situata e tyre, Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] thotë: ***“Ju nuk mund t'i përfshini të gjithë njerëzit me pasurinë tuaj, andaj, le të jetë ajo që do t'i përfshijë prej jush buzëqeshja dhe sjellja e mirë.”*** /Transmeton Bezzari/ Madje Islami më tepër e preferon sjelljen e mirë ndaj njeriut, edhe nëse nuk i jep asgjë, sesa t'i japësh diçka, por në të njëjtën kohë ta ofendosh. ***“Një fjalë e mirë dhe një lehtësim (që i bëhet lypësit) është më e dobishme se një lëmoshë që përcillet me të keqe. Allahu nuk ka nevojë për askë, është i butë.”*** (El-Bekare: 263)

Fjala e mirë është veti e cila shkon bashkërisht me mirësinë dhe vlerat e larta, të cilat e propozojnë njeriun e pajisur me to, për kënaqësinë e Allahut dhe ia caktojnë atij begatinë e përhershme.

Transmetohet prej Enesit, i cili thotë: ***“Një njeri i tha Pejgamberit [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem]: “Ma mëso një punë, e cila do të më fusë në Xhenet!”*** (Pejgamberi) Tha: ***“Ushqe njerëzit, përhap selamin, falu natën kur njerëzit flejnë, do të hysh në Xhenet i shpëtuar.”*** /Transmeton Bezzari/

Allahu i Madhërishëm urdhëron që dialogu ynë me pjesëtarët e feve të tjera të jetë në këta kufij të qetësisë fisnike, ku

nuk do të ketë dhunë e injorim, me përjashtim, nëse ndonjë njeri i keq na sulmon, atëherë ai duhet të pengohet dhe të ndalet armiqësia e tij: ***“Ithtarët e librit mos i polemizoni ndryshe (kur i thirrni në fenë tuaj) vetëm ashtu si është më së miri, përveç atyre që janë mizorë...”*** (El-Ankebut: 46)

Njerëzit e mëdhenj kanë kujdes në çdo situatë; ata ruhen që mos të lëshojnë ndonjë fjalë të keqe dhe të mos jenë mendjelehtë apo arrogantë.

Maliku transmeton, se i është përcjellë atij prej Jahja Ibën Seidit, se Isai [alejhis-selam] kaloi pranë një derri në rrugë dhe i tha: ***“Shko i qetë!”*** I thanë Isait: ***“I thua kështu derrit?”*** Ai tha: ***“Unë frikohem mos e mësoj gjuhën time të flas fjalë të ndyra!”***

Disa njerëz jetojnë pa fije turpi dhe janë arrogantë; nga shprehitë e tyre nuk i ndalojnë bindjet; virtytet e tyre nuk i bëjnë të njerëzishëm dhe nuk brengosen fare se i dëmtojnë të tjerët. Kur gjejnë fushë të përshtatshme për ta ngopur natyrën e tyre arrogante e injorante, ata veprojnë si të tërbuar nuk dëgjojnë asnjë thirrje dhe nuk mund t'i ndalin të ligat e tyre.

Njeriu fisnik nuk duhet të ngatërrohet në fjalë me tipat e tillë, sepse nxitja e arrogancës së tyre është e keqe e madhe, ndërkaq pengimi i saj është i domosdoshëm. Andaj Islami e legjitimoi izolimin e mendjelehtëve.

Njëherë, një njeri prej injorantëve të përmendur, u ndal para shtëpisë së Pejgamberit [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] dhe dëshironte të hynte brenda. Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] u tregua i mirë ndaj tij, derisa e largoi. Kjo ishte e domosdoshme, ngase butësia është fren për mendjelehtin, e sikur ta lënte ta derdhte tërë atë që kishte ai në natyrën e tij arrogante, do të dëgjonte atë që nuk e dëshironin veshët e tij!!

Transmetohet prej Aishes [radijAllahu anha], e cila thotë: “Një njeri kërkoi leje të hyjë te Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] dhe tha: ***“Ky është njeri i keq.”*** Mirëpo, kur ai hyri te Pejgamberi, ky e priti me zemërgjerësi dhe i foli me butësi, e kur doli, i thashë: ***“O Pejgamber i Allahut, kur dëgjove se vjen ky njeri, the kështu e kështu, e pastaj iu tregove mikpritës dhe zemërgjerë!!”*** Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] tha: ***“Oj Aishe, kur më ke parë mua të lig? Njeriu me pozitë më të keqe tek Allahu, Ditën e Gjykimit, është ai të cilin e braktisin***

njerëzit duke u frikuar nga arroganca e tij.” /Transmeton Buha-riu/

Këtë metodë e verifikojnë përvojat. Njeriu nuk bën ta humbë karakterin e vet me ata të cilët nuk kanë karakter njerëzor. Sikur njeriu të merrej me edukimin e çdo injoranti që e takon, atë do ta lodhnin kurthet e shumta në të cilat do të has-te. Andaj, prej vetive të para me të cilat karakterizohen robërit e devotshëm të Allahut, numërohet kjo masë mbrojtëse: **“E robërit e Zotit janë ata që ecin nëpër tokë të qetë, e kur atyre me fjalë u drejtohen injorantët, ata thonë: Paqe!”** (El-Furkan: 63)

“Dhe kur e dëgjojnë ndonjë llomotitje marrëzie, i kthejnë shpinën dhe thonë: Ne kemi veprat tona e ju tuajat, qofshi larg nesh, ne nuk na duhen injorantët!” (El-Kasas: 55)

Njeriu mund ta shuajë mllefin e vet njëherë, e pastaj di të shpërthejë! Por duhet ditur se prej muslimanit të vyeshëm kërkohet që ta zhagisë të keqen më tepër se aq, ashtu që mos ta lërë plangprishësinë që të dominojë me të në fund.

Transmetohet prej Seid Ibën Mussejibit, i cili thotë: “Derisa ishte Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] i ulur me shokët e vet, një njeri i ra në qafë Ebu Bekrit dhe e ofendoi, ndërkaq Ebu Bekri nuk ia ktheu; pastaj përsëri e ofendoi, e ai heshti; pastaj për së treti e ofendoi, e Ebu Bekri ngadhnjeu, ndërsa Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] u ngrit. Ebu Bekri [radijAllahu anhu] i tha: **“O Pejgamber i Allahut, a u hidhërove me mua?”** Tha: **“Jo, por zbriti një melek nga qielli, duke e përgënjeshtruar atë që ai tha. Kur t’i ngadhnjeve, meleku shkoj, e djalli u ul, e unë nuk ulem kur ulet djalli.”** /Transmeton Ebu Davudi/

Braktisja e mendjelehtëve nuk nënkupton pranimin e nënçmimit; dallimi në mes këtyre dy rasteve është shumë i madh. E para është kontrollimi i vetes para faktorëve shqetësues, si dhe ndalimi i vetes, me çdo kusht, që mos ta provokojnë cytjet e mllefrit dhe të hakmarrjes. Ndërkaq e dyta është inercion i shpirtit dhe nënshtrim i vetë përbuzjes, si dhe pranimi i asaj të cilën nuk pajtohet një njeri i mençur apo i njerëzishëm.

Kur’ani e ka proklamuar simpatinë e tij ndaj braktisjes së mendjelehtëve dhe urrejtjen e tij ndaj pranimit të nënçmimit:

“Allahu nuk e do publikimin e shprehjeve të këqija, përveç (publikimit) të atij që i është bërë e padrejtë. Allahu është dëgjues, i dijshtëm. Nëse publikoni ndonjë të mirë ose e fshihni atë, ose i falni ndonjë të keqe (dikujt), Allahu i plotfuqishëm fal shumë.” (En-Nisa: 148-149)

Prej garancive, të cilat i ka paraparë Islami për mbrojtjen e fjalëve nga arroganca dhe epshi, është ndalimi i polemizimit dhe mbyllja e dyerve të tij, pa marrë parasysh se a është me të drejtë apo jo, për shkak se ka situata të cilat e zotërojnë njeriun dhe e shtynë të dominojë, e bëjnë njeriun t’i provokojë të tjerët me fjalë dhe t’i gjuajë dilemat të cilat e ndihmojnë anën e tij dhe shprehjet të cilat e favorizojnë argumentin e tij. Kështu, dëshira për të triumfuar do të jetë më e rëndësishme tek ai se ngadhnjimi i të vërtetës, e, po ashtu, i paraqet veset e kokëfortësisë dhe egoizmit në një formë të shëmtuar, kurse pranë tyre nuk ka vend për sqarim apo qetësi!!

Islami i injoron këto situata dhe i konsideron të dëmshme për fenë dhe moralin. Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] thotë: *“Kush i lë polemizimet, duke qenë fajtor, do t’i ndërtohet një shtëpi në oborr të Xhenetit; kush i le polemizimet duke qenë në të drejtë, do t’i ndërtohet një shtëpi në mes të Xhenetit; e kush ka moral të vyeshëm, do t’i ndërtohet në pjesën më të lartë të tij.”* /Transmeton Ebu Davudi/

Disa njerëz janë shumë llafazanë, gjë që i nxit të ngatërohen edhe me dijetarin edhe me injorantin, dhe e bëjnë fjalosjen epsh dominues te ta, e ata asnjëherë nuk mund ta kontrollojnë atë.

Nëse retorika e tyre dominon mbi çështjet e njerëzve, e prish krejt, e nëse dominon mbi të vërtetat e fesë, e njollos bukurinë e tyre dhe e humb prestigjin e tyre. Allahu është shumë i zemëruar me këtë grup llomotitës njerëzish. Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] thotë: *“Njerëzit të cilët më së tepërmi i urren Allahu janë polemizuesit e ashpër.”* /Transmeton Buhariu/; *“Çdo popull që ka devijuar pas udhëzimit i është dhënë polemizimit.”* /Transmeton Tirmidhiu/

Ky grup nuk ndalet me aftësinë e të shprehurit te kufijt e paraparë; ai dëshiron vetëm fjalë, dëshiron që me këtë të tregojë superioritet dhe zhagitje; tek ai në rend të parë vijnë ter-

mat, e në rend të dytë kuptimet, ndërkaq qëllimeve fisnike ndoshta u ka takuar vendi i fundit, e ndoshta edhe nuk gjejnë vend në mes të kësaj zhurme.

Njëherë ndodhi që një njeri, prej atyre të papjekurve, erdhi te Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] dhe, sa herë që Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] fliste diçka, ai e mundonte veten që të fliste diçka që do të ishte mbi fjalët e Pejgamberit [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem]!! Kur shkoi, Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] tha: *“Allahu nuk e do këtë dhe të ngjashmit me të. Ata i hutojnë (mbështjellin) njerëzit me gjuhët e tyre, siç e mbështjell lopa me gjuhën e saj barin; kështu do t’i mbështjellë Allahu gjuhët dhe fytyrat e tyre në zjarr.”* /Transmeton Taberaniu/

Polemikat në fe, politikë, shkencë dhe arte, kur zhvillohen nga këta pseudointelektualë, e prishin fenë, politikën, shkencën dhe artet; ndoshta shkaku i rënies sociale, ndarjeve juridike, grupimeve sipas sekteve, si dhe shumë gjërave të tjera që e kanë goditur umetin islam, është kjo polemikë e mallkuar në të vërtetat fetare dhe çështjet jetësore. Polemika është gjëja më e largët nga studimi objektiv dhe argumentimi i qëlluar.

Transmetohet nga disa sahabë, se kanë thënë: “Një ditë, derisa ishim duke polemizuar për një çështje fetare, arriti Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] dhe, kur na pa ashtu, u hidhërua aq tepër, sa që nuk e kemi parë të hidhërohet në atë mënyrë, pastaj na qortoi dhe tha: *“Ngadalë, o populli i Muhamedit! Ata që ishin para jush mu për këtë u shkatërruan; lëreni polemizimin, se nuk ka hajr në të; lëreni polemizimin, se besimtari nuk polemizon; lëreni polemizimin, se humbja e polemizuesit veç është kompletuar; lëreni polemizimin, se mjafton si mëkat të vazhdosh me polemikë; lëreni polemikën, se unë nuk ndërmjetësoj për polemizuesin në Ditën e Gjykimit; lëreni polemizimin, se unë jam garantues për tre pallate në Xhenet, një në oborr, një në mes të tij, dhe një në pjesën më të lartë të tij, për atë që e lë polemizimin, duke qenë korrekt; lëreni polemizimin, se gjëja e parë nga e cila më ndaloj Zoti im, pas adhurimit të idhujve, është polemizimi (dysхими).”* /Transmeton Taberaniu/

Njerëzit, nëpër tubime të ndryshme, bisedojnë, ndërkaq Islami i urren tubimet e parazitëve, të cilët e kalojnë kohën e tyre në injorimin e lajmeve dhe gjurmimin e të metave, sepse ata kanë pasuri të tepërt, nën hijen e së cilës rehatohen dhe nuk kanë punë tjetër vetëm se të merren me çështjet e të the-rëve: ***“Mjerë për secilin që ofendon e përqesh (njerëzit). Që ka tubuar pasuri dhe që atë e ruan të mos i pakësohet. E mendon se pasuria e tij do ta bëjë të përjetshëm. Jo, të mos mendojë ashtu! Se ai pa tjetër do të hidhet në Hutame.”*** (El-Humeze: 1-4)

Në kohën tonë mjaft janë përhapur qëndrimet e njerëzve nëpër klube dhe kafene. Ndërkaq, kjo është një e metë e cila e goditi shoqërinë me sëmundje të ndryshme, dhe nëpër fshatra dhe qytete këto janë shumë pa asnjë nevojë.

Në hadith përmendet: ***“Ruajuni nga qëndrimet nëpër rrugë.”*** Thanë (shokët): ***“Ne nuk kemi qare pa qëndruar aty, sepse bisedojmë.”*** (Pejgamberi) Tha: ***“Nëse keni vendosur patjetër të qëndroni, jepjani rrugës hakun e vet.”*** Thanë: ***“Cili është haku i rrugës?”*** Tha: ***“Ruajtja e shikimit, largimi i pengesave, kthimi i selamit, urdhërimi në të mirë dhe ndalimi nga e keqja.”***
/Transmeton Muslimi /

SIGURIA NGA SHPIRTLIGËSIA (URREJTJA)

Nuk ka qetësi më të madhe për njeriun, mënyrë më të mirë që t'i largojë brengat e tij dhe gëzim më të madh për të se sa të jetojë me zemër të shëndoshë, të pastër prej cytjeve të shpirtligësisë dhe shpërthimit të urrejtjes. Kur e sheh se dikujt i është dhënë ndonjë begati, ai duhet të jetë i kënaqur me të, dhe e sheh mirësinë e Allahut në të, e po ashtu, e sheh nevojën e robërve të Allahut për Të, dhe e përkujton fjalën e Pejgamberit të Allahut: *“O Allahu im, çdo e mirë që më jepet mua apo ndonjë prej krijesave të Tua, ajo është vetëm prej Teje, e Ti nuk ke shok; pra Ty të takon i tërë lavdërimi dhe falënderim.”* /Transmeton Ebu Davudi/

E kur e sheh se një njeri e gjen ndonjë e keqe, i vjen keq për të, dhe i lutet Zotit t'ia largojë atë vështirësi dhe t'ia falë mëkatet, e përkujton atë me të cilën Pejgamberi iu drejtua Zotit:

*O Zot, nëse fal, Ti ua fal të gjithëve
Dhe çdo rob i Tënd që vuan*

Me këtë muslimani jeton faqebardhë, i kënaqur me Zotin dhe jetën, me shpirt të qetë nga tendencat e urrejtjes së verbër, sepse prishja e zemrës me ligësi është sëmundje shkatërruese, e imani shumë shpejt del nga zemra labile, siç derdhet uji nga ena me vrima!!

Qëndrimi i Islamit ndaj zemrës së zezë është i rrezikshëm, sepse zemra e zezë i shkatërron punët e mira, e shemb shkëlqesinë e tyre dhe e errëson kthjelltësinë e tyre.

Ndërkaq te zemra e ndritshme, Allahu i Madhërishëm e bekon edhe atë që është pak prej saj; Ai është më i shpejtë te ajo, me çdo të mirë.

Transmetohet nga Abdull-llah Ibën Amri: I thanë: *“O Pejgamber i Allahut, cilët janë njerëzit më të mirë?”* Tha: *“Çdo-njëri i cili ka zemër të qetë dhe është korrekt.”* I thanë: *“Korrektin e dimë, e cili ka zemër të qetë?”* Tha: *“Ajo është zemra e devotshme dhe e pastër, në të cilën nuk ka mëkat dhe ligësi, nuk ka tradhti dhe zili!”* /Transmeton Ibën Maxhe/

Nisur nga ky fakt, bashkësi e vërtetë muslimane është ajo e cila ngrihet mbi ndjenjat e dashurisë së përbashkët, afrimit unik, bashkëpunimit reciprok, sjelljes së butë, në të cilën nuk do të ketë vend për individualizmin dominues jomirënjohës, por ajo do të jetë ashtu siç e atribuon Kur’ani: ***“Edhe ata që kanë ardhur pas tyre e thonë: Zoti ynë, falna ne dhe vëllezërit tanë që para nesh u pajisën me besim dhe mos lejo në zemrat tona farë urrejtjeje ndaj tyre që besuan. Zoti ynë Ti je i Butë, Mëshirues!”*** (El-Hashr: 10)

Nëse zhvillohen dhe vërshojnë rrënjët e armiqësisë, dhe përhapen gjembat e saj, ajo i than lulet e besimit të freskët dhe e paralizon dashurinë e paqen që e pretendon. Në atë rast, në kryerjen e detyrave obligative nuk do të ketë dobi e as që shpirti do të mbrohet me to.

Armiqësia, në të shumtën e rasteve, i matufos mendjet e njerëzve dhe i shtyn ata në kryerjen e mëkateve të vogla, të cilat e dëmtojnë nivelin e njerëzisë dhe mëkateve të mëdha, të cilat meritojnë mallkim; syri i mllëfosur shikon nga një kënd i errët, pra, ai është i verbër, dhe nuk i sheh vlerat; ai i stërzmadhon të ligat, e madje urrejtja mund ta çojë deri në atë masë, sa t’i imagjinojë dhe paragjykojë gënjeshttrat. Tërë këtë Islami e urren dhe ruhet reciprokisht që ato mos të ndodhin si dhe e konsideron ndalimin e tyre prej mirësive më të çmuara.

Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] thotë: *“A t’ju lajmëroj për diçka që është më e vlefshme se grada e agjërit, namazit dhe lëmoshës?”* Thanë: *“Po!”* Tha: *“Pajtimi i njerëzve, sepse futja e zënkave mes njerëzve është eliminuese (që rruan); nuk them se i rruan flokët, por e rruan fenë!”* /Transmeton Tirmidhiu/

Ndoshta shejtanit nuk i shkon për dore që një njeri të mençur ta bëjë adhurues të putave, por ai - i cili vazhdimisht tenton ta mashtrojë njeriun dhe ta çojë në humnerë - nuk do të dështojë nga largimi i njeriut nga Zoti, ashtu që njeriu mos t'i dijë obligimet e veta ndaj Zotit; ai këtë mashtrim e arrin përmes ndezjes së zjarrit të armiqësisë në zemra, ashtu që, kur të ndizet ky zjarr, djalli kënaqet duke shikuar se si ai e djeg të tashmen dhe ardhmërinë e njerëzve dhe si i shkatërron marrëdhëniet dhe karakteret e tyre. Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] thotë: *“Shejtani nuk ka shpresë se do ta adhurojnë namazxhinjtë në Gadishullin Arabik, por ai nuk i ka humbur shpresat nga futja e kacafytjeve në mes tyre.”* /Transmeton Muslimi/

Kjo është për shkak se kur e keqja i sundon zemrat, atëherë ajo e largon dashurinë e tyre, e thyen vazon e tyre, i kthen njerëzit në gjendje ashpërsie dhe kokëfortësie, e këpusin atë për të cilën ka urdhëruar Allahu të bëhet lidhja, dhe bëjnë trazira në tokë.

Islami që mjaft vigjilent ndaj simptomeve të mbrapshtisë, andaj edhe arriti t'i shërojë ato para se të zmadhohen dhe të shndërrohen në armiqësi të tepruar. Dihet mirë se njerëzit dallojnë në mes vete në temperament dhe kuptim, e, po ashtu, takimi i tyre në arenën jetësore mund të lindë ngushtim dhe devijim, nëse nuk ndodh edhe konfrontim e ftohje; për këtë Islami ka paraparë edhe norma të cilat do t'ua mënjanojnë muslimanëve praktikën e ndarjes dhe trazirave dhe do t'ua lidhin zemrat e tyre për ndjenjat e miqësisë dhe dashurisë; kështu ai ndaloi nga ndërprerja e marrëdhënieve reciproke dhe braktisja e njëri-tjetrit.

Po, mund të ndodh që ta ndjesh të keqen e cila të drejtohet ty, ashtu që të zemërohesh e të ngushtohesh për shkak të saj, dhe mendon seriozisht për t'u larguar nga protagonist i kësaj të keqeje. Mirëpo, Allahu nuk është i kënaqur që të mbarojë lidhja në mes dy muslimanëve në këtë mënyrë. Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] thotë: *“Mos i ndërpritni marrëdhëniet ndërmjet vete, mos ia ktheni shpinën njëri-tjetrit, mos e urreni njëri-tjetrin dhe mos keni zili për njëri-tjetrin; dhe bëhuni*

robër të Allahut, vëllezër. Nuk i lejohet muslimanit të mos flasë me vëllain e vet mbi tri ditë.” /Transmeton Buhariu/

Sipas një transmetimi tjetër: *“Nuk i lejohet një besimtar i të mos flasë me besimtarin mbi tri ditë; nëse kalojnë tri ditë, le ta takojë dhe le t'i japë selam, nëse ia kthen selamin, atëherë janë pjesëmarrës në shpërblim, e nëse nuk ia kthen selamin, atëherë ai është mëkatar, e ai që ka dhënë selam ka dalë prej hidhërimit.” /Transmeton Ebu Davudi/*

Ky afat, tri ditë, është periudhë kur qetësohet njeriu dhe shuhet urrejtja, e pas saj muslimani duhet të vazhdojë të jetë komunikativ me vëllezërit e vet dhe të kthehet me ata ashtu siç kanë qenë para kësaj. Hidhërimi është sikur një mjegull: sa tubohet, fryn një erë e cila e shkapërderdh, e horizonti përsëri pastrohet pas asaj vranësire.

Njeriu, në çdo kacafytje që nxitet, është një prej dy personave: ose tiran, ose bëhet padrejtësi. Nëse ai i sulmon të tjerët dhe ua nëpërkëmb të drejtën, duhet të ndërpritet nga mbrapshtia që sjell dhe të përmirësohet sjellja e tij. Po ashtu, ai duhet të dijë se nuk do të mund ta shuajë urrejtjen nga zemra e armikut të vet ndryshe, por vetëm se nëse i siguron atij qetësi dhe kënaqësi. Islami, për këtë rast, e ka urdhëruar njeriun që ta përmirësojë shokun e vet dhe ta konsolidojë mendjen e tij.

Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] thotë: *“Kush i ka ndonjë hak vëllait të vet, në nder apo diçka tjetër, le të kërkojë prej tij hallallëk sot, para se të humben dinarët e dirhemët, ashtu që, nëse ka vepra të mira, do t'i merren atij sipas padrejtësisë që ka bërë, e nëse ai vetë nuk ka vepra të mira, do të merren nga veprat e këqija të shokut të vet dhe do t'i hidhen atij.” /Transmeton Ibën Maxhe/*

Islami kështu i preferon atij që ka ndonjë hak ndaj dikujt. Ndërkaq, atë, të cilit i kanë hak të tjerët, e stimulon që të jetë i butë dhe të falë, si dhe t'i fshijë gabimet e djeshme me pranimin e faljes së atij që i kërkon falje dhe mirëkuptim, ndërkaq refuzimi i faljes është gabim i madh. Në hadith përmendet: *“Prej atij që kërkon falje vëllai i vet, për gabimin e bërë, e ai nuk ia pranon, ai bën mëkat sikur tagrambledhësi me dhunë.” /Transmeton Ibën Maxhe/*

Në një transmetim qëndron: *“Cilit i arsyetohet dikush, e ai nuk pranon, nuk do të kalojë në Haud.”*

Me këtë udhëzim të qartë, për të dy palët bashkërisht, Islami e lufton urrejtjen dhe e mbyt virusin e saj që në djep, e ngren shoqërinë e besimtarëve në një piedestal të lartë të miqësisë reciproke dhe marrëdhënieve të drejta në çdo sferë.

Islami e konsideron prej argumenteve të poshtërimit dhe natyrës së ulët të vendoset urrejtja në thellësitë e shpirtit dhe të mos dalë prej tij, por të valëzojë brenda tij siç valëzon vullkani i fshehtë.

Shumë prej atyre, në zemrat e të cilëve është mbyllur urrejtja, presin ta zbrazin atë në fytyrën e atij me të cilin kaqafyten; kështu ata nuk qetësohen pa u shkumbuar nga tërbimi, pa ofenduar e pa bërë tollovi. Transmetohet prej Ibën Abbasit, se Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] ka thënë: *“A doni ta dini se cilët janë njerëzit e këqinj prej jush?”* Thanë: *“Gjithsesi, nëse do, o Pejgamber i Allahut.”* Ai tha: *“Të këqinj janë ata që ulen vetë, i rrahin me shkop robërit e vet dhe nuk japin përkrahje. A doni t’ju lajmëroj për diçka edhe më të keqe?”* Thanë: *“Gjithsesi, nëse do, o Pejgamber i Allahut.”* Ai tha: *“I këtillë është ai i cili i urren njerëzit dhe njerëzit e urrejnë atë. A doni t’ju lajmëroj edhe më keq se kjo?”* Thanë: *“Gjithsesi, nëse do, o Pejgamber i Allahut.”* Tha: *“Të këtillë janë ata të cilët nuk i pranojnë lëshimet, nuk kanë mirëkuptim për arsye-timet dhe nuk i falin gabimet. A doni t’ju tregoj edhe më keq se kjo?”* Thanë: *“Gjithsesi, o Pejgamber i Allahut.”* Tha: *“Ai, prej të cilit nuk ka shpresë të bëjë mirë, dhe nuk mund të jenë njerëzit të sigurtë nga të këqijat e tij.”* /Transmeton Taberaniu/

Këto grupe, të cilat i përmendi hadithi në fjalë, janë shembuj të periudhave të urrejtjes, kur shkallëzohet sëmundja e saj dhe zbulohet turpi i saj. Por nuk është çudi, sepse që prej kohëve më të vjetra, madje edhe në injorancë, njerëzit e kanë kup-tuar se shpirtligësia është atribut i shtresave të ulëta të njerë-zimit! Ndërkaq, të njerëzishmit janë larg saj!

Antere thotë:

Nuk mbart urrejtje ai i cili është në gradë të lartë

E as që arrin lartësitë ai që nga natyra është nevrikosur

Ka disa ligësi nga të cilat Islami ua futi dronë njerëzve, e të cilat sikur t'i analizosh pak më afër, do ta vësh burimin e tyre të fshehtë. Ato ligësi, krahas dallimit të manifestimeve të tyre, përsëri kthehen në një sëmundje, e ajo është shpirtligësia.

Shpifja ndaj njerëzve të pafajshëm është krim në të cilin shpie urrejtja e madhe, por, pasi ndikimi i saj në falsifikimin e të vërtetave është i madh, e po ashtu edhe në njollosjen e njerëzve të ndershëm, Islami e konsideron atë prej trillimeve më të shëmtuara.

Aishja [radijAllahu anha] transmeton se Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] u ka thënë shokëve të vet: “A e dini cila është kamata më e madhe tek Allahu?” Thanë: “Këtë e dinë Allahu dhe Pejgamberi i Tij.” Tha: “Kamata më e madhe tek Allahu është shkelja e nderit të një muslimani.” Pastaj Pejgamberi i Allahut lexoi: **“E ata që fyejnë besimtarët dhe besimtarët, për çka ata nuk janë fajtorë, ata kanë ngarkuar veten me një mëkat shumë të madh.”** (El-Ahzab: 58) /Transmeton Ebu Ja’la/

Nuk ka dyshim se gjurmimi i të metave për njerëzit dhe atribuimi i negativiteteve ndaj atyre me qëllim flet për fëlliqësi dhe poshtërsi. Për disa krime të shpifjeve Islami ka caktuar masa ndëshkuese në këtë botë, ndërkaq ajo që është përgatitur në ahiret, për llojet e shpifjeve, është më e trishtueshme dhe më e dhimbshme.

Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] ka thënë: “Kush e përmend ndonjë njeri me diçka që ai në fakt nuk e ka, me qëllim që ta turpërojë, Allahu do ta mbyllë në zjarrin e Xhehenemit, derisa të sjellë atë që do ta zhdukë atë që e ka thënë për të.” /Transmeton Taberaniu/

Në një transmetim tjetër qëndron: “Çdo njeri, që e përhap për një musliman një fjalë nga e cila ai është i pastër, me qëllim që ta turpërojë me të në këtë botë, Allahu e ka borxh ta

shkrijë në zjarr Ditën e Gjykimit, derisa nuk vjen me atë që do ta mohojë fjalën e tij.”

Pasi ajo që e thotë është gënjeshtër, atëherë si mund ta arsyetojë tek Allahu të pavërtetën? Dhe si do të mund ta largojë prej vete barrën e saj?

Zemra e qetë ia imponon besimtarit që t’ua dojë të mirën njerëzve, nëse nuk ka mundësi t’u bëjë mirë ai vetë. Ndërkaq, ai i cili nuk u gjen njerëzve të këqija, e këtë ua përshkruan atyre në mënyrë shumë perfide dhe ua falsifikon atyre me shumë dinakëri, ai pra është gënjeshtar i paturpshëm i llojit të vet. Allahu i Madhërishëm thotë: ***“Ata, të cilët dëshirojnë që te besimtarët të përhapet imoraliteti, ata i pret dënim i dhembshëm në këtë dhe në botën tjetër. Allahu di (të fshehtat) e ju nuk dini.”*** (En-Nur: 19)

Prej mirësive të Allahut ndaj njerëzve është se Ai e preferoi mbulimin e të metave të tyre, edhe nëse janë korrekt në atribimet e tyre ndaj njerëzve të tillë. Nuk i lejohet një muslimani që t’i hakmerret një muslimani tjetër me fyerje, edhe nëse ia thotë atë që e posedon; njeriu me shpirt të qetë zemërohet për vuajtjet e njerëzve dhe kënaqet kur ata janë të qetë. Ndërkaq, dëfrimi me renditjen e skandaleve ndaj moralit, zbulimi i të fshehtave dhe publikimi i turpeve nuk është rruga e muslimanit të vërtetë. Për këtë, Islami e ndaloi përgojimin, sepse është derdhje e mllëfit të shuar dhe zemrës së nevojshme për mëshirë dhe pastërti.

Transmetohet prej Ebu Hurejres, se Pejgamberi i Allahut ka thënë: *“A e dini çka është përgojimi?”* Thanë: *“Allahu dhe Pejgamberi i Tij e dinë më mirë!”* Tha: *“Ta përmendësh vëllain tënd me atë që ai e urren.”* I thanë: *“Po mirë, nëse vëllai ynë e posedon atë që ia themi?”* Tha: *“Nëse ai është ashtu siç i thua ti, atëherë e ke përgojuar, e nëse nuk është ashtu siç i thua ti, atëherë i ke shpifur atij.”* /Transmeton Muslimi/

Prej rregullave, të cilat i ka miratuar Islami për mbrojtjen e dashurisë ndërvëllazërore dhe largimin nga përçarjet, është ndalimi i bartjes së fjalëve, sepse kjo është rrugë e cila shpie në njollosjen e pastërtisë dhe ndërrimin e zemrave.

Pejgamberi [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] ndalonte që t’i tregohet diç e pahijshme për shokët e vet dhe ka thënë *“Asnjëri*

*prej jush mos të më përcjellë për ndonjë prej shokëve të mi
diçka, sepse unë dëshiroj të dal në mesin tuaj me zemër të
qetë.” /Transmeton Ebu Davudi/*

Çdo njeri, i cili dëgjon diçka të tillë, duhet që mos t’ia zgjerojë budallallëkun mendjelehtit, sepse, ndoshta një fjalë e keqe do të vdiste në vendin e saj nëse lihet atje ku është thënë! Po ashtu, ndoshta një fjalë e keqe mund t’i ndezë luftërat, sepse një njeri i papjekur e ka transmetuar dhe ka fryrë në të, e ajo shndërrohet në shkëndijë e cila transferohet me turpe dhe fatkeqësi. Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] thotë: “*Nuk do të hyjë në Xhenet ai që i përcjell fjalët.*” /Transmeton Buhariu/ Në një version tjetër thuhet: “*shpërndarësi-kattatun.*”

Dijetarët thonë se të dy termat e kanë të njëjtin kuptim. Por thuhet edhe ajo se *Nemmam*-bartës i fjalëve, është personi i cili qëndron me një grup njerëzish, që bisedojnë dhe ai pastaj përcjell prej tyre. Ndërkaq, *Kattat*-përhapës, është ai që dëgjon ata, pa e vërejtur, e pastaj i bart ato fjalë.

Në hadith transmetohet: “*Bartja e fjalëve dhe shpirtligësia janë në zjarr; ato nuk tubohen në zemrën e një muslimani.*” /Transmeton Taberaniu/

Prej kushtëzimeve të mllefrit-shpirtligësisë janë: paragjykimet e këqija, pasimi i turpeve të njerëzve, përqeshja, turpërimi i njerëzve me negativitetet e tyre apo karakteristikat e tyre trupore dhe shpirtërore. Tërë këtë, Islami e urren ashpër. Pejgamberi i Allahut thotë: “*Kush di diçka për vëllain e vet dhe e mbulon, Allahu do t’ia mbulojë atij (të metat) Ditën e Gjykimit.*” /Transmeton Taberaniu/

Po ashtu thotë: “*Kush ia mbulon një turp muslimanit, sikur e ka ngjallur një vajzë të varrosur për së gjalli.*” /Transmeton Taberaniu/

Shumë herë pasuesit e gabimeve të njerëzve, me qëllim të zbulimit të tyre, janë më mëkatarë dhe më larg Zotit sesa njerëzit të cilët bëjnë të këqija haptazi, sepse gjurmimi i krimit, me qëllim të publikimit të tij, është më i shëmtuar se vetë bërja e krimit.

Ekziston dallim shumë i madh në mes dy emocioneve: emocionet e xhelozisë për normativat fetare dhe orvatja për mbroj-

tjen e tyre, si dhe emocionet e urrejtjes së njerëzve dhe orvatja për poshtërimin e tyre.

Emocionet e para mund të arrijnë në kulm te personi përkatës, por krahas kësaj ai do të jetë më larg hakmarrjes ndaj njerëzve, pritjes së lëshimeve të tyre dhe gëzimit në vuajtjet e tyre.

Zemra e shëndoshë është mirësi, e cila e bën muslimanin që mos ta lidhë hisen e tij prej kësaj jete me raportet e tij me njerëzit, sepse ai ndoshta ka dështuar atje ku kanë arritur sukses tjerët, e ndoshta ka çaluar atje ku kanë prirë të tjerët. Andaj, është marri, apo mjerim, që egoizmi ta mundë njeriun dhe ta bëjë që t'ia dëshirojë humbjen çdo njeriu, jo për diçka tjetër, por vetëm për atë se ai vetë personalisht nuk ka fituar gjë!

Pastaj, po ashtu, njeriu duhet të ketë diapazon më të gjerë dhe ndjenja më fisnike dhe sendet duhet t'i shikojë nga këndi i interesit të përgjithshëm, e jo nga këndi i epsheve të tij personale.

Zemërligëve u vlon kazani i urrejtjes në shpirtrat e tyre, sepse ata shikojnë interesin e kësaj bote, dhe kur shohin se ajo që e kanë dashur, u ka kaluar dhe është përqendruar në duart e të tjerëve, mu kjo është fatkeqësia që ata nuk i le të qetësohen!!!

Që në kohët e lashta, djalli e pa se hapi, të cilin ai e kishte lakmi, kaloi tek Ademi [alejhis-selam], andaj edhe u zotua se nuk do ta lënte askë që të kënaqet me të, pasi që ai u privua nga ajo: ***“(Iblisi) Tha:”Për shkak se më humbe mua, unë do t’u ulem atyre (do t’u zë pusi) në rrugën Tënde të drejtë. Mandej, do t’ju sillem atyre para, prapa, nga e djathta dhe nga e majta e tyre, e shumicën e tyre nuk do ta gjesh që të falënderohen (të besojnë)!” (El-A’raf: 16-17)***

Ky vlim djallëzor është ai që digjet në shpirtrat e urrejtësve dhe i shkatërron zemrat e tyre. Islami i thirri njerëzit që të largohen nga kjo vepër e irituar dhe në jetën e tyre të ndjekin një rrugë më të lartë dhe më të qetë.

Transmetohet prej Enes Ibën Malikut, i cili thotë: “Ishim të ulur te Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] dhe tha: ***“Tash do ta shihni një njeri prej banorëve të Xhenetit.”*** Dhe, doli një

njeri prej ensarëve (medinasve), mjekrra e të cilit kullonte pika uji nga abdesti, kurse këpucët e veta i kishte varur në dorën e majtë. Të nesërmen, Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] e tha të njëjtën gjë, e po ashtu e pamë njeriun e njëjtë, sikur herën e parë. Po ashtu, edhe në ditën e tretë Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] i tha të njëjtat fjalë, dhe e pamë atë njeri, sikur herën e parë. Kur u ngrit Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem], Abdull-llahu Ibën Amri e ndoqi këtë njeri dhe i tha: *“Unë u fjalosa me babain tim dhe u betova që mos të hyj tek ai tri ditë. Nëse e sheh të arsyeshme të më strehosh te ti, derisa të kalojë afati, do të qëndroja!”* Ai tha: *“Po.”*

Enesi thotë: *“Abdull-llahu tregon se qëndroi me atë njeri ato tri netë, por nuk e pa të ngrihet natën, përveç asaj se, kur ai kthehej në krahun tjetër në shtrat, e përmendte Allahun e Madhërishëm, derisa ngrihej për namazin e sabahut. Abdull-llahu tha: “Mirëpo, nuk e dëgjova të fliste diç tjetër, por vetëm se mirë. Kur kaluan tri netë, e unë gati sa nuk e nënçmova punën e tij, andaj i thashë: “O rob i Allahut, unë as që jam hidhëruar, e as që jam qortuar me babain tim, por e kam dëgjuar Pejgamberin [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] duke thënë për ty tri herë: “Tash ju do ta shihni një njeri prej banorëve të Xhenetit”, dhe dole ti tri herë me radhë, andaj desha të strehohem te ti, që ta shoh se çka vepron ti, me qëllim që të të pasoj, por nuk pashë se bëje punë të mëdha!! Andaj, çfarë bën ti, që tha për ty ashtu Pejgamberi i Allahut?”* Ai tha: *“Unë bëj vetëm atë që e pe.”* Abdull-llahu tha: *“Kur u nisa, më thirri dhe tha: “Unë bëj vetëm atë që e pe, mirëpo unë nuk e mashtroj asnjë musliman dhe as që e xhelozoj dikë për të mirat që ia ka dhënë Allahu.”* Abdull-llahu tha: *“Kjo pra të ka sjellë deri këtu!!”*
/Transmeton Ahmedi/

Sipas një transmetimi qëndron: *“O djali i vëllait tim, e gjitha është ajo që e pe, duke e shtuar atë se unë nuk e urrej asnjë musliman.”* /Transmeton Bezzari/

Islami e ka ndaluar zilinë, e po ashtu, Allahu i Madhërishëm e ka urdhëruar Pejgamberin e Vet që të kërkojë mbrojtje tek Allahu prej të ligave të ziliqarëve, sepse zilia është një gacë e cila ndizet në gjoks dhe e dëmton njeriun përkatës dhe në të

njëjtën kohë e shtyn atë që t'u sjell telashe njerëzve për shkak të saj.

Dëshira e njeriut për rrëmbimin e begative është dukuri negative e rrezikshme, pasojat e liga të së cilës, për shoqërinë, duhet të eliminohen dhe nuk duhet qenë të sigurtë në ndërgjegjen e njeriut të tillë për ndonjë punë. Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] thotë: *“Në barkun e një robi (njeriu) nuk mund të bashkohet pluhuri në rrugë të Allahut dhe flaka e Xhehenemit, dhe as që mund të bashkohet në gjoksin e një robi besimi dhe zilia.”* /Transmeton Bejhekiu/ Po ashtu thotë: *“Ruajuni zilisë, sepse zilia i djeg punët e mira siç i djeg zjarri drutë.”* /Transmeton Ebu Davudi/

Njeriu, që i urren ata të cilëve Zoti u ka dhënë të mira dhe dëshiron që ata të privohen nga ato dhunti gjatë natës, e të zgjohen në mëngjes të falimentuar, është ai të cilin errësira të ndryshme e kanë devijuar nga realiteti i jetës.

Ai, së pari, është i bllokuar nga kjo botë dhe të mirat e saj materiale, andaj lufton për to dhe qan pas tyre dhe, po ashtu i përcjell me mllef ata të cilët arrijnë hise të mëdha prej saj. Ky është gabim i madh në vlerësimin e të dy botëve, e ndoshta kjo edhe është injorancë dhe mospërfillje e jetës së ahiretit dhe përgatitjeve që duhet bërë për të, ngase njeriu duhet të jetë i gatshëm për të dhe të zemërohet për humbjen e saj. Allahu i Madhërishëm thotë: ***“O ju njerëz! Juve ju erdhi nga Zoti juaj këshilla (Kur’ani) dhe shërimi i asaj që gjendet në krahatorët tuaj (në zemra), edhe udhëzim e mëshirë për besimtarët. Thuaj: Vetëm mirësisë së Allahut dhe mëshirës së Tij le t’i gëzohen, se është shumë më e dobishme se ajo që grumbullojnë ata.”*** (Junus: 57-58)

Krahas kësaj, ziliqari po ashtu është njeri i pavendosur, i plogësht, injorant ndaj Zotit të vet dhe ligjeve të Tij në gjithësi, ngase ai, posa e humbi mirësinë për shkaqe të panjohura, u kthye t’u bëjë lajka njerëzve që patën sukses!!

E xhelozuan djaloshin, pasi nuk e arritën suksesin e tij

Të gjithë, pra, për të u bënë armiq dhe dushmanë

Më mirë për të do të ishte që ai t'i kthehej Zotit dhe ta lusë Atë t'i falë prej mirësive të Tij, sepse begatitë e tij nuk janë monopol i ndonjë personi të caktuar, e pas kësaj përsëri le ta fillojë aktivitetin e vet jetësor.

Ndoshta atë që nuk e ka arritur në fillim mund ta arrijë në tentimin e dytë. Nuk ka dyshim se kjo është më e ndershme se sa mllëfi ndaj tjerëve.

Dallimi është shumë i madh ndërmjet zilisë dhe aspiratave, zilisë dhe lakmisë për mirëqenie, zilisë dhe injorimit të gjendjes së rëndë dhe përzierjes në privim dhe begatim.

Kështu, aspiratat janë dëshirë për t'u ngritur dhe tentim për realizimin e saj, e kjo është praktika e njerëzve të devotshëm. Sulejmani [alejhis-selam] tha: *“Zoti im, më fal (gabin), më dhuro asi pushteti që askush pas meje nuk do ta ketë; vërtet, Ti je dhuruesi më i madh.”* (Sad: 35)

Robërit e të Gjithëmëshirshmit thanë: *“... Zoti ynë, na bë që të jemi të gëzuar me (punën) e grave tona dhe pasardhësve tanë, e neve na bën shembull për të devotshmit.”* (El-Furkan: 74)

Përgjimi i mirësive të Allahut, duke i pasur parasysh shkaqet e fitimit të tyre, është diçka që nuk ka të bëjë me përbuzjen e mirësive të Zotit, kur i jepen një njeriu të caktuar.

Ndërkaq, lakmia është dëshira e njeriut për të pasur mirësi të njëjta me ato që ua fali Allahu të tjerëve.

Pasi arritja e të tjerëve ka gjasa të jetë hapje e dyerve të trazirave, kapje për dëshira të mbrapshta dhe lakmi e asaj që njeriu ndoshta mendon se është e mirë për të, ndërkaq ajo në fakt është e dëmshme, Islami na orientoi në atë që duhet lypur dhe në atë ku duhet garuar. Për këtë, Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] thotë: *“Nuk ka zili, vetëm se në dy gjëra: një njeri të cilit i ka dhënë Allahu pasuri, e ai e çon këtë në vend të qëlluar, dhe një njeri të cilit Allahu i ka dhënë urtësi, e ai gjykon sipas saj dhe ua mëson të tjerëve.”* /Transmeton Buha-riu/

Zilia e përmendur në hadith ka për qëllim lakminë e mirësisë së njëjtë, e jo dëshirën për largimin e saj.

Qëllimi është që ideali i njeriut, të cilin e synon njeriu, të jetë i shkëlqyeshëm dhe i lartë, sepse rënie e aspiratave është të lidhen shpresat me situata të pavlera. Po ashtu, ka disa çështje, këmbëngulësia në kërkimin e të cilave konsiderohet marri që rezultojnë vetëm se humbje. Ndoshta mund të ketë mllaf ndaj njerëzve, jo për diçka tjetër, por për atë se Allahu i ka dalluar me aftësi të lindura apo me rezultate pozitive të dala nga këto aftësi. Për këto çështje, dhe të ngjashme, Allahu i Madhërishtë thotë: ***“Mos lakmoni në atë, që Allahu gradoi disa nga ju mbi disa të tjerë. Burrave ju takon hise nga ajo që fituan ata, dhe grave gjithashtu ju takon hise nga ajo që fituan ato. Allahut kërkoni nga të mirat e Tij. Allahu është i dijshëm për çdo send.”*** (En-Nisa: 32)

Ndërkaq, mospajtimi me pozitën joreale është konfirmim i drejtësisë së obligueshme e nuk është prej llojit të zilisë së përbuzur.

Andaj, nëse hidhërohemi se ndonjëri merr më tepër sesa ka dhënë mund, apo është ngritur në një pozitë që nuk e meriton në bazë të aftësive që i posedon, ky hidhërim është i kuptueshëm dhe i pranuar, bile ky është një prej formave të mbrojtjes së intereseve të përgjithshme, e me të nuk ka lidhje urrejtja personale.

Islami i kontrollon shpirtrat kohë pas kohe, që t'i pastrojë nga hedhurinat e mllëfit të pavlerë si dhe t'i begatojë me ndjenja më të pastra dhe më të ciltra ndaj njerëzve dhe ndaj jetës.

Çdo ditë, çdo javë dhe çdo vit, shpirtrat kalojnë përmes parimeve islame në një filtër që ndal njollat, i pastron të metat dhe në zemrat besimtare nuk mbetet asnjë gjurmë e shpirtligësisë.

Ajo që ndodh çdo ditë është se Islami ka sqaruar shumë mirë se namazet obligative nuk i sjellin dobi muslimanit, pa u shoqëruar me shpirtmadhësinë ndaj njerëzve dhe lirimin e tij nga tradhtia dhe kacafytjet. Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] thotë: ***“Tre grupeve të njerëzve namazet e tyre nuk u ngrihen mbi kokat e tyre asnjë pëllëmbë: Njeriut i cili u bëhet imam njerëzve e at e urrejnë, një gruas e cila e kalon natën duke qenë burri i saj i hidhëruar në të, dhe dy vëllezërve që i kanë prishur marrëdhëniet.”*** /Transmeton Ibën Maxhe/

Çdo javë bëhet statistika e asaj që ka bërë muslimani; Allahu i shikon ato, që ta thërrasë njeriun të dalë para asaj që ka vepruar dhe që e ka fshehur në vete për përgjegjësi dhe, nëse është shpirtmadh, do të shpëtojë prej turpërimit, e nëse është i ndotur me mëkatet e hidhërimit, zilisë e pezmatimit, do të çalojë në rrugë. Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] thotë: *“Çdo të hënë dhe të shtunë ekspozohen veprat; atë ditë Allahu i Lartësuar ia fal çdo njeriu që nuk i përshkruan Atij shok, me përjashtim të atij personi i cili është hidhëruar me vëllain e vet. Do të thotë: “Lërëni këta të dy, derisa të pajtohen.”* /Transmeton Muslimi/

Po ashtu, edhe çdo vit, pas netëve të gjata dhe ditëve të shumta, muslimani nuk duhet të mbetet peng në burgun e armiqësisë, i lidhur me prangat e urrejtjes. Allahu në këtë botë ka falur dhurata mirësie, begatinë e të cilave mund ta arrijnë vetëm të pastrit zemërgjerë. Në hadith përmendet: *“Allahu i Lartësuar i përgjon robërit e Vet natën e pesëmbëdhjetë të muajit Shaban dhe ua fal atyre që lypin falje, i mëshiron ata që kërkojnë mëshirë, ndërkaq shpirtligët i lë siç janë!”* /Transmeton Bejhekiu/

Andaj, kush vdes, pas gjithë këtyre filtrave të njëpasnjëshëm, me urrejtje të ngjitur në zemrën e vet, ai meriton të digjet në zjarr, sepse atë që nuk mundën ta pastrojnë mekanizmat fetar, nuk do të thotë se edhe zjarri nuk mund të arrijë te thelbi i tij dhe të shuajë shpirtligësinë dhe mëkatet e tij.

Hidhërimi dhe faktorët që shpiejnë në të apo ajo që rezulton nga ai, të cilin e përbuz Islami, është ai që lind për shkak të kësaj bote dhe pasioneve të saj, si dhe synimit për rrëmbimin e kënaqësive të saj dhe mëvetësimit me mirësitë e saj materiale.

Ndërkaq, urrejtja për hir të Zotit, hidhërimi për hir të së vërtetës dhe revolucionit për nder janë çështje tjetër...

Nuk është mëkat për muslimanin, t'i bojkotojë deri në vdekje ata që largohen nga urdhri i Allahut apo që i tejkalojnë kufijtë e Tij. Atij nuk i merret për të madhe të kultivojë në brendësinë e tij urrejtje ndaj tyre dhe haptazi t'i kundërshtojë. Por, përkundrazi, kjo është simptom e besimit të vërtetë dhe sinqeritetit ndaj Allahut.

Allahu i Madhërishëm na ka urdhëruar t'i braktisim armiqtë e Tij, edhe nëse ata janë njerëzit tanë më të afërt: ***“O ju që besuat, mos u ofroni miqësi (dashuri) prindërve tuaj, as vëllezërve tuaj, nëse ata vlerësojnë mosbesimin kundër besimit. E kush prej jush miqësohet me ta, ata janë mizorë.”*** (Et-Teube: 23)

Largimi i muslimanit nga ata shoqërimi i të cilëve dëmton, apo nga ata të cilët anojnë kah neglizhenca dhe tallja, është obligim.

Po ashtu, largimi i muslimanit nga ai që ka bërë gabim në obligimet ndaj Allahut, si ndëshkim ndaj personit të tillë, në një afat të caktuar apo të pacaktuar, nuk do të thotë gjë, sepse vetë Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] nuk ka folur me disa gra të veta dyzet ditë. Po ashtu edhe Abdull-llah Ibën Omeri nuk foli me njërin prej bijve të tij derisa vdiq, sepse ai e kishte refuzuar një qëndrim të Pejgamberit [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem], të cilin e transmetoi babai i tij për lejimin e daljes së grave në xhami.

FUQIA

Besimi stabil është burim i pashtershëm i aktivitetit kontinuitiv, ambicieve të akumuluar, qëndrueshmërisë së padrueshme dhe rezistimit të rreziqeve; bile ai është prijës i shkathët, që shpie në takimin e vdekjes pa frikë, nëse nuk është takim i dëshiruar dhe i pritur!

Kjo është natyra e besimit: kur ai thellohet dhe përforcohet, i jep njeriut fuqi, e cila skalitet në të gjitha sjelljet e tij. Andaj, kur njeriu me besim të tillë flet, ai është i sigurtë në fjalët e veta; kur punon, është stabil në punën e vet; kur orientohehet, është i qartë në qëllimin e tij; dhe pasi është i bindur në idenë që ia mbush mendjen dhe ndjenjën, dhe e cila e përshkon zemrën e tij, shumë pak mund të arrijë dyshimi në zemrën e tij, e, po ashtu, shumë pak mund ta lëkundin atë nga qëndrimi i tij shtrëngatat që e godasin, bile nuk i zihet për të madhe nëse u thotë atyre që i ka rreth vetes: ***“...veproni sipas gjendjes suaj, e edhe unë veproj sipas simes, e më vonë do ta dini. Secilit do t’i vijë dënimi që e poshtëron dhe do ta goditë dënim i përjetshëm!”*** (Ez-Zumer: 39-40)

Ky ton i shoqëruar me theks provokativ, ky shpirt i pavarur në punë, kjo bindje në atë që mendon se është realitet... e gjithë kjo e bën atë që të jetë njeri me ideale të dalluara në jetë dhe ai i shoqëron njerëzit me vetëdije të plotë: nëse i sheh se janë në rrugë të mbarë, u ndihmon atyre, e nëse i sheh gabimtarë, largohet dhe vetë e nxit ndërgjegjen.

Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] ka thënë: ***“Mos u bëni immea (jo stabil), e të thoni: “Unë jam me njerëzit: nëse njerëzit bëjnë mirë, edhe unë do të bëj mirë, e nëse ata bëjnë keq, edhe unë do të bëj keq!” Por, mësonie veten që, nëse njerëzit bëjnë mirë, edhe ju të bëni mirë, e nëse ata bëjnë***

keq, atëherë t'i largoheni ligësisë së tyre.” /Transmeton Tirmidhiu/

Njeriu i dobët është ai të cilin e nënshtrojnë tradita e përhapur dhe me veprat e të cilit dirigjojnë doket dominuese, edhe nëse janë të gabuara, dhe ia sjellin atij vuajtjet e kësaj dhe botës tjetër. Njerëzit kanë shpikur risi të ndryshme në gëzimet dhe mortet e tyre, dhe ata u treguan më lojalë ndaj praktikimit të tyre sesa ndaj praktikimit të vërtetave fetare.

Mirëpo besimtari i vërtetë nuk ka dert për një çështje që nuk ka mbështetje në fenë e Allahut, dhe ai gjatë injorimit të traditës dhe dokeve me siguri do të hasë në vështirësi. Megjithatë, ai nuk duhet t'ia ketë dronë askujt kur është në pyetje Allahu; ai duhet të marshojë në qëllimin e vet dhe nuk duhet ta brengosin kritikën e ashpër, e as fyerjet e njerëzve.

Transmetohet prej Ibën Abbasit [radijAllahu anhu], i cili thotë: Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] ka thënë: *“Kush e hidhëron Allahun, për qejfin e njerëzve, Allahu me të hidhërohet dhe me të do të hidhërohen edhe ata të cilëve u është bërë qejfi me hidhërimin e Allahut! E kush e kënaq Allahun, me hidhërimin e njerëzve, Allahu është i kënaqur me të, dhe me të do të kënaqen edhe ata të cilët janë hidhëruar për shkak të kënaqësisë së Allahut!! Derisa ta zbukurojë atë, dhe ta zbukurojë fjalën dhe veprën e tij në sytë e tij.” /Transmeton Taberaniu/*

Andaj, muslimani le të jetë i vendosur në atë që është i bindur, ndërkah le ta përbuzë nënçmimin dhe injorimin që e përjeton kur distancohet nga traditat e injorantëve; le ta trasojë për vete një rrugë me të cilën do ta synojë shpërblimin e Allahut të Madhërishtëm. Nëse besimi me iluzione i nxit disa të përqeshin dhe nënçmojnë, atëherë besimi me Islamin duhet t'i bëjë besimtarët e tij të fortë e të vendosur: ***“E kur të shohin ty, nuk të çmojnë ndryshe, por vetëm në tallje e thonë:”A ky është ai që Allahu e dërgoi Pejgamber? Sikur ne të mos ishim të qëndrueshëm ndaj tyre, ai gati na pat zmbrapsur prej zotave tanë! E më vonë, kur ta shohin qartazi dënimin, do ta kuptojnë se kush ishte më larg nga e vërteta.” (El-Furkan: 41-42)***

Po! Muslimani duhet ta ndjejë fuqinë e bindjes së vet në personalitetin e vet dhe shkëlqesinë e besimit në veten e vet.

Nëse nuk mundet këtë t’ia imponojë asaj që ka përreth, do të mbetet si kodra e lartë të cilën nuk mund ta luajnë prej vendi vërshimet e mëdha dhe as që mund ta mbulojnë thellësitat gjumuese. Çka do të mund t’i bëjnë njerëzit një njeriu i cili mburret me besimin e vet, i cili e ndien fuqinë për shkak të lidhjes së tij me Zotin dhe për shkak të përqendrueshmërisë së tij në fe? Ata, sikur t’i vërsuleshin të gjithë së bashku, nuk do të mund t’i bënin asgjë!

Transmetohet prej Ibën Abbasit, i cili thotë: “Një ditë kam qenë pas të Dërguarit të Zotit, Muhammedit [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], dhe më tha: *“O djalosh, ki ndërmend Allahun, Allahun do të të ruajë. Ki ndërmend Allahun, do ta gjesh para teje. Njihe Allahun (kur je) në bollëk, do të të njohë Ai ty në vësh-tirësi. Kur të kërkosh, kërkohet prej Allahut. Nëse kërkon ndihmë, kërkohet prej Allahut. Dije, sikur tërë populli të tubohej që të të ndihmojnë diç, nuk do të të ndihmonin, përveç atë çka ta ka caktuar Allahu. E nëse do të tuboheshin që në diç të të bëjnë dëm, nuk do të dëmtonin, përveç në atë çka Allahu tashmë ta ka caktuar. Janë ngritur lart pendat dhe janë tharë faqet.”*

Është fakt se vlera e fuqisë përqendrohet në shpirtin e muslimanit në besimin e Njeshmërisë së Zotit, sikur edhe vlerat e tjera të cilat e bëjnë atë ta refuzojë nënçmimin në tokë, sepse ai ka pozitë të lartë me atë se i përket qiellit, si dhe nga fakti se ai mundet, në suaza të besimit të vet, të përfaqësojë vetë një popull. Në gojën e tij duhet të jetë Fjala e Allahut të Madhërishëm: ***“Thuaje: A pos Allahut, Krijues i qiejve dhe i tokës, që ushqen të tjerët, ndërsa vetë nuk ushqehet, të pranoj Zot tjetër? Thuaj: Unë jam i urdhëruar të jem i pari që bindem dhe (urdhërohem): të mos bëhem kurrsesi nga idhujtarët.”*** (El-En’am: 14)

Prej mirësive të fuqisë, të cilën e obligon Islami, është që të kesh dëshirë të fortë, qëllim të vendosur për arritjen e qëllimit tënd me metoda valide të cilat të afrojnë kah ai duke e dhënë mundin tënd maksimal në arritjen e synimit tënd, dhe duke mos ia lënë fatit të bëjë diçka për ty, apo përcaktimeve që planifikojnë për ty atë që ti nuk e planifikove për veten tënde!! Ka disa njerëz, të cilët e shfrytëzojnë strehimin e tyre te Zoti si mbulesë për dështimet e tyre të turpshme dhe për shkak të

dobësisë së tyre të shëmtuar. Ky është falsifikim, që e urren Islami.

Transmetohet prej Auf Ibën Malikut, i cili thotë: “Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] gjykoi në mes dy njerëzve. Kur u larguan, ai në favor të të cilit nuk ishte gjykuar, tha: *“Më mjafton Allahu, dhe sa ndihmues i mirë që është Ai!”* Në këtë Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] tha: *“Allahu nuk e do paaftësinë! Ti duhet të jesh syçelë. Nëse të mund ndonjë çështje, thuaj: “Më mjafton Allahu, sa ndihmues i mirë që është Ai.”* /Transmeton Ebu Davudi/

Gjegjësisht, njeriu është i obliguar t’i aktivizojë të gjitha forcat e veta për t’i zotëruar problemet, me qëllim që t’i eliminonjë ato nga rruga e tij. Nëse arrin t’i tejkalojë e t’i vë nën kontroll, ai e ka kryer obligimin e vet, e nëse ai mposhtet para atyre problemeve pasi e dha mundin e vet, atëherë mbështetja e tij tek Allahu është strehim me të cilin mbrohet prej të ligave të dështimit; ai me këtë në të dy rastet do të jetë i fortë: në të parin, me punën e tij, ndërsa në të dytin, me mbështetjen e tij në Zotin.

Islami nuk ka dëshirë që njeriu të jetë i dyshimtë në çështjet e tij, të habitesh në zgjedhjen e më të qëlluarës dhe më të mirës, të shumohen cytjet në kokën tënde e të formosh para teje klimë të dyshimit dhe paragjykimin, e në këtë mënyrë mos ta dish çka të bësh, apo, të dobësohet fuqia jote në kapjen e asaj që të sjell dobi, e të ikë ajo prej teje. Kjo gjendje jostabile nuk i ka hije muslimanit.

Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] thotë: *“Besimtari i fuqishëm është më i mirë dhe më i dashur tek Allahu, sesa besimtari i dobët. Por, në secilin ka dobi. Orvatu për arritjen e asaj që të bën dobi; kërko ndihmë prej Allahut dhe mos u trego i pafuqishëm; nëse të godet diçka, mos thuaj:”Sikur të kisha vepruar kështu, do të ishte kështu”, por thuaj: “Allahu ka caktuar dhe e ka bërë atë që ka dashur”, sepse fjala “sikur” e çel punën e shejtanit.”* /Transmeton Muslimi/

Veprimtaria e shejtanit është përcjellja e të kaluarës me vajtime dhe mjerime; ai veprim është, pra, futja e pesimizmit dhe dëshpërimit për atë që ka kaluar. Njeriu kthehet prapa vetëm në atë masë sa ka dobi prej së kaluarës në aktualitetin

ekzistues dhe në të ardhmen, ndërkaq qëndrimi me disfatat e djeshme, rikthimi i zemërimeve të tyre dhe pësimi për fatkeqësitë e së kaluarës, si dhe përsëritja e “sikur” dhe “ah, të ishte”, të gjitha këto nuk janë prej natyrës së muslimanit, bile këtë Kur’ani e konsideron prej manifestimeve të dëshpërimit, që sillet në zemrat e mosbesimtarëve: ***“O besimtarë, mos u bëni si ata që nuk besuan dhe, për vëllezërit e tyre që kishin dalë në udhëtim (tregtie e gjallërimi) ose që kishin shkuar në luftë thonin: Sikur të kishin ndenjur pranë nesh (e të mos dilnin), ata as nuk do të vdisnin as nuk do të mbyteshin. Atë (bindje), Allahu ua bëri një dëshpërim në zemrat e tyre. Pse Allahu është Ai që jep jetë dhe jep vdekje dhe Allahu sheh atë që ju punoni.”*** (Ali Imran: 156)

Në hadith përmendet: ***“Kush dëshiron të jetë njeriu më i fortë, le të mbështetet në Allahun.”***

Mbështetja në Allahun, me të cilën forcohet njeriu, është një formë e bindjes së thellë në Allahun; ajo e freskon njeriun kur atë e preokupojnë gjendje të vështira, dhe kur shikon përrreth e nuk sheh ndihmës e as shpresë!

Luftëtari i dhunës ka guxim të fortë dhe trimëri të madhe, edhe përsërisht dobësisë së pajisjes dhe ndihmuesit të paktë. Ai, kur mbështetet në Allahun, ndjen se është mbështetur në një shtyllë të fortë, dhe nga kjo mbështetje përfiton qëndrueshmëri dhe stabilitet. Kështu ai vazhdon të bëjë rezistencë, derisa të shkëlqejnë sihariqet e ngadhnjimit gjatë një ambienti të errësuar. Allahu i Madhërishëm na ka treguar se, mbështetja në Allahun ka qenë ushqim i luftës së gjatë të cilën e zhvilluan pejgamberët dhe ithtarët e tyre kundër padrejtësive të tiranëve dhe trazirave të diktatorëve: ***“E përse të mos i mbështetemi Allahut, derisa Ai na udhëzoi në rrugën tonë (të drejtë). Për Zotin, ne gjithsesi do të durojmë e do të përballojmë mundimet që na bëni, e vetëm Allahut le t’i mbështeten vazhdimisht ata që gjithnjë iu mbështetën.”*** (Ibrahim: 12)

Pushtetarët e prishur dhe pala e tyre lojalitetin e besimtarëve ndaj vetes, shpresimin e tyre për mirësi në ardhmëri, dhe aspiratat e tyre se dobësia e tyre aktuale do të shndërrohet në fuqi dominuese... e quanin mashtrim!!

“Kur hipokritët dhe ata që në zemrat e tyre kishte sëmundje (dyshim) thanë: Këta (muslimanët) i ka mashtruar feja e tyre (s’kanë fuqi të luftojnë). Po kush mbështetet në Allahun, s’ka dyshim, se Allahu është ngadhnjyes i urtë.” (El-Enfal: 49)

Mbështetja reale në Allahun e Madhërishëm, është partnere e mundit të shterur dhe vullnetit të fortë. Mbështetja në Allahun e Madhërishëm është ndarë nga këto kuptime vetëm në shekujt kur u deformua Islami dhe kur nga ithtarët e tij ai u mor si zbavitje dhe lojë.

Ajo e bën muslimanin të fortë që të largohet nga jeta e prishur dhe amorale dhe të ndjekë rrugën e pastërtisë dhe qëndrueshmërisë, ngase njeriu me ndërgjegje të prishur apo njerëzi të perënduar nuk është i fortë, edhe sikur mos t’i mungojë atij as qumështi i zogut, apo edhe sikur të jetë ai në suitën mbretërore.

Allahu i Madhërishëm e ka këshilluar popullin e Hudit [alejhis-selam] dhe i ka udhëzuar ata në faktorët e fuqisë së vërtetë, e ata ishin tiranë të ashpër, dhe u tha: ***“... kërkoni falje prej Zotit tuaj dhe ktheniu Atij, Ai ju lëshon shi me bollëk, dhe fuqisë suaj i shton fuqi, e mos refuzoni e të bëheni mëkatarë!”*** (Hud: 52)

Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] deshi t’ua zbu-kurojë punët e mira njerëzve, t’i nxisë ata për kryerjen e tyre dhe t’ua sqarojë atyre madhësitinë e njeriut kur bën mirë dhe e mposht shejtanin, e ngritet në stadiumet e larta, andaj e përmendi këtë shembull në kontekst të fjalëve të tij. Ai tha: ***“Kur e krijoi Allahu tokën, ajo filloi të shtrihet dhe rrafshohet. Ai e forcoi me kodra, dhe ajo u stabilizua. Melekët u habitën nga fuqia e kodrave dhe thanë: “O Zoti ynë, a krijove diçka tjetër më të fortë se kodrat?” Tha: “Po, hekurin.” Thanë: “A krijove diçka më të fortë se hekuri?” Tha: “Po, zjarrin.” Thanë: “A krijove diçka më të fortë se zjarri?” Tha: “Po, ujin.” Thanë: “A krijove diçka më të fortë se uji?” Tha: “Po, erën.” Thanë: “A krijove diçka më të fortë se era?” Tha: “Po, njeriun i cili kur jep lëmoshë me dorën e djathtë, nuk ia sheh e majta!”***
/Transmeton Tirmidhiu/

Njeriu, kjo krijesë e çuditshme, konsiderohet zotëri i të gjitha elementeve të tjera të gjithësisë; ai matet me më të vrazhdtën dhe më të rëndën e gjithësisë dhe ua tejkalon e i rëndon atëbotë kur do të jetë njeri i vyeshëm. Por, ai do të mallkohet në tokë dhe në qiell dhe do ta rëndojë grimca dhe pluhuri atëherë kur do të jetë njeri i poshtër.

Shembulli, të cilin e tregoi hadithi, nuk është tjetër, veçse prezantim i vlerës së njeriut bamirës, dhe ilustrim i qëndrueshmërisë dhe lartësisë së tij kur paraprin në sferën e mirësisë.

Prej elementeve të fuqisë, është edhe ajo që njeriu të jetë transparent, t'i presë njerëzit me zemër të hapur dhe parime të njohura. Ai nuk duhet të tregohet, në llogari të së vërtetës, me atë që e ul prestigjin e tij dhe të përkrahësve të tij. Por, ai duhet ta bëjë fuqinë e vet prej fuqisë së besimit të cilin e përfaqëson dhe për të cilin jeton, dhe ai asnjëherë nuk heq dorë nga kjo transparencë në miratimin e ndonjë të vërtete.

Në kohën e Pejgamberit [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] u zu Dielli në ditën kur vdiq djali i tij, Ibrahim. Për këtë njerëzit thanë: *“Dielli u zu për shkak të vdekjes së Ibrahimit!!”* Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] u ngrit, u ligjëroi njerëzve, dhe tha: *“Dielli dhe Hëna nuk zihen as për vdekjen e as për lindjen e dikujt, por ato janë dy shenja të Zotit, të cilat ua ka treguar robërve të Vet; kur do ta shihni këtë, shpejtoni në namaz.”* /Transmeton Buhariu/

Kjo, ngase njeriu që gjallëron në të vërteta nuk bën tregti me të pavërteta; ai nuk ka nevojë për një gjë të tillë. Transparenca e tij është argument i një pasurie të madhe të fisnikërisë, e cila i mjafton e nuk ka nevojë për djallëzi dhe shfrytëzim, e po ashtu e ndërton personalitetin e vet mbi baza konstante të mirësisë dhe përsosurisë.

Parimi i urdhërimit në të mirë dhe ndalimit nga e keqja buro nga ky lartësim shpirtëror, sepse kjo mbështetet në transparencën me të sinqertit për atë që kanë lëshuar, por e gjithë kjo me qëllim të mënjanimi të lëshimeve të tilla, ashtu që të forcohet pozita e realitetit dhe mirësisë. Në librat e tjerë i kemi sqaruar qëllimet shoqërore dhe politike që i ka lidhur Islami me parimin e urdhrit dhe ndalesës.

Ajo që dëshirojmë ta konfirmojmë këtu është se muslimani duhet t'i gjykojë të metat e përhapura, të jetë guximtar në sulmimin e tyre, nuk duhet të ketë frikë prej asnjë njeriu me pozitë të lartë, e as që duhet të turpërohet prej të afërmit dhe nuk duhet të mërzitet, për hir të Zotit, prej asnjë akuze që i drejtohet.

Islami urren që të dobësohet njeriu para mëkatarëve që kanë pozita të larta dhe t'i thërrasë ata me attribute respekti. Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] thotë: *“Kur njeriu i thotë hipokritit: “O zotëri”, e ka hidhëruar Zotin e vet.”* /Transmeton Hakimi/

Krim edhe më i madh është nëse një njeri i shkel kufijt e mbrojtur, e pastaj i dëgjon ata të cilët e lavdërojnë, e jo ata që e nënçmojnë: ***“... Atë që poshtëron Allahu nuk ka kush që mund ta bëjë të ndershëm. Allahu punon atë që dëshiron.”*** (El-Haxh: 18)

Me ndalimin e përgojimit Islami e mbron burrin e muslimanit dhe e forcon elementin e forcës në të. Njeriu, që përvidhet që t'i vjellë mllfet e tij në fshehtësi, me përmendjen e të metave sekrete apo të njohura, ai pa dyshim është njeri i ulët. Njeriu, i cili e ndjen në vete fuqinë e përgjigjes motiveve të së vërtetës, ai ballafaqohet me kë të dojë, me çka të dojë, e nuk fshihet që të akuzojë pas muri.

Por, kjo nuk do të thotë se kryerja e të këqijave nga ana e tij është për shkak se ne duam ta keqpërdorim. Por, kur hasim ndonjë mangësi te ndonjë person, ne përballë saj jemi para disa çështjeve të caktuara: Nëse kjo mangësi është e metë në trupin e tij, apo dobësi në aftësinë e tij, është turp ta përbuzësh atë për një gjë të tillë, në qoftë se këtë e bën para syve ose pas shpine.

Nëse kjo është mëkat, në të cilin ka rrëshqitur rastësisht, sepse nuk është prej natyrës së tij që të bëjë gjëra të tilla, kjo është rrëzim i atij, dhe nënçmim është ta turpërojmë njeriun e tillë dhe ta proklamojmë mes njerëzve me një gjë të tillë.

Mirëpo, nëse mangësia që e kemi hasur është krenari e mospërfillësit apo mëkat i proklamuesit, kjo është ajo të cilës i duhet bërë ballë me thënien e së vërtetës, duke ua plasur veshët pa pasur fare dert.

Me qëllim që të jetë kjo fjalë e singertë duhet larguar shpirtligësia dhe dëshira e keqbërjes dhe të dominojë dëshira ekskluzive për ndryshimin e të shëmtuarës dhe konsolidimin e individit dhe shoqërisë. Assesi nuk i takon që të përmendet mëkatari për të keq te armiqtë e tij, me qëllim që të afrohesh te zemrat e tyre, apo të ushqehesh prej tryezave të tyre, apo që të tregohesh se i urren vetitë të cilat i përbuz tek ai. Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] thotë: *“Kush ha një kafsha-të me të përmendurit e një muslimani, Allahu do ta ushqejë me të ngjashme prej Xhehenemi. Kush vesh ndonjë rrobë, me të përmendurit e ndonjë muslimani, Allahu do t’ia veshë atij një të ngjashme prej Xhehenemi. Kush arrin me të përmendurit e një muslimani pozitë për sy e faqe, Allahu do t’ia kthejë këtë në Ditën e Gjykimit.”* /Transmeton Ebu Davudi/

Përgojimi është shprehi e të dobhtëve, dhe “çdo përgojim është shkathtësi e atyre që nuk janë të shkathët.”

Islami i urren ata të cilët jetojnë në këtë botë si mëkatarë mbi të cilët dominojnë vetitë e servilizmit dhe vërsuljes mbi të mirat e tjerëve, ata të cilët dëshirojnë të jenë në këtë jetë sikur dhelpra e cila ushqehet prej asaj që kanë lënë luanët.

Muslimani është shumë më i madh që ta lidhë qenien e tij me të tjerët në këtë mënyrë nënçmuese, por ai duhet të largohet nga pozitat nënçmuese e të marshojë në tokë duke kërkuar dinjitetin dhe prestigjin.

Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] i ka përmendur banorët e Xhenetit dhe karakteristikat e tyre, virtytet e fuqisë, prestigjit dhe vyeshmërisë, dhe këto ua atribuoi të parëve; ndërkaq poshtërsitë e nënçmimit, manipulimit, paaftësisë dhe talljes ua bashkangjiti palës tjetër, dhe tha: *“Banorët e Xhenetit janë tre sish: Pushtetari i drejtë, fisnik e i suksesshëm; njeriu i mëshirshëm, i ndjeshëm ndaj çdo të afërmi dhe muslimani; dhe i ndershmi i përmbajtur, i cili ka fëmijë. Ndërkaq banorët e zjarrit janë: Tradhtari, i cili çdo ambicie që i paraqitet - edhe po të jetë e imët - e tradhton; njeriu i cili mëngjes e mbrëmje të mashtron në familjen dhe pasurinë tënde.”* Përmendi koprracinë, gënjeshtren dhe fyesit e shëmtuar. *“Allahu më shpalli mua që të jeni modest, e mos të mburret asnjëri*

ndaj tjetrit, e as mos ta mendojë njëri-tjetrin.” /Transmeton Muslimi/

Por, ka çështje me të cilat mund të ballafaqohet muslimani, e të largohet me to, e ndoshta edhe mund të dobësohet në vete derisa ato e shoqërojnë, mund të bëjnë shtypje e cila e ndal njeriun, e bëjnë të mendojë keq, shumë pesimist dhe jo sa duhet produktiv; ndërkaq obligimi i muslimanit është që të mundohet maksimalisht që të lirohet nga këto pranga të mjerishme dhe të dalë nga kurthet e saj tragjike. Pejgamberi [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] kërkonte mbrojtje nga Zoti prej këtyre vuajtjeve shkatërruese: *“O Zot, unë kërkoj mbrojtje te Ti nga brengat dhe dëshpërimi, dhe kërkoj mbrojtje nga Ti prej paaftësisë dhe përtacisë, dhe kërkoj mbrojtje te Ti nga frika dhe koprracia, dhe kërkoj mbrojtje te Ti nga mbytja në borxhe dhe tirania e njerëzve.”* /Transmeton Ebu Davudi/

Durimi dhe shpresa janë arma e të sotmes dhe së nesërmes, nën hijen e tyre njeriu u përballon fatkeqësive tragjike dhe nuk nënshtrohet, por qëndron i mbrojtur nga të gjitha anët, lart mbi ndodhitë dhe trazirat, sepse ai është besimtar, kurse besimtari nuk i nënshtrohet askujt tjetër vetëm se Allahut.

BUTËSIA DHE FALJA

Shkallët e njerëzve në qëndrueshmëri përpara provokimeve dallojnë, disa prej tyre i mashtrojnë cikërrimet dhe i tërbojnë menjëherë, kurse disa prej tyre i shqetësojnë fatkeqësitë, e ata mbeten me dhembjen e tyre duke e mbrojtur mendimin e tyre objektiv dhe sjelljen njerëzore.

Edhe pse vetitë qenësore të njeriut kanë ndikim të madh në hisen e njerëzve prej ashpërsisë dhe qetësisë, azhuritetit dhe maturisë, njollosjes dhe pastërtisë, përsëri ekziston një lidhje e fortë në mes bindjes së njeriut në vetvete dhe sjelljes së tij të matur me tjerët, si dhe faljes së gabimeve të të tjerëve. Njeriut të madh, realisht, saherë që ngjitet në horizontet e përkryeshmërisë, zgjerohet kraharori, i shtohet butësia, ua fal gabimet personale dhe ua pranon arsyetimet njerëzve për lëshimet e tyre!! Nëse atë e sulmon ndonjë mendjelehtë, duke dashur ta kompromentojë, ai atë e shikon nga pozita e lartë e tij, ashtu siç i shikon filozofi fëmijët të cilët luajnë në rrugë, e që ndoshta edhe mund ta gjuajnë me gurë.

Kemi patur rast të shohim se si i shpie hidhërimi njerëzit deri në kufij të çmendurisë; kur e urrejnë edhe veten dhe mendojnë se aq rëndë janë nënçmuar, sa këtë nuk e pastron diç tjetër por vetëm se derdhja e gjakut.

Sikur njeriu të jetonte pas mureve të larta të virtyteve të tij, ai do ta ndjente këtë mundim të dhembjes në këtë formë të ashpër. Assesi, por nënçmimet bien mbi artikuluesin e tyre para se të arrijnë në cakun e tyre të largët.

Ky kuptim na e sqaron mençurinë e Hudit [alejhis-selam] duke e dëgjuar përgjigjen e popullit të vet, pasi që i thirri në njëshmërinë e Allahut, kur ata thanë: ***“... Ne po të shohim mendjelehtë dhe të konsiderojmë vërtet rrenacak! Tha (Hu-***

di): O populli im, nuk jam mendjelehtë (nuk kam të metë mendore), por unë jam i dërguar prej Zotit të botëve. (Jam dërguar) Që t'u komunikoj shpalljet e Zotit tim dhe unë jam këshillues besnik për ju.” (El-A'raf: 66-68)

Në fyerjet e këtyre injorantëve nuk reagoi butësia e Hudit [alejhis-selam], sepse diferenca është shumë e madhe në mes njeriut të cilin e zgjodhi Allahu për Pejgamber, i cili është në kulminacion të mbarësisë dhe mirësisë, dhe popullit që e nënçmoi vetveten dhe iu dha adhurimit të gurëve, duke konsideruar se gurët u sjellin dobi e dëm! Si mund të ngushtohet mësuesi i madh me ulurimat e këtyre të gjymtëve?

Pejgamberi i Allahut, Muhammedi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem], deshi t'ua mësojë shokëve të vet këtë mësim mbi maturinë dhe kontrollimin e vetes. Transmetohet se një beduin erdhi te Pejgamberi t'i kërkojë diçka, ai i dha, e pastaj i tha: *“A bëra mirë ndaj teje?”* Beduini tha: *“Jo, nuk bëre mirë!”* Muslimanët u hidhëruan dhe u ngritën kundër tij, kurse Pejgamberi ua bëri me shenjë që të ndalen... Pastaj u ngrit dhe hyri në shtëpi, e thirri atë dhe i dha edhe diçka tepër. Pastaj i tha: *“A ta plotësova dëshirën?”* Beduini tha: *“Po, Allahu të shpërbleftë për familjen dhe farefisin me të mira.”* Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] i tha atij: *“Ti kur e the atë që e dëgjua pak më parë, shokët e mi u prekën, nëse dëshiron, thuaja atyre atë që ma the mua, ashtu që ta mënjanojnë bindjen e keqe që e kanë formuar për ty.”* Tha: *“Po.”* Dhe erdhi të nesërmen, dhe Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] tha: *“Ky beduini e tha atë që e tha, e ne i dhamë edhe më tepër, e mendoj se është i kënaqur, a është ashtu?”* Tha: *“Po, Allahu të shpërbleftë për familjen dhe farefisin me të mira.”* Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] tha: *“Shembulli im dhe shembulli i këtij është si shembulli i një njeriu të cilit i ka ikur deveja, e njerëzit iu vunë pas ta zënë, por me këtë vetëm se e dëbuan edhe më tepër; pronari i tyre i thirri dhe u tha: “Më leni vetë ta zë deven time, sepse unë jam më i njohur dhe më i butë ndaj saj sesa ju.” E u nis drejt saj, mori prej barishteve të tokës, dhe kështu e ktheu derisa erdhi dhe u ul, e shaloi dhe u ngjiti në të. Sikur t'u kisha lënë, kur e tha njeriu atë që e tha, e ta mbytshit, do të hynte në zjarr.”*

Pejgamberin e butë nuk e kaploi tmerri për shkak të arrogancës së bedunit në fillim dhe në të njohu natyrën e një grupi njerëzish, i cili karakterizohet me fjalë të zbrazëta dhe nxitim në të keqe. Sikur njerëzve të tillë t'u shpejtohej ndëshkimi, do të zhdukeshin, dhe nuk do të ishte një gjë e tillë padrejtësi.

Mirëpo, reformatorët e mëdhenj nuk përfundojnë me epilogun e masës së gjerë në këtë përfundim të dhembshëm; ata prej maturisë së tyre i pajisin njerëzit e ngutshëm me qëllim që t'i përqendrojnë me fuqi në bamirësi dhe t'ua lejojnë gjuhëve të tyre ta bëjnë shprehi lavdërimin.

Çmimin e saj nuk mund ta shfrytëzojë si zbukurim gjetësi i rastësishëm, edhe me qenë lëmoshë e madhe, sepse çka është dhënia e pasurisë përballë përvetësimit të njerëzve?

Beduinin, i cili e bleu kënaqësinë e tij me atë që përmendëm, nuk është larg mendjes ta shohësh pas disa ditësh të ngarkuar me një detyrë të rrezikshme, në të cilën e jep edhe kokën e vet me dëshirë!! Pasuria në duart e reformatorëve të mëdhenj nuk është tjetër, veçse nevoja e lypësve të ardhur, lakmues, apo është mbeturinë e tokës me të cilën ngarkohen kafshët teka-njoze për të kaluar me to hapësira të mëdha shkretinore. Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] ndonjëherë nervozohet, mirëpo ai nuk i tejkalonte kufijtë e respektit dhe arsyes. Prej biografisë së tij është përcjell se ai asnjëherë nuk ka ndëshkuar për shkak të vetin personal, por ka ndëshkuar vetëm atëherë kur janë shkelur kufijtë e Allahut.

Andaj, kur beduini arrogant i tha atij duke i ndarë plaçkat e luftës: *“Bëhu i drejtë, sepse kjo është ndarje e cila nuk është bërë për hir të Zotit”*, Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] nuk bëri më tepër, përveçse ia tregoi atij atë që ai nuk e dinte, e këshilloi veten, ia përkujtoi vetes atë që tha beduini për të dhe tha: *“Mjer për ty, kush është ai i cili do të jetë i drejtë, nëse nuk jam unë i drejtë? Do të shkatërrohesha dhe do të humbesha, nëse nuk jam i drejtë.”* Dhe njëkohësisht i ndaloj shokët e vet ta vrisnin, kur disa prej tyre u munduan ta bëjnë këtë.

Një ditë prej ditëve, Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] u ligjëroi njerëzve, dhe mes tjerash u tha: *“Njerëzit janë të krijuar në grada të ndryshme; ka disa prej tyre të cilët*

ngadalë hidhërohen, e shpejt falin; shpejt hidhërohen dhe shpejt falin; ngadalë hidhërohen dhe ngadalë falin; këta korrespondojnë mes vete. Dijeni se disa prej tyre shpejt hidhërohen, e ngadalë falin. Dijeni se më i miri prej tyre është ai i cili ngadalë hidhërohet, e shpejt fal, e më i keqi prej tyre është ai i cili shpejt hidhërohet, e ngadalë fal. Dijeni se disa prej tyre janë real në kthimin e borxhit dhe real në lypjen e tij; disa prej tyre janë të mbrapshtë në kthimin e borxhit, por real në lypjen e tij; disa prej tyre janë arrogantë në lypje, por real në kthyerje; këta korrespondojnë mes vete. Dijeni se më i miri prej tyre është ai i cili është real në kthyerjen e borxhit dhe real në lypjen e tij, ndërkaq më i keqi i tyre është arrogant i kthyerje dhe arrogant i lypje.”

“Dijeni se hidhërimi është një gacë në zemrën e njeriut; a nuk e keni vërejtur se i skuqen sytë dhe i fryhen damarët? Kush ndjen diçka të këtillë, le të ngjitet për toke.” /Transmeton Tirmidhiu/, respektivisht le të mbetet në vendin e tij dhe le të ulet, ngase kur lëshohet pas flakës së hidhërimit, prish çdo gjë pa vetëdije dhe nën shtypjen e madhe të pasioneve, ashtu që nuk lë vend për konsolidimin e tyre.

Hadithi i ndershëm i sqaroi grupet e njerëzve dhe piedestallet e tyre në mirësi, kurse besimtari e ven veten e vet atje ku duhet.

Njeriun që shumë shpejt dhe tejmas hidhërohet, kjo e bie në gjendje tërbimi, kështu ai e shan edhe derën kur nuk mund ta hapë, e ndodh që ta thyejë mjetin që i gjendet në dorë, apo ta mallkojë kafshën e cila mbi vete e mban.

Në një rast, era ia ngriti një njeriu rrobat, e ai e mallkoi erën, kurse Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] tha: *“Mos e mallko, sepse ajo është e urdhëruar dhe e nënshtruar, ngase ai i cili mallkon diçka për të cilën nuk është kompetent, mallkimi i kthehet atij.”* /Transmeton Tirmidhiu/

Të këqijat e hidhërimit janë të shumta, kurse rezultatet e tij janë të mjerueshme, andaj gjakftohtësia është argument i fuqisë së lavdëruar dhe solidarizimit fisnik.

Transmetohet prej Ibën Mes’udit, i cili thotë: “Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] ka thënë: *“Çka konsideroni ju fuqi?”* Thanë: *“Atë të cilin nuk mund ta mundin njerëzit.”* Tha:

“Jo, por ai i cili e kontrollon veten në rast hidhërimi.” /Transmeton Muslimi/

Një njeri i tha Pejgamberit [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem]: *“Më këshillo, por mos shumë, se frikohem mos harroj!”* (Pejgamberi) Tha: *“Mos u hidhëro.”* /Transmeton Maliku/ Kjo përgjigje koncize është më e mira që mund t'i jepet pyetjes e cila formulohet në këtë mënyrë.

Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem], ata që vinin tek ai dhe kërkonin t'i udhëzojë, i këshillonte me atë që është në pajtim me natyrën dhe ambientin e tyre: ndonjëherë ishte konciz, e ndonjëherë i gjatë, në bazë të asaj që kërkonin rrethanat.

Injoranca, problemin e së cilës e pastroi Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem], ishte dy llojesh: injorancë kundër ditorisë dhe injorancë kundër butësisë. Errësira e së parës shuhet me njohuritë e ndryshme dhe artet e udhëzimit, ndërkaq ndalimi i padrejtësisë së dytës mbështetet në shtypjen e epshit dhe pengimin e trazirave.

Arabët e parë mburreshin me atë se injorancën e përballonin me injorancë më të madhe:

*Dijeni se ai që do të tregohet injorant ndaj nesh
Ne do t'ia tejkalojmë me injorancë atij*

Islami erdhi dhe e ndaloi këtë erupcion, dhe i ngriti shtyllat e shoqërisë mbi mirësi, e nëse nuk mundet mbi këtë, atëherë mbi drejtësi. Ky synim do të arrihet vetëm atëherë kur do të dominojë mendja e shëndoshë mbi instiktin e hidhërimit.

Shumë prej këshillave që Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] ua dha arabëve ishin të orientuara në këtë drejtim, saqë manifestimet e mendjelehtësisë dhe teprimit u konsideruan ikje prej Islamit. Dhe nisur nga këto pranga me të cilat është lidhur bashkësia, ajo nuk luhetet dhe nuk tronditet.

“Sharja e muslimanit është mëkat, ndërkaq luftimi i tij është kufër (mosbesim).” /Transmeton Buhariu

Abdull-llah Ibën Mes'udi thotë: *“Ndërmjet çdo muslimani dhe muslimanit tjetër ka mburojë nga Allahu i Madhërishëm,*

andaj, kur dikush i thotë tjetrit ndonjë fjalë të paturpshme, e ka grisur mburojën e Allahut.” /Transmeton Bejhekiu/

Një beduin erdhi te Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] me dëshirë që ta mësojë Islamin, mirëpo nuk kishte njohuri të mëparshme për Pejgamberin [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] e as për atë në të cilën thirrte ai. Beduini, i cili quhej Xhabir Ibën Selim, thotë: *“Pashë një njeri, mendimin e të cilit e merrnin njerëzit; çdo gjë që thoshte ai, ata e pranonin. Thashë: “Kush është ky?” Thanë: “Pejgamberi i Allahut!” Thashë: “Për ty qoftë shpëtimi, o Pejgamber i Allahut!” Ai tha: “Mos thuaj për ty qoftë shpëtimi, sepse kjo është përshëndetja e të vdekurit, por thuaj: Paqja qoftë mbi ty!” I thashë: “Ti je Pejgamber i Allahut?” Ai u përgjigj: “Unë jam Pejgamberi i Allahut, që kur të godet ndonjë e keqe, e lus Allahun, dhe Ai ta largon atë; apo të kaplon thatësia, unë e lus Atë, dhe Ai lëshon begati; nëse je në ndonjë vend të panjohur dhe e humb kafshën me të cilën udhëton, unë e lus Atë, dhe Ai ta kthen kafshën tënde.” Pastaj i thashë: “Më obligo me diçka.” E ai më tha: “Mos e shaj askë!” Dhe pas kësaj unë nuk shava më askë, as njeri të lirë e as rob, as deve e as dele. Ai po ashtu tha: “Mos e përbuz të mirën, foli vëllait tënd me fytyrë të kthjellët, sepse kjo është prej mirësisë...” Pastaj tha: “Nëse dikush të fyen dhe nënçmon me ato gjëra që i di për ty, ti mos e fyej me atë që e di për të, sepse pasojat e saj do të jenë mbi të.” /Transmeton Ebu Davudi/*

Ka disa njerëz të cilët nuk heshtin në rast nervoze; ai çdoherë është në erupsion dhe pezëm, të cilit në fytyrën e tij reflektojnë vranësi. Nëse e prek dikush, ai dridhet sikur njeriu me ethe, fillon të bërtet e të shkumojë, të mallkojë e të akuzojë, ndërkaq Islami është i pastër nga këto vese të fëlliqura. Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] thotë: *“Besimtari nuk është akuzues i tepërt, mallkues i tepërt, i mbrapshtë dhe i pafytyrë.” /Transmeton Tirmidhiu/*

Mallkimi është prej vetive të ulëta, dhe ata që i mallkojnë të tjerët për çështje shumë të imta i ekspozohen sprovimit të madh; bile njeriu duhet t’i ikë mallkimit të tjetrit, edhe nëse ai i bën ndonjë të keqe të madhe.

Sa më tepër të kultivohet besimi në zemër, bashkë me të kultivohet edhe toleranca dhe shtohet butësia, e njeriu i ikën

kërkimit të shkatërrimit dhe pezmit të atyre që kanë gabuar ndaj tij.

Pejgamberit të Allahut i është thënë: *“Lutu kundër idhujtarëve dhe mallkoji ata.”* Kurse ai tha: *“Unë jam dërguar mëshirë, e nuk jam dërguar mallkues.”* Për atë, sa është muslimani gjakftohtë dhe e shuan mllëfin e vet, i kontrollon fjalët e veta, nuk ua var veshin lëshimeve ndaj tij dhe brengoset për gabimet e bëra, e tillë do të jetë pozita e tij tek Allahu.

Për këtë edhe Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] ia tërhoqi vërejtjen Ebu Bekrit [radijAllahu anhu], pse i mallkoi disa prej robërve të vet, dhe i tha: *“Nuk i ka hije siddikut (të sinqertit) të jetë mallkues.”* /Transmeton Muslimi/ Sipas një transmetimi tjetër: *“Nuk shkojnë bashkë të jeni edhe mallkues edhe të sinqertë.”* /Transmeton Hakimi/ Prandaj Ebu Bekri i liroi ata robër, si shpajim i asaj që doli prej tij kundrejt tyre, dhe erdhi te Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] dhe i tha: *“Nuk e përsëris më.”*

Ngase mallkimi është një bombë e mbrapshtë dhe e rrezikshme, në të cilën më tepër nxit zemërimi i verbër sesa merita e ndëshkimit. Moskujdesi i njerëzve ndaj këtyre gjuajtjeve të ashpra nuk është në rregull, sepse asnjë nuk shpëton nga e liga e tyre. Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] thotë: *“Kur besimtari mallkon diçka, mallkimi ngjitet në qiell dhe para tij mbyllen dyert e qiellit. Pastaj zbret në tokë dhe po ashtu mbyllen dyert e saj. Pastaj fillon të sillet djathtas e majtas; nëse nuk gjen vend të përshtatshëm, kthehet tek ai i cili është mallkuar, nëse është meritues... e përndryshe kthehet te lëshuesi i tij.”* /Transmeton Ebu Davudi/

Islami i ndaloj fyerjet e palogjikshme dhe sharjet e ndërsjella në mes të të kacafyturve.

Në sa beteja shkelen nderet dhe sharjet e ndaluara invadojnë mbi shenjtëritë e vlefshme, ndërkaq shkaku i vetëm i këtyre mëkateve të rënda është dominimi i hidhërimit dhe humbja e kulturës. Mëkatet e këtyre luftërave të turpshme kthehen te ndezësi i parë i flakës së tyre, siç përmendet në hadith: *“Fyesve reciprok u takon ajo që thonë; atij që e fillon i pari i takon mëkati, derisa të sulmojë ai që është shkelur.”* /Transmeton Muslimi/

Shpëtimi nga këto konflikte të ashpra është në dominimin e butësisë mbi hidhërimin dhe dominimin e faljes mbi hakmarrjen. Nuk ka dyshim se njeriun e zemëron çdo sulm ndaj personalitetit të tij, apo ndaj atij që e do, dhe, kur i jepet rasti i hakmarrjes, nxiton në pagimin e të keqes me një tjetër si ajo. Ai nuk mund të qetësohet derisa nuk e ngushton borxhliun e vet aq sa vetë ai ka përjetuar dhembje.

Mirëpo ekziston një mënyrë tjetër, e cila është më e preferueshme se kjo, më e dashur për Allahun, dhe më dëshmuuese për madhësinë dhe njerëzinë, e ajo është që ai ta shuajë pezmin e vet dhe mos të shpërthejë, ta ndalë dorën e vet dhe mos të hakmerret, si dhe ta konsiderojë faljen e tij gabimtarit një lloj falënderimi ndaj Allahut, i Cili ia mundësoi ta kthejë hakun e vet nëse dëshiron.

Transmetohet prej Ibën Abbasit, i cili thotë: “Kur erdhi Ujejne Ibën Hisn (në Medine), u vendos te djali i vëllait të vet, Hur Ibën Kajsi, kurse ky ishte prej atyre të cilët i afronte Omeri [radijAllahu anhu], sepse dijetarët (njohësit e mirë të Kur’anit) ishin anëtarë të përhershëm të kuvendit të udhëheqësit të besimtarëve, Omer Ibën Hattabit [radijAllahu anhu] dhe konsultuesit e tij, pa marrë parasysh a ishin pleq apo të rinj. Ujejne tha: “O djali i vëllait tim, caktoje një afat te udhëheqësi i besimtarëve.” Ky këtë e bëri, dhe kur hyri Ujejne te Omeri [radijAllahu anhu] tha: “O biri i Hattabit, betohem në Allahun, nuk na jep neve mjaft, e as që gjykon mes nesh me drejtësi.” Omeri [radijAllahu anhu] u hidhërua, saqë deshi t’i ngrihet atij. Atëherë Huri i tha: “O udhëheqës i besimtarëve, Allahu i thotë Pejgamberit të Vet: **“Ti (Muhammed) merre të lehtë, urdhëro për mirë dhe hiq prej të padijshmëve.”** (El-A’raf: 199), ndërsa ky është prej të padijshmëve.” Për Allahun, Omeri nuk i tejkaloi këto këshilla kur ai ia lexoi atij, dhe çdo herë ndalej para librit të Allahut.” /Transmeton Buhariu/

Omeri u hidhërua për fyerjet që ia bëri beduini dhe për këtë deshi t’ia tërhiqte vërejtjen, sepse ai nuk hyri ta këshillojë për diçka të mirë apo ta kërkojë hakun e vet, por i hyri sundimtarit në pushtetin e tij që ta fyejë pa arsye dhe të lypë prej tij t’i jap shumë gjëra pa punë! Mirëpo, posa iu tërhoq vërejtja se njeriu është prej të padijshmëve, u largua dhe e la të shkojë

rehat. Në hadith përmendet: *“Kush e shuan një mllef duke pasur mundësi ta zbrazë, në Ditën e Gjykimit Allahu do ta thërrasë para gjithë krijesave, me qëllim që t’i jap mundësi të zgjedh cilat hurije i dëshiron.”* /Transmeton Ebu Davudi/

Transmetohet prej Ubade Ibën Samitit, se Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] ka thënë: *“A t’ju tregoj me çka i përsos Allahu virtytet dhe i lartëson gradat?”* Shokët thanë: *“Po, o Pejgamber i Allahut.”* Tha: *“Të jesh i butë ndaj atij që është arrogant ndaj teje; t’ia falish atij që të ka bërë ndonjë padrejtësi; t’i japish atij që të ka injoruar; dhe t’i mbash lidhjet me atë që të ka lënë (nuk të vjen).”* /Transmeton Taberaniu/

Kur’ani Famëlartë këto virtyte të vyeshme i konsideroi rrugë shpëtimi e cila e shpie njeriun me nxitim në Xhenetet e larta: ***“Dhe ngutuni (me punë që meritoni) në falje mëkatesh nga Zoti juaj dhe për në një Xhenet, gjerësia e të cilit është si gjerësia e qiejve dhe e tokës, i përgatitur për të devotshmit. Të cilët japin kur janë shilirë edhe kur janë në vështirësi dhe që e frenojnë mllefin, që u falin (të keqen) njerëzve, e Allahu i do bamirësit.”*** (Ali Imran: 133-134)

Prej rrëfimeve të faljes, e cila nuk e ka shembullin në mes njerëzve, është falja prej Pejgamberit [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] e prijësit të hipokritëve, Abdull-llah Ibën Ubejjit. Abdull-llah Ibën Ubejji ishte armik i përbetuar i muslimanëve, dhe çdoherë shikonte t’ua bënte sherrin; u përgatiste komplete, dhe saherë që i jepej rasti t’i akuzonte dhe t’ua fyente Pejgamberin, e shfrytëzonte këtë. Ky është ai që e përhapi fjalën e keqe për nënën e besimtarëve, Aishen, me ç’rast filluan shpëfshëm dezinformues të bërbelitit me shpifjen rreth saj dhe t’i lëkundin seriozisht themelet e shoqërisë islame me këtë akuzë të turpshme, ndërkaq traditat e lindjes që nga kohët e lashta e vunë nderin e gruas në kulm të shenjtërisë dhe me të e lidhin prestigjin e saj dhe prestigjin e familjes së saj të largët dhe të afërt.

Për këtë, hovi i dhembjes ka qenë i ashpër në shpirtin e Pejgamberit dhe të shokëve të tij, e turpi nga kjo shpifje e mbrapshtë i mbushte shpirtrat e tyre me pikëllim dhe dëshpërim, derisa në fund zbritën ajetet kur’anore dhe e zbuluan tradhtinë e hipokritëve dhe shpaluan akuzat e tyre të pabaza për

prestigjin e nderit të nënës së besimtarëve dhe pastërtisë së faqes së jetës së saj.

“S’ka dyshim se ata që trilluan shpifjen, janë një grup prej jush. Ju mos e merrni atë si ndonjë dëm për ju, për-kundrazi, ajo do të jetë në dobinë tuaj. Secilit prej tyre do t’i takojë dënimi sipas pjesëmarrjes në mëkat, e atij prej tyre që e barti pjesën e madhe (të shpifjes) i takon dënim i madh.” (En-Nur: 11)

Dënimi iu shqiptua atyre që ishin manipuluar në këtë tragjedi, ndërkaq virusi i së keqes shpëtoi... që ta vazhdojë tradhtinë e tij ndaj muslimanëve dhe t’u sjellë dëme sa të mundet!!

Allahu i caktoi fitore Pejgamberit të Vet dhe ushtrisë së tij, dhe Islami i mënjanoi fosilet e shekujve të ankthshëm. Armiqtë e tij u kufizuan në vetvete, bile atyre u hynë nga këndet e tyre. U mposht Ibën Ubejji, pastaj u sëmur dhe vdiq, pasi era e hipokrizisë së tij qelbi çdo vend. Erdhi djali i tij të kërkojë falje nga Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] për babain e vet dhe ky ia fali. Pastaj ia kërkoi këmishën, që t’ia bëjë *qefin* (ta mbështjell), e Pejgamberi ia dha. Pastaj kërkoi prej tij që t’ia falte xhenazen dhe të lypte falje për të, e Pejgamberi i butë e falës nuk e refuzoi këtë kërkesë, por qëndroi para kufomës së shpifësit të djeshëm kundër nderit të tij, dhe kërkoi për të falje.

Mirëpo drejtësia hyjnore e zgjidhi definitivisht këtë problem, dhe zbriti Fjala e Allahut të Madhërishtëm: ***“Kërko falje për ta ose mos kërko (është njëjtë), e edhe nëse kërkon falje shtatëdhjetë herë, Allahu nuk do t’ua falë, sepse ata mohuan Allahun dhe të Dërguarin e Tij, e Allahu nuk vë në rrugë të drejtë (të shpëtimit), ata që nuk e respektojnë.” (Et-Teube: 80)***

Me çështjen e shpifjes ndaj Aishes është e lidhur edhe ajo se një i afërt i Ebu Bekrit [radijAllahu anhu] i cili jetonte me mirësinë e tij, nuk u mbrojt nga involvimi në cenimin e nderit të zonjës, babai i së cilës e mirëmbante atë (të afërmin). Me këtë ai e harroi obligimin islam, obligimin e afërsisë dhe obligimin e mirësisë së bërë, gjë që e preku Ebu Bekrin [radijAllahu anhu] dhe e shtyu të betohet që ta lëshojë prej dore të afërmin në fjalë e mos ta ketë atë qëndrim sikur më parë. Për këtë zbriti

ajeti: *“Të ndershmit dhe të pasurit nga ju, të mos betohen se nuk do t’u japin të afërmve, të varfërve dhe atyre që për hir të Allahut kanë vendlindjet e tyre, po le t’ua falin (gabimin) dhe mos t’ua zënë për të madhe. A nuk dëshironi që Allahu t’u falë ju? Allahu falë dhe mëshiron shumë.”* (En-Nur: 22)

Ebu Bekri [radijAllahu anhu] përsëri vazhdoi të jetë bamiresh ndaj tij si më parë, duke thënë: *“Unë dëshiroj të ma falë Allahu.”*

BUJARIA DHE FISNIKËRIA

Islami është fe e cila mbahet me dhënie dhe ndarje të pasurisë, ndërkaq humbet në koprraci. Për këtë, ua bëri të dashur bijve të tij shpirtgjerësinë, dorëdhënien, dhe i këshilloi të shpejtojnë në bamirësi dhe mirësi, si dhe i këshilloi që mirësinë ndaj njerëzve ta bëjnë preokupimin e tyre të përhershëm dhe mos të ndahen prej saj asnjëherë: ***“Ata, të cilët pasurinë e vet e shpërndajnë (në rrugë të Zotit) natën e ditën, fshehurazi ose haptazi, ata shpërblimin e vet e kanë te Zoti i tyre dhe për ta nuk ka as frikë, as pikëllim.”*** (El-Bekare: 274)

Muslimani e ka obligim të jetë i matur në kërkesat e vetvetes, ashtu që mos ta harxhojë tërë pasurinë e vet, sepse ai duhet të bashkangjese edhe dikë me vete në atë të mirë që ia ka dhënë Allahu, si dhe të bëjë në pasurinë e vet vend për t’u ndihmuar të mjerëve dhe për t’ua lehtësuar të lodhurve. Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] thotë: ***“O njeri, nëse bën mirësi, kjo është më mirë për ty, e nëse nuk e bën këtë, kjo është më keq për ty; ti nuk do të qortohesh për begatitë, fillo me ata që i mbikëqyr, dhe dije se dora e lartë (që jep) është më e mirë se dora e ulët (që lyp).”*** /Transmeton Muslimi/

Kur’ani e thekson këtë kuptim, kur e bashkangjiti ndalesën nga teprimi me urdhrin e shpenzimit ndaj të afërmeve dhe të varfërve. Harxhuesi i tepërt është shpenzues i kotë mendjelehtë, dhe kajmakun e pasurisë së vet e humb në epshet e tij personale. E pas saj, çka mbetet për detyrat obligative dhe ndihmën e domosdoshme?

Allahu i Madhërishëm thotë: ***“Dhe jepi çdo të afërmi të drejtën që i takon, edhe të varfërit, edhe atij në kurbet, po mos shpenzo tepër e pa rrugë. Ata që shpenzojnë tepër (mas-***

trafxhinjtë) janë vëllezër (në veprim) të djajve, e djalli është përbuzës i madh i Zotit të Tij.” (El-Isra: 26-27)

Konteksti vazhdoi me porosinë ndaj të nevojshmëve dhe mbrojtjen e dinjitetit të tyre; kështu e urdhëroi muslimanin që t’ua dëshirojë atyre të mirën dhe t’u thotë fjalë të mira, nëse nuk mund t’ua japë atë që e dëshirojnë: **“Nëse detyrohesh t’ua kthesh shpinën atyre (të afërmve etj.), duke kërkuar mëshirën, të cilën e shpreson nga Zoti yt (furnizim për t’i ndihmuar ata), atëherë thuaju atyre fjalë të mira (të lehta).”** (El-Isra: 28)

Thirrja e Islamit në bujari dhe altruizëm është e bujshme dhe konstante dhe lufta e tij kundër koprracisë dhe dorështërngueshmërisë është permanente dhe e shpallur. Në hadith për-mendet: **“Altruisti është afër Allahut, afër njerëzve, afër Xhenetit, dhe larg nga zjarri; ndërkaq, koprraci është larg nga Allahu, larg nga njerëzit, larg nga Xheneti dhe afër zjarrit; dhe një njeri altruist i padijshëm është më i dashur tek Allahu sesa një koprrac i devotshëm (ibadetxhi).”** /Transmeton Tirmidhiu/

Në botë nuk ekziston sistem - dhe nuk do të ekzistojë - në të cilin njerëzit nuk do të kenë nevojë për ndihmë reciproke dhe solidarizim, por, për arritjen e qetësisë dhe garantimin e lumturisë, patjetër i forti të jetë i butë ndaj të dobbit, pasaniku të jetë i afrueshëm me të varfërin, pasi natyra e shoqërisë njerëzore është e tillë që të afrohen fuqia dhe dobësia, pasuria dhe varfëria.

Sikur të kishin qenë pasuria dhe skamja në pajtim me aftë-sitë intelektuale që u janë dhënë njerëzve, disa do të depono-nin shumë pasuri, ndërkaq disa do të jetonin në bollëk; këto janë ligjet e natyrës njerëzore në të cilat nuk ka falsifikim. Por dëshpërimi depërton te njerëzit kur ata jetojnë të izoluar, nuk njohin përveçse vetveten dhe ekskluzivisht kërkesat e vetes, edhe përsëri asaj se Allahu i Madhërishëm i ka përzier njerëzit në mes vete dhe këtë përzierje, duke pasur parasysh dallimin e gjendjes së tyre, e bëri sprovim të madh me të cilin e kalit besi-min dhe e shpërndan mirësinë: **“... Ne bëmë njërin prej jush sprovë për tjetrin se a do të jeni të durueshëm. E Zoti yt është Ai që sheh çdo gjë.”** (El-Furkan: 20)

Asnjë popull nuk mund të korrë sukses në këtë rrafsh, pa qenë lidhjet e forta në mes bijve të tij; kështu, nuk lë të varfër

të vuajë nga dhembjet e skamjes dhe nuk lë pasanik i cili do t'i monopolizojë mirësitë e pasurisë.

Në Islam ekzistojnë parime precize për realizimin e këtyre objektivave fisnik, kurse prej tyre është adoptimi i shpirtit për të bërë mirë, ofrimi i ndihmës dhe veprat bamirëse. Me rezultatet e këtij adoptimi të shkëlqyeshëm nuk bëhen të lumtur vetëm të dobtit, por siguria dhe qetësia e tyre kthehet edhe te vetë protagonistët e saj! Kështu i mbrojnë ata nga dridhjet e mllleve dhe pasojat e egoizmit të verbër. Allahu i Madhëri-shëm thotë: ***“Ja, ju jeni ata që ftoheni për të dhënë në rrugën e Allahut (për luftë kundër armikut tuaj), e dikush prej jush bën koprraci, e kush bën koprraci, ai bën kundër vetvetes, Allahu s'ka farë nevojë, e ju jeni të varfër (keni nevojë)...”*** (Muhammed: 38)

Varfëria është e metë e cila, kur gjendet te njeriu, e ngushton dhe e rrëzon nën pozitën të cilën ua caktoi Allahu njerëzve; ajo, po ashtu, është rrezik ta privojë atë nga prestigji me të cilin Allahu e bëri njeriun superior ndaj krijesave të tjera. Është shumë rëndë për njeriun që të shohë një person me rroba të grisura, vrimat e së cilës gati sa nuk ia zbulojnë pjesët e turpshme, apo këmbëzbathur, të cilit sipërfaqja e tokës ia ka shkatërruar gishtat dhe shputat e këmbës, ose kur i uritur i lëshon sytë në ushqime të ndryshme, e pastaj e kthen skamja të molisur.

Ata të cilët i shohin këto skena rrëqethëse e pastaj nuk preken në shpirt nga ato, ata nuk janë njerëz dhe nuk janë besimtarë. Në përgjithësi, në mes njerëzve, ka farefisni e cila duhet të respektohet dhe nuk duhet lejuar që atë ta shkëpusë skamja.

Prej besimit është që njeriu të ketë drojë nga Zoti për gjendjen e këtyre të ngratëve.

Një herë Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] pati rastin të shohë një prej skemave të këtilla dëshpëruese, gjë që e preku mjaft. Për këtë i tuboi muslimanët dhe u foli, ua përkujtoi obligimin e njeriut ndaj njeriut dhe frikën e tyre ndaj Allahut dhe Ditës së Fundit, dhe vazhdoi t'u flasë atyre, derisa tubuan mjete të nevojshme jetësore dhe rroba për mbulim.

Transmetohet prej Xheririt, i cili thotë: “Një mëngjes ishim te Pejgamberi i Allahut, kur erdhën te ai disa njerëz të zhveshur me rroba të grisura, të gjithë ishin të fisit Mudar. Posa i pa, fytyra e Pejgamberit [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] u ndërrua dhe u pikëllua nga varfëria që pa tek ata. Njëherë hyri, pastaj doli dhe e urdhëroi Bilalin ta thërrasë ezanin, u ngrit dhe u fal, pastaj ligjëroi dhe tha: *“O ju njerëz! Kinie frikë Zotin tuaj që ju ka krijuar prej një veteje (njeriu) dhe nga ajo krijoi palën (shoqen) e saj, e prej atyre dyve u shtuan burra shumë e gra. Dhe kinie frikë Allahun që me emrin e Tij përbetoheni, ruajeni farefisin (akraballëkun), se Allahu është mbikëqyrës mbi ju.*

O ju që besuat, kinie parasysh frikën ndaj Allahut, dhe le të shikojë njeriu se çka ka bërë për nesër...”

Pastaj tha: *“Le të japë lëmoshë njeriu nga dinarët që i posedon, dirhemët (ari dhe argjendi), rrobat e veta, nga sasia e grurit dhe hurmave që posedon”, derisa tha: “Po edhe një lëvure hurme.”*

Arriti një prej ensarëve (medinasve) me një strajcë të cilën mezi që e bante në dorë, bile edhe s’mund ta mbante! Pastaj një nga një pasuan njerëzit e tjerë. Kështu, pashë një turmë të madhe me ushqim dhe rroba... e kur, e pashë fytyrën e të dërguarit të Allahut se si shkëlqente sikur ari, dhe tha: *“Kush trason në Islam një traditë të mirë, ai do ta ketë shpërblimin e saj dhe shpërblimin e atyre që do ta pasojnë atë traditë pas tij, pa u munguar kurrëgjë në shpërblimet e tyre. Po ashtu, kush trason në Islam një traditë të keqe, ai do ta meritojë mëkatin e saj dhe mëkatin e atyre të cilët do të punojnë sipas saj, pa qenë mangut në mëkatet e tyre asgjë.”* /Transmeton Muslimi/

Këto fjalë fenomenale, janë thirrje për të garuar në mirësi dhe për të nxituar në hapjen e projekteve të dobishme, si treni i mëshirës dhe ndihma dimërore, dhe të ngjashme; po ashtu, këto fjalë janë vërejtje për ata të cilët i ngjallin doket e mbrapshta dhe me to i ndërlikojnë çështjet e bashkësisë, e kështu i lënë ata që do të vijnë pas, të pësojnë në ligësitë dhe vuajtjet e tyre.

Mirëpo, njeriu është i prirë kah dashuria ndaj pasurisë dhe orvatja për posedimin e saj; ai ec për këtë qëllim në anë të ndryshme të botës; egoizmi në shpirtin e njeriut ka sugjestion

të forta; të menduarit më të madh është për vetveten, e më pak për të tjerët.

Sikur t'i jepeshin njeriut të gjitha pasuritë e tokës, dhe sikur ai t'i kishte poseduar depotë e mëshirës supreme, nuk do ta kishte lejuar veten të jap lëmoshë me bollëk, por nga natyra e tij e ngushtë atij do t'i paraqiteshin shumë shkaqe të cilat do të venin në duart e tij pranga. ***“Thuaj: Sikur të kishit depotë e begative të Zotit tim, nga frika se po shpenzohen, do të bëheni koprrac; njeriu është dorështrënguar.”*** (El-Isra: 100)

Islami këto ndjenja i konsideron prej tendencave të liga të cilat duhet të luftohen energjikisht, dhe intrigave të tyre t'u bëhet ballë me zgjuarsia dhe aktivitet. Ai sqaroi bukur se të mirat e të dy botërave mund t'i akumulojë ai i cili arrin t'i mposhtë shtytjet e koprracisë në veten e vet dhe t'ia bëjë asaj shprehje fisnikërinë dhe dorëdhënien: ***“Andaj, sa të keni mundësi ruanu prej dënimit të Allahut, dëgjoni, respektoni dhe jepni për të mirën tuaj, e kush i ruhet lakmisë së vetvetes, të tillët janë të shpëtuarit.”*** (Et-Tegabun: 16)

Pasuritë e mbuluara nëpër depo, në të cilat fshihet e drejta e të varfërit dhe e të ngratit, janë e keqe e madhe për pronarin e tyre në këtë botë dhe në botën tjetër; pasuritë e tilla më së tepërmi u ngajjnë gjarprinjtë të fshehur në vrimat e tyre; rrezik i përgatitur për të keqen e njerëzve. Bile Islami tregoi se pasuritë e tilla njëmend shndërrohen në gjarprinjtë të cilët janë lëshuar të tërbuar me dhëmbët e tyre, duke e rrëmbyer pronarin e pasurisë që t'ia kafshojë dorën e tij të cilën ia ka mashtruar koprracia.

“... dhe çdo pronar i pasurisë i cili nuk ia nxjerr hakun e vet të duhur, kjo pasuri do t'i vijë Ditën e Gjykimit si gjarpër me dhëmbë duke e ndjekur me gojë të hapur; kur do të ikë prej tij, do të dëgjojë një duke e thirrur:”Merre pasurinë tënde të cilën e fshehe, unë nuk kam nevojë për të! Kur do ta shohë se ajo i është e patjetërsueshme, do ta fusë dorën në gojën e tij dhe do t'ia kafshojë sikur shtaza.” /Transmeton Buhariu/

Islami tenton ta vetëdijësojë njeriun në mënyrë të mirë dhe me bindje se dashuria e tij e flaktë ndaj pasurisë mund ta vë në pozita të palakmueshme, dhe ai, sikur të kishte menduar në esencën e asaj që posedon dhe përfundimin e tij me pasurinë e

tillë, do ta konsideronte shpirtëgjërësinë më të mirë se egoizmin dhe dhënien më të mirë se koprracia.

“Njeriu thotë:” Pasuria ime, pasuria ime!” por ai prej pasurisë së vet ka tri gjëra: Atë që e ka ngrënë dhe e ka mbaruar; atë që e ka veshur dhe është vjetëruar; apo atë që e ka dhënë dhe e ka përvetësuar. Ndërkaq, ajo që është jashtë këtyre, ka shkuar dhe ua lë njerëzve.” /Transmeton Muslimi/

Është habi që të pësojë njeriu në tubimin e asaj që ua lë të tjerëve; nëse nuk e shfrytëzon muslimani pasurinë e vet në atë që ia konsolidon jetesën dhe ia mbron kthimin e tij, atëherë në çka ta shfrytëzojë atë?

Këtë realitet e shpaloj Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] duke thënë: *“Cili prej jush e do më tepër pasurinë e trashëgimtarit të tij sesa pasurinë e vet personale?”* Ata thanë: *“Çdonjëri prej nesh pasurinë e vet e do më tepër.”* (Pejgamberi) Tha: *“Pasuria e tij është ajo që e ka dhënë, ndërsa pasuria e trashëgimtarit të tij është ajo që e ka lënë pas!!”* /Transmeton Buhariu/

Por krahas kësaj, Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem], kur e proklamoi tubimin e zekatit, e ndjeu sensibilitetin e ndjenjave të lakmisë te njerëzit dhe që i butë në shërimin e tyre, e për këtë tha: *“Do t’u vijnë juve kalorës që i urreni - ka për qëllim tubuesit e zekatit - për atë, kur do t’u vijnë, shfaqja e mikpritje dhe jepjauni atë që e kërkojnë; nëse janë të drejtë, kjo është për të mirën e tyre, e nëse nuk janë të drejtë, kjo do të jetë në dëm të tyre. Bëhuni të kënaqur, sepse kompleksi i zekatit tuaj është kënaqësia e tyre, dhe le të luten për të mirën tuaj.”* /Transmeton Ebu Davudi/

Suksesi i njeriut në eliminimin e pengesave të koprracisë, të cilat i pengojnë ndjenjat e mirësisë tek ai, në këndvështrimin islam është mirësi e përkryer, sepse dihet se shpresa e njeriut në jetë rritet dhe raportet e tij me të forcohen kur ai ka trup të shëndoshë dhe aspirata për ardhmëri, kur është i matur në shpenzime dhe e shton kapitalin e vet me qëllim që të sigurojë një të nesërme më të begatshme për vete dhe për pasardhësit e tij. Kur do t’i posedojë gjithë këto motive dhe e shtrin dorën në pasurinë e vet, atëherë ndan me gjithë zemër dhe nuk frikohet

se do t'i pakësohet e as se do t'i zhduket pasuria; ai kështu bën mirësi të madhe.

Erdhi një njeri te Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] dhe i tha: *“O Pejgamber i Allahut, cila lëmoshë ka shpërblim më të madh?”* Tha: *“Të ndash lëmoshë duke qenë i shëndoshë e lakmues i pasurisë, duke u frikuar prej varfërisë e të shpresosh në pasuri; mos e le derisa të të vijë fundi, e të thuash: Filanit ia lë këtë, filanit këtë, e filanit i ka takuar kjo.”* /Transmeton Buharriu/

Lëmosha e gjerë, me sinqeritet dhe mëshirë, i lan mëkatet dhe i fshin gabimet. Allahu i Madhërishëm thotë: *“Nëse lëmoshat i jepni haptazi, ajo është mirë, po nëse ato u jepni të varfërve fshehurazi, ajo është edhe më e mirë për ju dhe Ai ua largon (me punë të mira) të këqijat. Allahu është i njohur hollësisht për veprat tuaja.”* (El-Bekare: 271)

“Nëse Allahut i huazoni diçka të mirë, Ai juve ua shumëfishon atë dhe ju falë; Allahu është shumë mirënjohës, i butë. Është i gjithdijsmi i të fshehtës e i të dukshmes, është ngadhënjyesi, i urti.” (Et-Tegabun: 17-18)

Për atë, kur muslimani rrëshqet në ndonjë mëkat dhe vëren se ai mëkat e largoi atë nga Zoti, pastrimi që ia kthen atij kthjelltësinë, ia jep shkëlqimin dhe e mbështjell në rrobat e faljes dhe kënaqësisë, është që ai të shikojë në pasurinë të cilën aq tepër e ka lakmi dhe prej saj t'u ndajë të varfërve dhe të ngratëve, si shërbim me të cilin do të afrohet te Mëshiruesi më i mëshirshëm.

Transmetohet nga Ebu Dherri, se Pejgamberi i Allahut ka thënë: *“Një njeri i devotshëm prej Beni Israilëve i bëri ibadet (adhurim) Zotit në faltoren e tij gjashtëdhjetë vjet, dhe pati reshje, e toka u gjelbërua. Ky njeri i devotshëm e pa këtë prej faltores së tij, dhe tha: ‘Sikur të zbrisja në këtë vend e ta përkujtoja Allahun, e të më shtoheshin të mirat!!’ Zbriti, dhe me vete kishte një apo dy copë bukë. Dhe derisa ishte ai në atë vend, e takoi një grua dhe filloi t'i flasë asaj, e edhe ajo atij, derisa bëri marrëdhënie intime me të, dhe i ra të fikët. Zbriti pastaj në një përrua të lahet, kur papritmas arriti një lypës, të cilit i bëri me shenjë t'i marrë bukët, e pastaj vdiq. U mat adhurimi i tij gjashtëdhjetvjeçar me atë amoralitet, dhe amo-*

raliteti ia rëndoi punët e mira. Pastaj te punët e mira u vunë copat e bukës, me ç'rast rënduan punët e mira, dhe atij iu falën mëkatet.” /Transmeton Ibën Hibbani/

Prej shembujve më të shkëlqyer, që tregojnë ndikimin e altruizmit dhe bujarisë në falje dhe shpëtim, është inspirimi i Allahut drejtuar Pejgamberit të Tij, Jahjait [alejhis-selam], që ta mësojë popullin e tij: “... *Dhe ju urdhëroj me lëmoshë. Shembulli i kësaj është si shembulli i njeriut të cilin e kanë zënë peng armiqtë dhe ia kanë lidhur duart në qafë, pastaj e afrian që t’ia presin kokën, e ai thoshte: “A pranoni që unë ta shpaguaj veten prej jush?” Dhe filloi të japë sa mundte, derisa e pagoi veten.” /Transmeton Hakimi/*

Lëmoshat që i japim, krahas llojshmërisë së tyre, si zekat, dhuratë, furnizim e të ngjashme, kanë rol madhështor në jetën e kësaj bote dhe të botës tjetër; në bazë të saj dobësohet apo forcohet lidhja e muslimanit me fenë e vet dhe nuk do ta privojnë njeriun, si p.sh. korracia e tij, ndaj obligimeve të veta dhe paragjykimet e tij për Zotin. Dhe nuk do të mund t’ia tejkalojë askush në fisnikërinë dhe bindjen e tij në mirësinë e Zotit.

Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] thotë: “*Bamirësitë të mbrojnë nga fatkeqësitë, lëmosha e fshehtë e shuan hidhërimin e Zotit, respektimi i farefisit ta shton jetën.” /Transmeton Taberaniu/*

“*Mbroni pasuritë tuaja me zekat, shëroni të sëmurit tuaj me lëmoshë, dhe pritni valët e sprovimit me lutje dhe devotshmëri.” /Transmeton Ebu Davudi/*

Asgjë nuk është më e rëndë për shejtanin, më shkatërruese për lajkat e tij dhe më zhdukëse për cytjet e tij se nxjerrja e lëmoshës. Për këtë ai në shpirtrat e njerëzve e hedh plogështinë, me qëllim që t’i ngadalësojë në dhënie dhe t’i lidhë me frenat zhdukës. “*Djalli ju frikëson nga varfëria dhe ju urdhëron për të këqija, e Allahu ju garanton falje (mëkatësh) e begati; Allahu është Dhurues i madh, është i Dijshëm.” (El-Bekare: 268)*

Në hadith përmendet: “*Sa herë që ndan ndonjë njeri diçka prej sadakasë, i mposht nga ajo shtatëdhjetë djaj, të cilët bashkërisht, të gjithë, ndalojnë nga ajo.” /Transmeton Ahmedi/*

Transmetohet prej Aishes [radijAllahu anha], se ata prenë një dele, e Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] pyeti: *“Ç’ka mbetur prej saj?”* Ajo tha: *“Prej saj ka mbetur vetëm shpatulla.”* Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] tha: *“E gjithë delja ka mbetur, përveq shpatullës.”* /Transmeton Tirmidhiu/³

Këtë e konfirmon Fjala e Allahut të Madhërishëm: ***“Ajo që e keni pranë vetes është e përkohshme, e ajo që është tek Allahu është e përhershme...”*** (En-Nahl: 96)

Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] e transmeton nga Zoti këtë hadith: *“O bir i Ademit (njeri), zbrazte depon tënde, se te Unë nuk ka djegie, fundosje, vjedhje; do të ta kompensoj me atë që do të kesh më tepër nevojë.”* /Transmeton Bejhëkiu/

Njeriu ndonjëherë mund të preokupohet nga paragjykimet se altruizmi e pakëson kapitalin dhe të afron kah varfëria, e po ashtu, se ia rrëmben njeriut begatinë e qetësisë në hijen e pasurisë së tij të madhe dhe mirësive të pranishme. Ky paragjykim është prej cytjeve të shejtanit në shpirttrat e të dobtëve.

Por, e vërteta është se bujaria është mënyrë e begatimit dhe altruizmi është shkak i shtimit, dhe ai që i bën duart e veta korridor për begatitë e Zotit, ai do të mbetet i furnizuar me begati, i pajisur në jetën e tij me bollëk të përhershëm nga mëshira dhe bujaria e Allahut.

Në hadith përmendet: *“Për tri gjëra betohem... Pasuria e njeriut asnjëherë nuk është pakësuar nga lëmosha; sa herë që njeriut i është bërë ndonjë padrejtësi, e ai ka duruar, Allahu e shton fuqinë e tij; dhe sa herë që e hap njeriu derën e lypjes, Allahu po aq ia hap derën e varfërisë.”* /Transmeton Ibën Maxhe/

Le të kapet njeriu për litarin e zemërgjerësisë, le të nxitojë në mbushjen e boshllëqeve që i has, le t’i shikojë njerëzit e nevojshëm, që i drejtohen atij, siç i shikon faktorët e tregtisë së suksesshme. Nëse sot ka dhënë pak, nesër apo pasnesër do të kthehet me shumë...

³ Ata krejt e kishin shpërndarë sadaka me përjashtim të shpatullës.

Allahu i Madhërishëm dhënien e mirë e konsideroi huazim human dhe nuk ia kthen njeriut përkatës të ngjashme apo dy herë të tillë, por shumë më tepër. Ai i stimuloi njerëzit të japin dhe u tregoi atyre se ajo që ua japin tjerëve është mjet i cili bën që Allahu t'i furnizojë njerëzit e tillë nga depot e Tij, të cilat nuk mbarojnë.

Në hadith të transmetuar nga Allahu i Madhërishëm përmendet: *“O rob i Im, jep, që të të jap ty; dora e Zotit është plot, nuk e harxhon shpërndarja natën e ditën. Çka mendoni për atë që e ka shpërndarë prej kur i ka krijuar qiejt e tokën? Nuk u pakësua ajo që posedonte; Arshi i Tij ishte mbi ujë, e Ai në dorë e kishte peshojën me të cilën ulte dhe ngrente.”* /Transmeton Buhariu/

Allahu i Madhërishëm thotë: **“... e çkado që të jepni, Ai e kompenson atë dhe Ai është Dhuruesi më i madh.”** (Sebe': 39)

Ata të cilët shpërndajnë - kur janë në bollëk dhe telashe - janë në mbikëqyrjen e Allahut dhe në mbrojtjen e Tij, për ta luten melekët dhe shpresojnë t'u shtohet pasuria; ndërsaq për deponuesit pritet vetëm humbje, dhe a thua ata do të jetojnë përjetë me pasurinë, apo pasuria do të jetë e përjetshme me ta? Pasuria është huazim i cili te ne u transferua prej të tjerëve, atëherë pse gjithë kjo këmbëngulje në të dhe ky anim kah ajo?

Çdo interes i kësaj bote, me të cilin lidhen njerëzit, nuk ka dyshim se ia lënë trashëgimtarit të qiejve dhe tokës, dhe te Zoti i tyre do të kthehen këmbëzbathur, pa pasuri e pozitë, siç u krijuan herën e parë, dhe do të lidhen me pasurinë e tyre Ditën e Gjykimit. Andaj, nuk është çudi që të hakmerret Zoti ndaj atyre të cilët i harrojnë këto të vërteta dhe lëshohen në tokë pa pasur asnjë brengë tjetër përveç tubimit të asaj që e dëmton dhe harresës së asaj që i sjell dobi. Pejgamberi [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] thotë: *“Nuk ka ditë në të cilën nuk zbresin dy melekë, njëri thotë: ‘O Zot, kompensoja atij i cili jep’, kurse tjetri thotë: ‘O Zot, shkatërroja atij që është koprrac.’* /Transmeton Muslimi/

Njeriu mund ta lakmojë pasurinë edhe për atë se dëshiron t'i lërë fëmijët e vet të pasur, e cila do t'i mbrojë ata nga ndryshimet në shoqëri. Ky është qëllim i mirë, sepse muslimani është i obliguar t'i mbrojë pasardhësit e tij, të mos i lërë të

varur dhe t'i shohë se nuk kanë nevojë për njerëzit. Islami, i cili të urdhëron ta luftosh varfërinë në shtëpinë e huaj, nuk pajtohet që ta sjellësh atë në shtëpinë tënde. Në hadith përmendet: *"... dhe t'i lësh pasardhësit tuaj të pasur është më mirë, sesa t'i lësh të varur prej njerëzve."* /Transmeton Buhariu/

Mirëpo, mbikëqyrja e fëmijës dhe të siguarit e ardhmërisë së tij nuk bën të jetë në llogari të fesë dhe moralit të tij, për shkak se është marri që njeriu ta sakrifikojë veten, njerëzinë e tij dhe kënaqësinë e Zotit, duke reduktuar fitimin e tij, për hir të asaj që t'ua lë pasardhësve.

Islami e ka sqaruar atë se fëmijët dhe pasuria e muslimanit janë si begatitë e tjera të cilat i jepen atij që të sprovohet; nëse ndalet tek ato, dhe nuk i përfill obligimet e detyruara dhe sakrificat e kërkuara, këto begati do të jenë burim i vuajtjeve të tij, bile do të jenë armiku më brutal i tij. Është shpjegimi i ajetit: ***"O ju që besuat, vërtet, disa nga bashkëshortet tuaja dhe nga fëmijët tuaj janë armiq tuaj, andaj kini kujdes ndaj tyre, e nëse nuk merrni masa, nuk ua vini veshin dhe i falni, ta dini se edhe Allahu është mëkatfalës, mëshirues. S'ka dyshim se pasuria juaj dhe fëmijët tuaj janë vetëm sprovë, ndërsa ajo që është tek Allahu, është shpërblim i madh."*** (Et-Tegabun: 14-15)

Po! Nëse nuk shkon njeriu në xhihad me qëllim që të qëndrojë afër gruas së vet, apo e ka pakësuar dhënien, me qëllim që të deponojë më shumë pasuri për fëmijët e tij, ai është gabimtar në falënderimin e dhuntive të cilat iu dhanë atij dhe me marrëzinë e vet e ka shndërruar atë dhunti në dënim për të.

Transmetohet nga Haule binti Hakim, e cila thotë: *"Doli një ditë Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] duke e shtrënguar në gjoks një prej djemve të vajzës së tij, dhe thoshte: "Ju i shtini njerëzit të jenë koprracë, frikacakë e injorantë, e ju jeni prej bimëve aromatike të Allahut!"* /Transmeton Tirmidhiu/

Ai i cili për shkak të fëmijëve të vet bëhet koprrac, frikacak e injorant, ka humbur, ndërkas ai i cili i ka njohur obligimet ndaj Allahut dhe robërve të Tij para çdo gjëje, ka shpëtuar. Duke pasur parasysh atë se koprracia ndaj obligimeve dhe depoinimi i pasurisë për fëmijët nuk e mënjanon varfërinë, nuk e

pakëson pasurinë dhe Ditën e Gjykimit nuk do të pranojë arsye-tim nga pronari i saj.

Transmetohet prej Abdull-llah Ibën Mes'udit, se Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] ka thënë: *“Allahu i Lartësuar i ringjalli dy robër të Vet, të cilëve u kishte dhënë pasuri dhe fëmijë të shumtë. Pastaj i tha njërit prej tyre: “O filan bir i filanit.” Tha: ‘Urdhëro o Zot!’ I tha: ‘A nuk ta shtova pasurinë dhe fëmijët?’ Tha: “Gjithsesi, o Zot!” I tha: ‘Çka bëre me atë që ta dhashë?’ Tha: “Ia lashë fëmijës tim, nga frika se mos të mbetet i varur prej të tjerëve!” I tha: “Ti sikur të dije, pak do të qeshje e shumë do të qaje. Ty, ajo që ia pate dronë, të gjeti.”*

Pastaj do t'i thotë tjetrit: “O filan, bir i filanit”, e ai do të përgjigjet: “Urdhëro o Zot!” I tha: ‘A nuk ta shtova pasurinë dhe fëmijët?’ Tha: “Gjithsesi o Zot!” I tha: ‘Ç’bëre me atë që ta dhashë?’ Tha: “E shpenzova në adhurimin Tënd, dhe i lashë trashëgimtarit tim pas begatinë Tënde të bujshme!” I Tha: “Ti sikur ta kishe ditur, shumë do të qeshje e pak do të qaje. Atë për të cilën u lidhe, sot e gjetel!” /Transmeton Taberaniu/

Islami porositi që njeriu njëherë ta nderojë vetveten, pastaj familjarët, pastaj farefisin, e pastaj edhe njerëzve tjerë.

Qëllimi me atë që ta nderojë njeriu vetveten është që t'i plotësojë nevojat me gjëra të lejuara dhe në këtë mënyrë ta pengojë atë nga harami, ta mbrojë atë nga manifestimet e varfërisë, të cilat e dëmtojnë pozitën e njeriut në shoqëri dhe e ulin atë nën rangun e domosdoshëm për prestigjin e muslimanit; e gjithë kjo në suaza të maturisë, në të cilën nuk ka teprim dhe keqpërdorim. Muslimani duhet ta ketë atë pasuri e cila ia realizon këto objektiva legjitime; nëse nuk e ka këtë pasuri, ai është i varfër.

Transmetohet prej Ebu Seid El-Hudrijut, i cili thotë: *“Hyri në xhami një njeri në gjendje të mjerueshme, ndërkaq Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] urdhëronte të ndahej lëmoshë, dhe njerëzit iu përgjigjën urdhrit. Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] i dha atij dy palë rroba, pastaj tha: “Jipni lëmoshë!”, e njeriu i hodhi një palë rroba. Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] tha: “A e patë këtë njeri, i cili ishte*

në pamje të mjerueshme, dhe i dhashë dy palë rroba, e pastaj thashë: “Jipni lëmoshë”, e ai i hodhi një palë rroba!! Merri rrobat tua”, dhe e dëboi...” /Transmeton Ebu Davudi/

Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] dëshiron t'i eliminojë prej shoqërisë dukuritë e leckamanisë, skamjes dhe varfërisë, sepse disa njerëzve nuk u bëhet vonë të jetojnë të uritur e të zhveshur. Por njerëzit e tillë nuk duhet ta imponojnë këndvështrimin e tyre në jetë, mbi vetë mësimet fetare. Sepse Islami obligon që njeriu të ketë prej mirësive të kësaj jete, atë që do t'ia ngrejë kokën dhe do t'ia mbrojë fytyrën.

Transmetohet prej Xhabirit i cili thotë: “Erdhi një njeri me ar në sasi të vesë dhe tha: “ *Pejgamber i Allahut, këtë e kam nga natyra, merre këtë, se është lëmoshë, nuk kam gjë tjetër veç saj!*” Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] e refuzoi. Ai përsëri i erdhi kah ana e djathtë, dhe ia tha të njëjtat fjalë. Pejgamberi përsëri e largoi. Ai i erdhi nga ana e majtë dhe ia përsëriti të njëjtën, kurse Pejgamberi prapë e refuzoi. Pastaj i erdhi prej pas shpine, dhe ia tha po të njëjtat fjalë. Atëherë Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] e mori dhe e gjuajti me të e sikur ta kishte goditur, do ta lëndonte, pastaj tha: “*Ndo njëri prej jush vjen me tërë atë që e posedon, dhe thotë: ‘Kjo është lëmoshë’, e pastaj ulet e lyp prej njerëzve. Lëmosha më e mirë është ajo që jepet nga pasuria...*” /Transmeton Ebu Davudi/

I zoti i shtëpisë duhet t'i dijë nevojat e arsyeshme të familjes dhe fëmijëve të vet dhe me zemërgjerësi të japë në plotësimin e tyre, sepse nuk është prej fesë që njeriu ta lërë bashkëshorten, djemtë apo bijat e veta, në gjendje depresive, të nevojave dhe ngushtësisë, e pastaj ta shpenzojë pasurinë në ndonjë vend tjetër, po kushedi sa të jetë me rëndësi një gjë e tillë. Lidhjet familjare janë më meritore për vëmendje dhe përforsim sesa lidhjet e tjera.

Pejgamberi i Allahut thotë: “*Një dinar të cilin e shpezon në rrugë të Allahut, një dinar të cilin e shpenzon për robin dhe një dinar të cilin e jep lëmoshë për familjen tënde, prej këtyre, shpërblim më të madh ka ai që e shpenzove për familjen tënde.*” /Transmeton Muslimi/

Këtë e përmendëm më parë në kreun “Sinqeriteti”, me fjalën e Pejgamberit [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem]: *“Kur muslimani shpenzon diçka për familjen e vet dhe llogarit në të, ajo i merret për lëmoshë.”* /Transmeton Buhariu/

Islami, me këtë udhëzim preciz, dëshiron t’i rendisë shpenzimet legjitime në mënyrë të vlefshme frytdhënëse. Për atë, familja është shtylla e madhe e shoqërisë dhe qeliza e gjallë e cila e formon trungun e saj madhështor. Nisur nga kjo, drejtimi i përkujdesjes nga ajo, në rend të parë, është më e dobishme për tërë umetin, sesa privimi i saj dhe largimi i të drejtave të saj nga ajo. Po ashtu, në këtë udhëzim qortohet një grup njerëzish, të cilët anojnë kah harxhimi i tepërt jashtë shtëpive të tyre dhe në mes shokëve apo njerëzve që edhe nuk i njohin, e kur kthehen në familjet e veta bëhen shembuj të këqinj të skamjes dhe arrogancës...!

Të afërmit e muslimanit janë njerëzit të cilët më së tepërmi meritojnë ta shfrytëzojnë pasurinë e tij të tepërt; e drejtë e tyre është që atyre t’u drejtohet çdo kontribut i cili del nga dora e tij bujare. Kjo është e kapshme për trurin e shëndoshë, sepse, nëse njeriu ka afër vetes një njeri të nevojshëm, nuk ka kuptim që t’i lë ato mirësi dhe të njëjtat t’ia bëjë ndonjërit që është më larg; bile, kjo mund të mbjellë edhe mllëf në zemrat e të privuarve dhe tu japë të kuptojnë se mospërfillja e tyre është e qëllimt, që të maltretohen e nënçmohen. Nëse ky veprim është për të irrituar të afërmit, atëherë lëmosha e tij refuzohet dhe shndërrohet në mjerim.

Në hadith përmendet: *“...O populli i Muhammedit! Pasha Atë i Cili më dërgoi mua me të vërtetën, Allahu nuk do ta pranojë lëmoshën e atij i cili ka të afërm që kanë nevojë për ndihmën e tij, e ai ua jep tjerëve. Pasha Atë në dorë të të Cilit gjendet shpirti im, Allahu nuk do ta shikojë atë në Ditën e Gjykimit.”* /Transmeton Taberaniu/

Transmetohet prej Zejnebit të fisit Thekif, gruas së Abdull-llah Ibën Mes’udit, e cila thotë: Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] ka thënë: *“Jepni sadaka oj gra, po bile edhe prej stolisë suaj.”* Zejnebi thotë: “U ktheva tek Abdull-llah Ibën Mes’udi, dhe i thashë: *“Ti je njeri i dobët materialisht, kurse Pejgamberi na ka urdhëruar të japim lëmoshë, andaj, shko e*

pyete, nëse është e lejuar, do ta jap ty, e nëse jo, do t'ua jap të tjerëve...” Abdull-llahu i tha: “Jo, por shko tek ai ti vetë!” Zejnebi thotë: Shkova tek ai, kur një grua prej ensarëve e kishte të njëjtën brengë sikur unë. Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] kishte devotshmëri të madhe, andaj te ne doli Bilali, dhe unë i thashë atij: “Shko te Pejgamberi e i thuaj se nja dy gra janë te dera, dhe e pyesin se a u pranohet lëmosha atyre nëse ua ndajnë burrave të tyre dhe jetimëve që i kanë në mbikëqyrje. Por, mos i trego se kush jemi ne.” Zejnebi thotë: Bilali hyri te Pejgamberi i Allahut dhe e pyeti, e Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] tha: “Kush janë ato të dyja?” Ai tha: “Një grua prej ensarëve dhe Zejnebi.” Atëherë Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] tha: “Cila Zejneb?” Bilali iu përgjigj: “Gruaja e Abdull-llah Ibën Mes’udit.” Atëherë Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] iu përgjigj: “Atyre u takon shpërblimi i farefisnisë dhe i lëmoshës.” /Transmeton Buhariu/

Po ashtu, Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] thotë: “Lëmosha që i jepet një të ngrati, është vetëm lëmoshë, ndërkaq ajo që i jepet një të afërmi, është e dyfishtë: lëmoshë dhe respekt farefisnor.” /Transmeton Tirmidhiu/

DURIMI

“Durimi është shkëlqim...” /Transmeton Muslimi/

Kur bëhen serioze dhe ndërlikohen krizat, dhe depresionet pasojnë e zgjaten, vetëm durimi është ai që ia ndez muslimanit dritën e mbrojtjes nga pësimi dhe udhëzim që të ndalon nga pesimizmi. Durimi është virtyt për të cilin është i nevojshëm njeriu edhe në këtë botë edhe në botën tjetër, dhe ai patjetër mbi të t’i ndërtojë veprimet dhe shpresat e veta, sepse, përndryshe, do të jetë satirik... Duhet ta adoptojë veten në përballimin e vuajtjeve pa panik, t’i presë rezultatet, sado qofshin larg, dhe t’u rezistojë telasheve, sado të rënda, me zemër në të cilën nuk ka fije dyshimi dhe mendje të cilën nuk e preokupon asnjë brengë. Duhet të jetë plot bindje e qëndrueshmëri. Nuk kënaqet me një re që paraqitet në qiell, po bile edhe sikur të pasonin pas saj shumë të tjera, por mbetet i bindur se simptomat e rehatisë patjetër do të vijnë dhe urtësi është të priten ato me qetësi dhe bindje.

Allahu i Madhërishëm ka pohuar se njerëzit nuk kanë për të mbetur pa u sprovuar, derisa t’ua largojnë frikën telashet e pritura; kështu ata nuk mund t’i mposhtin befasishtë, e as t’u nënshtrohen atyre. ***“Ne do t’u sprovojmë juve, derisa t’i njohim (të dihen konkretisht) luftëtarët dhe ata që ishin të qëndrueshëm nga mesi juaj, po edhe do të sprovojmë veprat tuaja.”*** (Muhammed: 31)

Në këtë kontekst është edhe fjala e poetit:

I njohëm netët para se të na vijnë

E kur na kapluan, nuk na shtuan diçka të re!

Nuk ka dyshim se përballimi i situatave me njohuri të ndritshme dhe përgatitje të plotë është më e dobishme për njeriun dhe më afër perfeksionizmit të çështjeve të tij. Allahu i Madhërishëm thotë: “... **po në qoftë se duroni dhe ruheni, ajo është gjëja më vendimtare.**” (Ali Imran: 186)

Durimi mbështetet në dy të vërteta të rëndësishme:

E para ka të bëjë me natyrën e jetës së kësaj bote. Sepse Allahu i Madhërishëm këtë botë nuk e ka bërë të përhershme dhe vendgjykim, por e ka bërë vendsprovim dhe gjurmim; periudha që e kalon në të është periudhë e sprovave të vazhdueshme dhe ai del prej një provimi që të hyjë në një tjetër. Ndodh që sprovimi i parë të ndryshojë plotësisht, gjegjësisht njeriu mund të sprovohet me diçka dhe të kundërtën e saj, sikur hekuri i cili skuqet në zjarr e pastaj hidhet në ujë, dhe kështu me radhë.

Sulejmani [alejhis-selam] e njihte mirë natyrën e kësaj bote, kur iu mundësua atij pushtet i madh në të, dhe tha: “... **Kjo është nga dhuntia e Zotit tim që të më sprovtojë mua se a do ta falënderoj, apo mos do ta përbuz. E kush falënderon, ai falënderon për të mirën e vet, e kush përbuz, Zoti im (s’ka nevojë), është i pa nevojë e bujar!**” (En-Neml: 40)

Sprovimi me zemërime i ka shkaqet e panjohura. Është mirë të kuptojmë se gjendja e njerëzve në këtë jetë është si një ushtri e cila është përgatitur për luftë, ndërkaq disa njësi të saj janë ngarkuar me luftë deri në vdekje, me qëllim të shpëtimit të njësive të tjera të ushtrisë. Shpëtimi i njësive të tjera do të bëhet me qëllim të angazhimit të tyre në beteja të reja, të cilat do t’i caktojë komanda supreme, në bazë të kërkesës së interesit madhor. Andaj, vlerësimi i ndonjë individi në këto valë të furishme nuk merret parasysh, sepse çështja është shumë më e gjerë sesa të lidhet me qenien e një individi të caktuar.

Po ashtu, disave mund t’u caktohen disa lloje sprovimesh, të cilat mund edhe të jenë fundi i tyre. Para individit nuk ka zgjidhje tjetër, përveçse t’i përballojë sprovës që e pret me durim dhe dorëzim. Pasi jeta është sprovim, atëherë le t’i përkushtojmë orvatjet tona që të shpëtojmë në të.

Provimi i jetës nuk është fjalë që shkruhet apo instruksion që jepet. Por dhembje që ka mundësi ta ngadhnjejë shpirtin

dhe t'i hapë atij një rrugë prej tmerrit dhe ngushtisë. Këto janë kontradikta të cilat e bëjnë këtë botë që t'i ngopë barqet e qenve, kurse të sinqertëve ua ekspozon urinë. Këto janë padrejtësi që e shtyjnë një popull të pretendojë në hyjni, ndërkaq të tjerët të bien dëshmorë duke i mbrojtur të drejtat e tyre të rrëmbyera.

Historia e njerëzimit, që nga fillimi i njerëzve e deri më sot, është tragjike! Është normale që njeriu ta trasojë rrugën e vet në jetë duke qenë i bindur se është përplot me ferra dhe gjemba.

Ndërkaq e vërteta e dytë ka të bëjë me natyrën e besimit.

Besimi është lidhje në mes njeriut dhe Zotit të Madhërishtëm, nëse raportet e miqësisë në mes njerëzve merren në konsideratë dhe vlerësohen vetëm atëherë kur i konfirmon kalimi i ditëve, varietetet e kohës dhe ndryshimi i situatave. I tillë është edhe besimi: lidhja e tij patjetër t'i nënshtrohet sprovimit që do ta eksperimentojë, andaj do ta zbulojë besueshmërinë ose falsifikimin e tij. Allahu i Madhërishtëm thotë: ***“A menduan njerëzit të thonë: Ne kemi besuar, e të mos vihen në provë? Ne i sprovuam ata që ishin para tyre, ashtu që Allahu gjithëqysh do t'i dallojë ata që e thanë të vërtetën do t'i dallojë dhe gënjeshtarët.”*** (El-Ankebut: 2-3)

Nuk ka dyshim se Allahu i di edhe çështjet e dukshme edhe ato sekrete, dhe se ky sprovim nuk do të sjellë asgjë të re në njohurinë e Zotit, e cila i përfshin fillimet dhe mbarimet, mirëpo duhet ditur se njeriu nuk llogaritet në bazë të asaj që është në diturinë e Allahut, por llogaria e tij do të jetë në bazë të punës së tij personale. Pasi disa kriminelë do t'i mohojnë të këqijat të cilat i kanë bërë, atëherë si mund t'u bihet atyre kundërgjend ndryshe, përpos se me sprovimin që do ta dëshmojnë ekstremitetet e tyre dhe do ta deklarojnë pjesët e trupit të tyre? Allahu i Madhërishtëm për të tillët thotë: ***“Përkujto ditën kur Ne i tubojmë të gjithë, dhe u themi atyre që i shoqëruan: “Ku janë ata të shoqëruarit tuaj, që i trillonit?” Atëherë (pas atij sprovimi) përgjigje tjetër s'u mbetet përveç të thonë: “Për Allahun, o Zoti ynë, ne nuk ishim idhujtarë!” Shih, se si bëjnë gënjeshtër kundër vetes dhe si u shkoi huq ajo që trillonin!”*** (El-En'am: 22-24)

Andaj, si mund të mjaftojmë me llogaritjen e tyre në bazë të diturisë së Zotit? Shpagimi i drejtë mund t'u bëhet atyre vetëm nga veprat e tyre, të cilat do ta pohojnë, për ata dhe për të tjerët, plangprishësinë e tyre dhe keqbërjen.

Durimi, pra, ndërtohet mbi këto dy të vërteta. Për shkakun e tyre feja e obligon durimin, edhe pse njeriu, prej natyrës së të cilit është që t'i injorojë të vërtetat, çmendet kur e godasin vështirësitë dhe është i pakënaqur me dhembjet që e përshkojnë; kështu tek ai ngjallet mosdurimi, i cili e bën atë që ta urrejë durimin dhe ia bën këtë t'i duket i pashije. Kështu, kur atë e ngushton diçka, apo kur dështon në realizimin e diçkahit, apo kur e gjen ndonjë tragjedi, atij i ngushtohet toka me tërë gjerësinë e saj dhe i ngushtohen ditët me gjithë gjatësinë e tyre! Ai orvatet të dalë nga kjo gjendje edhe më shpejt se lëvizja e syrit... Mirëpo kjo është orvatje e cila shumë pak mund të ketë sukses, sepse është në kundërshtim me natyrën e fesë dhe botës. Andaj për muslimanin është më mirë që ta stërvisë vetveten për pritje të gjatë. Allahu i Madhërishëm thotë: ***“Njeriu nga vetë natyra e tij është i ngutshëm, e Unë do t'ua tregoj juve masën Time ndëshkuese, pra mos kërkonit t'u vijë më shpejtë.”*** (El-Enbija 37)

Në hadith përmendet: ***“...dhe kush tregon durim, atë do ta begatojë Allahu me durim; askujt nuk i është dhënë begati më e mirë dhe më e begatshme se durimi.”*** /Transmeton Buhariu/

Durimi është prej shenjave të madhësisë dhe simboleve të përsosurisë; ai është prej dëshmive të dominimit të shpirtit mbi atë që ka përreth, për këtë edhe emri ***Sabur*** - Durimtar, është prej emrave të bukur të Allahut. Ai është i ngadalshëm, e nuk ngutet, nuk shpejton me ndëshkim, edhe pse njerëzit shpejtojnë me krime; e lëshon fuqinë e Tij determinuese, që ata të kryejnë veprimtarinë e tyre gjatë shtrirjes së shekujve, e jo ngushtisë së jetës, dhe në suaza të kohës së gjerë, e jo dëshirave të tërbuara dhe ndjenjave të përdhosura: ***“Ata kërkojnë prej teje t'ua ngutësh dënimin, po Allahu nuk e thyen premtimin e Vet, pse një ditë te Zoti yt, është sa njëmijë vjet, si llogaritni ju.”*** (El-Haxh: 47)

Durimi është prej elementeve të burrërisë së pjekur dhe heroizmit kulminant, sepse problemeve të jetës nuk mund t'u

bëjnë ballë të dobtit. Kështu, kur dikush dëshiron të bartë disa sendee të rënda nuk thërret fëmijë, të sëmurë, apo njerëz të trashë, por për punë zgjedh njerëz të fortë e të fuqishëm!! E tillë është edhe jeta: misionin e saj madhështor mund ta lartësojnë dhe ta transferojnë prej një brezi në tjetrin vetëm burrat gjigantë dhe trimat durimtarë.

Për këtë, hisja e prijesve prej përkujdesjes dhe mbikëqyrjes ka qenë në pajtim me aftësitë që u janë dhënë dhe veprat që i kanë kryer.

Është pyetur Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem]: “Cilët njerëz sprovohen më tepër?” Ai tha: *“Pejgamberët, pas-taj me radhë njerëzit më të mirë, e më të mirë. Njerëzit sprovohen në bazë të besimit të tyre. Cili ka besim më të fortë, ai sprovohet më tepër, e kush ka besim më të dobët, ai ka edhe sprovim më të dobët. Njeriun do ta godasin sprovat, derisa të ecë mbi tokë pa patur asnjë mëkat.”* /Transmeton Ibën Hibbani/

Andaj, ndryshueshmëria e hiseve të njerëzve, prej mundit, pasojave dhe preokupimeve të mëdha, është e lidhur me fuqinë e tyre për përballim dhe qëndrueshmëri.

Ligji i madhështisë dhe konsideratës është ai i cili e nxiti një komandant të madh amerikan të thotë: *“Mos e lut Zotin të ta lehtësojë barrën tënde, por lute Zotin të ta forcojë shpinën tënde.”* Për këtë, lehtësia e barrës, zbrazëtia e dorës dhe preokupimi i vogël janë veti, një hisë të madhe të të cilave mund ta fitojnë fëmijët, ndërkaq brengat e jetës dhe preokupimi me de-tyra, idhtia e luftës për ekzistencë dhe kontinuiteti i veprimtarisë janë natyra e veprimtarëve kreativ në jetë. Njeriun, që qëndron në shtëpinë e vet, nuk e kap pluhuri i rrugës; ushtarin që ikën nga fronti nuk e rëndojnë armët e as nuk e tremb lufta. Kurse ata të cilët morën pjesë në betejën e jetës dhe u hodhën në turmën e saj, ata u prekën nga të këqijat e saj, u goditën me plagë nga kjo betejë dhe përjetuan ato mundime e lodhje që i përjetuan.

Për këtë, Islami i nderoi të sprovuarit në këtë botë dhe i ngushëlloi të lodhurit, në atë mënyrë që i qetësoi dhe ua zbuti dhembjet.

“Shembulli i besimtarit është si shembulli i kërcellit të bimës të cilin e lëkund era: herë e rrëzon, e herë e drejton, derisa t’i vijë fundi. Ndërkaq shembulli i mosbesimtarit është si druri i cedrit, i cili është i ndarë nga rrënjët e veta; atë asgjë nuk e gjen, derisa të shkulet përnjëherë.” /Transmeton Muslimi/

Besimtari i dukshëm në jetë është cak i problemeve të saj të shumta, ndërkaq atë të pamundshmin, që ikën nga fusha, çka do ta godasë?

Dhe mu kjo është fshehtësia e fjalës së Pejgamberit [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem]: *“Kujt ia do Allahu të mirën, merr prej tij.” /Transmeton Buhariu/, dhe “Allahu kur e do një popull, e sprovon. Kush pajtohet me të, atij i takon pajtimi, e kush hidhërohet, atij i takon hidhërimi.” /Transmeton Tirmidhiu/*

Ai i cili u ekspozohet dhembjeve të jetës dhe u reziston atyre, ai tek Allahu ka gradë më të lartë se i dështuari që ikën larg...

Ajo që ka përgatitur Allahu i Madhërishëm, prej shpërblimit të madh, për të përvuajturit durimtarë, ia tejkalon asaj që Ai ka përgatitur për veprat e tjera të mira: *“Njerëzit e pasprovuar, kur do t’u jepen shpërblimet të sprovuarve, do të dëshironin t’u ishin rrjepur lëkurat e tyre me thikë.” /Transmeton Tirmidhiu/*

Është për t’u habitur se si disa njerëz kanë menduar se Islami i madhëron vuajtjet si vuajtje dhe i nderon dhembjet dhe lëngimet, kinse ato meritojnë të nderohen.

Ky është gabim trashanik. Transmetohet prej Enes Ibën Malikut, i cili thotë: *“Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] e pa një plak duke ecur ndërmjet dy djemve të vet të cilët e mbanin, dhe pyeti: “Ç’bën ky kështu?” I thanë: “Është zotuar të ecë në këmbë!” Atëherë Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] tha: “Allahu nuk ka nevojë që ky ta mendojë veten”, dhe e urdhëroi të hipë në diçka.” /Transmeton Buhariu/*

Transmetohet prej Ibën Abbasit se motra e Ukbes u zotua ta bëjë haxhin në këmbë, ndërkaq Ukbeja i tha Pejgamberit të Allahut se ajo nuk ka mundësi ta bëjë këtë, e Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] i tha: *“Allahu nuk ka nevojë për ecjen*

e motrës sate; le të hipë në diçka dhe le të dhurojë një kafshë të madhe.” /Transmeton Ebu Davudi/

Allahu i Madhërishëm thotë: **“Çfarë ka Allahu me dënimin tuaj? E falënderuat dhe i besuat? (e para nuk i pakëson sundimin e as e dyta nuk i shton)...” (En-Nisa: 147)**

Por, Islami, njerëzve të sprovuar dhe të munduar, ua lavdëron mosdorëzimin e tyre dhe fuqinë e bindjes së tyre; kur ua përmend atyre dhembjet të cilat i përjetojnë, apo vështirësitë të cilat i përballojnë, atij i intereson vetëm sprovimi, të cilin e përmban, i cili duhet të tejkalohet me fuqi dhe përlësi, e jo me indiferencë dhe me indisponim ndaj caktimit.

Transmetohet se Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] hyri te një grua e sëmurë, dhe e gjeti duke e mallkuar sëmundjen dhe denoncuar zjarrminë. Pejgamberit [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] kjo nuk i pëlqeu dhe i tha asaj si ngushëllim: *“Zjarrmia i largon mëkatet e njeriut, ashtu siç e largon farkatari ndryshkun e hekurit.” /Transmeton Muslimi/*

A do të thotë kjo që t’i zhvillojmë viruset e sëmundjes, dhe t’ua dhurojmë ato atyre që i duam? Disa njerëz kështu duan të kuptohet kjo, kurse marritë janë të ndryshme!

Njeriu, në fillim të betejës mund të bjerë në tokë, e po ashtu, vështirësitë mund ta imponojnë që t’u jepet drejtimeve ekstreme, mirëpo, ai, gjatë kalimit të tij nëpër situata të rënda jetësore, edhe më tepër do të afrohet tek Allahu, derisa është me besim të fortë dhe kokë lartë.

Llomotitje e kotë është t’i konsiderojë muslimani vuajtjet që e godasin si harresë e Allahut ndaj tij dhe largim të tij nga mëshira e Allahut. Mirëpo, për fat të keq, ky botëkuptim dominoi në mesin e muslimanëve në shekujt e dekadencës dhe letargjisë, e ne pak më parë përmendëm se vështirësitë e jetës janë në pajtim me preokupimet e njerëzve në aspektin e ngritjes dhe rënies. Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] thotë: *“I ndershmi, biri i të ndershmit, biri i të ndershmit, biri i të ndershmit, është Jusufi i biri i Jakubit, i biri i Is’hakut, i biri i Ibrahimit.” /Transmeton Buhariu/*

Ky, pra, ishte Pejgamber dhe u edukua në gjirin e Pejgamberëve; rrodhi nga një gjenezë e thellë; ai është i ndershëm tek

Allahu me zgjedhje dhe mision... Shihe këtë të ndershëm si i kaloi periudhat e para të jetës, si dilte nga një vështirësi në tjetrën. I vdiq nëna duke qenë foshnje, pastaj kundër tij bënë komplot vëllezërit e vet, të cilët e rrëmbyen prej babait dhe e hodhën në pus, me qëllim që në thellësinë e pusit të përjetojë fundin e vet të panjohur.

Atë e shpëtoi një karvan, që ta marrin si rob e pastaj ta shesin në tregun e robërve me një çmim të vogël e për pak para.

Atë e bleu mbreti i Egjiptit, me ç'rast, posa u vendos në oborrin e tij, iu ekspozua intrigave perfide dhe u akuzua, duke qenë i ndershëm e i mbrojtur, se kinse dëshiron të bëjë amoralitet. Edhe përskaaj transparencës së pafajësisë së tij, ai u fut në burg me fajtorët, jo disa ditë apo muaj, por disa vjet!

Sikur ndonjë njeri tjetër ta shikonte të kaluarën e vet dhe ta haste atë të rënduar me dhembje në këtë mënyrë, do t'i mërzhitej toka dhe do të zemërohej me qiellin; ndërkaq Jusufi [alejhis-selam] mbeti me bindje të shkëlqyer pas mureve të burgut duke ua përkujtuar Allahun atyre që e kishin harruar dhe duke ua treguar mirësinë e Tij atyre që e kishin injoruar.

“O ju dy shokët e mi të burgut, a është më mirë të adhurohen zota të ndryshëm apo Allahu, i vetmi ngadhënjimtar? Ata që ju adhuronin përveç Allahut, nuk janë thotë vetëm se emra që pagëzuat ju dhe prindërit tuaj. Allahu nuk shpalli ndonjë fakt për ta, vendimi (në çështjen e adhurimit) nuk i takon kujt, pos Allahut, e Ai urdhëroi të mos adhuronit tjetër, por vetëm Atë. Kjo është feja e drejtë, por shumica e njerëzve nuk e dinë.” (Jusuf: 39-40)

Kështu, pra, janë njerëzit me virtyte; ata nuk e humbin kthjelltësinë e fesë së tyre, nëse e humbin kthjelltësinë e kësaj bote; nuk mposhten para vetes së tyre, për shkak të një fatkeqësie që i ka goditur... Ti e sheh se si një poet, nga ata që i lakmojnë mirësitë e kësaj bote, e mposht skamjen me hiperbolizimin e krenarisë së tij dhe duke, u mburrur me preokupimet e veta, thotë:

Njerëzit e ngritur janë cak i të sëmurëve

Të cilët nuk kanë preokupime, siç nuk kanë mençuri!

Ajo që patëm rastin ta shohim në jetën e Pejgamberëve, njerëzve të sinqertë, dëshmorëve dhe të devotshmëve, konfirmon se madhështia e pozitës fitohet me rëndimin e barrave dhe vuajtjet e vështirësive.

Është përcjellë prej Pejgamberit të Allahut se: *“Nëse një njeri te Zoti e ka ndonjë pozitë, e ai nuk mund ta arrijë atë me punë, Allahu do ta sprovtojë atë në trupin e tij, pasurinë e tij ose fëmijët e tij, e pastaj ai bën durim në të derisa ta arrijë pozitën të cilën e kishte më parë tek Allahu i Lartësuar.”*

/Transmeton Ahmedi/

Sikur vuajtjet e shumta janë sinjal për mirësinë e cila i përgatitet njeriut dhe prestigji i cili synohet për të. Në të shumtën e rasteve dhembjet janë pastrim, të cilat te besimtarët i sjell caktimi i Zotit, që ta sekuestrojnë atë që lakmojnë ata prej dëfrimeve të kësaj bote; kështu nuk do të zgjasë mashtrimi i tyre me të apo mbështetja e tyre në to. E ku ta dish, ndoshta një e keqe të bën dobi dhe sa sprova, në esencë, janë shpërblim dhe mëshirë!!

Maturia, durimi dhe pritja janë virtyte të cilat përputhen me ligjet ekzistuese të natyrës dhe rregullat e saj të përherëshme. Kështu, fara nuk mbin menjëherë sa hudhet, e as që piqet menjëherë sa mbin, por patjetër duhet të qëndrojë disa muaj, derisa të mund të vilen frytet e dëshiruara. Embrioni qëndron në barkun e femrës disa muaj, derisa ta marrë formën e duhur të njeriut. Allahu i Madhërishëm na ka treguar se Ai e ka krijuar gjithësinë për gjashtë ditë, ndërkaq për Zotin nuk është e pamundshme që tërë këtë ta bëjë sa për një lëvizje të syrit, apo më pak. Kalimi i ditëve dhe netëve, për njerëzit, është afati prej të cilit këputet ymri i tyre, shihet gjendja e tyre dhe mbi flakën e qetë të të cilit piqen virtytet e tyre... e pastaj kthehen te Krijuesi i tyre: ***“... Ashtu siç filloi (krijoi) së pari do të ktheheni tek Ai. Një grup (nga ju) Ai e vuri në rrugë të drejtë, e një grup meritoi të jetë i humbur...”*** (El-A'raf: 29-30)

Koha shoqëron çdo dinamizëm dhe statizëm në ekzistencë. Nëse nuk jemi durimtarë, do të digjemi me zjarrin e dëshpërimit, e pastaj nuk do të ndryshojmë asgjë nga natyra e sendeve, të cilat definitivisht ecin sipas caktimit.

Durimi është disa llojesh: Durim në adhurim, durim nga mëkati dhe durim në fatkeqësi.

Durimi në adhurim bazohet në atë se detyrat e domosdoshme të Islamit, kryerja e tyre permanente, kanë nevojë për qëndrueshmëri dhe mund. Kështu p.sh. namazi është obligim i cili përsëritet. Për të Allahu i Madhërishëm thotë:

“Urdhëro familjen tënde të falë namaz, edhe ti vetë zbatoje atë...” (Ta Ha: 132)

“Kërkoni ndihmë (në të gjitha çështjet) me durim dhe me namaz, vërtetë, ajo është e madhe (vështirë), por jo edhe për ata që kanë frikë (Zotin).” (El-Bekare: 45)

Sjellja e mirë me besimtarët, dashuria e tyre kontinuitive dhe tejkalimi i lëshimeve të tyre janë virtyte të cilat mbështeten në durimin e mirë:

“Përkufizoje veten tënde me ata që lusin Zotin e tyre mëngjes e mbrëmje, e që kanë për qëllim kënaqësinë (razinë) e Tij...” (El-Kehf: 28)

Porositja e njëri-tjetrit për durim është shoqëruese e porositjes së njëri-tjetrit për të vërtetën, e Allahu i Madhërishëm u betua se shpëtimi i njeriut varet prej këtyre dyjave:

“Pasha kohën! Nuk ka dyshim se njeriu është në një humbje të sigurt. Me përjashtim të atyre që besuan, që bënë vepra të mira, që porositën njëri-tjetrin t'i përmbahen të vërtetës dhe që këshilluan njëri-tjetrin të jenë të durueshëm.” (El-Asr: 1-3)

Durimi ndaj mëkateve është elementi i rezistencës ndaj provokimeve që janë shtrirë në rrugën e njerëzve dhe që ua zbuluruan atyre kryerjen e mëkateve të ndaluara. Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] ka thënë: ***“Xheneti është mbuluar me mundime, kurse zjarri me epshe.”*** /Transmeton Muslimi/

Pranimin e mundimeve dhe refuzimin e epsheve mund ta bëjë vetëm njeriu durimtar. Durimi këtu është gjurmë e bindjes së paluhatshme dhe drejtimit të orientuar në kënaqësinë e Allahut... Ky është shpirti i çiltërsisë, i cili e mbron besimtarin nga fëlliqësitë e poshtërsive dhe mashtrimi i mëkateve: ***“... Zoti ynë, na dhuro durim (për dënimin që do të na e bën faraoni) dhe na bë të vdesim muslimanë.” (El-A'raf: 126)***

Po ashtu, ekziston edhe durimi ndaj asaj që e godet besimtarin në veten e tij apo pasurinë e tij, në pozitën e tij apo familjen e tij. Të gjitha këto gjëra janë të mundshme. Është absurde që jeta e njeriut të jetë e zbrazët prej tyre, e nëse ndonjërin nuk e godasin valët e saj vdekjeprurëse, atë do ta prekë frustracioni i fluskave të saj.

Por duhet ditur atë se, kur muslimani mbrohet me Zotin dhe strehohet tek Ai, me këtë e thyen tehun e tragjedive dhe shumë pak ato kanë mundësi të shkaktojnë dhembje në trupin e tij. Në të shumtën e rasteve bindja e fortë është mposhtëse e dhembjeve të forta, sikur dominimi i anestezisë në operacionet e rënda. Besimtari nuk do të ndahet prej mëshirës së Zotit, përderisa feja e tij nuk shkrihet në kriza dhe bindja e tij nuk lëkundet në vështirësi:

“Ne do t’ju sprovojmë me ndonjë frikë, me uri, me ndonjë humbje nga pasuria e nga jeta, e edhe nga frytet, po ti jepju myzhde durimtarëve. Të cilët, kur i godet ndonjë e pakëndshme thonë: Ne jemi të Allahut dhe ne vetëm tek Ai kthehemi! Të tillët janë që te Zoti i tyre kanë bekime e mëshirë dhe të tillët janë ata të udhëzuarit në rrugën e drejtë.” (El-Bekare: 155-157)

Transmetohet prej Umri Alasë, e cila është prej atyre që i dhanë besën Pejgamberit [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem], se ka thënë: *“Më thirri Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem], kurse unë isha e sëmurë, dhe më tha: “Oj Umri Ala, përgëzo, se me dhembjen Allahu ia shlyen muslimanit gabimet, ashtu siç e pastron zjarri arin dhe argjendin.”* /Transmeton Ebu Davudi/

Po ashtu, kemi edhe hadithin: *“Allahu i Lartësuar për robin e tij nuk pëlqen shpërblim tjetër përveç Xhenetit, të cilit kur ia merr atë që e do më shumë prej njerëzve, ai bën durim dhe llogarit në shpërblimin e Tij.”* /Transmeton Nesaiu/

Mirëpo, nuk duhet larguar prej mendjes ajo se, çdo gjë me të cilën lidhemi dhe supozojmë se kemi hise në të, lidhja e Allahut me të është më e fortë dhe hisja e Allahut në të është më me prioritet.

Fëmija është gjëja më e shtrenjtë për njeriun dhe gjëja më e dashur për të. Përmes tij ai doli në këtë botë dhe në gjirin e tij u rrit; prindi në të sheh vazhdimin e vetes së tij dhe një pje-

së të ndjenjave të tij. Nëse atë e gjen vdekja, babai që humbi të birin pëshpërit: “Biri im!”

Mirëpo, zëri i së vërtetës, para pëshpëritjes së dëshpërimit, na bën të themi: Nëse babai e ka humbur fëmijën e vet, Zoti e ka kthyer robin e Vet. Ai i Cili ia hapi sytë për t’i parë dritat e jetës, është Ai i Cili edhe i mbylli ato; Ai i Cili e zhvilloi atë trup me begati të ndryshme, Ai do ta kthejë në materien e tij të parë... në tokë. Kur thotë prindi: “Biri im”, Krijuesi thotë: “Robi im, Unë, para të tjerëve, kam prioritet tek ai dhe jam më merit-
tor.”

Transmetohet nga Kasim Ibën Muhammedi, i cili thotë: Më vdiq mua njëra grua, dhe më erdhi Muhammed Ibën Ka’b El-Kuredhiju që të më shprehë ngushëllime për të dhe tha: “Te Beni Israilët ka qenë një njeri i mençur, i ditur, i devotshëm, studiues. Ai kishte një grua në të cilën ishte i mahnitur, por ajo i vdiq. Kjo e dëshpëroi shumë, sa që hyri në një shtëpi, e mbylli veten dhe u izolua. Tek ai nuk hynte askush. Për të dëgjoi një grua prej Beni Israilëve, dhe erdhi tek ai, e u tha: “Unë kam nevojë ta pyes për diçka, dhe nuk më mjafton pa kontaktuar direkt me të.” U ndal te dera, dhe e lajmëruan këtë njeri për të. Ai i dha leje të hyjë, e ajo i tha: “Dua të të pyes për diçka.” Ai tha: “Çka do të pyesësh?” Ajo i tha: “Unë huazova nga një fqinje imja stoli; një kohë e përdora, e pastaj ajo ma kërkoi mua atë, andaj, a t’ia kthej a jo?” Ai Tha: “Po, për Allahun!!” Ajo i tha: “Stolia ka qëndruar tek unë një kohë të gjatë!” Ai tha: “Ajo stoli meriton t’i kthehet asaj!” Ajo i tha: “Zoti të mëshiroftë! A të vjen keq për atë që ta ka dhënë hua Zoti, e pastaj e mori prej teje? Ai është më meritör për të se ti.” Ai e kuptoi gjendjen në të cilën ishte, dhe Zoti i bëri dobi me fjalët e saj.” /Transmeton Maliku/

MATURIA DHE NDERSHMËRIA

Islami përmban një grumbull instruksionesh, të cilat kanë të bëjnë me jetën e muslimanëve në veçanti, me të cilat synoi rregullimin e çështjeve të tyre fizike dhe psikike dhe vënien e tyre në baza fisnike. Këto janë rregulla të cilat kanë të bëjnë me ushqimin, veshmbathjen dhe banimin e muslimanit, dhe aspiratat e tjera të cilat orvatet t'i realizojnë në këtë jetë, me të cilat ai nuk anon kah asketizmi i thellë e as materializmi i tërbuar; këto janë mesatare dhe objektive, andaj edhe zbatimi i tyre është i lehtë dhe i afërt.

Islami i bashkon kërkesat e trupit dhe shpirtit në mësimet e tij, e ndëpret dominimin e njërës mbi tjetrën dhe në koordinimin e nevojave të tyre sheh ndihmë për njeriun në kryerjen e misionit të tij në këtë jetë dhe pas saj. Filozofitë të cilat mbinë në tokë dhe që i formuluan njerëzit që të manevrojnë në trapezin e tyre, kur prej tyre u abstraktuan udhëzimet hyjnore, patën shumë pak sukses në vënien e baraspeshës në mes kërkesave të trupit dhe aspiratave të shpirtit, si dhe në mes të sigurimit të botës tjetër, në të cilën do të kthehemi, dhe mbikëqyrjes së kësaj bote, nga e cila e filluam marshin!

Disa orvaten për shkatërrimin e trupit, duke supozuar se shpirti nuk mund të ngrihet në piedestale të larta pa u liruar nga prangat e trupit. Ndërkaq disa të tjerë i patën për qëllim kënaqësitë trupore dhe u kufizuan në kufijtë e tyre të ultë, duke e përbuzur çdo gjë jashtë tyre.

Ndërkaq, në Islam nuk do të gjesht asketizëm që i ngushton njerëzit dhe ata të vuajnë nga ashpërsia e tij. Por, në të njëjtën kohë, ti në të nuk do të gjesht as instinkte shtazarake të bazuara në destruktivitetin e epsheve dhe nënshtrimin e pasioneve.

Por, këtu duhet përmendur një e vërtetë të prerë, e ajo është se: jeta e besimtarit të bindur në botën e ardhshme nuk është sikur jeta e mosbesimtarit, i cili e konsideron jetën e vet mbi tokë, bashkërisht, edhe dunja edhe ahiret. Kjo botë, për të, është rasti i parë dhe i fundit për kryerjen e kontributit të tij dhe arritjen e qëllimeve të tij.

Pjesa më e madhe e atyre të cilët e humbin nderin e tyre, i ndjekin pasionet dhe jetojnë vetëm për kënaqje materiale i takojnë grupit të fundit. Ose, ata në të do të mbarojnë, nëse nuk udhëzohen në udhëzimin e tyre dhe nëse nuk heqin dorë nga devijimi. Për këta, Allahu i Madhërishëm thotë: ***“Ata që besuan dhe bënë vepra të mira Allahu do t’i shtie në Xhenete nëpër të cilët rrjedhin lumenj, e ata që nuk besuan, përjetojnë kënaqësi (në këtë jetë) dhe hanë ashtu si hanë kafshët, e vendi i tyre është zjarri.”*** (Muhammed: 12)

“Ata që nuk besuan shpeshherë do të kishin dëshiruar të kishin qenë muslimanë. Lëri (Muhammed) ata, të hanë, të dëfrehen dhe t’i preokupojë shpresa (se do të jetojnë shumë), e më vonë do të kuptojnë.” (El-Hixhr: 2-3)

Ndërkaq, besimtari, aspiratat dhe dëshirat e veta i ndan në mes kësaj bote dhe botës tjetër, dhe e kërkon mirësinë për veten për sot dhe nesër. Kur’ani i Ndershëm na ka mësuar se pritja e begatisë dhe lumturisë në të dy botët është prej përmendjes më të madhe të Allahut! Allahu i Madhërishëm thotë: ***“E kur t’i kryeni detyrat tuaja, përmendnie Allahun sikurse i përkujtoni prindërit tuaj, bile përmendnie edhe më fortë. Ka disa prej njerëzve që thonë: Zoti ynë, na jep Ti neve në këtë botë! Për të nuk ka asgjë në botën tjetër. E, ka prej tyre asish që thotë: Zoti ynë, na jep të mira në këtë jetë, të mira edhe në botën tjetër, dhe na ruaj prej dënimit me zjarr! Të tillët e kanë shpërblimin nga ajo që e fituan. Allahu është i shpejtë në llogari.”*** (El-Bekare: 200-202)

Në instruksionet drejtuar Karunit konfirmohet domosdoshmëria e punës për të dy këto elemente bashkërisht, sepse kjo botë është mjet i botës tjetër. Ndërkaq vlefshmëria e mjetit është garanci për suksesin e qëllimit, ashtu siç shpie sistematismi i predispozitave në arritjen e rezultatit të pritur. Andaj udhëzimi i Allahut drejtuar Karunit i përmban të gjitha këto kup-

time: *“Dhe me atë që të ka dhënë Allahu, kërko (ta fitosh) botën tjetër, e mos le mangu atë që të takon nga kjo botë, dhe bën mirë ashtu siç të ka bërë Allahu ty, e mos bën të këqija në tokë, se Allahu nuk i do çrregulluesit.”* (El-Kasas: 77)

Duke u bazuar në atë që përmendëm më parë prej këtyre parimeve, Islami e porosit njeriun që mos të jetë rob i barkut të vet të jetojë në këtë botë që të hajë; ai shkon e vjen duke patur vetëm një qëllim: që të mbledhë në tryezën e vet ushqime të ndryshme, ashtu që kur i gjenden mbi të ushqimet që i pëlqen dhe i dëshiron, ai gëzohet dhe qetësohet, përndryshe revoltohet dhe hidhërohet dhe konsideron se caktimi i Zotit është kundër tij!

Njerëzit të cilët thellohen në ngopje dhe dëfrime, dhe shpejtojnë, para së gjithash, në mjetet e kuzhinës dhe orekset e ndryshme, ata nuk janë të përshtatshëm për punë madhështore dhe aspiratat e tyre të pasivizuara nuk i nxitin për xhihad dhe sakrifikim. Transmetohet prej Pejgamberit [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] se ka thënë: *“Njerëzit që do të ngopen më tepër në këtë botë, më gjatë do të jenë të uritur Ditën e Gjykimit.”* /Transmeton Bezzari/

Ndërkaq dihet se një numër i madh i sëmundjeve të rënda dhe pasojave të rrezikshme vjen nga rëndimi i lukthit me atë që nuk mund ta tretë... Për këtë në hadith përmendet: *“Njeriu nuk ka mbushur asnjë enë më të rrezikshme se barku.”* /Transmeton Tirmidhiu/

Largimi i njeriut nga ushqimet e tepërta nuk mund të arrihet ekskluzivisht me asketizëm apo abstenim pa ndonjë kuptim të arsyeshëm, por rruga më e rregullt është që njeriu ta lidhë qëllimin e tij me ambicie të mëdha, e pastaj t'i qaset arritjes së tyre; kjo do ta largojë atë nga dëfrimet e ndryshme dhe kënaqësitë e shumta të lira.

Një herë te Pejgamberi i Allahut erdhi musafir një mosbesimtar. Pejgamberi urdhëroi të milet për të një dele. Mosbesimtari e piu qumështin e saj, pastaj edhe të një tjetrës, derisa e piu qumështin e shtatë deleve. Pastaj, në mëngjes, kur u ngrit, e përqafoi Islamin, e Pejgamberi urdhëroi të milet një dele dhe ai e piu qumështin e saj, pastaj edhe të një tjetrës, por nuk mundi ta përfundojë! Atëherë Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi

ve sel-lem] tha: *“Besimtari pi me një zorrë, kurse mosbesimtari pi me shtatë zorra.”* /Transmeton Muslimi/

Kjo, ngase këtë njeri e okupuan meditimet kur e kuptoi mahnitjen e transferimit nga periudha e injorancës në periudhën e dritës, dhe kur e njohu qëndrimin e tij të ri ndaj Zotit të vet dhe obligimeve fetare e llogarisë në botën tjetër. Për këtë, ngritja e aspiratave të tij, për formimin e një jete më të lartë sesa ajo që kaloi, pati ndikim të madh në shmangien e tij nga kërkimi më tepër sesa ajo që i jepej.

Është realitet se ushqimet e shijshme dhe të mirat e përkohshme të kësaj bote nuk meritojnë që njerëzit jepen pas në këtë mënyrë të turpshme, siç e shohim në kohën tonë. Pejgamberi [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] thotë: *“Ushqimi i njeriut është bërë shembull për këtë botë, kur i hidhen erëzat dhe kripa, shiko në çka shndërrohet.”* /Transmeton Ahmedi/

Në një transmetim tjetër qëndron: *“Allahu i Lartësuar, atë që del prej njeriut e ka bërë shembull për këtë botë.”*

Njeriu shkurtëpamës mund ta keqkuptojë këtë, bile mund ta konsiderojë si largues të muslimanit nga jeta dhe stimulim i tij për lënien e mirësive dhe braktisjen e dhuntive të saj. Mirëpo asgjë prej kësaj nuk ka për qëllim Islami, sepse ndalimi i të lejuarës është sikur lejimi i të ndaluarës; ky është krim i refuzuar, ndërkaq obligimi i muslimanit ndaj Allahut është që harami mos ta mposhtë durimin e tij, e as hallalli mirënjohjen e tij.

Ndërkaq e drejta e tij në këtë jetë dhe shfrytëzimi i mirësive të saj është e pakontestueshme:

“Ata që besuan dhe bënë punë të mira, nuk kanë mëkat për atë që u ushqyen (më herët) derisa ata ruhen (prej haramit), besojnë dhe bëjnë vepra të mira, mandej ruhen (nga ajo që ka qenë e lejuar, e është ndaluar) dhe besojnë dhe pastaj ruhen (nga çdo mëkat) dhe bëjnë mirë. Allahu i do ata që bëjnë mirë.” (El-Maide: 93)

Patëm rastin ta shohim bujarinë e babait të Pejgamberëve, Ibrahimit [alejhis-selam] me miqtë e tij, kur nxitoi t’ua presë atyre një viç të trashë, të cilin ua vuri në tryezë pa i pyetur e papritur: ***“Dhe ai pa u vërejtur shko i te familja e vet dhe***

**solli një viç të majmë të pjekur. Atë ua afroi atyre e tha:
“Përse nuk hani?” (Edh-Dharijat: 26-27)**

Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] dhe shokët e tij në jetën e tyre private punonin në pajtim me ajetin kur’anor: **“O ju që besuat! Mos i ndaloni (mos i bëni haram) të mirat që për ju Allahu i lejoi (i bëri hallall) dhe mos teproni, se Allahu nuk i do ata që e teprojnë (i kalojnë kufijtë e dispozitave të Zotit).” (El-Maide: 87)**

Trupi i ka kërkesat e veta, dhe për të mençurit nuk është aspak kontestuese se mosplotësimi i tyre e dëmton atë, andaj Islami nuk ka asgjë të përbashkët me çdo përmbajtje apo aske-tizëm i cili largon nga këto kërkesa. Sulmet e ashpra, të cilat ia bëri Islami materializmit, kanë për qëllim fryrjen e kokëlartëve dhe ngopjen e dispeptikëve, të zhytur në epsht e tyre.

Islami, po ashtu, porositi për maturi në veshje; ai urren që njeriu të mburret apo të krenohet me rroba. Islami nuk e konsi-deron pamjen e bukur prej elementeve të burrërisë apo parime-ve të karakterit të madh; ndoshta një njeri rrobat e të cilit nuk bëjnë as një dirhem, ka shpirt më të rëndë se tonelata e tonelata ar e argjend. Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] thotë: **“Ndoshta një njeri me flokë të shpupuritur, i pluhurosur e i leckosur, sikur të betohet në emër të Zotit, do ta plotëson-te.” /Transmeton Tirmidhiu/**

Është marri që njeriu ta bëjë trupin e vet salon mode dhe të ecë në mesin e njerëzve duke pritur që shikimet e magjep-sura të drejtohen kah ai nga çdo anë. Ka disa të rinj të papje-kur, që kalojnë orë të tëra në shtëpi vetëm duke e kompletuar imazhin e vet dhe duke u bindur në sharmin e tyre. E sikur ata të angazhoheshin me kalimin e kësaj kohe në shtimin e diturisë apo pasurimin e njohurive fetare! Por, pasimin e rrobave në trupin e tyre e konsiderojnë shenjë të përsosurisë dhe kënaqjes!

Islami e gjykoj këtë naivitete dhe i largoi muslimanët prej tij... Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] thotë: **“Kush vesh rroba për t’u ekspozuar në këtë botë, Allahu do t’i veshë atij rroba të nënçmimit në botën tjetër, dhe në ta do të ndezë zjarr.” /Transmeton Ibën Maxhe/** Është realitet se të zhgënje-rit prej meshkujve dhe femrave, kur iu pakësuan hiset e tyre

prej etikës shpirtërore, menduan se teprimi në rroba do t'i mbulojë mangësitë e tyre. Eh, sa gabuan!

Transmetohet prej Ebu Burejdes, i cili thotë: *“Hyra tek Aishja [radijAllahu anha] dhe ajo na nxori neve një palë rroba të arnuara dhe një mbulesë të poshtme, e cila prodhohej në Jemen. Ajo u betua në Allahun, se Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] vdiq në këto dy palë rroba.”* /Transmeton Buha-riu/

Transmetohet prej Xhabirit, i cili thotë: *“Prezantuam në martesën e Aliut me Fatimen, dhe nuk kemi parë martesë më të mirë se ajo. Na shtruan një hastër, na sollën hurme e rrush të thatë dhe hëngrëm. Shtrati i saj natën e martesës ka qenë lëkurë e regjur e dashit.”* /Transmeton Bezzari/

Mospasja nevojë për luks dhe mjaftimi me gjërat e domosdoshme është prej dëshmive të përsosjes së moralit.

Le ta përkujtojë i riu jetën e tij të dytë

Le të jetë nevoja e tij ajo që e ka poseduar

Dhe le ta dijë se luksi i jetës është preokupim

Mirëpo, prej kësaj nuk duhet të kuptojmë se feja i preferon rrobat e këqija, apo se ajo gëzohet me pamjet e zymta, apo se e pëlqen veshjen e stelave dhe rrobave të grisura e të vjetëruara, siç veprojnë disa njerëz injorant. Assesi, assesi!

Një njeri e pyeti Abdull-llah Ibën Omerin: *“Çfarë rrobash të vesh?”* Ai i tha: *“Ato rroba, për të cilat nuk do të përqeshin njerëzit mendjelehtë dhe nuk do të të qortojnë njerëzit e urtë.”* I tha: *“Sa janë ato rroba?”* Ai i tha: *“Ato sillen prej pesë deri në njëzet dirhem (monedha argjendi).”* /Transmeton Taberaniu/ Por ky caktim i çmimeve i përgjigjet kohës së Ibën Omerit, e koha jonë mund të jetë shumë më tepër se ai.

Erdhi një njeri te Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem], dhe kishte të veshur rroba të pavlera, e ai i tha atij: *“A ke pasuri?”* Ai iu përgjigj: *“Po.”* Pejgamberi i tha: *“Prej cilës pasuri?”* Ai i tha: *“Allahu më ka falur prej çdo pasurie.”* Pejgamberi i tha: *“Pasi Allahu të ka dhënë pasuri, le t'i shohë gjurmët e*

begatisë së Zotit dhe fisnikërisë së Tij në ty.” /Transmeton Nesaiu/

Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] thotë: *“Çka i kushton ndonjërit prej jush, nëse ka bollëk, që të ketë për ditën e xhuma dy palë rroba, përskaaj rrobave të punës.” /Transmeton Ebu Davudi/*

Islami, pra, ithtarëve të vet ua preferon edhe zbukurimin edhe imazhin e bukur. Dallimi është shumë i madh në mes një njeriu i cili e zbukuron anën e tij të jashtme, por e lë anën e brendshme, dhe kohën e pasurinë më të madhe të tij e kalon në rroba të cilat i ngjet për trupin, dhe në mes një tjetri i cili preokupim më të madh të vetin e ka mbrojtjen e realitetit të vet dhe përsosjen e personalitetit, e pastaj në turmën e obligimeve nuk e harron veshjen e rrobave me të cilat zbukurohet dhe takohet me njerëzit.

Njerëzit e kohës sonë presin risi të panumërta të modës në stinë të ndryshme të vitit; rrobat e verës dallojnë nga ato të vjeshtës, të vjeshtës dallojnë nga të dimrit, e të dimrit dallojnë nga ato të pranverës. Madje, terminet e një dite kërkojnë lloje të caktuara të rrobave, sepse ajo që i përket mbrëmjes, nuk përkon me ditën! Është ky teprim i shëmtuar, të cilin ua imponojnë shoqërive, në Lindje e Perëndim, gratë, robërit e grave dhe të përngjasuarit me gratë! Ky është një pasion prej të cilit Islami është larg, dhe prej të cilit distancohen të devotshmit. Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] thotë: *“Mjerë për gratë prej dy të kuqëve: arit dhe shafranit.” /Transmeton Ibën Hibbani/ Ky kërcënim është për ato gra që shkrihen pas stolisë, pas modave të ndryshme dhe ngjyrave, gjëra këto që i pengojnë nga punët e mëdha!*

Në Islam qartë është definuar se ari dhe mëndafshi janë të ndaluar për burrat, ndërkaq zbukurimet e tjera janë të lejuara për ta. Nuk është prej natyrës së burrave të vënë stoli e të përdorin preparate kozmetike. Ndërkaq, sa u përket grave, edhe pse për to janë të lejuar mëndafshi dhe ari, nuk është e lejuar që zbukurimin dhe pispillosjen ta bëjnë preokupim kryesor, i cili do t’ua merrte tërë kohën dhe do t’ua harxhonte pasurinë.

Islami nuk ndalon që të ngrihen kështjella e pallate të forta, të ndërtohen shkolla e universitete, strehimore, kopshte

fëmijësh e spitale, të ngrihen rrokaqiej të mëdhenj, ashtu që në ndërtimin e tyre të investohen shumë para, ngase interesat e përgjithshme të popujve ekzistojnë gjatë me brezat, andaj këto duhen lidhur me oborre të gjëra dhe mure të larta, por ç'do të thotë që njeriu mendjemprehtë t'i ndërtojë vetes ose kënaqësive të veta një pallat i cili do të përforcohet në tokë dhe do të ngritet në qiell?

Islami e preferon modestinë ekskluzive në ngritjen dhe orenditë e shtëpive, e po ashtu ai porositi që mos të lodhet njeriu e ta teprojë në këto investime.

Transmeton Kajs Ibën Hazimi, i cili thotë: “Shkuam ta shohim Habab Ibën El-Erethin, i cili ishte mjekuar shtatë herë me zjarr në barkun e tij, dhe tha: *“Shokët tanë të parë shkuan, atyre nuk u mungoi kjo botë. Ne përvetësuam aq, sa nuk mund t'i gjesh vend tjetër, përveç tokës!”* Pastaj shkua tek ai njëherë tjetër, kur ai ndërtonte një mur, dhe tha: *“Muslimani shpërblehet për çdo gjë që e jep, përveç atyre gjërave që i vë në këtë tokë.”* /Transmeton Buhariu/

Ky sahabi i shquar me të vërtetë ndërtonte, por, për shkak të vetëdijes së tij të lartë për domosdoshmërinë e dhënies në rrugë të Allahut, mendoi se ajo që e investon në ndërtim, nuk shpërblehet; dhe me të vërtetë ashtu është, njeriu assesi nuk shpërblehet për të, nëse ndërton me qëllim të mburrjes dhe ekspozimit, nga dashuria e flaktë ndaj kësaj bote dhe moskujdesi ndaj botës tjetër; e nëse e ndërton atë në mënyrë që ta mbrojë dhe sigurojë, shpërblimi i tij për punën e tillë është i garantuar, dhe në këtë rast ndërtimi është adhurim.⁴

Sa i përket enterierit, qëndrimi i Islamit për të është decid: Islami i ka këputur rrënjët e luksit brenda dhomave të shtëpisë, si dhe e urren përhapjen e qilimave të shtrenjtë dhe dekorimeve në të. Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] i tha Muadh Ibën Xhebelit kur e dërgoi në Jemen: *“Ruaju bollëkut të shumtë, se robërit e Allahut nuk kanë bollëk të shumtë.”* /Transmeton Ahmed/

⁴ Konsulto kreun: “Singeriteti”.

Prej këtu, Islami i ndaloi enët e arit dhe argjendit dhe shtrojet e mëndafshit dhe të armaçit.⁵ Njerëzve u mjafton që enët e tyre të jenë prej elementeve të njohura të gjithë, e po ashtu edhe shtrojet e tyre.

Transmetohet prej Hudhejjes, i cili thotë: *“Pejgamberi [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] ndaloi të hamë e të pimë në enët e arit dhe argjendit, e, po ashtu, ta veshim mëndafshin dhe armaçin dhe të ulemi në to.”* /Transmeton Buhariu/

Prej kësaj dikush mund të përfundojë se vrazhdësia është karakteristikë e jetës islame! Sikur të ishte i vërtetë ky botë-kuptim, atëherë do të thonim: Ç’të metë ka në të? Duke ditur se është habi të identifikohet jeta komode me përdorimin e mëndafshit dhe arit! Të gjithë njerëzit mund të jetojnë të lumtur e të qetë pa përdorur arin si zbukurim dhe pa veshur mëndafsh.

Islami dëshiron t’i shkulë rrënjët e luksit nga jeta e individit dhe bashkësisë, ashtu që të sigurohet ekzistenca e popujve dhe të mbetet uniteti i tyre. Umetit musliman i ka hije ta bëjë jetën e vet në shërbim të Zotit, në xhihad të vazhdueshëm për lartësimin e të vërtetës dhe mbrojtjen e thirrjes së saj dhe t’i braktisë mashtrimet e kësaj bote dhe interesat e saj të vogla.

Ndërkaq, mahnitja pas epsheve dhe zhytja në ndalesa është ikje nga obligimet dhe zbrapsje nga serioziteti, si dhe humbje e shenjave të dinjitetit, e këto janë veti të cilat, po depërtuan në një popull, e varrosin për së gjalli.

Transmetohet prej Pejgamberit të Allahut: *“Do të ketë disa njerëz prej popullit tim të cilët do të hanë ushqime të ndryshme, do të pijnë pije të llojllojshme, do të veshin tesha të llojllojshme dhe do të shesin mendjemadhësi edhe në të folur. Këta janë njerëzit më të këqinj prej umetit tim.”* /Transmeton Taberaniu/

Ti do ta shohësh korrektësinë e këtij hadithi të njerëzit të cilët e kanë trashëguar fenë me fjalë, të cilët e konsiderojnë atë lojë e tallje, e me këtë humbën në këtë botë dhe humbën të vërtetat e fesë.

⁵ Copë prej cohe e qëndisur me mëndafsh ose me ar.

Allahu i qortoi njerëzit të cilët u tërbuan pas kënaqësive, e u mashtruan me zbavitje dhe dëfrim, dhe u kufizuan në kërkesat e trupit dhe botën e instinkteve të ulëta, dhe tha: ***“E në ditën kur ata që nuk besuan paraqiten pranë zjarrit (e u thonë): Ju i shfrytëzuat të mirat në jetën e dunjasë dhe i përjetuat ato Sot, për shkak se keni bërë mendjemadhësi në tokë pa të drejtë dhe për shkak se nuk respektuat urdhrat e Zotit, do të shpërbleheni me dënimin nënçmues.”*** (El-Ahkaf: 20)

E kur do ta marrin ata dënimin e tyre, do të përkujtohen se kjo është për shkak të humbjes së nderit maturisë, dhe devijimit dhe paturpësisë së tyre.

“Këtë (dënim) e keni për shkak se gëzoheshi padrejtë në dynja (duke bërë mëkate etj.) dhe për shkak se krenoheshi (me mendjemadhësi).” (Gafir: 75)

Është realitet se një pjesë e madhe e fajit për shkatërrimin e shtetit islam është i lidhur me humbjen e nderit dhe përhapjen e kënaqësive, ndërkaq Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] ia ka tërhequr vërejtjen umetit të vet nga kjo rënie shpirtërore.

Transmetohet prej Ebu Berzes, se Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] ka thënë: ***“Frikohem për ju nga epshet djallëzore në barqet dhe organet gjenitale dhe devijimet hamendëse.”*** /Transmeton Ahmedi/

Islami filloi në mes njerëzve të varfër, të cilët skamja nuk i linte t’i arrinin ato gjëra që i kishin të lejuara, e lëre më të fryhen me gjëra të këndshme. Skamja e rëndë, të cilën e përjetonin, ishte shkak i ankesave të tyre.

Transmetohet prej Ebu Hurejres, i cili thotë: “Pashë shtatëdhjetë vetë prej atyre që rrinin në skaj të xhamisë (*ehlus-suffe*), asnjëri prej tyre nuk kishte rroba complete, ose kishte vetëm pjesën e poshtme, ose pjesën e lartë të lidhur për qafe. Disa prej tyre arrinin deri në gjysmë të këmbëve, e disa të tjera deri në gjunjë, andaj i mblidhnin me dorë, me qëllim që mos t’u shihen pjesët e turpshme.” /Transmeton Buhariu/

Varfëria është plagë që dhemb dhe e drejtë e njerëzve është që të shpëtojnë nga kjo sprovë. Po ashtu, edhe vetë Isla-

mi, mirësitë e kësaj bote i bën të drejtë të atyre që kanë besuar. Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] frikohej që kjo ndalesë e ashpër mos jepte kundërefekt kur do të dominojë Islami dhe do të përhapeshin parimet e tij, andaj na tërhoqi vërejtjen nga gjendja tjetër e cila do të ndodhë pas vdekjes së tij, gjegjësisht sqaroi se nëse humbja e të mirave të kësaj bote është e keqe, mashtrimi me të mirat e saj dhe lufta reciproke për to, është e keqe edhe më e madhe.

Mesatarja është esenca e mirësisë. Ndërkaq, mesatarja (objektivizmi) këtu është që ta posedosh jetën e begatshme me qëllim që ta shfrytëzosh për arritjen e shembujve ideal, e jo ta posedosh jetën e të nënshtrojë për hedhurinat e saj, e as që të privohesh thjesht nga jeta dhe të izoloresh në vetmi.

Këtë e ka pasur për qëllim Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] kur tha: *“Për Allahun, nuk ua kam frikën juve prej varfërisë, por frikohem mos u jepeni interesave materiale të kësaj bote ashtu siç iu dhanë atyre ata që ishin para jush, e ju të vraponi pas saj ashtu siç vrapuan të tjerët, e ajo t’u shkatërrojë siç i shkatërroi ata që ishin para jush.”* /Transmeton Buhariu/

Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] ka thënë: *“Sjellja e mirë, përmbajtja dhe maturia, janë një e njëzet e katërta pjesë e pejgamberisë.”* /Transmeton Tirmidhiu/

PASTËRTIA, ZBUKURIMI DHE SHËNDETI

Muslimani e ka obligim që në çdo çast të jetës së vet të synojë kah përsosuria, si dhe ta nxisë aktivitetin për ngritjen materiale dhe shpirtërore, sepse ardhmëria e tij tek Allahu është e lidhur me shkallën të cilën ai e arrin në zhvillimin e vet. Nëse e gjen vdekja kur ai është në kulminacion, ai do të jetë prej banorëve të Xhenetit më të lartë - Firdeus; nëse e gjen vdekja duke qenë mesatar, i transferon hapat e vet në rrezet e afërta, dhe mjafton për të nëse shpëton; e nëse e gjen kur ai është zmburur dhe e ka humbur qëllimin, e rrëmbejnë atë rojtarët e dënimit të dhembshëm. Kush është në këtë botë i verbër, në Ditën e Gjykimit do të ringjallet i verbër, e kush është në këtë botë i fëlliqur, do të ringjallet i tillë. Pejgamberi [sal-Allahu alejhi ve sel-lem] ka treguar se njeriu i interesuar për pastërtinë e trupit, fytyrës dhe gjymtyrëve të veta, do të ringjallet Ditën e Gjykimit në atë gjendje, me fytyrë të shkëlqyer, ball të ndritshëm e trup dhe gjymtyrë të pastra!!!

Transmetohet prej Ebu Hurejres se Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] i vizitoi varret dhe tha: *“Es-selamu alejkum, o njerëz besimtarë! Edhe ne, me lejen e Zotit, së shpejti juve do t’u bashkangjitemi. Pata dëshirë t’i shohim vëllezërit tanë.”* Sahabët thanë: *“A nuk jemi ne vëllezërit e tu, o Pejgamber i Allahut?”* Ai tha: *“Ju jeni shokët e mi, ndërsa vëllezërit tanë janë ata që ende nuk kanë ardhur.”* Shokët i thanë: *“Si do ta njohësh atë që ende nuk ka ardhur, se është prej umetit tënd, o Pejgamber i Allahut?”* Ai u përgjigj: *“Çka thoni, nëse një njeri ka një kalë i cili ka lara të bardha, me të cilat është ngjyrosur mes shpatullave, në mesin e një turrme kuajsh të zi, a nuk do ta njohte ai kalin e vet?”* Shokët u përgjigjën: *“Gjithsesi, o Pejga-*

mber i Allahut.” Atëherë Pejgamberi tha: “*Ata do të vijnë me gjymtyrë të shkëlqyera nga abdesti.*” /Transmeton Muslimi/

Me të vërtetë, shëndeti i trupit, bukuria dhe shkëlqimi i tij janë prej çështjeve të cilave Islami u ka kushtuar kujdes të madh dhe i konsideroi ato prej esencës së misionit të vet. Njeriu nuk do të peshojë në peshojën e Islamit dhe nuk do të gëzojë respekt pa e bërë traditë pastërtinë dhe rregullimin e trupit, dhe pa qenë, në ngrënien, pirjen dhe pamjen e tij personale, larg njollave të fëlliqura dhe pamjeve të shëmtuara. Shëndeti dhe pastërtia e trupit nuk janë vetëm konsolidim fizik, por ato kanë ndikim të thellë në pastrimin e shpirtit dhe forcimin e njeriut për t’i përballuar ngarkesat e jetës. Ngarkesat jetësore kanë nevojë të madhe për trup të fortë e durimtar.

Islami e nderoi trupin, andaj edhe e bëri pastrimin e tij të plotë si kusht të patjetërsueshëm për çdo namaz, kurse namazin e bëri obligim pesë herë në ditë; Islami e obligoi muslimanin që ta lajë tërë trupin në shumë situata të cilat e përcjellin njeriun si zakonisht, e kjo, pra, është pastrimi i plotë, ndërkaq në situata të tjera, normale, mjafton larja e gjymtyrëve dhe pjesëve të cilat i ekspozohen pluhurit të ambientit dhe kryerjes së punëve të ndryshme: “*O ju që besuat! Kur doni të ngriteni për të falur namazin, lani fytyrat tuaja dhe duart tuaja deri në bërryla; fërkoni kokat tuaja, e këmbët lani deri në dy zogjt. Nëse jeni xhunubë, atëherë pastrohuni (lahuni)!...*” (El-Maide: 6)

Për këtë, metoda që e përcaktoi Islami për mbajtjen e trupit pastër në çdo kohë bazohet në lidhjen e pastrimit të domosdoshëm me pozitat e natyrës materiale të njeriut. Sikur të ishte njeriu thjesht vetëm shpirt, ai nuk do të kishte nevojë për larje dhe pastrim të vazhdueshëm, mirëpo, pasi ai qëndron në këtë sipërfaqe materiale të formuar prej dheut, në tokë, mbi të cilën jeton, prej bimëve dhe shtazëve të së cilës ushqehet, në të cilën i lë hedhurinat e lukthit dhe ku në fund varroset, Islami e ka lidhur abdestin obligativ me veçoritë e kësaj natyre materiale dhe me çdo gjë që formohet nga tretja e ushqimit më trup, hedhurina e gazra.

Asnjëherë nuk do të jetë obligimi i pastrimit metodë më produktive dhe më e drejtë se kjo që e trasoi Islami, sepse kjo metodë e shtyn njeriun ta bëjë shprehi pastrimin e tërë trupit

dhe abdestin, edhe nëse ai është i pastër, dhe kjo metodë e mënjanon nga popullata muslimane çdo gjurmë të fëlliqësisë dhe ndytjes.

Mirëpo, duhet ditur se, Islami nuk ia la çështjen e pastrimit komplet kushteve të cilat e imponojnë, sepse disa njerëz janë dembelë në çështjen e pastrimit, nëse nuk kanë ndonjë shkak i cili e obligon një gjë të tillë, andaj Islami ia caktoi pastrimit një ditë në çdo javë. Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] thotë: *“Pastrimi i ditës së xhuma është obligim për çdo njeri të moshës madhore; po ashtu edhe përdorimi i misvakut për dhëmbët dhe parfumosja.”* /Transmeton Muslimi/

Në hadith qëndron: *“Kjo është ditë të cilën Allahu e bëri festë për muslimanët, andaj, kush vjen në xhuma, le të pastrohet.”* /Transmeton Ibën Maxhe/

Islami e obligoi pastrimin prej ushqimit, pasi që preferoi pastrimin për ushqim, për të cilën gjë mjafton larja e duarve; ai urdhëroi që të pastrohemi nga mbeturinat, erërat dhe gjurmët e tij, sepse kjo është më pastër dhe më mirë për njeriun.

Nxitja për këtë pastrim të nevojshëm dallon sipas masës së grimcave të mbetura të ushqimit nëpër trup. Nëse depërtojnë këto mbeturina në vendet e sekrecionit, muslimani e ka obligim të pastrohet prej tyre. Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] thotë: *“Fërkohuni, sepse kjo është pastërti! Pastërtia thërret në besim, ndërkaq besimi me bartësin e tij është në Xhenet.”* /Transmeton Taberaniu/

Pastrimi i abdestit i është bashkangjitur pastrimit të ushqimit, në udhëzimin e Pejgamberit [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem].

Transmetohet nga Ebu Ejjubi, i cili thotë: “Doli para nesh Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] dhe tha: *“Ju lumtë atyre që rrëmojnë në pastrim, prej umetit tim!”* I thanë: “Cilët janë ata që rrëmojnë, o Pejgamber i Allahut?” Ai u përgjigj: *“Ata që e fërkojnë trupin në abdest dhe ata që rrëmohen prej ushqimit. Fërkimi i trupit është gargara në gojë, futja e ujit në hundë dhe fërkimi mes gishtave. Ndërkaq prej rrëmimit të ushqimit është rrëmimi i dhëmbëve: Nuk ka gjë më të rëndë për dy melekët sesa të shohin në mes dhëmbëve të njeriut ushqim kur ai është duke u falur.”* /Transmeton Ahmedi/

Përkujdesi i fesë ndaj pastrimit të gojës, larjes së dhëmbëve dhe pastrimit të grimcave që mbesin mes tyre, nuk e ka shembullin në porositë e mjekësisë klasike e moderne. Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] thotë: *“Përdoreni misvakun, sepse misvaku është pastrues i gojës dhe kënaqje e Allahut. Sa herë që më ka ardhur Xhibrili, më ka porositur për misvakun, ashtu që madje unë u frikova se mos po më bëhet farz mua dhe umetit tim.”* /Transmeton Ibën Maxhe/ Në një transmetim tjetër qëndron: *“U urdhërova me misvak, derisa mendova se për këtë do të më shpallet pjesë nga Kur’ani ose inspirim.”*

Ai që i përcjell sëmundjet e gojës dhe dhëmbëve, të cilat paraqiten si shkak i mospërfilljes së pastrimit të tyre, do ta kuptojë fshehtësinë e kujdesit të madh të Islamit ndaj rrëmimit të dhëmbëve me mjete të cilat e mbrojnë shkëlqimin dhe shëndetin e tyre, rrëhim ky i cili do ta mënjanojë atë që i ka mbuluar ata dhe që fshihet rreth tyre. Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] thotë: *“U urdhërova ta përdor misvakun aq shumë, saqë u frikova mos po më bien dhëmbët.”* /Transmeton Bezzari/

Ndaj ushqimeve që kanë erëra të forta dhe mbeturina të vrazhdëta, si mishi, peshku etj, njeriu duhet të jetë mjaft i kujdesshëm në pastrimin e tyre, sepse pastrimi prej tyre është i domosdoshëm për mbrojtjen e shëndetit, si dhe i domosdoshëm për mbrojtjen e prestigjit të veçantë dhe rregullave të përgjithshme.

Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] thotë: *“Kush flet me duar plot erë nga yndyrnat, dhe atë e godet diçka, mos ta fajësojë askë përveç vetes.”* /Transmeton Bezzari/

Ka shumë transmetime të cilat bëjnë me dije se mikrobet e gjejnë tokën e tyre pjellore në duart dhe gojët e fëlliqura, dhe për këtë ato edhe porosisin që të ruheni prej të ligave të tyre.

Po ashtu, prej respektit të Islamit ndaj individit dhe shoqërisë është të ndaluarit për atë që ka ngrënë hudhër, qepë ose rrikë që të jetë i pranishëm në tubime, ngase era e keqe e këtyre ushqimeve u pengon njerëzve që marrin pjesë në atë vend dhe i largon ata nga njeriu që i ka ngrënë ato.

Islami e ka shfuqizuar praninë me xhemat në xhami për ata njerëz të cilët kanë ngrënë ushqime të këtilla, e po ashtu e ka anuluar praninë në xhemat edhe për ata persona të cilët vuajnë

nga sëmundje që e bëjnë erën e gojës dhe trupit të tyre erë qelbëse; kjo etikë e ndershme është mbrojtje e preferuar për të sëmurit dhe të shëndoshët.

Islami porositi që njeriu të ketë imazh të mirë dhe formë fisnike, dhe këtë bonton ua ka bashkangjitur rregullave që duhet pasë parasysh në namaz: ***“O bijtë e Ademit, vishuni bukur për çdo namaz (lutje)...”*** (El-A’raf: 31)

Pejgamberi i Allahut, Muhammedi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem], i mësonte muslimanët që t’u kushtojnë vëmendje këtyre punëve dhe t’u përmbahen atyre në çështjet e tyre personale, ashtu që të duket muslimani në imazhin, rrobat dhe pamjen e tij i bukur dhe i pranueshëm. Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] thotë: ***“Kush ka flokë, le t’i rregullojë.”*** /Transmeton Ebu Davudi/

Transmetohet prej Ebu Katades, se i ka thënë Pejgamberit të Allahut: “O Pejgamber i Allahut, unë kam shumë flokë, a t’i kreh?” Ai i tha: ***“Po, dhe rregulloji!”*** Ebu Katadeja ndodhte që t’i lyente ato dy herë në ditë, për shkak të fjalës së Pejgamberit të Allahut.” /Transmeton Nesaiu/ Pra, rregullimi dhe parfumosja e kokës është veprim i pëlqyer.

Transmetohet prej Ata Ibën Jesarit, i cili thotë: “Erdhi një njeri te Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] me flokë dhe mjekër të shprishur. Pejgamberi i bëri me shenjë, sikur e urdhëroi t’i rregullojë flokët; ai i rregulloi, e pastaj u kthye. Atëherë Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] tha: ***“A nuk është kështu më mirë, sesa të vijë ndonjëri prej jush me flokë të shprishura sikur të jetë djall?”*** /Transmeton Maliku/

Transmetohet prej Xhabir Ibën Abdull-llahut se Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] e ka parë një njeri me flokë të shpupuritura dhe ka thënë: ***“A nuk ka ky diçka që do t’ia rregullonte flokët?”*** /Transmeton Ebu Davudi/ Ai, po ashtu, pa një tjetër me rroba të përlyera, dhe tha: ***“A nuk ka ky njeri diçka me të cilën do t’i pastronte rrobat?”***

Andaj, pedanteria pa teprim, zbukurimi pa art e dekorim, dhe bukuria e formës pas bukurisë së esencës janë prej parimeve islame të cilat ua ndërtojnë bijve të Islamit pozitën e lartë dhe pamjen e bukur.

Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] thotë: *“Nuk do të hyjë në Xhenet ai që ka në zemrën e vet mendjemadhësi sa një grimcë e imët.”* Në këtë një njeri tha: *“E ç’është puna me atë që do të ketë këpucë dhe rroba të mira?”* Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] iu përgjigj: *“Allahu i Madhërishëm është i Bukur dhe e do bukurinë.”* /Transmeton Muslimi/

Në një transmetim tjetër qëndron se një njeri i bukur erdhi te Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] dhe tha: *“Unë e dua bukurinë, dhe prej saj më është dhënë ajo që e sheh. Bile shkoj aq larg, sa që nuk dua të ma kalojë dikush edhe me një rrip këpucësh! Andaj, a është kjo prej mendjemadhësisë, o Pejgamber i Allahut?”* Ai tha: *“Jo, sepse mendjemadhësi është refuzimi i të vërtetës dhe injorimi i njerëzve.”*

Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem], në vërejtjet e tij në këtë rrafsh, ishte shumë preciz, andaj, kur shihte se një musliman ishte neglizhent në zbukurimin e vetes dhe rregullimin e pamjes së tij, e ndalonte nga këto lëshime dhe e urdhëronte të vishte rroba më të mira.

Transmetohet prej Xhabir Ibën Abdull-llahut, i cili thotë: Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] e shikoi një njeri i cili na i ruante devet, e ai kishte dy guna me kësulë, të cilat ishin vjetëruar. Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] tha: *“A nuk ka të tjera përveç këtyre të dyjave?”* Unë i thashë: *“Gjithsesi! Ai ka dy palë rroba në torbë, të cilat ia dhashë unë.”* Pejgamberi tha: *“Thirreni, le t’i veshë.”* Ai i veshi, e kur shkoi Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] tha: *“Çka ka ky, e theftë qafën, po a nuk është kjo më mirë?”* Këtë e dëgjoi ai personi, dhe tha: *“Në rrugë të Allahut, o Pejgamber i Allahut!”* Ai u përgjigj: *“Në rrugë të Allahut!”* Kështu ky person u vra në rrugë të Allahut. /Transmeton Maliku/

Ky njeri e kuptoi esencën e talljes këshilluese të cilën ia bëri Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] dhe kështu e shfrytëzoi atë për të mirë; e shihet se ai ishte prej atyre që i zmbrops brenga e jetës nga kujdesi për çështjet e tyre personale; mirëpo, krahas kësaj, kushedi sa t’i shtohen njeriut preokupimet dhe brengat, ai nuk guxon ta harrojë obligimin e kujdesit ndaj veshjes, pastërtisë dhe pedanterisë së tij.

Disa ushtrues të devotshmërisë i konsiderojnë rrobat e parregulluara dhe të përlyera formë të adhurimit, e ndoshta bile edhe me qëllim i veshin rrobat e vjetra, që në këtë mënyrë ta tregojnë moslakminë e tyre ndaj kësaj bote dhe dashurinë e tyre ndaj botës tjetër. Ndërkaq kjo është prej injorancës klasike ndaj fesë dhe falsifikimit të parimeve të saj.

Na ka rrëfyer Ibën Abbasi, i cili thotë: “Kur dolën havarixhët, shkova tek Aliu [radijAllahu anhu], dhe më tha, *“Shko tek ata njerëz.”* Për këtë unë veshja prej mantelave më të bukur të Jemenit, i takova, e ata më thanë: *“Mirë se na erdhe, o Ibën Abbas. Ç’është kjo mantelë?”* Unë u thashë: *“Çka nuk pëlqeni tek unë! E kam parë Pejgamberin duke veshur mantelat më të bukur.”* /Transmeton Ebu Davudi/

Transmetohet prej Beras, se Pejgamberi ka patur shtat mesatar: *“E kam parë me një mantel të kuq, ashtu që asnjëherë nuk pata parë gjë më të bukur se ai.”* /Transmeton Muslimi/

Ky pastrim dhe zbukurim u shtri prej individëve muslimanë deri në shtëpitë dhe rrugët e tyre, sepse Islami bëri me dije për pastrimin e shtëpive prej hedhurinave dhe plehërave, ashtu që të mos jenë tërheqëse për insektet dhe burim i sëmundjeve. Çifutët ishin shumë të pakujdesshëm në këtë pikëpamje, andaj u ndaluan muslimanët që t’u përngjasojnë atyre.

Transmetohet se Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] ka thënë: *“Allahu i Madhërishëm është i Mirë dhe e do të mirën, i Pastër dhe e do pastërtinë, Fisnik dhe e do fisnikërinë, Bujar dhe e do bujarinë. Andaj pastroni oborret tuaja, e mos u përngjasoni çifutëve.”* /Transmeton Tirmidhiu/

Largimi i pengesave nga rruga është një degë prej degëve të besimit, e kjo punë e lehtë dhe e vlefshme herë u trajtua lutje, e herë lëmoshë. Në hadith qëndron: *“T’i ndihmsh të dobëtit është lutje, dhe t’i mënjano sh pengesat nga rruga është lutje.”* /Transmeton Ibën Huzejme/ Në një hadith tjetër thuhet: *“... çdo hap për në namaz është lëmoshë, dhe largimi i pengesave nga rruga është lëmoshë.”* /Transmeton Buhariu/

Gjegjësisht, këtu hyn mënjanimi i pengesave, si: gurët, gjembat, fëlliqësitë, e të ngjashme.

Përkujdesi i Islamit ndaj pastërtisë dhe shëndetit është pjesë nga përkujdesi i tij ndaj fuqisë materiale dhe artistike të muslimanëve. Islami kërkon trupa në damarët e të cilëve do të rrjedhë gjak i shëndoshë, i cili do t'i pasurojë njerëzit me entuziazëm dhe aktivitet. Ngase trupat e plogësht nuk mund t'u përballojnë obligimeve, dhe duart që dridhen nuk mund të bëjnë mirësi.

Trupi i shëndoshë nuk ka ndikim vetëm në të menduarit e shëndoshë, por edhe në optimizmin e njeriut ndaj jetës dhe njerëzve... Misioni islam është shumë i gjerë në objektivat e tij dhe shumë i fortë në qenien e tij, andaj edhe nuk mund të jetojë në një popull të plogësht, të sëmure e të paaftë.

Për këtë, Islami e luftoi sëmundjen dhe vuri pengesa para mikrobeve të saj, me qëllim që ata të mos përhapen, e që pastaj me të të përhapet dobësia, ngecja dhe pesimizmi, dhe në të të harxhohen potencialet e shteteve dhe popujve.

Islami i mundësoi masat preventive përmes parimeve të pastërtisë së përgjithshme, siç patëm rastin të shohim më parë. Pastaj përmes jetës së rregulluar, të cilën duhet ta ndjekë muslimani, ai zgjohet para agimit, i largohet pagjumësisë natën, u ruhet kurthave të epshit, është mesatar në ushqimin e tij, është i ndershëm në jetesën dhe sjelljen e tij, aktivitetin e vet e përtërin përmes namazeve ditore dhe agjërimit në çdo vit.

Dhe mos harro se largimi nga mëkatet është mbrojtje e madhe nga sëmundjet e fëlliqura. Andaj, kur njeriu bie nën kthetrat e sëmundjes, duhet ta shërojë atë nëse do të shpëtojë prej saj. Ndërkaq Islami i udhëzon njerëzit në kërkimin e medikamenteve adekuate për sëmundjet të cilat i godasin ata.

Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] thotë:

“Allahu i Lartësuar për çdo sëmundje e ka dhënë edhe ilaçin.” /Transmeton Buhariu/

“Allahu e ka dhënë sëmundjen dhe ilaçin, dhe çdo sëmundjes ia ka dhënë edhe ilaçin; andaj shërohuni, e mos u shëroni me haram (gjëra të ndaluara).” /Transmeton Ebu Davudi/

“Për çdo sëmundje ka edhe ilaç, andaj kur të gjendet ilaçi i sëmundjes, shërohemi me lejen e Zotit.” /Transmeton Muslimi/

Islami e ndaloi drejtimin në bestytini të ndryshme për të kërkuar shërim, sepse çdo shkencë i ka ekspertët e vet të cilët e njohin atë mirë, andaj ata edhe duhet të dëgjohen. Ndërkaq, plangprishësit, të cilët futen atje ku nuk duhet dhe ku nuk e kanë vendin, nuk është e lejuar për muslimanin t'u drejtohet apo t'u besojë supozimeve të tyre. Transmetohet prej Ukbe Ibën Amirit, i cili thotë: E kam dëgjuar Pejgamberin e Allahut duke thënë: *“Kush vë talismane, Zoti mos ia plotësoftë atij dëshirat; dhe, kush vë hajmali, Zoti mos i dhëntë atij.”* /Transmeton Hakimi/

Mirëpo, edhe përkaj kësaj, “shërimi” përmes hajmalive, shkrimeve dhe mjeshtrove magjike është i përhapur mjaft në masën e thjeshtë! Islami të gjitha këto i konsideron formë të idhujtarisë, sepse këto janë trashëgimi e injorancës, e cila thirrëj në iluzione absurde.

Po ashtu, Ukbeja transmeton se një grup prej dhjetë vetësh erdhën te Pejgamberi i Allahut dhe i dhanë besë. Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] u dha besë nëntë vetave, ndërsa njërin e refuzoi! Ata thanë: “Çka ka ky?” Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] u përgjigj: *“Në krah ka të varur hajmali.”* Atëherë njeriu në fjalë e këputi hajmalinë, e pastaj Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] i dha besë edhe atij, dhe shtoi: *“Kush var diçka, ai ka bërë idhujtari!”* /Transmeton Ahmedi/

Prej mjeteve të qëlluara preventive, të cilat i ka paraparë Islami, është edhe obligueshmëria e kryerjes së nevojës në vende të ndara, në mënyrë që të shkojnë mbeturinat e organizmit në vend të thellë në tokë, ashtu që mos të ndotet prej tyre uji e as të përlyhen rrugët e ndejet.

Sikur muslimanët t'i praktikonin këto rregulla të shkëlqyeshme, ata do të shpëtonin nga pasojat e sëmundjeve, që ua dobësojnë fuqinë, ua shkelin respektin dhe i ngarkojnë me barra të rënda. Transmetohet prej Xhabirit, se Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] ka ndaluar që njeriu ta kryejë nevojën e vogël në ujin amull. /Transmeton Muslimi/ Po ashtu, transmetohet prej tij, se ka ndaluar të kryhet nevoja e vogël në ujin që rrjedh. /Transmeton Taberaniu/

Transmetohet prej Muadhit i cili thotë: “Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] ka thënë: *“Ruajuni prej tre të mallku-*

arve: dalja jashtë afër burimeve, afër udhëkryqeve dhe nën hije.” /Transmeton Ebu Davudi/

Domethënë se këto punë e bëjnë që të mallkohet njeriu përkatës, sepse njeriu që e kryen nevojën në rrugë publike, ai nuk ka njerëzi, pasi që ky kryen një punë e cila shkakton neveri dhe mllef. Kurse Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] ka thënë: *“Kush u pengon muslimanëve në rrugët e tyre, ai e ka merituar mallkimin e tyre.” /Transmeton Taberaniu/*

Në një variant tjetër qëndron: *“Cili e kryen nevojën në ndonjë prej rrugëve të muslimanëve, mbi të është mallkimi i Allahut i melekëve dhe mbarë njerëzve.” /Transmeton Bejhekiu/*

Të gjitha këto gjëra të ndaluara janë bazë e përhapjes së sëmundjeve endemike te ne muslimanët, sepse masa e thjeshtë nuk ua ka vërë veshin dhe ato u kanë sjellë kokëçarje.

Islami i ka vënë bazat e preventivës shëndetësore. Kështu, kur paraqitet ndonjë sëmundje ngjitëse në një vend, ai këtë vend e izolon fort dhe e ndalon hyrjen dhe daljen në të. Kjo bëhet me qëllim që të mblidhet efekti i sëmundjes në rreth sa më të ngushtë. Pejgamberi i Allahut ka thënë: *“Kur të dëgjoni se në një vend është përhapur kolera, mos shkoni atje, e nëse përhapet kolera në një vend ku jeni edhe ju, atëherë mos dilni prej aty.” /Transmeton Buhariu/*

Islami i ngushëlloi banorët e vendit të kapluar nga epidemia dhe ua bëri të dashur qëndrimin në të, sepse dëshira për të shpëtuar shumëkujt ia zbuluron ikjen prej aty tinëzisht, kurse kjo dëshirë për sigurimin e mbrojtjes personale ia ekspozon vendit, në përgjithësi, rrezikun fatkeq.

Për këtë, Pejgamberi i Allahut thotë: *“... çdo njeri, që gjendet në një vend në të cilin është përhapur kolera dhe qëndron në të e nuk del, durimtar dhe duke llogaritur në Zotin, duke e ditur se do ta godasë vetëm ajo që ia ka caktuar atij Allahu, ai do të ketë shpërblim sikur dëshmoi (shehidi).” /Transmeton Buhariu/*

Ndoshta ndonjë aventurier tenton të shkojë në vendin e kapluar nga epidemia duke u mbështetur në atë se frika nga infektimi është dobësi e bindjes apo ikje nga gjykimi i caktuar. Por kjo është gabim, sepse Omeri [radijAllahu anhu] refuzoi të

udhëtojë në Sham kur u paraqit në të kolera. Atëherë atij iu tha: *“Po ikën prej caktimit të Zotit?”* Ai u përgjigj: *“Ikim prej caktimit të Zotit në caktimin e Zotit.”*

Marrja parasysh e shkaqeve është realitet, dhe kjo është prej caktimit të Zotit, siç u shpreh Omeri [radijAllahu anhu], sepse Islami e ka obliguar mbrojtjen nga infektimet. Për këtë Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] thotë: *“Le të mos qëndrojnë i sëmuri tek i shëndoshi.”* /Transmeton Buhariu/

Po ashtu thotë: *“Ik prej atij që vuan nga elefantiaza⁶, siç ikën prej luanit.”* /Transmeton Buhariu/

Mirëpo, duhet ditur se, edhe pse infektimi është realitet, nuk do të thotë se çdo infektim të godet. Sepse ndodh që një person ta bartë virusin e sëmundjes, e mos të infektohet nga ai, sepse në të ka imunitet special, e bile shpëton prej virusit të tillë dhe e transferon te të tjerët!

Sikur të ndikonte çdo infektim, të gjithë njerëzit do të vdisnin për një ditë. Sepse, siç pohojnë mjekët, ekzistojnë raste specifike për t'u sëmurë nga infektimi. Ky është kuptimi i hadithit: *“Nuk ka infektim.”* Ky mohim nuk ka të bëjë me mohimin e esencës së infektimit, sepse pjesa e fundit e hadithit e ndalon këtë, e kjo është fjala e Pejgamberit [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem], menjëherë pas saj: *“...dhe ik prej atij që vuan nga elefantijaza, siç që ikën prej luanit.”*

⁶ “Sëmundja e elefantit” që karakterizohet me trashjen e lëkurës dhe me shfaqjen e gungave në lëkurë (sidomos në gjymtyrët).

TURPI

Turpi është shenjë korrekte e natyrës së njeriut; ai flet për vlerën e besimit dhe shkallën e kulturës së tij. Andaj, kur e sheh se një njeri ngushtohet nga veprimi i asaj që nuk duhet, apo e sheh se skuqja e turpit e përshkon fytyrën e tij, kur prej tij del diçka e pahijshme, dije se ai njeri ka ndërgjegje të zgjuar, natyrë të çiltër dhe prejardhje të pastër. Nëse e sheh një njeri të paturpshëm, me ndjenja të marra, i cili nuk ia vë veshin asaj se çka merr e çka lë, ai është njeri në të cilin nuk ka hajr, dhe turpi për të nuk paraqet pengesë mbrontsë nga bërja e mëkateve dhe kryerja e ligësive.

Islami i porositi bijtë e vet që të jenë të turpshëm, dhe këtë veti të lartë e bëri vlerën më të shquar me të cilën dallohet Islami. Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] thotë: *“Çdo fe e ka moralin e saj, kurse morali i Islamit është turpi.”* /Transmeton Maliku/

Ashpërsia ka qenë e dukshme në mësimet çifute në kohën e Musait [alejhis-selam], kurse toleranca ka qenë e dukshme në mësimet e Krishterizmit në kohën e Isait [alejhis-selam]. Ndërkaq Islami u dallua me turp. Të gjitha fetë urdhërojnë në virtyte si tërësi, dhe për to në tërësi kërkojnë llogari.

Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] desh që ta bëjë sensibilitetin e muslimanit ndaj mirësisë së virtyteve të mira dhe mbrapshtisë së veprave të liga, motiv i cili do ta shtyjë atë të kapet për virtytet dhe t'i braktisë veprat e liga, nga turpi i lënies të së mirës dhe veprimit të së keqes, pa marrë parasysh shpërblimin dhe dënimin, siç thotë Ibën Kajjimi:

*Zëre që për ringjalljen ende nuk na kanë arritur
të deleguarit e saj
E zjarri i Xhehenemit ende nuk është ndezur.
A nuk është obligim meritator
turpi i njerëzve prej begatuesit?*

Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] ka qenë njeriu që ka pasur natyrë më të butë, sjellje më të vyeshme dhe ndjenja më të thella ndaj obligimit dhe largimit nga e ndaluara.

Transmetohet nga Ebu Seid El-Hudriju, i cili thotë: *“Pejgamberi ishte më i turpërueshëm sesa vajza beqare në dhomën e saj, kurse kur urrente diçka, këtë e vërenim në fytyrën e tij.”* /Transmeton Muslimi/

Besimi është lidhje fisnike në mes njerëzve dhe Zotit, dhe prej obligimeve ndaj kësaj lidhjeje ndikimi i saj i parë është pastrimi i shpirtit, konsolidimi i moralit dhe përmirësimi i vepërave. Kjo nuk mund të arrihet pa u rrënjësuar në shpirtin e njeriut një ndjenjë e gjallë me të cilën çdo herë do të distancohet nga gabimet dhe do të ndiejë nënçmim nga çështjet e kota. Ndërkaq njohja e punëve të liga, pa u mbrojtur, dhe kryerja e mëkateve të vogla, pa keqardhje, është argument i humbjes së turpit të njeriu, e pastaj edhe besimit. Pejgamberi i Allahut thotë: *“Turpi dhe besimi janë unik (binjakë): nëse mungon njëri, mungon edhe tjetri.”* /Transmeton Hakimi/

Shkak i kësaj është ajo se kur njeriu e humb turpin, ai shkon prej të keqes kah më e keqja, dhe zbret prej një pune të ligë në një tjetër edhe më të ligë, dhe kështu vazhdon të ecë tatëpjetëzës derisa të përfundojë në shkallën më të ulët. Transmetohet prej Pejgamberit [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] një hadith i cili flet për periudhat e kësaj rënie, e cila fillon me humbjen e turpit dhe mbaron me pasojat e rrezikshme:

“Allahu i Lartësuar, kur do ta mposhtë një njeri, e mënjanon prej tij turpin. E kur i hiqet atij turpi, atëherë do ta shohësh vetëm të urrejtur; e kur do ta takosh vetëm të tillë, prej tij largohet edhe besnikëria; e kur do të largohet prej tij besnikëria, do ta shohësh atë vetëm tradhtar të madh. E kur do

të jetë vetëm i tillë, atëherë prej tij do të largohet edhe mëshira; e kur do të largohet edhe mëshira, ti do ta shohësh atë vetëm të braktisur e të mallkuar; e kur do ta shohësh vetëm të tillë, atëherë ai do të dalë prej lidhjes së fesë.” /Transmeton Ibën Maxhe/

Kjo është renditje precize në cilësimin e Pejgamberit: sëmundje e shpirtit dhe pasim i periudhave të tjera. Dhe u pa se si u transferua çdo periudhë e fëlliqur në një tjetër edhe më të ligë. Andaj, njeriu që e gris perden e fytyrës së vet nuk bën llogari për punët që i kryen dhe as që ka dert se qortohet për sjelljet e veta; ai ua shtrin njerëzve dorën e dëmit dhe i bën padrejtësi çdonjërit që është nën pushtetin e tij. Njerëzit e këtillë, mbrapshtanë, nuk do të gjejnë zemër e cila do të tregojë mëshirë ndaj tyre, bile, përkundrazi, ata mbjellin dhe kultivojnë mllefe në zemra.

Çfarë dashurie mund t'i tregohet një njeriu që nuk brengoset prej Zotit dhe u vërsulet njerëzve? Nuk e zbraps atë prej mëkateve asnjë fije turpi, dhe, kur arrin njeriu në një gjendje të këtillë, atëherë në të nuk ka besim për asgjë. Si mund t'i besohet atij ndonjë pasuri, kur ai nuk turpërohet aspak nga keqpërdorimi i saj? Si mund t'i besohet atij në nderë, kur ai nuk brengoset se i turpëron njerëzit? Si mund t'i besohet atij ndonjë termin, kur atij nuk i vjen rëndë aspak që mos t'i përmbahet, apo ndonjë obligim, kur atij nuk i intereson fare se nuk e kryen?

Kur njeriu e humb turpin dhe besën, ai shndërrohet në egërsirë grabitqare dhe marshon i tërbuar pas epsheve të tij, dhe për këtë qëllim i shkel edhe ndjenjat më të pastra. Kështu, ai ua rrëmben të varfërve pasurinë, pa i ardhur aspak keq për ta; i shikon vuajtjet e të persekutuarve dhe të dobtëve, e zemra e tij nuk ndien mëshirë; egoizmi i tij i përdhosur ka vënë para syve të tij perde të errët, andaj ai nuk di tjetër gjë, përveç lajthitjeve dhe mashtrimeve që i bën në emër të pasurisë... Dhe atëherë kur do ta arrijë njeriu këtë gradë të ulët, ai i ka këputur frenat e fesë dhe është lëshuar nga litari i Islamit.

Turpi i ka vendet e veta, kur preferohet. Kështu, turpi në bisedë kërkon prej muslimanit që ta pastrojë gojën e tij nga të irrituarat, gjuhën e tij ta distancojë nga të metat, të turpërohet nga përmendja e dobësive të tjerëve, sepse sjellje e keqe është

të lëshohen nga njeriu fjalë të paturpshme pa u kujdesur për vendin dhe pasojat e tyre. Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] thotë: *“Turpi është prej besimit, e besimi është në Xhenet; ndërkaq paturpësia është prej arrogancës, e arroganca është në zjarr.”* /Transmeton Ahmedi/

Po ashtu, prej turpit në bisedë është që njeriu të jetë i matur gjatë bisedave të tij nëpër ndeja, sepse disa njerëz nuk turpërohen nga përvetësimi i të drejtës ekskluzive për të folur në tubime të mëdha, dhe kështu i mbushin zemrat me shqetësim nga zgjatja e bisedave të tyre; kurse Islami e urren këtë lloj të njerëzve. Pejgamberi i Allahut ka thënë: *“Kush e mëson retorikën që t’i përvetësojë zemrat e njerëzve, Allahu në Ditën e Gjykimit nuk do të pranojë prej tij as ndryshim e as kompensim.”* /Transmeton Ebu Davudi/

“Allahu e urren njeriun elokuent⁷, i cili godet me fjalët e tij siç që godet lopa me brirë.” /Transmeton Tirmidhiu/

Fshehtësia e kësaj urrejtjeje qëndron në atë se, informatat e këtyre njerëzve nuk janë pa shtesa, karakteri i tyre nuk shpëton nga hipokrizia dhe dominimi i tyre në tubime është kanal i sëmundjeve etike, të cilat shumë shpejt do t’i shëronte turpi, sikur ta posedonin këtë. Prandaj edhe në disa transmetime përmendet se paaftësia është më e mirë sesa kjo retorikë; por bëhet fjalë për paaftësinë (mbylljen) e gjuhës dhe jo të zemrës.

Prej turpit është që njeriu të turpërohet që prej tij të dëgjohet ndonjë e keqe dhe të orvatet që personaliteti i tij të mbetet i pastër nga njollosjet dhe larg dezinformatave të këqija. Kështu, ndalohet përgojimi për atë që nuk dihet, ndërkaq ai që ka hapur regjistrin e tij dhe e ka zbuluar turpin e vet, njerëzit nuk do të mund të bëjnë kundër tij sa bën ai kundër vetes. Për këtë, Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] e urdhëroi atë, të cilin e kanë ndyrë fëlliqësiat e mëkateve, që të fshehit prej njerëzve.

Dallimi është shumë i qartë në mes atij që me punën e vet synon famë dhe atij që i largon nga fama e vet paragjykimet e njerëzve. Ruajtja e muslimanit përmes fshehjes së të ligave dhe

⁷ Që di të flasë bukur, që të lë mbresë të thellë me gojëtarinë e tij të bukur e të natyrshme.

ekspozimit të të mirave nuk nënkupton hipokrizi. Assesi, por qëllimi është në moszbulimin e hapët të të ligave, dhe turpi nga kryerja e tyre publikisht.

Ngase, njeriu i cili turpërohet ta publikojë një të keqe, tregon se në të ende ka diçka të mirë; e po ashtu, edhe njeriu i cili kërkon të publikohet mirësia e tij, në të ende vazhdon të ketë diçka të keqe... Mirëpo, duhet ditur patjetër se, njeriu duhet të turpërohet prej vetes ashtu siç turpërohet prej njerëzve. Andaj, nëse nuk do që ta shohin të tjerët keq, le të mos dojë që ta shohë veten e vet në gjendje të tillë të keqe, me përjashtim, nëse e konsideron vetveten aq shumë të devaluuar që të turpërohet prej saj. Është thënë: “Kush e bën një punë fshehurazi, nga e cila turpërohet ta veprojë publikisht, ai nuk e çmon aspak vetveten.” Nisur nga kjo, muslimani e ka obligim që të largohet nga veprat e ndyta, qofshin ato të fshehta apo publike, dhe pa marrë parasysh a është në vetmi, apo del para njerëzve.

Në një transmetim qëndron: *“Atë që dëshiron ta dëgjojnë veshët e tu, bëje, e atë që urren ta dëgjojnë veshët tu, largohu prej saj.”*

Turpi është kulminacioni i mirësisë; ai është element i vyeshmërisë në çdo punë që gjendet. Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] thotë: *“Në çdo çështje që gjendet teprimi, e shëmtton, e në çdo çështje që gjendet turpi, e zbukuron.”* /Transmeton Tirmidhiu/

Sikur turpi të shndërrohej në trup, ai do të ishte simbol i mirëqenies dhe i konsolidimit. Transmetohet prej Aishes, se Pejgamberi i Allahut i ka thënë asaj: *“Sikur të ishte turpi njeri, do të ishte njeri i devotshëm, e sikur të ishte e liga njeri, do të ishte njeri i keq.”* /Transmeton Taberaniu/

Prej turpit të njeriut ndaj njerëzve është që t’ua njohë pozitën njerëzve meritore dhe çdo njeriu të mirë t’ia japë mirësinë që e meriton. Kështu, fëmija me ata që e rrisin dhe nxënësi me ata që e mësojnë duhet të ketë sjellje që bazohet në respekt dhe përparësi, andaj, nuk lejohet ta ngrejë zërin më tepër se ata e as që të dalë para tyre.

Në hadith përmendet: *“Jini modest me ata që ju mësojnë.”* /Transmeton Taberaniu/ Po ashtu, në një hadith tjetër përmen-

det: *“O Zot, të lutem mos të më zërë ajo kohë kur nuk pasohet i dituri dhe nuk turpërohet i urti.”* /Transmeton Ahmedi/

Transmetohet prej Abdull-llah Ibën Busrit, i cili thotë: *“Që prej kohësh kam dëgjuar një hadith: “Nëse je me njerëz të cilëve u janë farkuar fytyrat, ashtu që nuk sheh në mesin e tyre asnjë njeri i cili frikohet prej Zotit, dije se çështja është holluar (është e mjerueshme)!”* /Transmeton Ahmedi/

Turpi nuk është frikë, sepse njeriu i turpërueshëm më parë do të kishte pranuar t'i derdhet gjaku sesa t'i derdhet uji fytyrës së tij (ta shkelë nderin) e mu kjo është forma më e lartë e trimërisë.

Ndoshta mund të ketë në turp një dozë të frikës, edhe pse kjo ka të bëjë me frikën e njeriut të vyeshëm për vlerat e tij morale dhe cilësitë e tij njerëzore, ashtu që lulëzimin e tyre mos t'ia rrëmbejë gjendja kaotike. Kjo frikë është identike me guximin, në rastet e pëlqyera.

Kështu, kur çifutët e lashtë u zmbrapsën nga luftimi i tiranëve që kishin hyrë në tokën e shenjtë: ***“Dy burra, prej atyre (prijësve) që Allahu i kishte pajisur me bindje dhe kishin frikën e Tij, thanë:”Hynju atyre nga dera, e kur t'u hyni nga ajo, atëherë ju jeni ngadhnjyes...”*** (El-Maide: 23)

Pra, ata të cilët i kanë drojë Allahut, ata që frikohen prej turpërimit dhe turpërohen nga ikja, ata janë të cilët do ta udhëhiqnin sulmin dhe do t'i afroreshin fitores në rast lufte.

Nuk ka dyshim se turpit të plotë i paraprin përgatitja paraprake natyrore. Sepse, ka disa karaktere, që pandërgjegjshmëria gati është pjesë e pandashme e tyre; e, në të njëjtën kohë, sheh nga ana tjetër disa njerëz shumë të turpërueshëm dhe mjaft të ndjeshëm. Mirëpo, frika, edhe pse është elementi më i dukshëm në turpërim, ndodh edhe në të mirë edhe në të keq, e bile mund ta fusë njeriun në situata kritike të palakmueshme. Ndërkaq, turpërimi gjendet ekskluzivisht në normat fetare; andaj, ai që ka frikë nga qortimet e plangprishësve nuk konsiderohet njeri me turp. Turpi nuk mund të jetë përballë të pavërtetës, e, po ashtu, turpi nuk ka vend te njerëzit të cilët kanë devijuar; turpi nuk ka vend në sjellje, kur njeriu merr qëndrim që ta ndihmojë të vërtetën... Idhujtarët ia zunë për të madhe Islamit, sepse ai i nënçmoi idhujt, kurse Islami e shpaloj paaftë-

sinë e tyre për të krijuar një mizë, bile i turpëroi edhe për atë se nuk janë të aftë as ta mbrojnë veten, nëse i sulmon një mizë. Për këtë zbriti Fjala e Allahut të Madhërishëm: ***“Allahu nuk ngurron që të marrë çfarëdo shembulli, qoftë mushkojë a diçka edhe më e imët se ajo. Për sa u përket atyre që besuan, ata e dinë se ai (shembulli) është i vërtetë nga Zoti i tyre, ndërsa ata të cilët mohuan, do të thonë: Ç’deshi Allahu me këtë si shembull?...”*** (El-Bekare: 26)

Për këtë, paraqitja e idhujve në këtë formë të paaftësisë dhe dështimit është realitet: ***“Sepse Allahu nuk turpërohet nga e vërteta.”*** Dhe, me qëllim të tregimit të vërtetës, muslimani nuk ka frikë prej askujt dhe nuk ka dert për pezmin e dikujt.

Turpi, në gradat e tij më të larta dhe më fisnike, është turpi prej Allahut, sepse ne ushqehemi nga mirësitë e Tij dhe marrim frymë në ajrin e Tij, ecim mbi tokën e Tij dhe na mbulon qielli i Tij. Sikur dikujt t’ia bënte dikush një të mirë të vogël, ai do të ngushtohej mjaft që t’i sillte ndonjë të keqe atij njeriu, e si mos të rrëqethen njerëzit nga sjellja e keqe ndaj Zotit të tyre, të mirat e të Cilët i ndjekin prej djepi e deri në varr, madje edhe pas kësaj?!

Obligimi i njerëzve ndaj Zotit është shumë i madh, dhe sikur ta kishin çmuar drejtë këtë obligim, ata vetvetiu do të vraponin në veprimin e punëve të mira dhe njëkohësisht do të largoheshin nga veprat e liga, nga turpi i kthimit të mirësisë ekskluzive me injorim dhe nënçmim.

Transmetohet prej Ibën Mes’udit, i cili thotë: ***“Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] ka thënë: “Kini turp prej Allahut, sinqerisht!” Ne i thamë: “O Pejgamber i Allahut, ne turpërohem prej Allahut.” Ai tha: “Jo, nuk është ajo që duhet të jetë. Turpërimi i sinqertë prej Allahut është që ta mbrosh kokën dhe atë që përmban, barkun dhe atë që mban, dhe ta përkujtosh vdekjen dhe sprovimin. Ai që e do botën tjetër, e lë zbukurimin e kësaj bote dhe i jep përparësi ahiretit ndaj kësaj bote. Andaj, kush e bën këtë, ai është turpëruar sinqerisht prej Allahut.”*** /Transmeton Tirmidhiu/

Kjo këshillë, për të cilën thuhet se është e Ibën Mes’udit, përmban shumë rregulla islame dhe metoda të mirësisë. Sepse muslimani duhet ta pastrojë gjuhën e vet, që të mos futet në

mbrapshti; duhet ta pastrojë shikimin e vet, që të mos vështrojë vende të turpshme dhe me epsh; duhet ta pastrojë veshin e vet, që të mos vjedhë ndonjë sekret apo të zbulojë ndonjë fshehtësi. Ai duhet ta ndalojë barkun e vet, që të mos pranojë haram, dhe ta bindë atë me të pastërtën e paktë. Po ashtu, ai duhet ta kalojë kohën e vet në kënaqësinë e Allahut dhe ta lakmojë mirësinë që gjendet tek Ai, e assesi mos ta nënshtrojnë sulmet e jetesës dhe interesat mashtruese.

Për atë, nëse e bën këtë me vetëdije se Allahu e mbikëqyr, dhe nga keqardhja e të bërit ndonjë gabim ndaj Zotit, ai është turpëruar sinqerisht prej Allahut.

Turpi, me këtë përfshirje, është e tërë feja, e kur me të quhen një grumbull punësh të mira, ai atëherë është një pjesë prej besimit dhe gjurmë e tij.

Pejgamberi i Allahut thotë: *“Besimi ka shtatëdhjetë e disa degë, më e larta është fjala ‘nuk ka të adhuruar tjetër me të drejtë, përveç Allahut’, e më e ulëta është largimi i gjembave nga rruga; e edhe turpi është një degë e besimit.”* /Transmeton Buhariu/

Kur gjendet në praninë e disa njerëzve të cilët i respekton, dhe orvatet që ata të jenë të kënaqur me të, njeriu i kontrollon në mënyrë precize sjelljet e veta, flet me masë, sillet me vëmendje. Ndërkaq, muslimani, i cili e di nga mësimet e fesë së vet se asnjëherë nuk mund të fshehit nga Zoti, sepse çdoherë është para Tij, ditën dhe natën, duhet të ketë drojë më të madhe nga madhështia e Zotit, dhe respekti ndaj normave të Tij duhet të jetë më i përkryer. Kjo është domethënia e transmetimit: *“Ki turp ndaj Allahut, ashtu siç ki turp prej njerëzve me peshë në popullin tënd.”*

Dridhja e njeriut dhe zbehja e fytyrës së tij në disa raste është argument i një lartësie të fshehtë dhe natyre fisnike, e *“Turpi në tërësi është i dobishëm.”* /Transmeton Muslimi/

Ndërkaq, nëse ngjyra e turpit bie prej fytyrës, ashtu siç bie lëvorja e gjelbër nga dega e butë, atëherë e ke shkatërruar jetën e vyeshme, ndërkaq thërrimet e tjera përgatiten të jenë lëndë djegëse e zjarrit, e kjo është ajo që i thuhet: *“Nëse nuk ke turp, bëj çka të duash.”*

VËLLAZËRIMI

Nuk ekzistojnë motive të arsyeshme të cilat i shtyjnë njerëzit të jetojnë të ndarë e të armiqësuar, sepse motivet e bazuara në logjikën e realitetit dhe ndjenjave të shëndosha i afrojnë njerëzit mes vete dhe u përgatisin atyre shoqëri solidarizuese ku mbizotëron dashuria, e me këtë do të shtrihej edhe siguria në sipërfaqen e tokës. Allahu i Madhërishëm të gjitha prejardhjet dhe llojet e njerëzve i bëri prej dy prindërve, që prej këtyre farefisnive të afërta të bëjë një pikëtakim ku do të gërshetohen dhe forcohen lidhjet: ***“O ju njerëz, vërtet Ne ju krijuam juve prej një mashkulli dhe një femre, ju bëmë popuj e fise që të njiheni ndërmjet vete, e s’ka dyshim se tek Allahu më i ndershmi ndër ju është ai që më tepër është ruajtur (nga të këqijat), e Allahu është shumë i dijshtëm dhe hollësisht i njohur për çdo gjë.”*** (El-Huxhurat: 13)

Pra, njohja, e jo largimi, është thelbi i marrëdhënieve në mes njerëzve. Mirëpo mund të paraqiten pengesa, që e ndalojnë këtë njohje reciproke të rrjedhë si duhet në shtratin e saj dhe të vazhdojë jeta me gjurmët e veta pozitive. Në garën e njerëzve për fitimin e rizkut, dhe në dallimet e tyre në kuptimin e realitetit dhe përcaktimin e mirësisë mund të nxiten divergjenca, të ndodhin konfrontime, edhe pse këto ngjarje negative nuk duhet të ndikojnë për të harruar urtësinë primare nga krijimi i njeriut dhe gjallërimit të tokës me orvatjet e tyre të koordinuara.

Çdo lidhje, e cila e thellon këtë njohje reciproke dhe i eliminon pengesat nga rruga e saj, është lidhje që duhet përkrahur dhe i duhen shfrytëzuar veçoritë, sepse Islami nuk është thjesht vetëm një lidhje që i tubon një numër të madh, a të vogël njerëzish, por paraqet një konglomerat të vërtetash të cilat i

miratojnë relacionet e shëndosha në mes njerëzve dhe Zotit, e pastaj edhe në mes njerëzve në përgjithësi.

Andaj, ithtarët e Islamit dhe bartësit e misionit të tij duhet ta përjetojnë madhërinë e besimit me të cilin Allahu i hapi zemrat e tyre, në të cilin i bashkoi ata, si dhe të ngrihet njohja reciproke në mes tyre në bazë të përkujdeses dhe solidaritetit, të cilat janë në përputhje me të... Ajo është njohje e cila e përtërin lidhjen e përbashkët, të venitur, në mes njerëzve, e, po ashtu, e konfirmon gjenezën e përbashkët materiale e cila mbaron tek Ademi me gjenezën shpirtërore, që kthehet te parimet e feve të sublimuara në misionin islam. Me këtë, feja e pastër bëhet themel i vëllazërisë së fortë, i bashkon ithtarët e vet në të gjitha anët e botës dhe prej tyre, edhe përkaj dallueshmërisë në vende e kohë, formon një unitet me themele të forta dhe me mure të larta të cilit nuk mund t'i bëjnë asgjë shtrëngatat e forta.

Kjo vëllazëri është shpirti i gjallë i besimit dhe thelbi i ndjenjave sensible, të cilat i kalit muslimani për vëllazërit e tij, aq sa ai jeton me ta dhe për ta, dhe ata sikur janë degë të cilat kanë dalë nga një trung, apo një shpirt i cili ka hyrë në trupa të ndryshëm.

Egoizmi dominues është e metë e njeriut dhe shkatërrues i vlerave të tij. Nëse dominon synimi i tij mbi një njeri, atëherë e mira e tij zhduket kurse e liga zhvillohet, dhe e kufizon atë në një rreth të ngushtë e të mjerë, në të cilin nuk njeh tjetërkë, përveç vetes; ai nuk trazohet me gëzim apo dëshpërim, me përjashtim asaj që e prek prej të mirës apo të keqes.

Islami e luftoi këtë egoizëm tiran me vëllazërinë e drejtë, dhe i tregoi njeriut se jeta nuk i takon ekskluzivisht vetëm atij, dhe se ajo nuk mund të përmirësohet vetëm me të, por le ta dijë njeriu se ka edhe njerëz të tjerë si ai, nëse e ka parasysh obligimin e tyre ndaj tij dhe interesin e vet tek ata; le të ketë parasysh edhe obligimet e tij ndaj atyre dhe interesat e tyre tek ai; ky gjest e liron njeriun nga egoizmi i vogël dhe e bën atë që të ketë ndjenja ndaj të tjerëve kur ka ndaj vetes. Kështu ai nuk do ta teprojë dhe nuk do të bëjë lëshime.

Prej obligimeve të tua ndaj vëllait tënd është që ta refuzosh dëmtimin e tij dhe të nxitosh ta pengosh një gjë të tillë,

ashtu që nëse e prek atë diçka që e dëmton, ti e shoqëron në dhembje dhe bashkërisht me të ndien zemërim. Ndërkaq, të jesh me ndjenja të vdekura, të të vijë pak keq ngase e keqja ka ndodhur larg prej teje, dhe nëse ty kjo nuk të intereson, kjo është sjellje e keqe dhe i ka lidhjet e këputura me ndjenjat e vëllazërisë gjithpërfshirëse, e cila i bashkon shpirtrat e muslimanëve dhe e bën njeriun të preket nga dhembja që e godet vëllain e tij, gjë që dëshmon për vërtetësinë e fjalës së Pejgamberit të Allahut: *“Shembulli i muslimanëve në dashamirësi, mëshirë dhe ndihmë të ndërsjellë, është sikurse trupi që ka të sëmure ndonjë pjesë, atëherë i tëri vuan nga pagjumësia dhe zjarrmia.”* /Transmeton Buhariu/

Dhembje e vërtetë është ajo e cila të shtyn me vrull t’i largosh vuajtjet e vëllazërve të tu. Kështu, nuk qetësohesh derisa ta mënjano pikëllimin dhe ta largosh errësirën e atyre vuajtjeve. Nëse ke sukses në këtë, fytyra jote ndriçohet dhe ndër-gjegja jote qetësohet.

Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] thotë: *“Muslimani është vëlla i muslimanit, nuk i bën padrejtësi dhe nuk e dorëzon. Kush i ndihmon vëllait të vet, Allahu do t’i ndihmojë atij, kush ia largon muslimanit një brengë, për këtë Allahu do t’ia largojë atij një brengë prej brengave të Ditës së Gjykimit. E kush i mbulon turpet e një muslimani, atij do t’ia mbulojë Allahu Ditën e Gjykimit.”* /Transmetojnë Buhariu dhe Muslimi/

Prej manifestimeve të vëllazërisë fisnike është që t’ia duash të mirën vëllait tënd dhe të gëzohesh për atë që e arrin ai siç që gëzohesh për një të mirë të cilën e arrin ti. Nëse mendo-hesh në realizimin e kësaj mirësie, ti je afruar te Allahu me adhurimet më të pastërta dhe me shpërblimin më të madh.

Transmetohet prej Ibën Abbasit se, duke qenë i mbyllur në l’tikaf (qëndrim në xhami) në xhaminë e Pejgamberit [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] erdhi tek ai një njeri, e përshëndeti, pastaj u ul. Atëherë Ibën Abbasi i tha atij: *“O ti filan, pse je i dëshpëruar dhe i pikëlluar kështu?”* Ai tha: *“O djali i axhës së Pejgamberit të Allahut! Ndaj filan njeriut kam obligim miqësie e lojaliteti, por, pasha shenjtërinë e atij që qëndron në këtë varr, nuk kam mundësi ta kryej këtë obligim!”* Ibën Abbasi i tha: *“A të bisedoj me të për çështjen tënde?”* Ai tha: *“Nëse*

do.” Atëherë Ibën Abbasi i mbathi këpucët dhe doli prej xhamisë, kurse ai njeriu i tha: *“A harrove në çfarë gjendje ishe?”* Ai iu përgjigj: *“Jo, por e dëgjova atë që qëndron në këtë varr, i cili pat thënë: “Kush del që t’ia kryejë vëllait të vet një punë dhe e arrin atë, është më mirë sesa të qëndrojë në l’tikaf dhjetë vjet. Kush bën l’tikaf një ditë për hir të Allahut të Lartësuar, Allahu do të bëjë në mes tij dhe në mes zjarrit tre hendeqe më larg sesa ç’është ndërmjet Lindjes e Perëndimit!”* /Transmeton Bejhekiu/ Në një transmetim tjetër qëndron: *“Çdo hendek është më larg tjetrit sesa Lindja e Perëndimi.”*

Ky hadith e ilustron përforsimin e Islamit me lidhjet e vëllazërisë së mirë dhe vlerësimin e tij të lartë ndaj formave të shërbimeve të përgjithshme për të cilat ka nevojë shoqëria me qëllim të përforsimit të themeleve të saj dhe mbrojtjes së trungut të saj.

Ibën Abbasi e pa më të arsyeshme që ta lërë l’tikafin, i cili është adhurim ekskluziv, me peshë të madhe tek Allahu, sepse ai është zhytje në namaz, agjërim dhe përkujtim të Allahut, e pastaj, po ashtu, ai bëhej në xhaminë e Pejgamberit [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem], ku shtohet shpërblimi për një mijë më tepër sesa në xhamitë e tjera. Mirëpo, krahas tërë kësaj, kuptimi i thellë i Ibën Abbasit për normat fetare bëri që ai ta lërë këtë lloj adhurimi, me qëllim që t’i bëjë shërbim një muslimani që kërkon ndihmë. Kështu ai mësoi prej Pejgamberit të Allahut.

Ngarkesat jetësore janë të mëdha, kurse vështirësitë zbrezin mbi njerëzit ashtu siç bie shiu dhe i përfshin tokat pjellore dhe thatësitat. Njeriu, vetë si individ, nuk ka fuqi të qëndrojë gjatë përballë këtyre vështirësive, e edhe nëse qëndron, ai do të jepte mund të madh, i cili do të ishte i panevojshëm sikur vëllezërit e tij të vraponin ta ndihmonin dhe ta përkrahnin në realizimin e synimit. Është thënë: *“Njeriu si individ i vetëm është pak, por me vëllezërit e vet është shumë.”*

Prej të drejtës së vëllazërisë është që muslimani të ndiejë se vëllezërit e tij i ka mbështetje në gëzim dhe skamje dhe se fuqia e tij nuk mund të lëvizë në jetë e mëvetësishme, por fuqitë e besimtarëve e mbështesin dhe e ndihmojnë. Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] ka thënë: *“Besimtari për besim-*

tarin është si pjesët e ndërtesës, të cilat e përforcojnë njëra-tjetrën.” /Transmeton Buhariu/

Nisur nga kjo, vëllazëria e sinqertë është begati e dyfishtë, jo vetëm begati e homogjenitetit shpirtëror, por edhe begati e bashkëpunimit material.

Allahu i Madhërishëm disa herë me radhë e ka përsëritur përmendjen e kësaj begatie në një ajet: “... **Përkujtonie nime-tin e Allahut ndaj jush, kur ju (para se ta pranoni fenë islame) ishit të armiqësuar, e Ai bashkoi zemrat tuaja dhe ashtu me dhuntinë e Tij aquat të jeni vëllezër...**” (Ali Imran: 103)

Vëllazëria fetare obligon solidaritet në mes muslimanëve, e jo mbështetjen e fanatizmave të verbër; ajo thërret për përkrahjen e besimtarëve reformues për realizmin e të vërtetës dhe shkatërrimin e të pavërtetës, për pengimin e keqbërësit dhe ndihmimin e atij që i është bërë e padrejtë. Andaj nuk duhet lënë muslimani të qëndrojë i vetëm në ndonjë mejdan, por patjetër të qëndrojmë në anën e tij në çdo situatë, me qëllim që, nëse devijon, ta udhëzojmë, nëse e tepron, ta ndërprejmë, nëse sulmohet, ta mbrojmë dhe të luftojmë me të kur kërkohet një gjë e tillë. Ky, pra, është kuptimi i solidaritetit, të cilin e obligoi Islami. Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] thotë: “*Ndihmoje vëllain tënd, qoftë tiran apo qoftë që i bëhet e padrejtë.*” Njëri tha: “*I ndihmoj nëse i bëhet e padrejtë, e si t’i ndihmoj kur ai bën padrejtësi?*” Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] i tha: “*Ta pengosh nga padrejtësia, në këtë mënyrë i ke ndihmuar.*” /Transmeton Buhariu/

Nënçmimi i muslimanit është punë e madhe, sepse një gjë e tillë, nëse ndodh, është rrugë që çon në nënçmimin e gjithë muslimanëve; kjo do t’i shkatërrojë vetitë e mburrjes dhe fisnikërisë në mes tyre, kështu që ai që i është bërë padrejtësi, me vullnet apo pa vullnet, do t’i nënshtrohet përbuzjes që e ka goditur... pastaj do të ikë larg dhe do të këputen lidhjet e vëllazërisë mes tij dhe atyre që e kanë nënçmuar.

Muslimanët u zhvlerësuan, si individë dhe si popuj, kur u këputën lidhjet vëllazërore në mes tyre dhe kur filluan ta shikojnë njëri-tjetrin me habi dhe injorim. Kështu erdhën deri në atë shkallë saqë vëllai nënçmohej para vëllait, e ai i mblidhte

shpatullat dhe e shikonte punën e vet, sikur nuk i hynte në punë një gjë e tillë!

Ky nënçmim u solli muslimanëve përbuzje dhe turp. Islami e luftoi ashpër këtë element dhe i mallkoi ata të cilët tërhiqen në hijet e veta të errëta e të mjerueshme. Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] ka thënë: *“Mos qëndroni në ato vende ku i mëshohet një njeriu pa të drejtë, sepse mallkimi zbret mbi ata që janë aty, kur nuk e mbrojnë atë.”* /Transmeton Taberaniu/

Andaj, kur e sheh se vëllain tënd e ka gjetur një e keqe, apo ai është nënçmuar, trego gatishmëri për t'i dalë në ndihmë dhe për ta përkrahur, derisa bashkë me ty ai ta kthejë atë që i takon dhe ta largon dhunën. Transmetohet prej Pejgamberit [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] se ka thënë: *“Kush i ndihmon një njeriu që i është bërë padrejtësi, derisa t'ia vërtetojë atij të drejtën, Allahu i Lartësuar do t'ia përforcojë atij këmbët në urën e kalimit (Sirat) atë ditë kur do të rrëshqasin këmbët.”* /Transmeton Asbahani/

Ky obligim i madh edhe më tepër konfirmohet nëse në shoqëri ke autoritet apo pozitë të cilën e preokupojnë dëshirat dhe frikat. Autoritetit i duhet dhënë zekati i vet, sikurse që i jepet zekati edhe pasurisë, andaj, nëse të begaton Allahu me pushtet në tokë dhe ndikim në mes njerëzve, kjo nuk është që ti të fryhesh pas tërheqjes në vete apo të tregohesh mendjemadh pas modestisë. Por, Allahu ta ka mundësuar ty këtë, me qëllim që të marrësh mbi vete obligime të cilat nuk mund të kryhen ndryshe, vetëmse përmes teje; andaj, nëse ti e lehtëson realizimin e tyre, e ke kryer obligimin e duhur dhe e ke fituar shpërblimin e premtuar, përndryshe, e ke injoruar begatinë dhe ia ke ekspozuar shkatërrimit. Transmetohet prej Pejgamberit të Allahut, i cili thotë: *“Allahu u ka dhënë disa njerëzve begati, të cilat i ka vendosur tek ata derisa janë në ndihmë të muslimanëve dhe nuk u mërzhiten, e kur do t'u mërzhiten, do t'i transferojë te të tjerët.”* /Transmeton Taberaniu/

Mirëpo, duhet ditur se, përdorimi i autoritetit të njeriut, për të mirën e njerëzve dhe ndalimin e dëmtimit të tyre, duhet të bëhet në kufij të nderitë dhe pastërtisë, sepse, nëse një njeri e bën këtë duke pritur dhuratë, ai e ka humbur shpërblimin e tij tek Allahu, dhe me punën e tij e ka ngrënë të fëlliqi-

rën. Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] thotë: *“Kush ndërmjetëson për ndonjërin dhe për këtë atij i dhurohet ndonjë dhuratë dhe ai e pranon, ai ka hyrë nga një derë e madhe prej dyerve të mëkateve të mëdha.”* /Transmeton Ebu Davudi/

Ka disa ligësi të cilat Islami i luftoi, sepse ato janë kontradiktore me etikën e vëllazërisë dhe kushtet e saj.

Vëllazëria është parimi, sipas të cilit rregullohen rreshtat drejt dhe i cili e kthen atë që ka dalë para në vendin e vet dhe e nxjerr atë që ka mbetur pas në vendin e vet. Për atë, nëse ndodh konflikt apo divergjencë, zbatohen ligjet e vëllazërisë mbi të gjithë dhe ekzekutohet gjykimi i saj: ***“S’ka dyshim se besimtarët janë vëllezër, pra bëni pajtim ndërmjet vëllazërve tuaj dhe kinie frikë Allahun, që të jeni të mëshiruar (nga Zoti).”*** (El-Huxhurat: 10)

Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] ua ka tërhequr vërejtjen muslimanëve prej këtyre ndytësive, në hadithin e tij të shkëlqyeshëm; këto janë vepra të shëmtuara, të cilat shkurtpamësit i duken se nuk paraqesin shumë rrezik, mirëpo, ato, për ata që i kanë parasysh pasojat e tyre, i copëtojnë zemrat dhe i shuajnë ndjenjat e dashurisë. Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] thotë: *“Ruajuni prej paragjykimeve, sepse paragjykimet janë gënjeshtër më e madhe; mos spiunoni, mos garoni mes vete, mos e xhelozoni njëri-tjetrin, mos e urreni njëri-tjetrin, mos ia ktheni shpinën njëri-tjetrit, por bëhuni robër të Allahut, vëllezër siç ju nderoi juve Allahu i Lartësuar... Muslimani është vëlla i muslimanit, nuk i bën dhunë atij, nuk e lë (në baltë) dhe nuk e nënçmon; për një njeri është e keqe e mjaftueshme që ta nënçmojë vëllain musliman. Çdo musliman, kundruall çdo muslimani, e ka haram pasurinë e tij, gjakun e tij dhe nderin e tij... Allahu nuk shikon në format tuaja dhe trupat tuaj, por shikon në zemrat tuaja dhe punët tuaja... Devotshmëria është mu këtu, devotshmëria është mu këtu, devotshmëria është mu këtu (dhe tregonte në kraharorin e tij). Kini kujdes të mos bëjë dikush kontratë mbi kontratën e tjetrit për shitje... Nuk i lejohet një muslimani ta bojkotojë vëllain e vet mbi tri ditë.”* /Transmeton Muslimi/

Në shoqërinë, e cila jeton në mbikëqyrjen e Zotit, e që bashkohet në dispozitat islame, vëllazëria e besimit vihet në

vend të vëllazërisë së gjakut, e ndoshta edhe i jep përparësi lidhjes së besimit mbi atë të gjakut.

Është realitet se lidhjet e vëllazërisë për hir të Zotit janë ato të cilat i bashkuan bijtë e Islamit herën e parë, e ngritën shtetin islam, e lartësuan flamurin e tij, në to u mbështet Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] në formimin e umetit i cili u përballoi sulmeve të idhujtarisë shpirtligë dhe armiqve të tjerë spekulantë; e, pastaj, pas një lufte të gjatë doli ky umet kokëlartë e me baza të forta, derisa në anën tjetër armiqtë e tij u shkrinë dhe u zhdukën.

Sendet ta përkujtojnë të kundërtën e tyre. Në kohën tonë, uniteti i çifutëve në të pavërtetën e tyre, orvatjet e tyre për ngritjen e mbretërisë së tyre, ardhja e tyre prej Lindjes e Përrëndimit, duke u drejtuar në Tokën e Shenjtë dhe duke i lënë trojet e tyre të para dhe pasuritë e përkujtimet që ato i përmbajnë; pra, kjo rilindje, e motivuar nga një besim i pabazë, na përkujton rilindjen edhe më të fuqishme që ndodhi para katërmëdhjetë shekujsh, kur u nisën muslimanët nga çdo anë drejt “Jethribit”, dhe u shpërngulën prej vendlindjeve të tyre, në truallin të cilin e zgjodhën për ngritjen e shtetit të parë islam...

Medina, e cila e përqafoi Islamin dhe e lartësoi fjalën e tij, i ndërtonte marrëdhëniet në mes vendasve dhe të ardhurve në bazë të sakrifikimit për hir të Zotit, në bazë të përparësisë së tjetrit me tolerancë fascinuese, të barazisë mes njerëzve, të nderit dhe dashurisë reciproke, të përhapjes së mirësisë dhe shenjtërimit të të vërtetës, në bërjen e mirësisë nga dëshira për të, e jo nga ngarkesa me të. Allahu i Madhërishëm thotë: ***“Edhe ata që përgatitën vendin (Medinen) dhe besimin para tyre, i duan ata që shpërnguleshin tek ata dhe nuk ndiejnë në gjoksat e tyre ndonjë nevojë (për zili a tjetër) nga ajo që u jepej atyre (muhaxhirëve), madje edhe sikur të kishin vetë nevojë për të, ata u jepnin përparësi atyre para vetvetes...”*** (El-Hashr: 9)

Këto janë, pra, shenjat e vëllazërisë së vërtetë, vëllazërisë së sinqertë për hir të Allahut, e jo vëllazërisë së interesave të përkohshme e as qëllimeve të ulëta.

Islami e kultivon këtë vëllazëri dhe e mbron që të mos futet në të ndonjë element i cili do ta ndyt. Andaj, një muslimani,

nuk i lejohet që vëllait të vet t'i shkaktojë ndonjë telashe, apo në shpirtin e tij të nxisë ndonjë shqetësim. Pejgamberi [salallahu alejhi ve sel-lem] thotë: *“Nuk i lejohet muslimanit që ta shqetësojë një musliman tjetër.”* /Transmeton Ebu Davudi/

Po ashtu, transmetohet prej Pejgamberit të Allahut, se ka thënë: *“Kush e shikon muslimanin me shikim i cilin e tremb pa të drejtë, Allahu do ta trembë atë në Ditën e Gjykimit.”* /Transmeton Taberaniu/

Ajo që çon në ofendim të muslimanit apo afron kah armiqësia ndaj tij, konsiderohet krim i rëndë. E çka mund të thuhet, atëherë, për ofendimin direkt dhe sulmimin e tij? Pejgamberi i Allahut ka thënë: *“Kush ia ngre para vetes vëllait të vet një armë, melekët e mallkojnë atë derisa të mbarojë; edhe po e pati vëlla prej babe dhe nëne.”* /Transmeton Muslimi/

Me këto instruksione, vëllazëria është sigurim i plotë, e cila e forcoi në shoqëri paqen dhe qetësinë...

Këtë vëllazëri edhe më tepër e përforcon ndalimi i Islamit për kryelartësi dhe mburrje. Sepse vëllezërit, të cilët e ndiejnë unitetin në një baba dhe lojalitetin ndaj një feje, nuk mund t'i bëjnë armiq interesat e kësaj bote... Po ashtu, nuk ka vend për kryelartësinë e pabazë në mes njerëzve që e dinë se prestigji i takon devotshmërisë! Kurse devotshmëria është në zemra, e zemrat janë në dorë të Zotit, dhe fshehtësinë e tyre nuk e di askush! Pejgamberi i Allahut ka thënë: *“Allahu më shpalli mua urdhër që të jemi të përlurur dhe mos t'i bëjmë padrejtësi njëri-tjetrit, e as mos të mburremi ndaj njëri-tjetrit.”* /Transmeton Ebu Davudi/

Islami frikohet për ata me të cilët luan djalli dhe i nxit të shpifin ndaj vëllezërve të vet, duke synuar në këtë mënyrë dominim në shoqëri; andaj, ai sqaroi se, njerëzit e tillë, të pamatur, do të devalvohen në Ditën e Gjykimit, dhe aq sa janë treguar kryelartë, aq do të tkurren, derisa të bëhen pluhur të cilin e shkelin këpucët. Në hadith përmendet: *“Kryelartët do të ringjallen në Ditën e Gjykimit sikurse grimcat në forma të njerëzve, të cilët do t'i mbulojë poshtërimi nga çdo anë.”* /Transmeton Tirmidhiu/

Prej elementeve, që i shkatërrojnë lidhjet e vëllazërisë janë: përqeshja, nënçmimi dhe përbuzja e të tjerëve. Këto veti

të liga formohen nga injoranca e pakuptimtë dhe nga moskujdesi i turpshëm, sepse prej obligimit ndaj të dobtit është që ai të ndihmohet, e jo të dëmtohet, dhe prej obligimeve ndaj të humburit është që ai të udhëzohet, e jo të qeshemi me të. Kështu, nëse gjendet një e metë te një njeri, apo i ekspozohet ai ndonjë të keqeje, gjëja e fundit që pritet prej “muslimanit” është që ai këtë ta bëjë nxitëse të ironisë dhe të talljes së tij: ***“O ju që besuat, nuk bën të tallet një popull me një popull tjetër, meqë të përqeshurit mund të jenë më të mirë nga ata të cilët përqeshin dikë tjetër, e as gratë me gratë e tjera, sepse mund të ndodh që gratë e tjera të jenë më të mira se ato që përqeshin (duke nënçmuar njëri-tjetrin)...”*** (El-Huxhurat: 11)

Transmetohet prej El-Hasenit se atyre që i përqeshin njerëzit, në ahiret do t’u hapet një derë e Xhenetit dhe do t’u thuhet: ***“Eja.”*** Ata do të vijnë me brengat dhe dëshpërimet e tyre, e kur do të vijnë, ajo do t’u mbyllet. Pastaj atyre do t’u hapet një derë tjetër, dhe do t’u thuhet: ***“Eja, eja.”*** Ata do të vijnë me brengat dhe zemërimin e tyre, e kur do të arrijnë, do t’u mbyllet. Dhe do të vazhdojë në këtë mënyrë, derisa ndonjërit prej tyre do t’i hapet një derë prej dyerve të Xhenetit, dhe do t’i thuhet: ***“Eja...”***, e ai nuk do të vijë nga pesimizmi.”
/Transmeton Bejhekiu/

Ky do të jetë shpërblimi i përqeshësve; ky është denim që vjen nga lloji i mëkatit të bërë, siç është qortim për përqeshësit dhe përkujtim për ta për atë që kanë bërë.

Prej masave që i ka paraparë Islami për mbrojtjen e vëllazërisë së përgjithshme dhe fshirjen e dallimeve artificiale, për konfirmimin e barabarësisë në gjak dhe barazisë në të drejtë, si dhe për vetëdijësimin e masave të gjera dhe elites, se mburrja me gjenezë është e pabazë, sepse atësia është prej Ademit [alejhis-selam], është se Islami i rumbullakësoi të gjitha përfundimet e saj në një moto ekskluzive. Andaj, askush nuk mund t’i japë përparësi të afërmit të tij, përveçse me veçoritë të cilat ai i fiton për vete me mundin dhe orvatjen e vet; prandaj, atij që nuk shquhet me vepra madhore, nuk do të mund t’i ndihmojnë stërgjiyshërit e tij, edhe po të jenë mbretër të ahiretit.

Transmetohet prej Ebu Hurejres, i cili thotë: Pejgamberi i Allahut ka thënë: ***“Në Ditën e Gjykimit Allahu do ta urdhërojë***

një thirrës të thotë: “Unë bëra origjina, dhe ju e bëtë këtë; Unë e bëra më të ndershmin e juve më të devotshmin, e ju nuk pranuat ndryshe të thoni, përveçse: “Filani i biri i filanit.” Sot e ngre origjinën time dhe e ul origjinën tuaj!” /Transmeton Bejhekiu/

Kjo është në pajtim me ajetin kur'anor: “E kur i fryhet surit (herën e dytë), atëherë, në atë ditë nuk do të ketë lidhje familjare mes tyre e as që do të pyes kush për njëri-tjetrin. E kujt i peshojnë më rëndë peshojat (veprat e mira), ata janë të shpëtuarit. Ndërsa, atyre që u peshojnë lehtë peshojat (veprat e mira), ata janë që humbën vetveten dhe janë në Xhehenem përgjithmonë.” (El-Mu'minun: 101-103)

Është për t'u habitur se tradita e arabëve, në lartësim për shkak të origjinës dhe ngritje për shkak të atësisë, dominoi në shoqërinë e tyre mbi mësimet islame, e mu kjo qe prej shkaqeve të plasaritjeve të rrezikshme në të kaluarën dhe të tashmen tonë...

Po ashtu, prej metodave islame për mbrojtjen e vëllazërisë në mes bijve të vet, sado që të dallojnë vendet dhe fiset e tyre, është zhdukja e shovinizmit dhe e nacionalizmit.

Është e natyrshme që njeriu ta dojë atdheun dhe popullin e vet, mirëpo assesi nuk lejohet që kjo të jetë shkak që njeriu të harrojë Zotin e vet, moralin dhe idealet e veta.

Pejgamberi i Allahut thotë: “Më i miri prej jush është ai që e mbron familjen e vet, përderisa nëse nuk është mëkat.” /Transmeton Ebu Davudi/

Po ashtu, është pyetur ai: “Çka është fanatizmi?” Ai tha: “T'i ndihmosh popullit tënd në padrejtësi.” /Transmeton Ebu Davudi/

Vëllazëria në Islam do të thotë sinqeritet ndaj Islamit, pasim të rrugës së tij, zbatimi i normave të tij, dominimi i natyrës së tij mbi lidhjet e përgjithshme dhe speciale, kërkim i përgjigjes prej tij për problemet që paraqiten, si dhe mospërfillje e ulurimave dhe thirrjeve të tjera.

UNITETI

Dispozitat dhe rregullativat islame e konsiderojnë individin pjesë të pandashme të qenies së popullit dhe element unikat të trupit të umetit, i cili asnjëherë nuk shkeputet prej tij, dhe individi, me dëshirë apo pa të, e merr hisen e vet prej asaj që shpërndahet nëpër tërë trupin, prej ushqimit, zhvillimit dhe ndjenjave.

Në interes të miratimit të kësaj erdhi edhe udhëzimi hyjnor, ashtu që ai nuk iu drejtua vetëm individit me urdhër dhe ndalim, por këtu i përfshiu të gjithë njerëzit me edukim dhe udhëzim. Pastaj, prej instruksioneve të cilat u jepen të gjithëve, individi dëgjon dhe i merr për këshillë. Kështu, në mënyrë konstante, erdhi konteksti i normativave në Kur'an dhe Sunet: ***“O ju që besuat, falni namazin me ruku e sexhde dhe vetëm Zotin tuaj adhuron. Bëni punë të mira (të dobishme), se do të gjeni shpëtim. Luftoni me një luftë të denjë për hir të Allahut...”*** (El-Haxh 77-78)

Andaj, kur muslimani qëndron para Allahut duke e lutur dhe kur i nënshtrohet Atij me lutje, adhurimi nuk do të artikulohet nga ai si rob i ndarë nga vëllezërit e vet, por si një palë nga turma unike e bashkuar; thotë: ***“Vetëm Ty të adhurojmë dhe vetëm te Ti kërkojmë ndihmë!”*** (El-Fatiha: 4), e jo “Vetëm Ty të adhuroj dhe vetëm prej Teje ndihmë kërkoj!”

Pastaj e lut Allahun t'i japë prej të mirave dhe udhëzimit të Tij, e nuk e veçon veten e vet me lutje, por e lyp mëshirën e Allahut për atë dhe për të tjerët, duke thënë: ***“Udhëzona (përforcona) për në rrugën e drejtë! Në rrugën e atyre, të cilët i begatove me të mira, jo në të atyre që kundër veti tërhoqën hidhërimin, e as në të atyre që e humbën veten!”*** (El-Fatiha: 5-7)

Allahu i Madhërishëm nuk i krijoi njerëzit që të ndahen dhe të përçahen... Ai u shpalli atyre një fe dhe u dërgoi një varg pejgamberësh që t'u prijnë të gjithë njerëzve në një rrugë. Ai, që nga lashtësia parakrijuese materiale, ua ka ndaluar njerëzve ta copëtojnë fenë e të ndahen në grupe-grupe.

Mirëpo, përsëri, epshet e tërbuara u bënë shkak që të harrohet kjo porosi e ndershme dhe njerëzit e injoruan thesarin e madh hyjnor e u ndanë në grupe, dhe çdo grup filloi t'i bëjë lajka dhe t'i vërë pusi tjetrit. Allahu i Madhërishëm thotë: *“(Ne u patëm thënë) O ju të Dërguar, hani atë që është e lejuar dhe e mirë dhe bëni vepra të mira se Unë e di atë që ju vep-roni. Kjo feja juaj është e vetmja fe, e Unë jam Zoti juaj, ruanju dënimit Tim. E ata më vonë u ndanë në grupe sipas çështjes së fesë, dhe secili grup krenohej me atë që kishte përvetësuar për vete. Andaj, ti (Muhammed) lëri ata edhe një kohë në atë mashtrimin e tyre.”* (El-Mu'minun: 51-54)

Allahu i Madhërishëm shpjegoi se pasimi i epshit dhe ndjekja e plangprishësisë është sekreti i kësaj përçarjeje të gjerë.

Është realitet se kur ndahet dituria nga morali dhe nuk bashkohet me sinqeritetin, ajo shndërrohet në fatkeqësi për bar-tësit e saj dhe për njerëzit e tjerë... Para ardhjes së fesë, njerë-zit i humbte injoranca, në xhunglat e saj çoroditëse, e kur erdhi feja, dhe atë e monopolizuan krerët e saj dhe me dituritë e saj bënë tregti për vete dhe aspiratat e tyre, masat dërrmuese devijuan në rrugë të mbrapshta! Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] kërkonte mbrojtje tek Allahu nga dituria që nuk bën dobi, dhe tha: *“Më së tepërmi frikohem për ju, pas meje, prej hipokritit të shkolluar.”* / Transmeton Bezzari/

Po, nuk ka dyshim se zemra e prishur e bën diturinë armë për trazira, andaj, bota, në të kaluarën dhe sot, u dëmtua nga kjo dituri destruktive. Kurse Allahu i Madhërishëm na ka lajmë-ruar se dijetarët vetëm me gjuhë, e jo edhe me zemër, janë ata të cilët e deformuan unitetin e njerëzve.

Allahu i Madhërishëm thotë: *“Ai u përcaktoi juve për fe atë që i pat përcaktuar Nuhut dhe atë që Ne ta shpallëm ty dhe atë me çka e patëm porositur Ibrahimin, Musain dhe Isain. (I porositëm) Ta praktikoni fenë e drejtë e mos u për-çani në të. Për idhujtarët është rëndë kjo në çka ju i thirrni*

ata. Allahu veçon për të (për besim të drejtë) atë që do dhe e udhëzon në të atë që i drejtohet Atij.” (Esh-Shura: 13)

Pastaj tha: **“Po ata, vetëm pasi që u erdhi e vërteta, nuk u përçanë për tjetër, por nga zilia mes tyre...” (Esh-Shura: 14)**

Po ashtu thotë: **“... E përpos atyre që iu kishte dhënë ai (libri) dhe u kishin ardhur argumente të qarta, nuk kundërshtoi kush në të (në librin), po edhe atë (kundërshtim e bënë) nga zilia ndërmjet tyre...” (El-Bekare: 213)**

Shiko, pra, në makutërinë e shkencës, kur ajo e humb sinqeritetin ndaj Zotit dhe ndjenjat ndaj njerëzve, si nxit divergjenca dhe e këput atë që urdhëroi Allahu të lidhet.

Dallimi në kuptim dhe gërshetimi i mendimeve nuk është gjë e panjohur në jetë, mirëpo nuk duhet të jetë kjo shkak i pezmatimeve dhe përçarjeve. Shkaku i përçarjeve ka të bëjë me ngërthimin e faktorëve të tjerë, të cilët e shfrytëzojnë largësinë e pikëpamjeve dhe mendimeve për të nxjerrë në shesh pasione të brendshme. Nisur nga kjo, hulumtimi mbi të vërtetën shndërrohet në një lloj të kokëfortësisë, e cila nuk ka kurrfarë lidhje me shkencën.

Sikur të ishin të çiltërta qëllimet për hulumtimin e të vërtetës dhe t'i qaseshin kësaj pune pionerët e saj, pa pasur orekse të dominimit, famës, postit a pasurisë, atëherë do të pastroheshin divergjencat, që e mbushën historinë përplot njolla e tragjedi.

Kemi vërejtur se ka disa çështje të imta rreth të cilave është hiperbolizuar dhe rreth të cilave janë zgjatur polemizimet, sepse këto polemizime fillimisht janë përshkuar nga interesa politike, e ndërkohë është reduktuar polemika në çështje të rëndësishme, ashtu që u lanë pikëpamjet të përqendrohen sipas dëshirës, sepse rezultatet e këtyre polemikave janë thjesht teorike!

Dhe, pasi kjo polemikë e dyshimtë është kontradiktore me fenë e Zotit dhe jetën e njerëzve, Islami e konsideroi atë shkëputje prej tij dhe mosbesim. Allahu i Madhërishëm thotë: **“Vërtet ata që e përçanë fenë e tyre dhe u ndanë në grupe, ti (Muhammed) nuk ke kurrfarë përgjegjësie. Çështja e tyre**

është vetëm tek Allahu, Ai do t'i njohë me atë që punuan.”
(El-En'am: 159)

Allahu i Madhërishëm ua tërhoqi vërejtjen muslimanëve, nga përçarja në fe dhe ndarjet në palë të konfrontuara e të mallkuara mes vete, siç vepruan të parët: ***“E mos u bëni si ata që u ndanë dhe u përçanë pasi patën zbritur argumentet. Ata do të pësojnë një dënim të madh. Në ditën kur ka fytyra që zbardhen dhe ka fytyra që nxihen. E për sa u përket atyre që fytyrat u janë nxirë (u thuhet): A edhe pas besimit tuaj u bëtë pabesimtarë? Vuanie pra, dënimin për shkak se ishit që nuk besojshit! Ndërsa atyre që fytyrat e tyre u janë zbardhur, ata janë në mëshirën (Xhenetin) e Allahut dhe aty janë përgjithmonë.”*** (Ali Imran: 105-107)

Bashkimi i zemrave dhe ndjenjave dhe harmonizimi i synimeve dhe i metodave, janë prej parimeve më të qarta të Islamit dhe virtytet më të shquara të muslimanëve të singertë... E, nuk ka dyshim se, unifikimi i radhëve dhe bashkimi i ideve, është themeli i fortë i ekzistencës së umetit, i kontinuitetit të shtetit të tij dhe suksesit të misionit të tij; nëse maksima e Njëshmërisë (*Teuhidit*) së Zotit është dera e Islamit, atëherë dijeni se unifikimi i ideve është fshehtësia e qëndrimit në të dhe pasimit të saj, si dhe garancia e parë e takimit të Zotit me fytyrë të ndritshme dhe faqe (biografi) të pastër.

Shpërblimi i një pune, në esencën dhe formën e saj, dallon shumë kur e kryen njeriu atë punë vetë, dhe kur e kryen me tjerët.

Kështu, dy rekatet e sabahut, apo rekatet e namazit të drekës, janë të njëjta dhe nuk kanë asgjë shtesë kur i jep përparësi njeriu faljes së tyre me xhemat, sesa në vetmi. Mirëpo, edhe përsëri kësaj, Islami e shtoi shpërblimin e këtyre namazeve për më shumë se njëzet shkallë, kur qëndron njeriu bashkë me të tjerët para Allahut.

Ky është një stimulim i madh për t'iu bashkangjitur xhematit dhe për ta braktisur mëvetësinë, si dhe shtytje për njeriun që të distancohet nga izolimi dhe të inkadrohet me njerëzit e tjerë të popullit të tij. Islami nuk i lejon muslimanit që të kufizohet në suaza të vetvetes dhe të egërsohet në mendimin dhe ndjenjën e tij dhe me interesin e vet të largohet nga interesi

dhe jeta e bashkësisë. Në hadith përmendet: “...tri gjëra nuk duhet t’i urrejë zemra e një besimtari: *Sinqeriteti i punës për hir të Zotit, këshillimi i udhëheqësve të muslimanëve, dhe përqendrimi konsekuent në bashkësinë e tyre, sepse lutja e tyre i përfshin përmes tyre.*” /Transmeton Bezzari/

Me qëllim të inkorporimit sa ma të madh të muslimanit në shoqërinë në të cilën jeton, Allahu e miratoi faljen e përbashkët (me xhemat) të namazeve ditore dhe i stimuloi njerëzit që të jenë të pranishëm në to dhe të hapërojnë shpesh në të. Pastaj, po ashtu, i obligoi banorët e fshatrave të vegjël, apo lagjeve të mëdha, që të takohen çdo javë për namazin e xhumasë; pastaj thirri në një takim edhe më të madh, në namazin e Bajrameve, dhe vendin e këtyre namazeve masovike e caktoi në hapësira të gjera jashtë qytetit, dhe i urdhëroi burrat dhe gratë, madje edhe ato me menstruacione, të jenë të pranishme atje me qëllim të plotësimit të dobisë dhe shtimit të mirësisë.

Pastaj thirri në një tubim edhe më masovik, i cili do t’i tubojë njerëzit prej Lindjes e deri në Perëndim; për këtë e bëri obligim haxhin, të cilit i caktoi vend dhe kohë të veçantë, ashtu që takimi në mes popujve muslimanë të jetë çështje e pa-tjetërsueshme. Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] me të madhe tregonte nga pasojat e izolimit dhe përçarjes dhe, në çdo rast që i jepej, thirrte në bashkim dhe unitet. Transmetohet prej Seid Ibën El-Musejjibit, i cili thotë: “Pejgamberi i Allahut ka thënë: *“Djalli i vërsulet njeriut kur është vetëm ose dy vetë, e nëse janë tre, atëherë ai largohet.*” /Transmeton Maliku/

Gjatë një udhëtimi ai vërejti se, kur ndalet karvani të pu-shojë, njerëzit shpërndahen nëpër vende të ndryshme, sikur në mes tyre nuk ka harmoni; ai këtë nuk e pëlqeu dhe ndaloj nga ky veprim.

Transmetohet prej Ebu Tha’lebes, i cili thotë: “Njerëzit, kur ndaleshin në ndonjë vend, ndaheshin nëpër vende të ndryshme. Për këtë, Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] tha: *“Shpërndarja juaj e këtillë është prej djallit.*” E pastaj, sa herë që njerëzit ndaleshin, ata afroheshin pranë njëri-tjetrit, saqë thuhet se sikur t’u ishte shtruar një pëlhurë, do t’i zinte të gjithë. /Transmeton Ebu Davudi/

Kjo është gjurmë e gërshetimit të ndjenjave, dashurisë reciproke dhe thurrjes së radhëve.

Njerëzit, nëse nuk i bashkon e vërteta, atëherë do t'i përcajë e pavërteta; nëse nuk i bashkon adhurimi i Allahut, do t'i copëtojë adhurimi i djallit; nëse nuk i tërheqin mirësitë e ahiretit, do të konfrontohen për interesat e kësaj bote... Për këtë, konfliktet e ndërsjella, të hidhura, janë prej veçorive të injorancës së errët dhe shprehisë së atyre që nuk kanë besim. Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] ka thënë: *“Mos u shndërroni pas meje në mosbesimtarë, duke u kthyer ta vritni njëritjetrit.”* /Transmeton Tirmidhiu/

Gjegjësisht, ka për qëllim se kjo betejë e përgjakshme u takon mosbesimtarëve, të cilët janë ndarë në mes vete në palë ndërluftuese.

Islami është fleksibil ndaj dallimeve të mendjeve në kuptim: atij që gabon, i dha një shpërblim, kurse atij që ia qëllon, dy shpërblime, pastaj i përfshiu të gjithë në gjirin e tij të gjerë, derisa janë të sigurtë në kërkimin e të vërtetës, duke synuar njohjen dhe zbatimin e saj. Pejgamberi i Allahut ka thënë: *“Nëse gjykon dijetari në bazë të analizave të bëra, dhe ia qëllon, atij i takojnë dy shpërblime; e nëse pas analizave të bëra gabon, atij i takon një shpërblim.”* /Transmeton Buhariu/

Ti, pra, e sheh se mëshira e Allahut lidhet me rezultatet e mendimit aq sa lidhet me vlefshmërinë e qëllimit. Andaj, pse ngushtohen njerëzit për atë që e ka zgjeruar feja e Allahut? Dhe, pse sillen në mes vete me arrogancë dhe ashpërsi?

Kur i urdhëroi Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] luftëtarët, të cilët dolën prej Medine, që mos ta falin ikindinë askund tjetër, vetëm se te fisi Beni Kurejdha, këtë urdhër disa e trajtuan ndryshe, duke thënë se kjo vlen derisa nuk ka kaluar koha, andaj edhe u falën në rrugë, ndërkaq të tjerët e kuptuan këtë urdhër fjalëpërfjalë, andaj edhe e falën ikindinë në mbrëmje. E Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] e pranoi kuptimin e të dy palëve, e pastaj përballë armikut i rreshtoi në një ushtri.

Kjo është metoda islame në evitimin e polemizimit shkençor, e nga kjo nuk mund të iket kur konsolidohen ndjenjat dhe mendjet... Ndërkaq, atëherë kur do të bëhet polemizimi për

këtë botë, të cilën do ta vëjë kokëfortësia dhe urrejtja, atëherë është humbur kjo botë, e para saj edhe feja.

Një dijetari i është thënë: *“Shkoju pas falësve në xhami, gati sa nuk janë vrarë!”* Ai tha: *“Për çka?”* I thanë: *“Disa duan ta falin namazin e teravisë tetë rekate, e disa të tjerë njëzet rekate.”* Ai tha: *“E pastaj çka?”* I thanë: *“Ata presin përgjigjen tënde.”* Ai u tha: *“Përgjigja ime është të mbyllet xhamia, e assesi mos të falet në të teravia, sepse teravia është namaz nafile (vullnetar), kurse uniteti i muslimanëve është farz, dhe nuk mund të kryhet një nafile e cila e rrënon farzin!”*

Sinqeriteti për hir të Zotit dhe këshilla për fé dhe për masat e gjera është larg kësaj zhurme për çështje të këtilla.

Në përputhshmëri me parimet islame për mbrojtjen e ume-tit nga pasojat e përçarjes, dijetarët kanë qëndrimin se ndryshimi i së keqes nuk është obligativ, nëse çon në një të keqe më të madhe, sepse ekzistimi i së keqes është dëm, por ndodhja e të keqes tjetër është dëm edhe më i madh; kështu, duhet ta bëjnë të keqen më të lehtë!

A nuk e sheh se mjeku nuk nis ta bëjë operacion trupin pa u vërtetuar se trupi ka mundësi t’i përballojë kësaj? E nëse ai e sheh se operacioni është rrezik për jetën, ndalet, edhe nëse mbetet sëmundja. Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] besatohej me ensarët (medinasit): *“Për dëgjueshmëri dhe respekt në skamje e bollëk, në mirëqenie e vështirësi, dhe të na jepni përparësi neve...”* /Transmeton Muslimi/

Kjo do të thotë se njeriu i devotshëm nuk duhet të bëhet pesimist për humbjen e hises së tij prej kësaj bote, ashtu që, nëse nuk përfillet në emërimin në ndonjë pozitë, apo i ulet paga, ai nuk e pushton horizontin me ulurimë e armiqësi, sepse, hidhërimi për këtë botë, në këtë mënyrë të shëmtuar, është veti e munafikëve, për të cilët Allahu i Madhërishëm thotë: ***“Ka prej tyre që do të bëjnë vërejtje në ndarjen e lëmoshës, nëse u jepet nga ajo, ata mbesin të kënaqur, e nëse nuk u jepet, ata hidhërohen.”*** (Et-Teube: 58)

Po të depërtonte shikimi në shumë prej këtyre ndarjeve, ti do ta shihje dashurinë ndaj kësaj bote dhe egoizmin e verbër i cili fshihet pas këtyre përmbysjeve me fjalë... Bashkimi është fuqi... E kjo nuk është vetëm në çështjet e njerëzve, por, një-

kohësisht, është edhe ligj i gjithësisë. Kur i shoqërohen perit të hollë edhe penj tjerë të ngjashëm, ai shndërrohet në litar të fortë që i tërheq peshat e mëdha; e kjo botë e madhe nuk është tjetër, përveçse një grumbull grimcash unike!

Një njeri i urtë ua sqaroi bijve të vet këtë domethënie në prag të vdekjes, me qëllim që t'u jetë mësim për unitetin. Ua vuri atyre para vetes një grumbull thuprash, e ata nuk mundën t'i thyejnë; ndërsa kur i shpërndanë një nga një, u thyen njëra pas tjetrës.

*Shtizat, kur tubohen nuk thyhen,
E kur ndahen, thyhen një nga një.*

Përçarja i dobëson edhe popujt e fortë, kurse i zhduk popujt e dobët... Për këtë, porosi të parë për muslimanët, pasi fituan në Betejën e Bedrit, Allahu i Madhërishëm e bëri bashkimin e radhëve dhe unitetin e tyre.

Kur u gjendën shpirtrat para pasurisë së fituar të luftës, duke lakmuar hisen e tyre në të dhe duke garuar në ndarjen e tyre, zbriti Fjala e Allahut të Madhërishëm: **“Të pyesin ty (Muhammed) për plaçkën (e fituar në luftë), thua ju: Plaça, (mënyra e ndarjes së saj) është çështje që i takon Allahut dhe të dërguarit, prandaj kini frikë Allahun, përmirësoni gjendjen e unitetit tuaj dhe nëse jeni besimtarë, respektone Allahun dhe të dërguarin e Tij.”** (El-Enfal: 1)

Pastaj ua bëri të qartë se bashkimi në veprimtari për hir të Zotit është rruga e fitores bindëse dhe e fuqisë tmerruese: **“Dhe respektone Allahun e të Dërguarin e Tij, e mos u përçani mes vete e të dobësoheni e ta humbni fuqinë (luftarake)...”** (El-Enfal: 46)

Po ashtu, ua tërhoqi vërejtjen që të mos zihen për këtë botë dhe të mos tubohen pas shkumës së saj, sikur ata që nuk shpresojnë në shpërblimin e Zotit, dhe tha: **“Mos u bëni si ata që dolën prej shtëpive të tyre sa për krenari e për t'i parë bota, e që pengonin nga rruga e Allahut...”** (El-Enfal: 47)

Pastaj muslimanët në Uhud morën një shuplakë të dhembshme, e cila ua humbi shtatëdhjetë heronj prej burrave të tyre, dhe i ktheu në Medine duke vuajtur nga dy gjëra: nga turpi i disfatës dhe nga turpi i gëzimit të pabesimtarëve.

E pse ndodhi kjo? Edhe përkaj asaj se besimi i tyre në Allahun dhe mbrojtja e tyre e të vërtetës u jepte përparësi për fitore bindëse. Kjo ndodhi ngase ata u përçanë, u ndanë dhe nuk e çuan në vend urdhrin e Allahut dhe të Pejgamberit të Tij:

“Allahu përmbushi premtimin e vet ndaj jush, ngase me vullnetin e Tij i korrët ata (me shpata) deri kur u dobësuar dhe u përçatë ndërmjet vete, në çështjen e vendit (që u pat caktuar Pejgamberi dhe pasi vërejtët atë që e dëshironit (prenë e luftës), e atëherë kundërshtuat (urdhërin e Pejgamberit). Pati prej jush që e deshën këtë jetë (ata që u ngutën pas presë) e pati prej jush që e deshtën botën tjetër. Pastaj për t’ju sprovuar u zmbrazi juve nga ata...” (Ali Imran: 152)

Sikur ta analizonin muslimanët gjendjen e tyre në këtë periudhë të rëndë të historisë së tyre, do ta ndjenin se turpi që i gjeti kthehet në deformimin e unitetit të tyre dhe në emocionet e tyre të ndryshme.

Sulmi bashkëkohor krishter si dhe sulmi cionist, i cili erdhi në margjina të të parit, nuk patën sukses në luhatjen e shtetit islam dhe flakjen e mirësisë së tij. Ata ia arritën këtij qëllimi vetëm pasi i paraprinë kësaj përmes ndarjes së muslimanëve në grupe të dobëta të parëndësishme, në shtete të vogla të pezmatuara; pasi nxitën mes tyre një problem, rrethi i të cilit pastaj zgjerohet pa shkak... Politika perëndimore, në kolonizimin dhe nënshtrimin e Lindjes, bazohet në parimin: “Përça e sundo.”

Islami orvatet për sigurinë e umetit të vet dhe mbrojtjen e qenies së tij dhe, për këtë shkak, ai fuqishëm i shuan simptomat e përçarjes dhe i thërret të gjithë individët që të ndihmohen në nxjerrjen e umetit nga kënetat e përçarjes dhe epilogjet e tij të zeza. *“Dora e Zotit është me bashkësinë, e kush ndahet, ai ka mbaruar në zjarr.”*

Armiqtë e Islamit tentojnë që ta ushtrojnë ndikimin e vet mbi një person, i cili do të jetë palë lojale e tyre, ta përvetësojnë atë, e pastaj do ta tërheqin tërë umetin përmes tij! Nuk ka dyshim se ai do ta zhdukë këtë eskalim, me qëllim që të

shpëtojë tërë bashkësia nga rreziku i ekzistencës së tij. Për këtë Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] thotë: *“Do të ndodhin lloj-lloj trazirash, e kush do të tentojë ta përçajë këtë umet, duke qenë bashkë, vriteni atë, kushdo që të jetë.”* /Transmeton Muslimi/

Dalja nga uniteti i popullit, që është dënimi i tij në këtë botë, pastaj do të hyjë në suaza të ajetit kur'anor: *“Kush i kundërvihet të Dërguarit, pasi që i është bërë e qartë e vërteta, dhe ndjek rrugë tjetër nga ajo e besimtarëve, Ne e lëmë në atë që ka zgjedhur (në dunja) e e fusim në Xhehenem. Përfundim i keq është ai.”* (En-Nisa: 115)

Mos t'i duket dikujt i çuditshëm ky kërcënim, sepse virusi i përçarjes nuk lind, pa lindur me të çdo gjë që e rrezikon përfundimin e umetit me shkatërrim.

Njerëzit posedojnë veti të këqija, që mund të shuhen vetvetiu nën ombrellën e një uniteti të plotë, mirëpo, kur paraqiten simptomat e përçarjes, i sheh se si tubohen ata rreth protestuesit të parë; shikuar nga jashtë, duket se janë tubuar rreth idealit, mirëpo brendia nuk është e tillë. Për këtë, Pejgamberi i Allahut thotë: *“Kush i tregon udhëheqësit mosdëgjueshmëri dhe largohet nga bashkësia, e vdes ndërkohë, ai ka patur vdekje injorante.”* /Transmeton Buhariu/

Në një hadith tjetër thuhet: *“... kush proteston kundër popullit tim, duke e goditur të mirin e të keqin, nuk përmbahet nga besimtarët dhe nuk e respekton marrëveshjen e atij që i është dhënë besë, ai nuk është me mua dhe unë nuk jam me të.”* /Transmeton Muslimi/

Prej hakut të njeriut të ngritur është që t'i jepet përparësi, ndërsa prej hakut të pasanikut është që umeti të ketë dobi prej tij. Mirëpo, duhet ditur se, njeriu, kushedi sa të jetë i ngritur dhe të ketë pasuri, nuk do t'i sjellë dobi vetes e as që do të ketë prej tij dobi umeti i vet nëse është i sëmurë nga dashuria e postit. Ai që kërkon udhëheqësi është i privuar nga ndihma e Zotit, e njeriu që privohet nga ndihma e Zotit është pesimist, edhe po të jetë gjeni. Për këtë, Islami e konfirmoi privimin e atyre që kërkojnë post nga pozitë që lakmojnë.

Transmetohet prej Ebu Musait, i cili thotë: *“Unë, bashkë me dy djem të xhaxhallarëve të mi, hymë te Pejgamberi [sal-*

[Allahu alejhi ve sel-lem]. Njëri prej tyre i tha: *“O Pejgamber i Allahut, na jep udhëheqësi mbi disa vende që t’i ka lënë në disponim Allahu.”* Edhe tjetri ia tha të njëjtën gjë. Pejgamberi atëherë u tha: *“Betohem në Zotin, nuk e emërojmë për këtë punë asnjë prej atyre që e kërkojnë, apo që janë këmbëngulës në të.”* /Transmeton Buhariu/

Është për t’u habitur se plasaritjet e turpshme, në të cilat pësuan shtyllat islame dhe populli i tij, filluan dhe u përsëritën, dhe ende vazhdojnë të fillojnë dhe të përsëriten, nga individët dhe familjet e sëmura nga dashuria për udhëheqësi.

Mutenebiu, më parë, i ka cilësuar me fjalët:

*Të parët e gjithë njerëzve janë nga ata,
Kurse të parët e muslimanëve janë të nënshtruarit e panjohu.r*

Andaj, le të ketë kujdes çdo musliman nga ky devijim, kudo që ta gjejë, dhe në unitetin e umetit të vet le ta vëjë një tullë.

ZGJEDHJA E SHOQËRISË

Shoqëria e veçantë ka ndikim të thellë në orientimin e ndjenjave dhe mendjes. E kjo, po ashtu, i ka rezultatet të rëndësishme, përkitazi me atë që përjeton e tërë shoqëria prej përparimit apo stagnimit, depresionit apo qetësisë.

Islami u kushtoi vëmendje këtyre lidhjeve, me njerëz që kanë ndikim te ty dhe ndikohen nga ti, si dhe i afrohen jetës tënde në mënyrë të rrezikshme për një afat më të gjatë.

Nëse këto lidhje fillojnë dhe zhvillohen me fisnikëri dhe sinqeritet, Allahu i pranon ato dhe do t'i bekojë, e nëse janë të lira dhe të ulëta, do t'ua refuzojë ato njerëzve përkatës: ***“Atë ditë shokët e ngushtë do të jenë armiq të njëri-tjetrit, përveç atyre që ishin të sinqertë në miqësi. (Atyre besimtarëve, që ishin shoqëruar për hir të Zotit, u thuhet): O adhuresit e Mi, sot nuk ka as frikë për ju, e as që do të jeni të pikëlluar!”*** (Ez-Zuhruf: 67-68)

Islami, siç e dimë, është fe e bashkimit dhe e afrimit, ndërsa ndjenja e njohjes me njerëzit dhe shoqërimi me ta është element thelbësor në mësimet e tij. Islami nuk bazohet në të huajësim, e as që i ka thirrur bijtë e vet në izolim të përgjithshëm dhe ikje nga ngarkesat e jetës; po ashtu, ai nuk e ka trasuar misionin e muslimanit në këtë tokë si tërheqje në dhomë apo adhurim në faltore. Assesi, assesi! Sepse gradat e larta Allahu i Madhërisëm nuk i ka përgatitur për tipin njerëzve të izoluar e të dobët. Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] thotë: ***“Besimtari i cili shoqërohet me njerëzit dhe bën durim në fyerjet e tyre, është më i dobishëm se besimtari i cili nuk shoqërohet me njerëzit dhe nuk bën durim në fyerjet e tyre.”*** /Transmeton Tirmidhiu/

Për kë janë paraparë xhematet? Për kë është bërë obligim xhumaja? Kush është ai që e bart barrën e xhihadit dhe ndihmon në krizat e tij të rënda? E gjithë kjo lyp një popull në të cilin në një masë të madhe janë përforcuar lidhjet e veçanta dhe të përgjithshme. Andaj, kur e pyetën disa herë Ibën Abbasin për një njeri i cili ditën agjëron e natën falet, mirëpo nuk është i pranishëm në xhemat dhe ditëve të xhumaja, ai u përgjigj: *“Lajmërojeni se është prej banorëve të zjarrit.”* /Transmeton Tirmidhiu/

Ngase Islami është shumë i interesuar që ritualet e tij madhështore të jenë vendtubim ku do të takohen muslimanët dhe do të bashkëpunojnë në kryerjen e tyre, si dhe të thithin prej ajrit të tyre të pastër ndjenjat e pastra të dashurisë dhe sinqeritetit të thellë. Dhe, sado që të shtohet numri që e rreshton muslimanin me vëllezërit e vet, atij aq edhe i shtohen mirësitë e Zotit.

Në hadith përmendet: *“...Namazi i njeriut me dikë tjetër është më i çiltër se namazi i tij në vetmi dhe namazi i tij me dy vetë është më i çiltër se namazi i tij vetëm me një, dhe sa më shumë që të ketë, kjo është më e dashur tek Allahu i Madhërishëm.”* /Transmeton Ahmedi/

Në një transmetim tjetër qëndron: *“Namazi i dy personave, kur njëri i bëhet imam tjetrit, është më i çiltër tek Allahu se namazi i katër vetëve ndaras. E namazi i katër vetëve është më i çiltër tek Allahu se namazi i tetë vetëve ndaras. E namazi i tetë vetëve, kur u prin imam njëri, është më i çiltër tek Allahu se namazi i njëqind vetëve të ndarë.”* /Transmeton Taberaniu/

Këto argumente nga Suneti tregojnë për dëshirën e madhe të Islamit në shtimin e numrit të muslimanëve, si dhe të pamurit e tyre grupe të stërshtuara e jo individ të ndarë.

Mirëpo, duhet ditur atë se çështja e izolimit dhe shoqërimit, dhe gjërat e tjera që pasojnë, si formimi i lidhjeve dhe i shoqërive, u nënshtrohen dispozitave të ndryshme.

Çdo izolim nga popullata, që e zhdruk xhihadin e urdhërimit në të mirë dhe ndalimit nga e keqja apo e dobëson anën e mbrojtjes së Islamit para armiqve të tij, është krim dhe nuk pranohet arsyetim nga njeriu i tillë.

E njerëzit, duhet ditur, kanë mentalitete të ndryshme. Disa prej tyre nxitojnë në tubimet madhështore dhe shumë shpejt vënë raporte me njerëz, e po ashtu janë të disponuar në afrimin e ftyrave dhe komunikim me të afërmin dhe të largtin; disa prej tyre i margjinalizojnë tubimet e mëdha, e kur rreth vetes bëjnë një mur, me vëmendje i shikojnë prej tij njerëzit dhe fshehen pas tij në rast të ndonjë sulmi.

Të dy mentalitetet Islami i udhëzoi në rrugën e tyre të drejtë. Të parit i thuhet: *“Shoqërohu me njerëzit, por fenë tënde mos e dëmto.”* Ndërkaq tjetrit i thuhet: *“Besimtari është i butë, i ndjeshëm, i dashur dhe i shoqërueshëm.”*

Mirëpo duhet ditur se Islami e obligoi distancimin nga trazirat. Kur turbullohet vendi dhe banorët e tij vrapojnë pas du-njasë, e zgjidhen nyjat e virtytit, bojkotimi i të keqes është një formë e mohimit të tij, por e gjithë kjo në korniza të shkallëve të ndryshimit, të cilat i miratoi Allahu i Madhërishëm për luftimin e së keqes, edhe atë: ndryshimi me fuqi (dorë), pastaj me fjalë, e pastaj me zemër.

Kjo do të thotë se distancimi nga e keqja nuk pranohet prej atij që ka mundësi ta ndryshojë atë me fjalë, e lëre më me fuqi, ndërkaq bojkotimi është një armë, që në këtë shekull u përdor me urtësi; këtë e eksperimentuan popujt e dobët me armikun e tyre tiran... E pozita e bojkotit, në mesin e armëve të tjera të luftës, është si pozita e distancimit ndaj mënyrave të shumta të konsolidimit, respektivisht, kjo është rrugëdalja e të paaftëve kur nuk gjejnë mënyrë tjetër jashtë largimit të tyre bashkë me besimin, ndërkaq në rast të ekzistimit të mënyrave të shumta, me të cilat mund të shuhen trazirat, distancimi, siç thamë, është krim i shëmtuar.

Në dritën e këtij sqarimi kuptohet fjala e Pejgamberit të Allahut, kur është pyetur: *“Cilët janë njerëzit më të mirë, o Pejgamber i Allahut?”* Ai u përgjigj: *“Një besimtar i cili lufton me veten e vet dhe pasurinë në rrugë të Allahut.”* I thanë: *“Pastaj kush?”* Ai tha: *“Një njeri i izoluar në një vend, dhe e adhuron Allahun.”* /Transmetojnë Buhariu dhe Muslimi/

Po ashtu, duhet theksuar se izolimi dhe shoqërimi nuk mund të jenë dy veti të përhershme të njeriut, andaj le ta ndajë muslimani kohën e vet ndërmjet mëvetësimit të dobishëm dhe

shoqërimin të mirë, me qëllim që të dy rastet t'i shfrytëzojë për ta konsoliduar tërë gjendjen e vet.

Dhe në këto baza i zgjedhim shokët, i dëshirojmë shoqëritë apo i largojmë. Kushti i parë i shoqërisë fisnike është pastrimi nga tendencat, sinqeriteti, lindja dhe rritja në rrugën e besimit dhe mirësisë, e kjo është domethënia e dashurisë për hir të Allahut.

Kur njeriu e rrënjos bindjen në zemrën e vet, e lumturia e besimit futet në zemrën e tij dhe e ndjen ëmbëlsinë e tij, të gjithë të gjallët i shikon në dritën e besimit të cilit i është përkushtuar. Ai dashuron për ideal, e jo për epsh, ai urren për ideal, e jo për privim.

Ndodh që të tubohen dy kope në një burim të ëmbël apo të turbullt; ndodh që njerëzit të takohen në interesa të kësaj bote përkohësisht apo vazhdimisht, e ndoshta në mes tyre mund të formohen lidhje të forta, edhe pse kjo formë e njohjes reciproke dhe e dashurisë së ndërsjellë nuk krahasohet me atë që formohet në mes njerëzve të shembujve të lartë prej dashurisë, pastërtisë, bashkëpunimit dhe sakrifikimit.

Për këtë, Islami i priti me mirëseardhje ndjenjat e shoqërisë së pastër dhe i nxiti besimtarët në pastrimin e tyre dhe sinqeritetin ndaj tyre. Dhe këtyre ndjenjave u dha shpërblime të bukura, të cilat i meriton njeriu i tillë. Pejgamberi i Allahut ka thënë: ***“Allahu i Lartësuar ka thënë:” Ata që duhen për hir të Madhërisë Sime, do të jenë nën hijen e Arshit Tim, atë ditë kur nuk do të ketë hije jashtë hijes Sime.***” /Transmeton Ahmedi/

Transmetohet prej Omer Ibën Hattabit, i cili thotë: “Pejgamberi i Allahut ka thënë: ***“Ka disa njerëz, të cilët nuk janë as pejgamberë e as dëshmorë, por në Ditën e Gjykimit do t’ua kenë lakmi pejgamberët dhe dëshmorët për pozitën e tyre te Zoti.”*** Shokët i thanë: ***“O Pejgamber i Allahut, na trego kush janë ata?”*** Ai u përgjigj: ***“Ata janë njerëzit të cilët janë dashur mes veti në emër të Zotit, pa patur lidhje fisnore mes vete, e pa pasur ndonjë interes material të përbashkët. Betohe në Allahun, fytyrat e tyre me të vërtetë janë dritë, ata janë mbi dritë, nuk frikohen kur frikohen njerëzit, e as që dëshpërohen kur dëshpërohen njerëzit.”*** Dhe e lexoi ajetin: ***“Ta keni të***

ditur se të dashurit e Allahut (evliatë) nuk kanë frikë (në botën tjetër) e as kurrfarë brengosje.” (Junus: 62) /Transmeton Ebu Davudi/

Por dashurinë për Zot nuk mund ta supozojë çdokush, e as që pranohet prej çdonjërit që e pretendon, ngase njeriu së pari duhet ta njohë Zotin e vet si duhet, pastaj ta shtojë këtë njohje, saqë të rëndojë ajo në shpirtin e tij çdo gjë tjetër, pastaj kjo njohje të ngrihet në dashurinë e vet Zotit dhe nxitjen e punëve për Të. Atëherë i besohet njeriut, se kur ka dashur dhe urreyer, ka dashur për hir të Zotit dhe ka urreyer për hir të Zotit.

Ndërkaq, mahnitja e njeriut pas aftësive të ndonjë njeriu të madh, apo pëlqimi dhe dashurimi i biografisë së dikujt tjetër, është një formë tjetër e shoqërisë, rreth të cilës nuk po flasim tash.

Pejgamberi i Allahut ka thënë: ***“Personi tek i cili gjenden tri gjëra, e ka gjetur ëmbëlsinë e besimit dhe shijen e tij: Që ta dojë Allahun dhe Pejgamberin e Tij më tepër se çdo send tjetër; të dojë për hir të Allahut dhe të urrejë për hir të Allahut, si dhe, më tepër të dojë të ndizet një zjarr i madh e të hyjë në të, sesa t’i bëjë shok Allahut.” /Transmeton Muslimi/***

Pasi dashuria për hir të Zotit është vula e periudhave para-prake në shkallët e besimit, po ashtu, edhe fryti i saj nuk është pjekur përveç se tek ata që i ka pjekur nxehtësia e sinqeritetit. Pejgamberi i Allahut ka thënë: ***“Dy njerëz të cilët e duan njëri-tjetrin për hir të Zotit, në mosprani të tyre, prej tyre më i dashur tek Allahu është ai i cili më së tepërmi e do shokun e vet.” /Transmeton Taberaniu/***

Të dy vëllezërit që e duan njëri-tjetrin janë në mbrojtjen e Allahut dhe nën mbikëqyrjen e Tij. Transmetohet prej Pejgamberit [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], e ky prej Allahut të Madhërishëm, i Cili i ka thënë: ***“Dashurinë Time e kanë merituar ata të cilët e duan njëri-tjetrin për hir Timin. Dashurinë Time e kanë merituar ata të cilët e vizitojnë njëri-tjetrin për hir Timin. Dashurinë Time e kanë merituar ata që sakrifiko-hen për Mua, dhe e kanë merituar dashurinë Time ata që shoqërohen për hir Timin.” /Transmetojnë Ahmedi dhe Taberaniu/***

Ndikimi i shokut te shoku i vet është i madh. Për këtë, njeriu duhet patjetër t'i zgjedhë vëllezërit e vet, ta sprovovë korrektësinë e tyre, me qëllim që të bindet në vlefshmërinë e tyre. Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] thotë: *“Njeriu është në fenë e shokut të vet; çdonjëri prej jush le të shikojë se cilin e shoqëron.”* /Transmeton Ebu Davudi/

Nëse janë burra, i ndihmojnë atij në kryerjen e obligimeve, në mosshkeljen e të drejtave, dhe e ndalojnë atë nga e keqja dhe bërja e haramit; ata, pra, janë shoqërues të mirë, me të cilët duhet të shoqërohet e të synojë në dashurinë e tyre. Përndryshe, le të jetë i kujdesshëm për tradhtinë e atyre që ia zbu-kurojnë rrugën e të keqes apo lëshohen me të në punë të kota e lojra.

Shoku i madh mund ta prijë shokun e vet në suksese në këtë botë dhe shpëtim në botën tjetër, ndërkaq shoku i marrë e manipulant është zemërim për shokun e vet. Sa e sa të pakujdesshëm janë penduar për këtë shoqërim të keq, sepse ai i vuri buzë gremenës dhe me të u fundosën në zjarrin e Xhehenemit.

Allahu i Madhërishëm thotë: *“Atë ditë zullumqari do t'i kafshojë duart e veta dhe do të thotë: I mjeri unë, ta kisha marrë rrugën e Pejgamberit! O shkatërrimi im, ah të mos e kisha bërë filanin mik! Në të vërtetë, pasi e gjeta rrugën e drejtë, ai më largoi mua prej asaj, e djalli është ai që njeriun e humb dhe e lë vetmuar.”* (El-Furkan: 27-29)

Natyra vjedh prej natyrës. Shumë shpejt njeriu mund të niset në drejtimin në të cilin e shpie shoku i vet; trysnia e ka ligjin e vet, i cili vlen për moralin, siç vlen për trupat, bile fryma e cila dominon në tubim, e burimi i saj mund të jetë prej një njeriu të fortë, i vërshton ata që i ka përreth me bujshmëri-në e asaj që shpërthen nga brendia e tij.

Është dëshmuar se trysnia e veprave të liga është më e lëvizshme dhe më e rrezikshme sesa trysnia e veprave të mira. Në shumë raste dëmi i duhanit transferohet prej atij që e pi cigaren në atë që nuk e pi, ndërkaq nuk ndodh e kundërta.

Nisur nga vlerësimi i këtyre gjurmëve dhe mbrojtja e karakterit të vyeshëm dhe traditave fisnike, Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] urdhëroi që të zgjidhet shoku. Për këtë tha: *“Shembulli i shoqëruesit të mirë është si shembulli i bartësit të*

miskut: nëse nuk arrin të marrësh prej tij, atëherë bile të arrin era e tij. Shembulli i shoqëruesit të keq është si shembulli i farkëtarit: nëse nuk ndytesth me katranin e tij, do të të arrijë tymi.” /Transmeton Ebu Davudi/

Nëse është kështu me shoqëruesin, që e takon në një takim kalimthi, në një kohë të shkurtë, atëherë çka mund të të themi ty për shokun e jetës, i cili të shoqëron në bollëk dhe skamje? Shoqëria e të mençurve të devotshëm mund ta arrijë kulminacionin, ndërkaq shoqëria e mendjelehtëve naiv është rrëshqitëse e shpejtë për në humnerë. Allahu i Madhërishtëm thotë: “... **Zullumqarët janë miq të njëri-tjetrit, kurse Allahu është mbrojtësi i besimtarëve të devotshëm. Ky (Kur'an) është dritë e dijes për njerëz, është udhëzues e mëshirë për një popull që beson bindshëm.**” (El-Xhathije: 19-20)

Shoqëria duhet të bazohet në fuqinë e bindjeve dhe lartësinë e veprave. Njerëzit më të mirë, me të cilët njeriu e mban shoqërinë dhe e ruan për këtë botë dhe botën tjetër dashurinë e tyre, janë ata në të cilët aludon transmetimi: “*Kush bashkëpunon me njerëzit dhe nuk u bën padrejtësi; flet me ta, dhe nuk i rren; u premtan, dhe nuk i mashtron; ai është prej atyre që e kanë përkryer njerëzinë dhe e kanë treguar drejtësinë, dhe imponohet vëllazëria e tij.*”

Nëse formohet shoqëria në emër të Zotit, ajo nuk mund të ekzistojë ndryshe, vetëm se me nënshttrimin e plotë ndaj Tij; si dhe, nuk do të jetë e ndershme, vetëm se me largimin e të dy shokëve, bashkërisht, nga hipokrizia dhe plangprishësia. E nëse depërton mëkati në veprimet e ndonjërit prej tyre apo të të dyve, zemrat ndryshohen dhe dashuria shuhet. Në hadith përmendet: “*Pasha Atë, në dorë të të Cilit është shpirti im, saherë që dy vetë e duan njëri-tjetrin, e pastaj ndahen, kjo ndodh për shkak të mëkatit të cilin e bën ndonjëri prej tyre.*”

Mu për këtë shkak, shokët e Pejgamberit [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] porositjen e njëri-tjetrit për të vërtetën dhe bashkëpunimin në mirësi e bënë mur për mbrojtjen e dashurisë ekzistuese në mes tyre, si dhe do t'i afrojë te falja e Zotit dhe kënaqësia e Tij.

Transmetohet prej Ebu Kalabes, i cili thotë: “Dy njerëz u takuan në treg, dhe njëri prej tyre i tha tjetrit: “*Eja të kërkoj-*

më falje prej Allahut gjatë moskujdesit të njerëzve.” Dhe ashtu vepruan. Njëri prej tyre vdiq, kurse tjetri e pa në ëndërr, duke l thënë: *“E more vesh se Allahu na i fali mëkatet atë natë kur u takuam në treg?”* /Transmeton Ibën Ebi Dunja/

Transmetohet prej Enes Ibën Malikut, i cili thotë: “Abdullah Ibën Revaha, kur e takonte ndonjërin prej shokëve të Pejgamberit, i thonte: *“Eja ta përmendim Zotin disa çaste.”* Një ditë, ia tha të njëjtën fjalë një njeriu, e ai u hidhërua dhe erdhi te Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] dhe i tha: *“A nuk e sheh çka bën Ibën Revaha? Ai largohet nga shoqërimi yt, në përmendje (shoqërim) tjetër, disa çaste?”* Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] tha: *“Allahu e mëshiroftë Ibën Revahën, ai i do tubimet me të cilët mburren melekët.”* /Transmetojnë Ahmedi dhe Taberaniu/

Shokët duhet të njihen në mes vete, me qëllim që shoqëria e tyre të jetë me vetëdije, si dhe t’ia përmendin njëri-tjetrit respektin dhe dashurinë që kanë për të. Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] thotë: *“Nëse dikush prej jush e do vëllain e vet, le ta lajmërojë se e do.”* /Transmeton Ahmedi/

Transmetohet prej Enesit, se një njeri ishte te Pejgamberi i Allahut, kur kaloi një tjetër andej pari, dhe tha: *“O Pejgamber i Allahut, unë e dua këtë njeri.”* Ai i tha: *“A e ke lajmëruar?”* Ai u përgjigj: *“Jo.”* Pejgamberi i tha: *“Atëherë lajmëroje.”* Ai shkoi, e arriti dhe i tha: *“Dije se unë të dua për hir të Zotit.”* Ai ia ktheu: *“Të dashtë Ai, për hir të të Cilit ti më do mua.”* /Transmeton Ebu Davudi/

Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] thotë: *“Kur një njeri shoqërohet me një njeri tjetër, le ta pyesë për emrin e tij, emrin e babait të tij dhe fisin e tij, sepse kjo është më afëruese për dashurinë.”* /Transmeton Tirmidhiu/

Nuk ka dyshim se temperamentet dhe të menduarit e ngjashëm kanë ndikim të madh në formimin e shoqërive dhe forcimin e lidhjeve. E është thënë: *“Ndoshta ti mund të kesh një vëlla, të cilin nuk ta ka lindur nëna.”* Njeriu, në dinamikën e jetës, mund të takohet me atë që ka sens për t’iu përgjigjur menjëherë e t’i bashkangjitet, dhe atëherë sikur e njeh atë që para shumë viteve. Kjo është në harmoni me hadithin: *“Shpirt-*

rat janë ushtri të mobilizuara, ato që njihen mes vete bashkohen, e ato që injorohen ndahen.” /Transmeton Buhariu/

Mirëpo, këtë ndjenjë duhet ta kontrollojë fuqia e besimit dhe sistemi i tij. Kjo është fuqi vitale e besimtarit në të gjitha orientimet e zemrës së tij; kështu, e bën ta dojë për hir të Zotit atë, të cilit nuk ia ka parë fytyrën asnjëherë, për shkak të largësisë territoriale apo paraprirjes në kohë. Po ashtu, i urren ata me të cilët nuk ka qenë bashkë asnjëherë, jo për diçka tjetër, po për atë se ai i don të zgjedhurit dhe i urren të ligët, e orientimet e zemrës në këtë mënyrë të sinqertë, e ngrejnë njeriun përkatës në grada mbi pozitën e vet.

Transmetohet prej Ebu Dherrit, i cili thotë: I thashë: *“O Pejgamber i Allahut, një njeri i do disa njerëz, por nuk mund t’i bëjë punët e tyre.”* Pejgamberi ia ktheu: *“Ti, o Ebu Dherr, je me ata që i do.”*

Prej rregullave të shoqërimit në Islam është që, vizita e ndërsjellë duhet të jetë e pastër nga çdo prapavijë, e sinqertë, për hir të Zotit.

Transmetohet prej Ebu Hurejres [radijAllahu anhu], e ky prej Pejgamberit [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem], se ka thënë: *“Një njeri e vizitoi një vëlla të vetin në një fshat, e Allahu e dërgoi të qëndrojë në rrugën e tij një melek. Dhe kur erdhi, i tha: “Ku je nisur?” Ai tha: “Jam nisur te një vëlla imi në këtë fshat.” Meleku i tha: “A ke te ai ndonjë interes që e synon?” Ai u përgjigj: “Jo, por unë vetëm se e desha për hir të Zotit...” Meleku i tha: “Mua më dërgoi te ti Allahu që të tregoj se Ai ty të do, ashtu siç e deshe ti atë për hir të Zotit.”* /Transmeton Buhariu/

Këto hapa njëmend janë të shtrenjta; ato janë si hapat e muxhahidëve në rrugë të Zotit, të cilat shpërblehen me mirësitë më të shkëlqyeshme.

Pejgamberi i Allahut ka thënë: *“Kush e viziton një të sëmurë, apo e viziton një vëlla të vet, për hir të Zotit, një thirrës e thërret: “Lum për ty, lum për udhëtimin tënd, dhe t’i i ke përgatitur vetes një vend në Xhenet.”* /Transmeton Ebu Davudi/

Po ashtu, thotë: “Çdo njeri që shkon ta vizitojë vëllain e vet për hir të Zotit, e thërret një thirrës prej qielli: “Lum për ty, dhe lum për Xhenetin që fitove.” Ose Allahu në mbretërinë e Arshit të Vet thotë: “**Robi im vizitoi për hir Timin, dhe Unë e marr përsipër gostitjen e tij**”, e nuk i dhuron atij shpërblim tjetër përveç Xhenetit.” /Transmeton Muslimi/

E muslimani, edhe pse të gjithë njerëzve ua do të mirën, edhe më tepër e do të mirën për shokët e vet dhe edhe më tepër gëzohet për të mirat që i arrijnë ata, nuk ka problem që, nëse gjen mirësi, t’i shoqërojë në të edhe vëllezërit e vet: “**... e mos e harroni bamirësinë ndërmjet jush. Vërtet Allahu sheh atë që veproni.**” (El-Bekare: 237)

Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] e pëlqeu dhurimin reciprok të dhuratave në mes shokëve dhe tha: “**Jepni dhurata njëri-tjetrit, sepse dhurata i mënjanon cytjet e krahërorit.**” /Transmeton Tirmidhiu/

Transmetohet prej Aishes [radijAllahu anha], e cila thotë: “**Pejgamberi i pranonte dhuratat dhe shpërblente për ato.**” /Transmeton Bezzari/

Mirëpo, duhet ditur se kur e nxjerr këtë etikë të lartë, stërngarkimi i tepërt me të, prej kufijve të tij, bëhet i urryer, sepse Islami e lufton shtirjen, por e favorizon modestinë, e me çdo metodë e cila ngërthen telashe dhe lajkatime Islami nuk ka të përbashkët kurrgjë, por Islami synon që t’i japë shoqërisë ngjyra të mirësjelljes, e cila ka imazh të bukur, pasi të bindet në shëndoshmërinë e esencës, si dhe ta bëjë atë mjet për lehtësimin e jetës dhe lehtësimin e vështirësive të saj: “**Shokët më të mirë tek Allahu janë ata që janë më të mirë mes vete; dhe fqinjtë më të mirë te Allahu janë ata që janë më të mirë për fqinjin e vet.**” /Transmeton Hakimi/

Islami ia ka lejuar njeriut që të hajë prej ushqimit të shokut të vet, siç ha prej ushqimit të prindërve, vëllezërve dhe të afërmve të vet: “**... të hani nga shtëpitë tua, ose nga shtëpitë e etërve tuaj, shtëpitë e nënave tua, në shtëpitë e vëllezërve e të motrave tua...**” deri sa tha: “**... ose të atyre që u janë besuar çelësat e tyre, ose (në shtëpitë) e miqve tuaj...**” (En-Nur: 61)

E kjo nuk duhet të habitë, sepse lidhja shoqërore është me vlerë të lartë, ndikim të madh, e bile ajo është shkak i ndihmës në krizat e rënda. Edhe pse këto kriza janë shpëtim prej dënimit të ferrit!

Allahu i Madhërishëm, në përshkrimin e gjendjes së idhujtarëve kur do t'i ngushtojë dënimi, thotë: ***“Pasha Allahun, njëmend ne kemi qenë krejtësisht të humbur. Kur juve (idhuj) u kemi barazuar me Zotin e botëve. Neve nuk na humbi kush tjetër vetëm se kriminelët (prijësit). E tash për ne nuk ka ndonjë ndihmës (ndërmjetësues). Nuk ka as ndonjë mik të sinqertë.”*** (Esh-Shuara: 97-101)

Mirëpo, duke i pasur parasysh obligimet e mëdha që lidhen me këto shoqëri, Pejgamberi i Allahut thotë: ***“Shoqëro vetëm besimtar, dhe ushqimin tënd le ta hajë vetëm i devotshmi.”***
/Transmeton Ebu Davudi/

Dhe, thashë: Vëlla!

Ata thanë: Vëlla nga gjaku?

U thashë atyre: Sojet janë farefisni.

Shoku im është në përkrahjen time, përqendrimin tim dhe drejtimin tim.

Edhe nëse jemi të largët në origjinë.

KRENARIA

Lartmadhëria ndaj njerëzve është veti e Zotit të njerëzve, i Cili ka krijuar dhe formësuar çdo gjë, i Cili ka gjykuar dhe udhëzuar, i Cili kur të godet, të nënshton dhe kur tregohet, dritave të shkëlqesisë së Tij i mahniten mendjet njerëzore: ***“Pra, falënderimi i qoftë vetëm Allahut, Zotit të qiejve, Zotit të tokës, Zotit të gjithësisë! Vetëm Atij i takon lartëmadhëria në qiej e në tokë dhe Ai është ngadhënjyesi, më i urti.”*** (El-Xhathije: 36-37)

Nënshtimi i njerëzve ndaj Zotit të tyre është nënshtim ndaj të vërtetës e jo nënshtim ndaj gënjeshtres, sepse krijimi, caktimi, pasuria dhe pushteti i takojnë vetëm Atij. Epilogu i njerëzve është nën vullnetin e Tij dhe i është nënshtuar dëshirës së Tij. Ata janë në situatë më të ndershme, atëherë kur balli i tyre i nënshtrohet Zotit të madh në sexhden (përkuljen) e gjatë të kërrusur. Atëherë do ta njohim gjendjen e tyre dhe do të qëndrojnë në kufijt e tyre, si dhe do t’ia japin Krijuesit të madh hakun e Vet, në të cilin nuk ka dyshim dhe nuk ka armiqësi në miratimin e tij.

Ndërkaq, nënshtimi i njeriut para një njeriu të njëjtë si ai, është, pa dyshim, krim. Kryelarti, në këtë rast, është shumë i lëshuar dhe plangprishës, e imagjinon për vete atë që nuk e meriton. I nënshtuari servil është injorant ndaj vlerës së tij, ngarkohet me barra të cilat nuk mund t’i mbajë. Islami e ndaloi kryelartësinë dhe nënshtimin dhe e obligoi krenarinë.

Pejgamberi [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] thotë: ***“Cili ka në zemër edhe sa një grimcë të kryelartësisë, Allahu do ta gjuajë në zjarr.”*** /Transmeton Ahmed/

“Derisa një njeri ecën në baltinë, mahnitet me vetveten, kokëngritur, mendjemadh në ecje, kur atë e fundos Allahu, dhe

ai do të fundoset në tokë deri në Ditën e Gjykimit.” /Transmeton Buhariu/

Ngase krenaria është cilësi e Zotit, kurse njerëzit nuk duhet ta përvetësojnë cilësinë të cilën e meriton vetëm Zoti, sepse mendjemadhësia te njerëzit është sinonim i disa vetive të ulëta, në krye të të cilave qëndron mohimi i të vërtetës dhe injoranca e aktualitetit, sjellja e keqe ndaj njerëzve, kalimi i normave, nënçmimi i virtyteve, e kështu me radhë.

Islami ia ndalon muslimanit të plogështohet, nënshtrohet, apo të ndjehet i dobët, dhe e hodhi në zemrën e tij shqetësimin e mosdisponimin për çdo situatë, i cili e lëndon prestigjin e tij dhe e ul pozitën e tij.

Transmetohet prej Enes Ibën Malikut, se Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] ka thënë: *“Kush dëshpërohet për këtë botë, ai zemërohet në Zotin. Cili ankohet për një fatkeqësi e cila e ka goditur, ai ankohet për Allahun e Lartësuar. Kush për-kulet para një pasaniku që ta arrijë atë që posedon ai, e ka hidhëruar Allahun dhe kujt i jepet Kur’ani dhe hyn në Xhehenem, atë e largon Allahu.” /Transmeton Taberaniu/*

Në një transmetim tjetër thuhet: *“Kush ulet pranë një pasaniku dhe i nënshtrohet atij për hir të ndonjë interesi material që e synon, atij i shkojnë dy të tretat e fesë dhe hyn në Xhehenem.”*

Ky hadith e dënon përrulësinë e cila tregohet nga disa njerëz kur i kapin kriza të ndryshme, ashtu që vajtojnë për intereset që u kanë kaluar, u bërtasin me zë të lartë njerëzve duke kërkuar ndihmë, si dhe rrokullisen në truallin e pasanikëve duke pritur një sasi që do t’ua japin atyre, apo do huazojnë prej tyre.

Vuajtja nga skamja nuk është nënshttrim, mirëpo shndërrimi i skamjes në poshtërim, kjo është ajo që e urren Islami. Që prej kohëve më të lashta, zakoni i burrërisë ka qenë që i plagosuri të qëndrojë në këmbë të veta derisa të shërohet dhe ta vazhdojë marshin me vendosmëri, e jo të plogështohet, pastaj të shndërrohet në parazit, e pastaj t’i presë bartësit. Në kuptim të hadithit në fjalë janë edhe vargjet e poetit:

*Unë nuk kam nevojë për atë që është i paturpshëm pasaniku,
Lehtësinë time ia ekspozoj atij që kërkon huazim.
Ndonjëherë tregohem i shtrënguar, e me këtë keqësohet
skamja edhe më tepër,
E arrij lehtësimin e pasanikut duke e patur nderin.
Këtë nuk e arriti askush me huazim apo caktim,
Derisa u pa dhe u tregua besnikëria tek unë.*

Me këtë ka për qëllim që vazhdimisht të përmbahet me të,
derisa të largohet vështirësia që e ka, pa iu nënshtuar askujt,
edhe po të jetë vëlla i besueshëm!

Në hadith përmendet: *“Kush e poshtëron veten me vullnet
e pa shtypje, ai nuk është prej nesh.”*

Islami e lë besimtarin të sigurtë, në vendin në të cilin mbin
krenaria, dhe ia dhuron lirinë e plotë, ndërkaq, besimtari duhet
t’i realizojë këto kuptime në ambientin e tij. E nëse kjo është e
pamundshme për t’u realizuar atje ku është, atëherë le të tran-
sferohet prej vendit që e poshtëron dhe le ta ndërtojë prestigjin
e vet kudo qoftë. Për këtë, Allahu i Madhërishëm thotë: **“En-
gjëjt që ua morën shpirtin e atyre që ishin mizorë të
vetvetes, ju thanë: Në çka ishit ju? - Ata thanë: Ne ishim të
paaftë në atë tokë! (engjëjt) U thanë: A nuk ishte e gjerë
toka e Allahut, e të migronit në të? (e të praktikoni lirisht
fenë e Zotit). Vendi i tyre është Xhehenemi dhe sa vend i keq
është ai!”** (En-Nisa: 97)

Allahu i Madhërishëm i arsyetoi të paaftit prej burrave, të
cilët nuk kanë fuqi të transferohen dhe nuk gjejnë mjet për
shpëtim, e këtyre ua bashkangjiti gratë dhe fëmijët, dhe tha:
**“Përveç atyre që ishin të paaftë nga burrat, gratë e fëmijët,
që nuk kishin mundësi të gjenin, as mënyrë, as rrugë (për
shpërngulje). Atyre do t’iu falë Allahu. Allahu është që shlyen
e falë shumë (gabime).”** (En-Nisa: 98-99) Ky kontekst jep të
kuptohet se Islami e urren dobësinë dhe njëkohësisht i ngre as-
piratat, me qëllim që ta japin tërë mundin e tyre që të shpë-
tojnë prej degradimit.

Mburrja e muslimanit me veten, fenë dhe Zotin, është krenaria e besimit të tij, ndërkaq krenaria e besimit dallon nga krenaria e mendjemadhësisë; kjo krenari është refuzimi i besimtarit që të përulet para ndonjë force, të poshtërohet në një vend apo të jetë barrë për njeriun. Kjo është krenari në të cilën ka protestë aq sa ka edhe qetësi; në të ka lartësim aq sa ka edhe përultësi; në të ka ngritje mbi bukuritë tërheqëse të kësaj bote, paragjykimet e njerëzve dhe gënjeshttrat e jetës; po ashtu, në të ka lëshim në shërbimin e muslimanëve dhe modesti ndaj tyre, si dhe respektim i të drejtës, e cila e bashkon me ata; në të punët nisen kah e mbara dhe kërkohet madhështia nga rrugë më të ndershme.

“Kush e dëshiron krenarinë, (le ta dijë) e tërë krenaria i takon Allahut (pra le ta kërkojë prej Tij), te Ai ngritet fjala e mirë (besimi) dhe veprimi i mirë, e Ai i pranon. E ata që përgatitin dredhira të këqija, për ata është një dënim i rëndë dhe dredhia e tyre është e zhdukur.” (Fatir: 10)

Krenaria, mburrja dhe prestigji janë prej vetive më të shquara në të cilat thirri Islami, të cilat i mbolli në fushat e shoqërisë dhe u zotua për zhvillimin e tyre me doktrinat që i miratoi dhe instruksionet që i ka paraparë. Në këtë aludon Omer Ibën Hattabi me fjalën e vet: *“Dëshiroj prej njeriut, që padrej-tësisë t’i thotë me gojë plot: Jo.”*

Për çka ushton muezini pesë herë në ditë, duke ftuar në madhërimin e Zotit Një, në fillim dhe mbarim të ezanit? Dhe pse përsëritet ky madhërim dhe i ngërthen tërë veprimet e namazit, prej qëndrimit në këmbë te qëndrimi ulur?

Kjo me qëllim të bindjes së fortë të muslimanit, bindje e cila nuk luhatet dhe nuk devijohet, se çdo i madhëruar, përveç Allahut, është i vogël, si dhe çdo një që tentohet të tregohet madhështor, përveç Allahut, ai është i degraduar; sikur kjo thirrje është obliguar që t’i kthejë njerëzit në të vërtetën saherë që i bën të dështojë kjo botë dhe i devijojnë kotësitë e saj të fshehta.

Në favor të konfirmimit të këtyre kuptimeve, Allahu i Madhërishëm i zgjodhi dy emrat, ***El-Adhim*** - i Madhi, dhe ***El-E’la*** - më i Larti, prej emrave të Tij të bukur, që t’i përsërisë muslimani gjatë rukusë dhe sexhdes së tij; kështu shpirti i tij

mbushet me njëshmërinë e Zotit të botëve, me madhërim dhe lartësim...

Krenaria është e drejtë e cila ka përballë një obligim, sepse nuk i takon një njeriu t'i kërkojë të drejtat e veta para se t'i kryejë obligimet që ka. Kështu, nëse angazhohesh me një detyrë, dhe e kryen si duhet, asnjë nuk mund të të kritikojë, dhe asnjë, me pozitë mbi ty apo nën ty, nuk do të thotë ndonjë fjalë të ligë, e ti mund ta mbrosh krenarinë tënde para udhëheqësve të tu, kur i zën plasaritjet përmes të cilave depërtojnë kritikën dhe qortimet që të drejtohen ty. Dhe dije se atëherë edhe armiku yt më i përjetuar do të ketë frikë prej teje. Allahu i Madhërishëm thotë: ***“Atyre që bëjnë vepra të mira, u takon e mira (Xheneti) e edhe më tepër (e shohin Allahun). Fytyrat e tyre nuk i mbulon pluhuri i zi as nënçmimi, ata janë banues të Xhenetit, aty janë përgjithmonë. E ata që bënë të këqija, dënimi i së keqes është aq sa është ajo, ata i mbulon poshtërimi. Ata nuk mund t'i mbrojnë kush nga Allahu, fytyrat e tyre, porsì t'i kishte mbuluar ndonjë copë e errët e natës. Ata janë banues të përjetshëm të zjarrit.”*** (Junus: 26-27)

Bërja e mëkateve është mënyrë e rënies dhe e poshtërimit, si dhe tatëpjetë për turpërimin e individit dhe bashkësisë. Allahu i Madhërishëm e sqaroi se disfata në Uhud që si shkak i disa gabimeve që i bënë disa.

“Vërtetë, ata që u zmbapën prej jush ditën e ndeshjes së dy grupeve (besimtarë dhe idhujtarë në Uhud), ata vetëm djalli i shtyri të rrëshqasin me disa punë të tyre që i bënë, po Allahu ua fali atyre gabimin; Allahu është mëkatfalës dhe i butë.” (Ali Imran: 155)

Pra, Islami, kur e porositi muslimanin për krenari, e udhëzoi edhe në shkaqet e tij, ia lehtësoi rrugët e tij, si dhe ia bëri të qartë se prestigji është në devotshmëri, lartësia është në adhurim, dhe se krenaria është në nënshtrueshmërinë ndaj Allahut. Andaj, besimtari që e di këtë dhe vepron sipas kësaj, duhet ta marrë hisen e vet të plotë e të pacunguar në jetën e lartë e autoritative. Ngase, nëse atij i vërsulet dikush, apo e ka për cak ndonjë armik, mbrojtja e vetëvetes për të është xhihad në rrugë të Zotit; po ashtu, kjo nuk është vetëm mbrojtje e të drejtës personale, por edhe miratim i të drejtave të përgjith-

shme dhe shembujve të lartë. Nisur nga kjo, vdekja e muslimanit duke e mbrojtur të drejtën e vet është shëhidllëk.

Erdhi një njeri te Pejgamberi i Allahut dhe i tha: *“O Pejgamber i Allahut, çka të bëj nëse vjen një njeri dhe dëshiron të grabisë pasurinë time?”* Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] tha: *“Mos ia jep pasurinë tënde!”* Pyetësi përsëri iu drejtua: *“E çka të bëj nëse më lufton?”* Pejgamberi i tha: *“Luftoje edhe ti!”* Ai përsëri i tha: *“Ç’bëhet nëse më vret?”* Pejgamberi i tha: *“Ti je atëherë shëhid!”* Ai përsëri pyeti: *“Ç’bëhet nëse unë e vras atë?”* Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] i tha: *“Ai është në zjarr.”* /Transmeton Muslimi/

Po, prej krenarisë së besimtarit është që mos t’i japë rast asnjërit që tenton t’i bëjë diçka, ta realizojë atë, apo të bëhet cak i çdo sulmuesi; por, ai duhet të luftojë me këmbëngulësi në mbrojtjen e vetes, nderit, pasurisë dhe familjes. Edhe nëse derdhen për këtë qëllim gjaqet, kjo është e lirë kur bëhet fjalë për mbrojtjen e nderit të lartë.

Allahu i Madhërishëm e miratoi hakmarrjen ndaj tiranit, me qëllim të mbështetjes së anës së të shtypurit dhe mposhtjes së anës së kacafytësit, kështuqë e lidhi muslimanin me të drejtat e veta dhe me to e mobilizoi atë, e, po ashtu, e stimuloi që të jetë këmbëngulës në këto të drejta dhe të mos lëshojë pe në to, por vetëm si falës fisnik apo nga zemërgjërësia, e cila ia shton krenarinë edhe më tepër.

Një herë ia kumtoi atij mësimet e besimit dhe parimet e përsosurisë dhe e përqendroi atë në rrugën e mirësisë dhe prestigjit, me fjalët: *“... e ajo që është tek Allahu, është shumë më e mirë dhe e përjetshme, por për ata që besuan, dhe që vetëm Zotit të tyre i mbështeten. Dhe ata që u shmangën mëkateve të mëdha e të shëmtuara, dhe kur hidhërohen, ata falin. Edhe ata që i përgjigjen thirrjes së Zotit të tyre dhe e falin namazin rregullisht, dhe ata që konsultohen mes vete për punë të përbashkëta, e nga ajo që Ne ua japim ata e shpërndajnë.”* (Esh-Shura: 36-38)

Pas këtyre instruksioneve, të cilat ua mundësojnë njerëzve adekuat krenarinë e plotë si individ dhe bashkësi, Allahu i Madhërishëm thotë: *“Edhe ata që kur i godet e padrejta, i kundërvihen. Ndëshkimi i të keqes bëhet me një të keqe në*

të njëjtën masë, e kush fal e bën pajtim, shpërblimi i tij është tek Allahu. Vërtet, Ai nuk i do zullumqarët.” (Esh-Shura: 39-40)

Prej natyrës së muslimanit është që të falë kur e hidhëron ndonjë që është nën atë, e po ashtu, prej natyrës së tij është, që t'i disiplinojë ata që e sulmojnë, ashtu që ta thyejë tehun e tyre dhe ta mposhtë vrullin e tyre. Ai, në këtë rast është i obli-guar ta tregojë fuqinë e tij, me qëllim që t'i trembë kriminelët, e, po ashtu, derisa ai është në këtë pozitë të lartë, ka të drejtë edhe të falë sepse falja e të fuqishmit, pasi të mënjanoen simptomat e dobësisë, është një formë tjetër e edukimit të kriminelëve dhe prestigjit të besimtarëve. Kështu, natyra e aje-teve të fundit ndryshon nga natyra e ajeteve të para.

Ajetet e para kanë për qëllim faljen e lëshimeve të të kë-qinjve: “... **dhe kur hidhërohen, ata falin.**” (Esh-Shura: 37)

Ndërkaq ajetet e tjera e denoncojnë kriminelin në gjyq, ku për të miratohet ndëshkim dhe koka e tij i nënshtrohet shpatës së normës ligjore përkatëse. Në rast të thyerjes së forcës së tij dhe fshehjes së guximit të tij, vjen mirësia pas zgjatjes së drejtësisë. Kjo do të jetë shtypje edhe më e madhe për të fshe-hurit dhe lartësim edhe më i madh i krenarisë së muslimanit.

Pasi në shpirtin e njeriut ka një dozë dobësie apo pesi-mizmi, kjo ndoshta mund ta shtyjë t'i nënshtrohet atij që ka faj, të vendosë për çështjet e tij dhe t'i plotësojë kërkesat e tij. E, me këtë, mund edhe të rrëshqasë në pozita, që bien ndesh me prestigjin. Mu për këtë, Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] na ka mësuar që të mos qetësohemi në këto çështje, por të qëndrojmë kokëlartë duke marshuar drejt asaj që synojmë, dhe tha: “**Kërkoni nevojat tuaja me krenarinë e shpir-it, sepse sendet rrjedhin sipas caktimeve.**”

Po ashtu, na ka sqaruar se njerëzit, edhe sikur të ishin tu-buar të gjithë, janë të pafuqishëm që ta ndalin një gjë që e ka caktuar Zoti, si dhe janë të pamundshëm të japin një gjë që e ka ndaluar Zoti, andaj, muslimani duhet ta kthejë epilogun e sendeve te caktuesi i tyre më i Madh, të mbështetet tek Ai dhe prej Tij të varet.

Le ta madhërojë fenë e vetë dhe le të mos nënshtrohet me të, le ta zotërojë veten e vet, e mos t'i japë rast një të marri

që të lartësohet e tregohet mendjemadh, sepse, asnjë vendim nuk mund të realizohet, pa e realizuar këtë Allahu. Allahu i Madhërishëm thotë: ***“Atë që Allahu ua dhuron njerëzve nga mëshira e Tij, nuk ka kush që mund ta pengojë, e atë që Ai e ndal, nuk ka kush që mund ta lirojë pos Tij; Ai është Ngadh-njyesi, i Gjithdijshmi.”*** (Fatir: 2)

Fuqia e pushtetit, të cilën Allahu i Madhërishëm ua dhuron disa njerëzve, nuk ndryshon as një milimetër në vullnetin e Sunduesit Absolut mbi njerëzit. Ne shumë herë mendojmë se jemi të mundur në çështjen tonë, mirëpo kjo ndjenjë është abstrakte për Zotin, të Cilin asgjë nuk mundet ta ndalojë: ***“... Allahu është Mbizotërues i punës së Vet, por shumica e njerëzve nuk e dinë (fshehtësinë e çështjeve).”*** (Jusuf: 21)

Më afër të vërtetës dhe dobisë, dhe më e përshtatshme për shërimin e problemeve, është që muslimani të qëndrojë i pa-thyeshëm dhe plot elan, mos të arrijnë ta përuhin brengat e as ta mposhtin vështirësitë, t'i drejtohet Zotit të vet me lutje, dhe vetëm Zotit t'ia shprehë nënshtrimin e vet; ai faqet e tij nuk ua hap krijesave, edhe atë duke e kuptuar Fjalën e Allahut drejtuar atij: ***“Nëse Allahu të provon me ndonjë të keqe, atë s'mund ta largojë kush pos Tij, po nëse dëshiron të japë ndonjë të mirë, s'ka kush që mund ta pengojë dhuntinë e Tij. E shpërblen me të, atë që do nga robët e Tij. Ai fal dhe mëshiron shumë.”*** (Junus: 107)

E ti e pe se si i mësoi Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] shokët e vet, që mos të jenë të varur dhe t'u mjaftojë ajo që kanë; po ashtu ai i ndaloi njerëzit që t'u lypin diçka të tjerëve, bile edhe një imtësi e cila nuk bën dëm, “kështu, ata zbritnin prej deveve të veta me qëllim që të merrnin thuprat, e assesi nuk pranonin që dikush t'ua jepte mbi deve.”

Njerëzit e ulin veten, dhe pranojnë nënçmim në fenë e tyre, qysh në këtë botë, për njërën prej dy çështjeve: prej goditjes në furnizim, apo në jetën e tyre. Është për t'u habitur se pse bëhet kjo, kur Allahu e ka eliminuar fuqinë e njerëzve mbi furnizimin dhe vdekjen, dhe askush nuk mund të përzihet në këto gjëra. Ndërkaq, njerëzit në fakt i nënçmon një iluzion, i cili lindet nga shpirtrat e sëmurë, nga lakmia pas jetës dhe frika nga kafshata e gojës. E, njerëzit, nga frika e nënçmimit nën-

çmohen dhe nga frika e skamjes janë në skamje, edhe pse Islami e ka ndërtuar esencën e Njëshmërisë mbi lidhjen me Zotin e Madhërisëm.

“Kush është ajo ushtri juaja që do t’ju ndihmojë, pos Mëshiruesit? Është e vërtetë se jobesimtarët gjenden në një mashtrim të madh. Kush është ai që ju ushqen, po qe se Ai ua ndërpret furnizimin e vet? Jo, askush, por ata vazhdojnë me arrogancë e kundërvënie.” (El-Mulk: 20-21)

Ibën Kajjimi, në lutjen e tij drejtuar Zotit, thotë:

O Ti, në të Cilin mbështetem për atë që e synoj!

Dhe nga i Cili kërkoj mbrojtje për atë që kam frikë.

Njerëzit nuk mund ta rregullojnë një kockë që Ti e ke thyer.

E as që mundin ta thyejnë një kockë që Ti e ke rregulluar.

I tillë, pra, është besimi i përkryer islam, dhe kjo është ajo me të cilën duhet të shërohen të dobëtit e ngratë, të cilët e humbin nderin e tyre duke u endur nëpër dyer, duke iu ngjitur njerëzve pas dhe duke u përlur para pragjeve.

Islami dëshiron t’i shkulë faktorët e pesimizmit nga shpirtat dhe ta largojë prej tyre ngushtinë, ashtu që të mund të marrin frymë lirisht. Për këtë, Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] thotë: ***“Furnizimi e kërkon njeriun, ashtu siç e kërkon atë edhe vdekja e tij.”*** /Transmeton Taberaniu/

Ai këtë e thotë jo që t’i ndalë njerëzit nga puna e domosdoshme, sepse ky është botëkuptimi i injorantëve, por ai këtë e thotë me qëllim që njerëzit të merren me punë të ndershme, si dhe të ndalen nga lypja e shëmtuar dhe miklimi i turpshëm, dhe mu kjo është sekreti i betimit: ***“E në qiell është furnizimi juaj dhe ajo që ju premtohet. Pasha Zotin e qiellit e të tokës, kjo është një e vërtetë ashtu siç është e vërtetë se ju flisni.”*** (Edh-Dharijat: 22-23)

Transmetohet prej Ibën Mes’udit, se Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] ka thënë: ***“Çdo punë e cila ju afron kah Xheneti, ju kam urdhëruar për të, dhe çdo punë e cila ju afron kah zjarri, ju kam ndaluar nga ajo. Andaj, mos ta konsiderojë***

dikush furnizimin e tij të vonuar, sepse Xhibrili mua më inspiroi se asnjëri prej jush nuk do të dalë nga kjo botë, para se ta plotësojë rrizkun e vet. Për atë, o ju njerëz, frikohuni Allahut, dhe kërkon i furnizim me punë të ndershme! Nëse dikush prej jush nuk e arrin tërë atë furnizim që dëshiron, le mos ta kërkojë duke bërë mëkat ndaj Zotit, sepse mirësia e Zotit nuk arrihet me mëkat ndaj Tij.” /Transmeton Hakimi/

Me këto porosi të flakta, Islami e ngriti vlerën e atij që i përmbahet urdhreve të tij, dhe e bëri që të ecë mbi tokë i fuqi-shëm dhe me nder. Pastaj sqaroi se, ata rreth të cilëve ne sillemi në nevojat tona, ata janë vetëm korridor të furnizimit, apo manifestim të privimit.

Transmetohet prej Abdull-llah Ibën Mes’udit, se Pejgamberi i Allahut ka thënë: *“Mos e kënaqni askë duke e hidhëruar Allahun, dhe mos e lavdëroni askë për mirësinë e Allahut. Mos e qortoni askë për atë që nuk ta ka dhënë Allahu. Sepse furnizimin e Allahut nuk mund të ta sjellë ty dëshira e ndonjë këmbëngulësi, e as që mund ta largojë prej teje urrejtja e ndonjërit që nuk të do. Por, Allahu me drejtësinë e Tij, gëzimin dhe rrugëdaljen e ka bërë në kënaqësi dhe bindje, kurse bren-gat dhe dëshpërimin e ka bërë në hidhërim.” /Transmeton Taberaniu/*

Por ky hadith nuk ka për qëllim mohimin e shërbimeve, e as shkeljen e mirësisë së atyre që bëjnë mirë, sepse në një hadith thuhet: *“Ai që nuk i falënderon njerëzit, nuk e falënderon Zotin.” /Transmeton Tirmidhiu/*

Porosia e hadithit është që mos të nënshtrohet njeriu me një mirësi dhe afrim, ashtu që të shkrihet dinjiteti i tij; Sepse mirësia e Zotit është më me prioritet. Nuk duhet që, ai që jep diçka, me dhuratën e tij, të ketë për synim blerjen e njerëzve, si dhe të dirigjojë me ta si të dojë, sepse kjo e ia shkatërron shpërblimin. Ky ka qenë dhe vazhdon të jetë synimi i atyre që nuk kanë dhënë për hir të Zotit, andaj të ndershmit rënkojnë nga dhuratat e tyre:

Për Zotin, djali i axhës tënd nuk është më fisnik se unë në origjinë,

*E as që është ai që duhet t'i jap llogari, e të më
poshtërojë!*

Ndërkaq, ata të cilët japin për hir të Zotit dhe i kryejnë obligimet ndaj njerëzve për hir të Tij, duke e treguar shpërblimin e tyre, Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] thotë:
“Kujt i jepet diçka, le të shpërblejë me diçka nëse ka; nëse nuk ka të shpërblejë, le ta lavdërojë bamirësin, sepse ai që e lavdëron atë, e ka falënderuar, e ai që e mbulon, e ka injoruar.”
/Transmeton Ebu Davudi/

Ndërkaq, frika nga vdekja dhe durimi i turpit, duke synuar me këtë ekzistencën në këtë botë, në çfarëdo mënyre, është mendjelehtësi, sepse ikja nuk e zgjat jetën dhe përballimi nuk e shkurton atë. E si mundet e kundërta, kur: ***“Çdo popull (që përgënjeshtroi pejgamberët) ka afatin e vet, e kur t’u vijë afati i tyre, ai nuk mund të shtyhet për asnjë moment, e as të përngutet më parë.”*** (El-A’raf: 34)

Caktimi i Zotit e arrin krenarinë, dhe atij i takon shpërblimi që meriton; po ashtu, e arrin edhe të ultin, e atij i takon dënimi që meriton. Andaj, bëhu krenar, pasi nga caktimi i gjykuar nuk mund të shpëtojë asnjë njeri.

MËSHIRA

Mëshira e përsos natyrën e njeriut, e bën njeriun të jetë i ndjeshëm ndaj dhembjeve të krijesave dhe të orvatet në eliminimin e tyre, i vjen keq për gabimet e tyre dhe ua dëshiron atyre udhëzimin. Mëshira është përsosuri në karakter, sepse moskujdesi i ndjenjave e ul njeriun në pozitë të kafshës dhe ia rrëmben më të shtrenjtën që e posedon, e ajo është ndjenja e gjallë përplot me dashuri dhe butësi. Bile edhe kafshës mund t'i ngjallen ndjenja të panjohura, të cilat e bëjnë të butë ndaj pasardhësve të saj që i ka lindur, andaj, vrazhdësia është kthim i natyrës në pozitën e kafshëve, madje edhe në pozitën e elementeve të ngurta, të cilat nuk kuptojnë dhe nuk lëvizin.

Mëshira, në pikën e saj më të lartë vertikale dhe shtrirjen e saj ekskluzive, është cilësi e Zotit të madh, sepse mëshira e Tij i ka përfshirë të gjitha krijesat dhe sferat. Ku të ndriçojë një rreze nga dituria e Tij, e cila përfshin çdo gjë, bashkë me të ndriçon edhe një rreze e mëshirës së bujshme. Për atë, prej lutjes së melekëve drejtuar Atij, qe:

“... Zoti ynë, Ti me mëshirën dhe me diturinë Tënde ke përfshirë çdo send, andaj falu atyre që u penduan dhe ndoqën rrugën Tënde, e edhe ruaj ata nga dënimi i Xhehennemit!” (Gafir: 7)

Transmetohet prej Omer Ibën Hattabit, i cili thotë: “I sollën Pejgamberit të Allahut disa pengje, ndërsa një grua prej pengjeve vraponte ngase i rridhnin gjinjtë e saj qumësht. Ajo e gjeti një foshnje prej pengjeve, e mori, e ngjiti për barkun e saj dhe i dha gji. Atëherë Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] tha: “Si mendoni, a mund ta hedhë kjo grua foshnjën e vet në zjarr?” Ne thamë: “Jo, për Allahun, kur ka mundësi që mos ta hedhë!” Atëherë Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] tha:

“Allahu është më i mëshirshëm për robërit e Vet, sesa kjo grua për fëmijën e saj.” /Transmeton Buhariu/

Shumë prej emrave të bukur të Allahut burojnë nga kuptimet e mëshirës, fisnikërisë, mirësisë dhe faljes. Në hadith kudsij përmendet: **“Mëshira Ime e ka mundur hidhërimin Tim.”** /Transmeton Muslimi/ Që do të thotë se, falja e Tij për gabimet e njerëzve ia tejkalon ndëshkimit të Tij për njerëzit dhe hidhërimit të Tij me ta, e me këtë Ai është më i miri Mëshirues: **“E ti thuaj:” O Zoti im, më fal e më mëshiro, se Ti je më Mëshiruesi i mëshiruesve!”** (El-Mu’minun: 118)

Tërë atë që e sheh në tokë prej dashurisë, ngazëllimit, solidaritetit dhe mirësisë është gjurmë nga mëshira e Zotit, nga e cila një pjesë ka lëshuar në zemrat e krijesave. Andaj, njerëzit me zemra më të buta, janë ata që kanë marrë më tepër hise nga kjo mëshirë, dhe të njëjtët janë edhe më të ndjeshëm për jetën e të dobtëve.

Ndërkaq, tiranët, mbrapshtanët dhe mendjemëdhejtë zemërgurë janë në fundin më të thellë të zjarrit. Në hadith thuhet: **“... njerëzit të cilët janë më larg Allahut të Lartësuar, janë ata që kanë zemër të vrazhdtë.”** /Transmeton Tirmidhiu/

Pejgamberi i Allahut, moslotimin e syrit dhe ngurtësinë e zemrës i konsideronte prej fatkeqësisë.

Allahu i Madhërishëm deshi t’ia falë botës një njeri, që do t’i shlyente plagët e saj, do t’ia lehtësonte zemërimin; të cilit do t’i vinte keq për gabimet e tyre dhe do të shkrihej në udhëzimin e tyre; i cili do t’i ndihmojë të dobtit dhe do të luftonte pranë tyre siç nëna lufton për t’i mbrojtur të vegjëlit e saj. Për këtë, e dërgoi Muhammedin [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem], dhe në zemrën e tij futi aq dituri dhe urtësi, në karakterin e tij futi senzibilitet dhe mirësi, në natyrën e tij - lehtësi dhe butësi, ndërsa në dorën e tij - bujari dhe fisnikëri, saqë e bëri njeriun më të mëshirshëm, më shpirtmadh dhe më zemërgjerë. Andaj, për të, Allahu i Madhërishëm thotë: **“Ti ishe i butë ndaj tyre, ngase Allahu të dhuroi mëshirë, e sikur të ishe i vrazhdë e zemërfortë, ata do të shkapërderdheshin prej teje...”** (Ali Imran: 159)

Këto virtyte të shkëlqyeshme e shoqëruan edhe në momentet më të rënda, kur u orvatën idhujtarët në Uhud ta vrasin, kur

e detyruan të drejtohet kah vendi ku kishin përgatitur një gropë për që të binte në të, kur i shikoi shokët e vet më të mirë duke stërpikur me gjaqet e tyre tokën e Uhdut. Atë e shikuan shokët e vet kur fytyra i ishte çarë, e dhëmbi i kishte rënë. Në këtë krizë, atij iu tha: *“Lutu kundër idhujtarëve.”* Por atë e sundoi butësia dhe shpirti i tij i lartë filloi të shohë arsyetime për armiq të tij, andaj edhe u lut: *“O Zot udhëzoje popullin tim, se ata nuk dinë!”*

Zemrat e mëdha shumë rrallë mund t'i tërbojnë motivet e vrazhdësisë, por ato çdo herë janë më afër faljes dhe butësisë sesa tërbimit dhe mllëfit.

Ashpërsia në karakterin e njeriut është argument i mangësisë së madhe, ndërkaq në historinë e një populli argument i një plangprishjeje të madhe. Andaj edhe nuk është çudi që Islami ua tërhoqi vërejtjen njerëzve prej saj, dhe këtë e konsideroi si shkak të mosrespektimit të urdhrit të Zotit dhe braktisjeje e njerëzve nga rruga e Tij e drejtë: ***“A nuk është koha që zemrat e atyre që besuan të zbuten me këshillat e Allahut dhe me atë të vërtetë që zbriti (me Kur'an), e të mos bëhen si ata, të cilëve u është dhënë libri më parë, e zgjati koha dhe zemrat e tyre u shtangën, e shumë prej tyre janë jashtë rrugës.”*** (El-Hadid: 16)

Islami urdhëroi për mëshirim të përgjithshëm, dhe këtë e bëri prej argumenteve të besimit të përkryer. Kështu, muslimani në zemrën e vet ka mëshirë të akumuluar dhe mirësi të fshehur ndaj të gjithë njerëzve; ai është kozmopolit ndaj tyre dhe ua lehtëson atyre aq sa ka mundësi. Pejgamberi i Allahut thotë: *“Nuk do të besoni, derisa të mëshironi.”* Shokët i thanë: *“O Pejgamber i Allahut, të gjithë ne jemi të mëshirshëm.”* Ai u tha: *“Po, por nuk arrihet kjo me mëshirën e dikujt ndaj shokut të vet, por kjo arrihet me mëshirën e përgjithshme.”* /Transmeton Taberaniu/

Po, njeriu mund t'u buzëqeshë shokëve të vet kur i takon, e po ashtu ai tregohet i butë ndaj fëmijëve të vet kur i sheh; kjo është çështje prezente te pjesa dërrmuese. Por, prej besimtarit kërkohet që rrethi i mëshirës së tij të jetë më i gjerë, ai e tregon gëzimin e tij, e manifeston dashurinë dhe mëshirën e tij për të gjithë ata që i takon...

Janë përmendur një varg hadithesh të cilat nxisin për këtë mëshirë përfshirëse. Kështu, Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] thotë: *“Kush nuk i mëshiron njerëzit, atë nuk do ta mëshirojë Allahu.”* /Transmeton Buhariu/ Në një version tjetër u shtua: *“Dhe, kush nuk ua fal të tjerëve, nuk do t'i falet edhe atij.”*

Po ashtu thotë: *“Kush nuk e mëshiron atë që është në tokë, atë nuk do ta mëshirojë kush është në qiell.”* /Transmeton Taberaniu/

Po ashtu thotë: *“Lum për atë që është i përlulur, por jo nga të metat, dhe nënshtrohet në veten e vet pa i lypur dikujt; ndan pasuri, të cilën e ka fituar në mënyrë të ndershme; i mëshiron njerëzit e papërfillur dhe të ngratë, si dhe i shoqëron dijetarët dhe të urtët.”* /Transmeton Taberaniu/

Nënshttrimi, jo për shkak të skamjes, do të thotë qetësi për besimtarët dhe butësi me ta. Allahu i Madhërishëm e ka përkshkruar shoqërinë muslimane, si e lidhur me këtë ndjenjë reciproke; andaj për njerëzit e saj tha: *“... modest e i butë ndaj besimtarëve, por i ashpër dhe i fortë ndaj mohuesve...”* (El-Maide: 54), e po ashtu tha: *“... të ashpër kundër jobesimtarëve, janë të mëshirshëm ndërmjet vete...”* (El-Fet'h: 29)

Mund të pyesësh: Ç'do të thotë përmendja e ashpërsisë në kontekst të fjalës mbi mëshirën? Realiteti është se Islami porosit në mëshirën e përgjithshme, nga e cila nuk përjashton as njeri, as kafshë e as shpend, ndërkaq dëshmitë e përmendura e konfirmojnë këtë përgjithësim, edhe pse disa njerëz dhe kafshë janë burim i rrezikut për të tjerët, si dhe shkaktues të frikës dhe trishtimit, ashtu që prej interesit të përgjithshëm të bashkësisë është që e keqja e tyre të ndalohet dhe të ligat e tyre të mbyllet. Në këtë rast, ashpërsia me ta mund të jetë mëshirë ndaj tyre dhe drejtim i devijimit të tyre.

Islami është fe e mirësisë, paqes dhe butësisë ndaj të gjithë njerëzve. Allahu i tha Pejgamberit të Tij: *“E Ne të dërguam ty (Muhammed) vetëm si mëshirë për të gjitha krijesat.”* (El-Enbija: 107)

Kurse të gjitha suret e Kur'anit fillojnë me **“Bismil-lahir-rahmanir-rahim** - Në emër të Allahut, Mëshiruesit të përgjithshëm, Mëshirëbërësit të përveçëm.”⁸

Mirëpo ujqit prej njerëzve nuk pranojnë tjetër, përveç kundërshtimit të mëshirës së gjerë dhe vënies së shkëmbinjve të mëdhenj në rrjedhën e saj, me qëllim që njerëzve t'u ndërpriten burimet e saj, ashtu që të shkatërrohen larg saj, në përrënjt e injorancës dhe hamendjes. Këto pengesa duhet patjetër të eliminohen dhe të jemi të ashpër ndaj vënësve të tyre. Dhe atëherë kur do të ndalen kundërshtimi dhe sfidat e tyre, do t'i përfshijë kjo mëshirë e përgjithshme. Në këtë mëshirë nuk ka mangësi, por të metat qëndrojnë tek ata që e kanë privuar veten e tyre prej saj. Po a nuk e sheh se mëshira e Allahut ka përfshirë çdo gjë? Por, edhe përkaj kësaj, atë nuk do të mund ta arrijë as idhujtar e as mohues: **“... e mëshira Ime ka përfshirë secilin send. Atë (Mëshirën) do ta caktoj për ata të cilët ruhen (mëkateve), e japin zekatin dhe për ata që argumentet tona i besojnë. Që pranojnë të Dërguarin (Muhammedin), Pejgamberin arab (që nuk shkruan as nuk lexon)...”** (El-A'raf: 156-157)

Siç thuhet: Kjo sallë zë një mijë veta, mirëpo në të mund të hyjnë vetëm ata që kanë bileta, e nëse disa njerëz nuk pranojnë ta mbajnë biletën e kërkuar, dhe për këtë shkak ndalohen nga hyrja dhe mbesin jashtë por kjo nuk e injoron madhësinë e sallës. E tillë është edhe fjala e Pejgamberit të Allahut: **“Të gjithë pjesëtarët e umetit tim do të hyjnë në Xhenet, përveç atyre që e refuzojnë këtë.”** Shokët i thanë: **“E kush refuzon?”** Ai iu përgjigj: **“Kush më pason mua do të hyjë në Xhenet, e kush më kundërshton, ai ka refuzuar.”** /Transmeton Buhariu/

Disa herë mëshira e vërtetë mund të duket si ashpërsi, por nuk është ashtu. Kështu për shembull, fëmijët në fillim dërgohen në shkollë me forcë dhe mësojnë nga frika. Sikur të liheshin të vepronin sipas epsheve të tyre, do t'i mbyste loja dhe zbatimja dhe do të rriteshin pa ditur asgjë. Për këtë edhe poeti thotë:

⁸ Këtu nuk bën pjesë vetëm një sure, surja “Et-Teube” e cila nuk fillon me bismil-lah (sh. p.).

*U ashpërsua që të frikohen, e kush është i mëshirshëm
Ndonjëherë le të bëhet i ashpër ndaj atyre që mëshiron.*

Po ashtu, edhe mjeku, kur bën në trup ndonjë operacion, përdor gërrshërë për prerjen e mishit, bile mund t'i imponohet të thyjë eshtrat dhe të presë gjymtyrët. E këtë e bën vetëm nga mëshira ndaj të sëmurit!

Andaj, mëshira nuk është butësi pa logjikë, apo sentimentalizëm që e mohon drejtësinë dhe ligjin. Assesi! Mëshira është ndjenjë e cila i respekton të gjitha këto të drejta. Pamja e maskarenjve dhe trupi i tyre luhaten në ajër, sytë e tyre fuqishëm e duan dritën dhe kërkojnë shpëtim, pamje kjo që mund të prekë ndjenjat, por sikur t'i përgjigjemi kësaj ndjenje të shpejtë dhe ta lëshojmë vrasësin në liri, toka do të ishte mbushur plot me trazira... Por mëshira reale është në pengimin e këtyre ndjenjave. ***“O ju të zotët e mendjes, kjo masë e dënimit është jetë për ju, ashtu që të ruheni (nga mbytja e njëri-tjetrit).”*** (El-Bekare: 179)

Ashpërsia, të cilën e injoron Islami, është rezultat i arrogancës së njeriut, dhe nuk ka të bëjë me logjikë e as drejtësi. Është instinkt i lig shtazarak, i cili ngopet prej të këqijave dhe ofendimeve, përkon me egoizmin ekskluziv dhe pasionin e verbër. Ndërkaq, mëshira është gjurmë prej bukurisë hyjnore, e cila në krizat e rënda u dhuron atyre një erë të këndshme që ua ngjall jetën dhe freskon zemrat.

Pejgamberi i Allahut ka thënë: ***“Allahu mëshirën e ka ndarë në njëqind pjesë, ndërkaq në tokë zbriti vetëm një pjesë, dhe prej kësaj pjese mëshirohen krijesat, saqë kafsha e ngre shputën e vet nga i vogli i saj me qëllim që mos ta shkelë.”*** /Transmeton Buhariu/

Në një transmetim tjetër thuhet: ***“Allahu i Lartësuar, ditën kur i ka krijuar qiejt dhe tokën, ka krijuar njëqind mëshira, çdo mëshirë e ka madhësinë sa ka në mes qiellit dhe tokës, dhe prej tyre në tokë lëshoi një mëshirë. Me të nëna e mëshiron fëmijën e saj dhe egërsirat e shpezët njëra-tjetrën.”*** /Transmeton Muslimi/

Ashtu siç zhvillohet mendja me njohuri të ndryshme, dhe pasurohet, edhe kjo mëshirë zhvillohet me metoda të ndryshme, që të zgjerohet dhe rritet... Ndërkaq, nëse lihet të shkrihet dhe të vdesë, bartësi i saj bëhet lëndë djegëse e Xhehenemit.

Transmetohet prej Ebu Hurejres, i cili thotë: “E kam dëgjuar të singërtin e vërtetuar, pronarin e kësaj dhome, babain e Kasimit {Pejgamberin [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem]}, duke thënë: *“Mëshira u merret vetëm fatkeqëve.”* /Transmeton Ebu Davudi/

Islami tregoi në atë se ka disa njerëz të veçantë të cilëve duhet t’u takojë më tepër hise prej mëshirës dhe mbikëqyrjes. Prej tyre janë të afërmit, sepse afërsia buron prej mëshirës, andaj duhet të përputhet me mëshirën në kuptimin e saj. Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] thotë: *“Të mëshirshmit do t’i mëshirojë Allahu i Lartësuar. Mëshironi ata që janë në tokë, t’ju mëshirojnë ata që janë në qiell. Afërsia është degë e të Mëshirshmit. Kush e respekton atë, atë do ta respektojë Allahu, e kush nuk e respekton atë, atë nuk do ta respektojë Allahu.”* /Transmeton Tirmidhiu/

Muslimani duhet t’i kryejë obligimet e veta ndaj të afërmeve, si dhe t’i forcojë me dashuri të vazhdueshme lidhjet ekzistuese të gjakut.

Njerëzit më të denjë për mirësinë e tij janë ata që i kanë bërë më tepër të mira dhe që kanë më tepër merita për të, e ata janë prindërit e tij. Allahu i Madhërishëm thotë: ***“Dhe në shenjë mëshire shtrihe pranë tyre krahun përulës e respektues, dhe thuaj: Zoti im! mëshiroi ata të dy, sikurse më edukuan mua kur isha i vogël.”*** (El-Isra: 24)

Pastaj vijnë fëmijët. Transmetohet prej Beras [radijAllahu anhu], i cili thotë: “Erdhi Ebu Bekri [radijAllahu anhu] te bija e vet, Aishja [radiAllahu anha], të cilën e kishte kapluar një zjarmi, dhe i tha: *“Si je oj bija ime”*, dhe e puthi në faqe. /Transmeton Buhariu/

Ndërkaq, te njerëzit e vrazhdë vërehet se ndjenjat e tyre nuk e kanë këtë natyrë të butësisë dhe mëshirës; në karakterin dhe fjalët e tyre ka arrogancë të urrejtur.

Transmetohet prej Ebu Hurejres, i cili thotë: “Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] i puthi dy djemtë e Aliut, Hasanin dhe Husejnin në prani të Ekrea Ibën Habis Et-Temimit. Ekrea tha: *“Unë kam dhjetë fëmijë, dhe asnjërin nuk e kam puthur asnjëherë!”* Pejgamberi e shikoi atë, dhe tha: *“Kush nuk mëshiron, nuk mëshirohet.”* Kurse në një transmetim tjetër: *“Ç’mund të të bëj ty, nëse Allahu ta ka larguar mëshirën prej zemrës tënde?”* /Transmeton Buhariu/

Transmetohet prej Enesit i cili thotë: “Hymë me Pejgamberin [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] te Ebu Sejfi, i cili ishte baba i gjirit i birit të Pejgamberit të Allahut, Ibrahimit. Pejgamberi e mori birin e vet, e puthi dhe e nuhati. Pastaj ne hymë te ai, kurse Ibrahim i jepte shpirt. Sytë e Pejgamberit lotuan, dhe në atë rast Ibën Afi tha: *“Ti o Pejgamber i Allahut?”* Sikur i erdhi habi qarja e Pejgamberit, ndërsa Pejgamberi i tha: *“O Ibën Afi, kjo është mëshirë.”* Pastaj e ndoqi me një tjetër dhe tha: *“Syri loton, zemra zbutet, e nuk themi gjë tjetër, por vetëm atë me çka është i kënaqur Zoti ynë. E ne që ndahemi prej teje, o Ibrahim, jemi të mërzhitur.”* /Transmeton Muslimi/

Muslimani nuk bën ta mbyllë zemrën dhe shtëpinë e vet për të afërmit, e as t’i ndërpresë lidhjet me ta e të jetojë larg tyre, ashtu që mos t’i ngushëllojë në vështirësi dhe mos t’u ndihmojë; kjo ndërprerje e privon njeriun nga bekimi i Zotit, dhe ia ekspozon atë hidhërimit të Tij.

Transmetohet prej Ebu Hurejres, i cili thotë: “E kam dëgjuar Pejgamberin e Allahut duke thënë: *“Farefisnia është një degë e të Mëshirshmit, e cila thotë: ‘O Zot, mua më prenë! O Zot, shumë keq vepruan me mua! O Zot, mua më është bërë padrejtësi! O Zot, o Zot.’ E Zoti i përgjigjet: “A nuk të mjafton që ta respektoj atë që të respekton ty dhe ta zhduk atë që të zhduk ty?”* /Transmeton Ahmedi/

Ata që jemi të obliguar t’i mëshirojmë janë edhe jetimët. Kështu, mirësia ndaj tyre, bamirësia, siguri i ekzistencës së tyre dhe mbrojtja e ardhmërisë së tyre është prej devotshmërive më të mëdha; madje edhe ndjenjat e devijuara drejtohen në këtë rrugë dhe bëhen serioze.

Transmetohet prej Ebu Hurejres, se një njeri u ankua te Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] se është shumë i ngur-

të në zemër, e ai i tha: *“Përkëdhele kokën e jetimit dhe ushqej të ngratët.”* /Transmeton Ahmedî/

Në një transmetim tjetër qëndron, se një njeri erdhi të ankohet për zemërgurtësinë e tij, e Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] i tha: *“A dëshiron që zemra jote të zbutet dhe nevojja jote të kryhet? Mëshiroe jetimin dhe përkëdhele kokën e tij, ushqejë atë prej ushqimit tënd, do të zbutet zemra jote dhe do të kryhet.”* /Transmeton Taberaniu/

Ngase zemra trishtohet në shoqëritë të cilat jetojnë në zbavitje të përhershme, si dhe të cilat mëngjes e mbrëmje i shohin vetëm horizontet e tyre të shkëlqyeshme dhe begatitë e tyre të mëdha, ndërkaq njerëzit e luksit i injorojnë rënkimet e masës së gjerë, sepse kënaqësitë që kanë arritur ua mbyllin atyre zemrat, ua verbojnë sytë, ashtu që nuk i lënë të ndjejnë nevojën e nevojtarëve, dhembjen e rënkuesve dhe dëshpërimin e të zemëruarve, kurse njerëzit i furnizojnë zemrat fisnike dhe ndjenjat senzibile kur gjenden në situata të ndryshme të jetës dhe sprovohen me të mira e të këqija... Atëherë njeriu ndjen mallëngjim bashkë me jetimin, humbje bashkë me atë që i ka vdekur fëmija dhe ngushti me të varfërin e ngratë.

Mëshirë duhet patur ndaj të sëmurve dhe të hendikepuarve, sepse ata njerëz të vuajtur kyçen në jetë me metoda të mangëta, të cilat i pamundësojnë të ecin në të dhe ta arrijnë hisen e vet në të. Këta i ka arsyetuar Allahu, e ne nuk bën t'i fajësojmë për atë që ua ka falur Allahu:

“Nuk është mëkat (të ngelë pa dalë) për të verbërin, për të çalin, e as për të sëmurin. E kush respekton Allahun dhe të dërguarin e Tij, Ai atë e shtie në Xhenete ku rrjedhin lumën, e kush ngel prapa, Ai atë e ndëshkon me një dënim të dhembshëm!” (El-Fet'h: 17)

I sëmuri është njeri të cilin e ka lidhur sëmundja, e ka penguar ashpërsia e sëmundjes dhe hidhëtia e barit. Ai, me durimin e vet ndaj dhembjeve të tij, është afër Allahut dhe meritë për mëshirën e Tij. Nëse një gjemb ia fshin besimtarit mëkatet, atëherë çka mund të thuhet për atë që e kanë lodhur sëmundjet dhe e kanë bërë t'i shijojë vuajtjet më të rënda? Kjo e bën të jetë nën mbikëqyrjen e Allahut! Për këtë, duhet të jemi të kujdesshëm, e mos të jemi arrogant ndaj të sëmurve dhe mos

të nënçmojmë sëmundjet e tyre, sepse arroganca ndaj tyre është krim i rëndë.

Prej vendeve të mëshirës është edhe sjellja e mirë me shërbësit, butësia ndaj tyre për punët me të cilat i ngarkojmë, falja e lëshimeve që bëhen nga ana e tyre mos ta ndjejmë fuqinë tonë me mendjemadhësi ndaj tyre, dhe mos të tallemi me nënshtrimin e tyre. Sepse, Allahu, kur i jep dikujt diçka, e ai pastaj sillet me arrogancë dhe jorealisht, ia merr atë mbi të cilën i dha pushtet dhe atij i përgatit një përfundim të zyrtë.

Transmetohet prej Ebu Mes'ud El-Bedrijut, i cili thotë: "Isha duke e rrahur me thupër një rob timin, kur dëgjova një zë prej pas, duke thënë: *"Dije, o Ebu Mes'ud."* Por nga nervoza, nuk e kuptova se ç'më thoshte. Dhe kur mu afrua, e pashë se ai ishte Pejgamberi i Allahut, i cili më tha: *"O Ebu Mes'ud, dije se Allahu është më i fuqishëm për ty sesa ti ndaj këtij robi."* Atëherë unë thashë: "O Pejgamber i Allahut, ky tani është i lirë për hir të Zotit." Pejgamberi ma ktheu: *"Sikur të mos e bëje këtë (sikur mos ta liroje), do të të përzhiste zjarri."* /Transmeton Muslimi

Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] thotë: *"Sjellja e mirë është shtim, kurse karakteri i keq është fatkeqësi."* /Transmeton Ebu Davudi/

Pejgamberit i erdhi një njeri, dhe e pyeti: *"Sa t'ia fal shërbëtorit?"* Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] i tha: *"Çdo ditë nga shtatëdhjetë herë!"*

Ka disa gra dhe burra të cilët e shfrytëzojnë dobësinë e shërbëtorit dhe u bëjnë ofendime të ndryshme; ndërkaq Islami ka ndaluar nga kjo vrazhdësi dhe është kërcënuar për të. Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] ka thënë: *"Kush mëshon një thupër, pa të drejtë, për të do t'i hakmerren në Ditën e Gjykimit"* /Transmeton Bezzari/

Prej mëshirës së kërkuar, është edhe butësia me kafshët. Omeri [radijAllahu anhu] e pa një njeri duke e hequr për këmbë delen e vet, që ta therte, dhe i tha: *"Mjerë për ty, hiqe si duhet për në vdekje."* Një njeri tha: "O Pejgamber i Allahut, unë e mëshiroj delen që pres." Pejgamberi i tha: *"Nëse e mëshiron atë, do të mëshirojë ty Allahu."* /Transmeton Hakimi/

Islami ua zë shumë për të madhe atyre që kanë zemra të ngurta ndaj kafshëve dhe që nuk brengosen për dhembjet e tyre; andaj edhe ka sqaruar se njeriu, edhe përsëri vlerës së tij të lartë, hyn në Xhehenem për një të keqe që ia bën një kafshe.

Pejgamberi i Allahut thotë: *“Një grua hyri në zjarr për shkak të një maceje, të cilën e kishte lidhur dhe nuk i jepte për të ngrënë, e po ashtu nuk e lënte të hante as prej gjallesave të tokës.”* /Transmeton Buhariu/

Gjithashtu, Islami sqaroi se, mëkatet e mëdha i fshin edhe një ndjenjë mëshire, e cila e përshkon zemrën, qoftë edhe ndaj një qeni!

Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] thotë: *“Derisa një njeri ishte duke udhëtuar, e kapi etja; e gjeti një pus, dhe zbriti në të, e piu ujë. Pastaj doli përsëri, kur e pa një qen duke gulçuar, i cili nga etja hante bimët. Njeriu tha: ‘Këtë qen e paska kapluar etja, siç më kishte kapluar mua!’ Andaj, zbriti në pus, e mbushi këpucën e vet me ujë, pastaj e kapi për gojë, e nxori dhe i dha ujë qenit. Këtij ia njohu këtë punë Allahu dhe ia fali.”* Shokët i thanë: *“O Pejgamber i Allahut, a edhe për kafshët ne shpërblehemi?”* Pejgamberi tha: *“Për çdo gjallesë ka shpërblim.”*

Në një transmetim tjetër qëndron: *“Një grua amorale e pa një qen, një ditë të nxehtë, duke u sjellur rreth një pusi; gjuha i ishte tharë nga etja, e ajo i nxori nallet e veta (për t’i dhënë ujë), dhe për këtë iu falën mëkatet asaj!”* /Transmeton Muslimi/

Nëse mëshira ndaj qenit i fal mëkatet e të pamoralshmeve, atëherë mëshira ndaj njerëzve bën çudira!

DITURIA DHE MENDJA

Natyra e Islamit ia imponon popullatës, e cila e ka për-qafuar atë, që të jetë popull i arsimuar, popull në të cilën do të jetë e lartë përqindja e intelektualëve dhe do të ulet, apo do të zhduket krejtësisht, përqindja e analfabetëve.

Kjo, ngase të vërtetat e kësaj feje, qofshin gjëra primare apo sekondare, nuk janë dogma që trashëgohen nga të parët apo doke të përhapura me intuita dhe hamendje. Assesi! Por janë të vërteta të cilat nxirren prej një libri të urtë dhe Suneti të qartë! Mënyra e nxjerrjes së tyre nuk ndalet thjesht vetëm në lexim, por patjetër të ekzistojë një popull në të cilin do të ketë koka inteligjente dhe metoda të larta e rregulla fisnike. E nuk ka dyshim se mësimi i metodave të Islamit, te çdo popull i cili interesohet për to, krijon klimë të jurisprudencës fetare të bazuar në urdhra dhe ndalesa, gjegjësisht të drejta dhe obligime; klimë të rregullave shoqërore, precize, të lidhura me parimin e urdhërimit për të mirë dhe ndalimit nga e keqja; klimë të studimit objektiv dhe hulumtimit të sigurtë, për shtrirjen e zgjidhjes islame për shumë probleme të ndryshme dhe çështje bashkëkohore që i imponon koha.

Nëse pakësohen këto elemente në një ambient, çështja islame do të zhduket dhe degët e tij veniten, siç thahet druri i lartë në tokën e cila e humb plleshmërinë dhe i thahet uji.

Po ashtu, pas kësaj kemi edhe të soditurit e qiellit, për të cilën gjë urdhri është permanent në kaptinat e Kur'anit, dhe u konsiderua baza e parë e formimit të besimit të fortë e stabil. Ky të menduar është ai i cili i hapi mendjet për elementet fascinuese të civilizimit bashkëkohor, i cili ia lehtësoi botës këto zbulime të shkëlqyeshme të sekreteve të ekzistencës, si dhe ua nënshtroi njerëzve atë për të cilën as që ëndërronin. Po ashtu,

kemi edhe porosi për pasimin ekskluziv vetëm të së vërtetës dhe hulumtimit të saj, sado që ajo të jetë e fshehtë; për refuzimin e paragjykimeve që sillen vërdallë dhe për ndalimin nga ndjekja e tyre, si dhe vënia e një kontrolli preciz për dëgjimin, shikimin dhe zemrën. Kjo është garanci për formimin e një shoqërie që do të jetë larg bestytnive dhe e pastër nga iluzionet dhe maskimet, e jo shoqëri përplot me magji, në të cilën do të jenë të theksuara alarmimet e rrejtshme dhe punët e kota dhe që do ta sundojnë doket absurde për të cilat Allahu nuk ka zbritur argument.

Dituria për Islamin është sikur jeta për njeriun, dhe kjo fe do të gjejë fole të sigurt vetëm te njerëzit e pjekur dhe të mençur.

Kështu, për një prej çështjeve, Allahu thotë: ***“Ky (Kur’an) është kumtesë për njerëz, që me të të këshillohen dhe ta dinë se Ai është vetëm një Zot, dhe që t’i këshilloj ata që kanë mend.”*** (Ibrahim: 52) Po ashtu, duke e ilustruar bisedën e Xhehenemlinjve, thotë: ***“... Sikur të kishim dëgjuar dhe pasur mend, ne nuk do të ishim ndër banuesit e zjarrit.”*** (El-Mulk: 10)

Për ata, ndjenjat e të cilëve janë shembur, aftësitë e të cilëve kanë vdekur dhe mendjet e të cilëve janë mbyllur, Allahu i Madhërishëm thotë: ***“Shembulli i (thirrësit të) atyre që nuk besuan, është sikurse i atij (bariut) që u lëshon britmë atyre (bagëtive) që nuk dëgjojnë tjetër vetëm se britmë e zë (e nuk kuptojnë). Ata janë të shurdhër, memecë e të verbër, ata nuk kuptojnë.”*** (El-Bekare: 171)

Allahu i Madhërishëm e lartësoi jetën me Islamin, pasi ajo u poq, u zhvilluan fuqitë e saj dhe u përgatit që t’i pranojë prej tij mësimet më të shquara dhe më të ngritura, ashtu që tërë Islami ishte në harmoni me zhvillimin e jetës drejt përkryeshmërisë; bile ai qe një stadium i gjerë në hapërimin e saj drejt ngritjes materiale dhe artistike.

Kështu, nëse ti e shikon namazin, i cili është rituali i parë në Islam, do ta shohësh se kryerja e tij dhe thirrja e ezanit për të është vepër ekskluzivisht intelektuale, sepse thirrja për në namaz përmban fjalë të cilat i mëshojnë mendjes dhe e zgjojnë zemrën; ato janë madhërim i Allahut, dëshmi për Njëshmërinë e

Tij dhe nxitje për shpëtim. Kjo thirrje nuk është zile, e cila e lëshon tingëllimën e saj në ajër dhe u drejtohet ndjenjave abstrakte. Vetë namazi është sinonim i ajeteve të cilat lexohen prej librit i cili i ka përmbledhur thirrjet serioze të mirësisë dhe dëshmitë e pjekurisë, ndërkaq fakti i pranueshmërisë së tij varet nga prania e rezonimit gjatë kryerjes së tij dhe të medituarit e mendjes për domethëniet e tij...

Realiteti është ai se në bazë të mendjemprehtësisë së njeriut, intelektualizmit të tij dhe stabilitetit të natyrës së tij do të jetë edhe qëndrueshmëria (stabiliteti) e tij në Islam. E, shumë larg është të prijë në këtë fe njeriu me mendime naive dhe ndjenja të sëmura.

Ajetet e para që u zbritën në Kur'an ishin Fjalët e Allahut të Madhërishëm drejtuar Pejgamberit të Tij:

“Lexo, me emrin e Zotit tënd, i cili krijoi (çdo gjë). Krijoi njeriun prej gjaku të ngjizur (në mitrën e nënës). Lexo! Se Zoti yt është bujari! Ai që e mësoi (njeriun) të shkruaj me pendë. I mësoi atë që nuk e dinte.” (El-Alek: 1-5)

Kjo është jehona e parë e cila e lartëson vlerën e lapsit, e çmon vlerën e diturisë dhe i shpall luftë analfabetizmit neglizhent. Allahu i Madhërishëm i lartësoi atë tepër gradat e dijetarëve, sa që i bashkangjiti me Vetën e Tij dhe melekët në dëshminë e Njeshmërisë së Tij dhe konfirmimin e drejtësisë së Tij: ***“Allahu vërtetoi se nuk ka zot tjetër përveç Tij, e dëshmuar edhe engjëjt e dijetarët, dhe se Ai është zbatues i drejtësisë. Nuk ka zot, përveç Tij, Fuqplotit e të Urtit.”*** (Ali Imran: 18)

Kjo nuk është çudi, sepse, si munden mendjet e dobëta dhe njohuritë e ngushta ta kuptojnë lartësinë e Të Madhërishmit të Lartë? Dhe, si mundet ai që jeton në margjina të jetës, me injorancën dhe errësirën e vet, ta njohë realitetin mbi Zotin e jetës, apo të kuptojë një segment prej cilësive të Tij madhore dhe fakteve të Tij të larta?

Për këtë, Allahu i vlerësoi lart dijetarët dhe u dha prioritet me fisnikërinë dhe mirësinë e Tij. Kështu, Pejgamberi i Allahut thotë: ***“Allahu i Lartësuar do t’u thotë në Ditën e Gjykimit dijetarëve, kur do të qëndrojë mbi Kursinë e Tij që t’i gjykojë njerëzit: “Unë ua kam dhuruar diturinë dhe urtësinë Time***

vetëm për atë që t'ua fali juve lëshimet e bëra, dhe nuk më intereson tjetër.” /Transmeton Taberaniu/

Hafidh Mundhiriju thotë: “Analizoje mirë Fjalën e Allahut të Madhërishëm: ***“diturinë dhe urtësinë Time”***, dhe do të bëhet e qartë se me këtë përkatësi nuk është për qëllim dituria e pjesës më të madhe të bashkëkohasve tanë, e cila është e zhveshur nga dituria mbi Të dhe sinqeriteti.

Pasimi i urtësisë pas punës, me lidhëse gramatikore, tregon se kjo është dituri të cilën nuk mund ta shtyp naiviteti, e as ta nënshtrojnë epshet.

Njohuria e mirë ka prioritet tek Allahu, nga puna e parregullt si dhe nga adhurimi i zbrazët, i ngjyrosur me injorancë dhe të meta.

Pejgamberi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] ka thënë:

“Vlera e diturisë është më e madhe se vlera e adhurimit.”
/Transmeton Bezzari/

“Dituria e paktë është më e dobishme se adhurimi i shumë.” /Transmeton Taberaniu/

“Adhurimi më i mirë është të kuptuarit.” /Transmeton Taberaniu/

“Nëse ngrihesh në mëngjes dhe e mëson një ajet prej librit të Allahut, është më e dobishme për ty sesa të falish njëqind rekate. Nëse ngrihesh në mëngjes dhe e mëson një çështje shkencore, pa marrë parasysh se a veprohet apo jo me të, është më e dobishme për ty sesa të falish njëmijë rekate.”
/Transmeton Ibën Maxhe/

Fshehtësia e këtij gjykimi qëndron në atë se adhurimi i injorantëve, si p.sh. lëmosha, është pak serioze, dhe ata e dëmtojnë veten, prej atje ku duan t'i bëjnë dobi, e po ashtu, ata i shqetësojnë shokët e tyre, prej atje ku e synojnë qetësinë e të njejtëve. Njerëzit injorant janë të kapur fortë për fé, dhe tregojnë ndaj saj fanatizëm të hapët, mirëpo, ata, gjatë hamendjes dhe naivitetit, ndaj fesë marrin qëndrim i cili e dëmton dhe turpëron, si dhe i sjell asaj shumë telashe. Ndërkaq, puna e dijetarëve ndyshon, sepse mendjemprehtësia dhe dituria e tyre dirigjon me sjelljet e tyre dhe i bën të pjekur, ashtu që, nëse prej tyre shohim pak punë, do të shohim shumë vendosmëri,

dhe vizione që e shoqërojnë atë. Për këtë, Pejgamberi [salallahu alejhi ve sel-lem] thotë: *“Një i ditur është më i rrezikshëm për shejtanin, sesa njëmijë adhures.”* /Transmeton Tirmidhiu/

Po ashtu ka thënë: *“Vlera e dijetarit ndaj adhuresit, është si vlera ime ndaj njeriut më të ulët prej jush.”* /Transmeton Tirmidhiu/

Transmetohet prej Pejgamberit të Allahut, se ka thënë: *“Vlera e dijetarit ndaj adhuresit është shtatëdhjetë gradë, në mes çdo grade distanca është shtatëdhjetë vjet udhëtim me kalë. Ngase, djalli ua shpik një risi njerëzve, por kur atë e sheh dijetari, i ndalon nga ajo. Adhuresi i qaset adhurimit të Zotit, por nuk është i udhëzuar dhe nuk e njeh.”* /Transmeton El-Esbahani/

Pjesa e fundit e këtij hadithi duket se është e futur nga fjalët e transmetuesve, me qëllim të sqarimit të urtësive që i ka përmbajtur hadithi.

Pasi horizonti i ngushtë nuk i lë besimit shtrirje, e as mirësisë korridor, Allahu i Madhërishëm thotë: ***“Këta janë shembuj që Ne ua sjellim njerëzve, po këta nuk i kupton kush pos dijetarëve.”*** (El-Ankebut: 43) Po ashtu, Ai sqaroi se ndër-gjegja e cila stimulon për mirësi, ndalon nga e keqja, e mbikëqyrë njeriun dhe pretendon kënaqësitë e Zotit, është ndër-gjegja e dijetarit të vetëdijshëm i cili e njeh Zotin e vet... *“(A jobesimtare e ka gjendjen më të mirë) Apo ai që kohën e natës e kalon në adhurim, duke bërë sexhde, duke qëndruar në këmbë, i ruhet (dënimit të) botës tjetër dhe shpreson në mëshirën e Zotit të vet? Thuaj: A janë të barabartë ata që dinë dhe ata që nuk dinë? Po, vetëm të zotët e mendjes marrin mësim.”* (Ez-Zumer: 9)

Dituria, të cilës i qaset muslimani, dyert e të cilës i hap me fuqi dhe që për kërkimin e saj udhëton prej anëve më të largëta të Lindjes dhe Perëndimit, nuk është dituri e caktuar, me fillim dhe fund të kufizuar. Andaj, çdo gjë që i zgjeron horizontet e vrojtimit, i mënjanon pengesat para mendjes së etur për shtimin e dijes, çdo gjë që e forcon lidhjen e njeriut me ekzistencën dhe i hap atij caqe më të largëta të zbulimit dhe njohjes, si dhe çdo gjë që i mundëson atij jetë dinjitoz në botë - të

gjitha këto duhet të kuptohen dhe të njihen rrënjësisht, kurse muslimani duhet të marrë hise prej saj. Për këtë universalitet kanë dëshmuar ajetet dhe hadithet.

Për sa u përket haditheve të cilat udhëzojnë në pasurimin me njohuri, sido që ato të jenë, ata janë të shumtë. Si për shembull fjala e Pejgamberit të Allahut:

“Kush e ndjek një rrugë, përmes të cilës kërkon dituri, me këtë Allahu ia lehtëson atij rrugën për në Xhenet.” /Transmeton Muslimi/

“Asnjë përfitues nuk ka arritur të fitojë si vlera e ditorisë e cila e udhëzon njeriun në rrugë të mbarë apo e largon nga e keqja, dhe ai nuk mund të jetë fetarisht si duhet, derisa nuk është mentalisht i tillë!” /Transmeton Taberaniu/

“Nuk lejohet zilia, vetëm se në dy gjëra: Një njeri, të cilit i ka dhënë Allahu pasuri, e ai e harxhon atë si duhet; dhe një njeri, të cilit i ka dhënë Allahu urtësi, e ai gjykon sipas saj dhe ua mëson të tjerëve.” /Transmeton Tirmidhiu/

“Me të vërtetë, Allahu, melekët e Tij, banorët e qiejve dhe tokës, bile edhe milingona në vrimën e saj dhe peshqit në thellësitë e deteve, kërkojnë mëshirë për ata që ua mësojnë njerëzve të mirën.” /Transmeton Tirmidhiu/

Konteksti i këtyre haditheve udhëzon në cilën dituri të kërkohet: mësimin e të dobishmes, urtësinë, atë që të mbron nga e keqja, atë që të afron kah e mira. Ndërkaq, veçantimi i ditorisë me lloj të caktuar të kulturës, si përcaktimi i pasurisë me lloj të caktuar të mallit, nuk ka bazë. Nuk ka dyshim se në krye të asaj që duhet ditur është njohja e obligimeve të njerëzve ndaj Allahut dhe njohja e obligimeve të njerëzve ndaj njëri-tjetrit. Sepse, udhëzimi i sjelljes në interes të përgjithshëm ka ndikim të madh në organizimin e bashkësive dhe orientimin e politikave. Por, është gabim të mendojmë se dituria e lavdëruar është ekskluzivisht vetëm studimi i fikhut (jurisprudence islame), tefsirit (shkencës mbi shpjegimin e Kur'anit), si dhe shkencave të ngjashme.

Ky është gabim i madh, sepse shkencat mbi gjithësinë dhe jetën, si dhe rezultatet e hulumtimit konsekuent në horizontet e qiellit dhe tokës, nuk janë më pak të rëndësishme se shkencat

ekskluzive fetare; bile, me to mund të lidhen rezultate të cilat i japin përparësi njohjes së tyre, ndaj thellimit në shkencat e sheriatit (fesë).

Këtu mjafton si dëshmi ajo se Kur'ani, kur e lartësoi vlerën e diturisë dhe peshën e madhe të dijetarëve, aludoi në dijetarët të cilët e njohin madhërinë e Krijuesit nga madhëria e krije-save, si dhe aludoi në diturinë e cila rezulton nga studimi i bimëve, kafshëve dhe çështjeve të tjera të natyrës.

Allahu i Madhërishëm thotë: ***“A nuk e sheh se Allahu lëshon nga qielli ujë, e Ne nxjerrim me të fruta, ngjyra e të cilëve është e ndryshme, e edhe nëpër kodra ka vija të bardha e të kuqe ngjyrash të ndryshme, e ka edhe shumë të zeza. Edhe nga njerëzit, nga gjallesat, nga kafshët po ashtu ka të ngjyrave të ndryshme. Po Allahut ia kanë frikën nga robërit e Tij, vetëm dijetarët, Allahu është mbi gjithçka është mëkatfalës.”*** (Fatir: 27-28); ***“Nga argumentet e Tij është krijimi i qiejve e i tokës, ndryshimi i gjuhëve tuaja dhe i ngjyrave tuaja. Edhe në këtë ka argumente për njerëz.”*** (Er-Rum: 22)

Dituritë e jetës janë të një rangu me dituritë e botës tjetër në shërbimin ndaj fesë dhe qartësimin e fakteve të saj. Gjëja më e ndërlikuar në to është se shkencat natyrore kanë nevojë për studime më të gjata, ndërkaq të njohurit e fesë është e lehtë për atë që ia kushton kësaj pune disa ditë. Pasi zgjerimi në rrafshe të ndryshme të sheriatit ka nevojë për hapësira më të gjera, ky zgjerim duhet ditur se është funksion shoqëror, sikur edhe funksionet e tjera që i realizon shpesh shteti. Kështu, për shembull, studimi i ligjeve dhe jurisprudencës, në esencën e vet, nuk është më i vlefshëm se studimi i medicinës, edhe sikur njeriu përkatës ta kishte arritur shkallën e Ebu Hanifes, dhe njeriu peshohet në diturinë e tij në bazë të asaj se sado t'ia kushtojë këtë dituri dobisë së njerëzve për hir të Zotit dhe duke pritur shpërblimin e Tij për këtë.

Muri ndarës, në mes të asaj që është fe e pastër dhe interes i pastër i kësaj bote, është shumë i hollë dhe shumë i dendur, por, siç sqaruam më parë, vendimtar është qëllimi i shëndoshë dhe synimi fisnik. Kështu, një gjë mund të jetë iritim i madh, kur merren parasysh epshet që e përshkojnë atë, por, në të

njëjtën kohë, mund të jetë xhihad i bekuar, në bazë të sinqeritetit i cili e shoqëron.

Njerëzit mund ta lexojnë ajetin kur'anor: ***“Pasuria dhe fëmijët janë stoli e jetës së kësaj bote...”*** (El-Kehf: 46), dhe të mendojnë se pasuria dhe fëmijët janë thjesht vetëm dobi! Kurse, nuk u shkon mendja se, pasuria dhe fëmijët janë potencial i xhihadit obligativ dhe se investimin e pasurisë dhe shtimin e fëmijëve Allahu i ka bërë fuqi ngadhënjyese për popujt që një kohë kanë qenë të nënshtuar, të cilëve pastaj ua mundësoi që ta kthejnë prestigjin e vet të humbur. Me çka dhe si?

“Pastaj, Ne ua kthyem juve mbisundimin kundër atyre, ju përforcuam me pasuri e me djem dhe ju shtuam më së shumti.” (El-Isra: 6) Kështu, pra, me pasuri dhe me djem u përforcua ky umet (popull), pasi u dobësua; marshoi përpara, pasi u zmbrops; dhe e ktheu kënaqësinë e Allahut, pasi e humbi atë.

E njëjta vlen edhe në rrethin e shkencës. Kështu, nëse njeriu u qaset çështjeve të plehërave, duke synuar me këtë plleshmërinë e tokës, kjo me asnjë grimcë nuk do t'ia mangësonte atij shpërblimin, bile ai mund t'ia tejkalojë njeriut që i rregullon këmbët e veta në mihrab⁹ dhe që tërë natën e kalon në namaz!

Islami e ngriti pozitën e dijetarëve dhe vlerën e mundit të tyre, si dhe i vlerësoi lart rezultatet e tyre.

Transmetohet prej Muadh Ibën Xhebelit, i cili thotë: “Mësoni dituri, sepse mësimi është frikë dhe respekt ndaj Zotit; kërkimi i diturisë është adhurim; përsëritja e diturive është lartësim i Allahut (*tesbih*); hulumtimi i diturive është xhihad; t'ua mësosh diturinë të tjerëve është lëmoshë; sakrifikimi i diturisë, për bartësit e saj, është afrim tek Allahu, sepse dituria është sinonim i shenjave të hallallit dhe haramit, tregues i rrugëve të banorëve të Xhenetit; Dituria është zbutje e tërbiimit, shoqërues gjatë udhëtimit, bashkëbisedues në vetmi, udhëzues për bollëk dhe skamje, armë kundër armikut dhe stoli te të dashurit; me të Allahu lartëson disa njerëz, i bën prijës dhe pishtar në të mirë, ashtu që hapat e tyre pasohen, veprimet e tyre ndiqen dhe mendimi i tyre pranohet, melekët e synojnë

⁹ Vendi i imanit në xhami.

shoqërimin e tyre e me fletët e tyre i ledhatojnë, dhe për ta kërkon falje çdo gjë, madje edhe peshqit dhe gjallesat e detit, kafshët e egra dhe të buta të tokës, sepse dituria është jeta e zemrave prej injorancës, kandil i dritës në errësirë; njeriu, me dituri i arrin piedestalet e të zgjedhurve dhe gradat më të larta në këtë botë dhe botën tjetër; analizat shkencore janë identike me agjërimin, studimi është identik me namazin; me dituri respektohet farefisi, dhe përmes ditorisë njihet hallalli nga harami; dituria është prijës, kurse praktika e ndjek, kjo u jepet njerëzve të lumtur, kurse nga ajo privohen të humburit.”
/Shënon Ibën Abdul-berri/

Mësimi i gjuhëve të huaja është prej natyrës së Islamit. Kështu, Pejgamberi i Allahut parapriu në shfrytëzimin e kësaj diturie, e për këtë edhe e urdhëroi sekretarin e tij, Zejd Ibën Thabitin që ta përvetësojë gjuhën asiriane. Zejdi thotë: “Më urdhëroi Pejgamberi i Allahut, dhe e mësova shkrimin hebraik në asirianishte. Betohem në Zotin, nuk kaloi as gjysmë muaji derisa e mësova dhe e përvetësova, dhe pastaj unë i shkruaja letrat e Pejgamberit që ua dërgonte atyre, si dhe ia lexoja letrat e tyre që ia dërgonin Pejgamberit.” /Transmeton Buhariu/

Kuptimi i gjuhëve të popujve konsiderohet prej domosdoshmërive islame, sepse misioni i Pejgamberit [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] i është drejtuar mbarë njerëzimit, ndërkaq tubimi i njerëzve në një gjuhë është absurd. Si? Ndryshimi i gjuhëve është prej fakteve të Zotit, sepse transmetimi i mësimëve islame te popujt e ndryshëm të botës, në gjuhët që i kuptojnë, është më afër mendjes dhe realitetit, sesa transferimi i popujve të ndryshëm në gjuhën arabe. Lidhur me komentimin e ajetit kur’anor: **“Ne asnjë nga të dërguarit nuk e dërguam ndryshe, vetëm në gjuhën e popullit të vet, ashtu që ai t’u shpjegojë atyre (në atë gjuhë)...”** (Ibrahim: 4), komentuesit e Kur’anit thonë: “Pejgamberi i Allahut, Muhammedi [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] u dërgua prej arabëve dhe në gjuhën e tyre, mirëpo ai i dërgoi të deleguarit e tij në anë të ndryshme, të cilët ua përkthenin mësimet njerëzve në gjuhën që ata e kuptonin, si dhe i thirrnin njerëzit, në rrugën e Allahut, në gjuhët e tyre!”

Këto fjalë tregojnë shumë qartë se muslimanët duhet t’i mësojnë gjuhët e huaja, sepse, përndryshe, e kanë tradhtuar

misionin që e kanë marrë përsipër dhe i kanë lënë njerëzit në injorancë.

Pastaj, po ashtu duhet ditur se shkenca nuk ka atdhe të veçantë dhe se ajo nuk mund të jetë monopol i një brezi të caktuar. Kështu, nëse u bëjmë një shikim burimeve të njohurive, të cilat e vërshtuan botën në të kaluarën dhe tash, do të shohim se burimet e shkencës janë si retë lëvizëse në qiell: ato nuk ndalen vetëm në një horizont, dhe nuk mund të ketë monopol mbi to vetëm një vend. Sa e sa popuj të ngritur kanë trashëguar injorancën, dhe sa e sa paraardhës injorantë pas vetes kanë inteqgjentë të shkathët! Evropa para disa shekujve vlonte nga shurdhmecët të cilët nuk kuptonin asgjë, ndërsa sot ajo dominon mbi trashëgiminë e civilizimeve të vjetra! Muslimani është i obliguar t'ua mësyjë vendeve të largëta, në mënyrë që të arrijë dituri nga çdo anë dhe çdo vend.

Pejgamberi i Allahut thotë:

“Muslimani asnjëherë nuk do të ngopet me të mirat që dëgjon, derisa të mbarojë në Xhenet.” /Transmeton Tirmidhiu/

“Urtësia është diçka e humbur nga besimtari, dhe kudo që ta gjejë, ai është më meritor për të.” /Transmeton Tirmidhiu/

“Kush del të kërkojë dituri, ai është në rrugë të Allahut derisa të kthehet.” /Transmeton Tirmidhiu/

Dituria dhe arsimimi janë shpirti i Islamit; thelbi i tij nuk mund të ekzistojë dhe ardhmëria e tij nuk garantohet pa to. Njerëzit, në këndvështrimin islam, janë të njëres prej dy palëve: ose nxënësi kërkon udhëzim, ose dijetari kërkon zgjerim. Pas kësaj, të tjerët janë të parëndësishëm. Pejgamberi i Allahut ka thënë: *“Arsimtari dhe nxënësi janë partner në mirësi, e në njerëzit e tjerë nuk ka dobi.”* /Transmeton Ibën Maxhe/

SHFRYTËZIMI I KOHËS DHE MARRJA MËSIM PREJ SAJ

Çdo gjë që ke humbur, ke shpresë se mund ta kthesh, përveç kohës. Nëse humbet koha, nuk ka shpresë për kthimin e saj. Andaj, koha është gjëja më e shtrenjtë që e ka njeriu, dhe njeriu i mençur duhet t'i presë ditët sikurse koprraci që pret një pasuri të madhe: ai nuk lë pas dore as diç të vogël, duke u mashtruar pas të madhes, dhe mundohet që çdo gjë, sado e imët, ta vërë në vendin të cilin e meriton.

Sikur çdonjëri prej nesh të bëjë një shikim prapa, duke u munduar ta kuptojnë momentin prej kur e ka filluar rrugën në këtë jetë, në mënyrë që t'i numërojnë ditët dhe vitet që i ka kaluar, nuk do të meditojnë gjatë, sepse do të shohë vetëm një fillim të mbyllur, e pastaj do të tubohen ditët dhe netët e gjata, por do të duken se janë një ditë me gjatësi dhe gjerësi rrjedhëse, me ngjarje të pandërprera.

Këtë e ndien njeriu tani, dhe të njëjtën do ta përjetojë edhe në Ditën e Gjykimit, kur do të ndalet për llogaritje:

“(Përkujto) Ditën kur i tubojmë ata, (atyre u duket) sikur nuk qëndruan (në dunja) vetëm një moment të ditës, atëherë njihen mes vete...” (Junus: 45)

“E ata pëshpërisin mes vete: nuk qëndruat (në dunja) më shumë se nja dhjetë ditë. Ne më së miri e dijmë se çka flasim ata, e edhe atë kur më i mençuri prej tyre u tha: Nuk qëndruat më shumë se një ditë!” (Ta Ha: 103-104)

“... atyre (idhujtarëve) do t'u duket sikur nuk kanë jetuar më tepër se një mbrëmje ose një mëngjes të saj.” (En-Naziat: 46)

Ky përjetim, me tërë atë që ka, do t'i shkrumojë ata të cilët e ëndrronin amshueshmërinë në tokë dhe që e lidhën

epilogun e tyre me dheun e saj. Ky është përjetim korrekt, nëse krahasohen ditët e kësaj bote me ditët e botës tjetër... Mirëpo, ndjenjat e atij që i kaluan ditët dhe i ikën muajt e vitet, i cili qarkulloi gjatë tërë ditës, u lodh e pushoi, janë ndjenja masht-ruese dhe devijuese, sepse ai, edhe përkaj gjithë kësaj, ende mbeti mospërfillës ndaj kohës, filloi të dëfrehet dhe të vazhdo-jë në këtë rrugë, derisa të arrijë pleqëri të thellë, e të hyjë në terrin e vdekjes, kur zgjohet me ashpërsi! Por, e kotë! Ai u zgjua pasi kaloi koha...

Halli i njerëzve në këtë botë është i çuditshëm; ata tallen, ndërkaq caktimi i Zotit ndaj tyre është serioz; ata harrojnë, kurse çdo imtësi e punës së tyre llogaritet: ***“Në ditën kur Allahu i ringjall ata të gjithë, i njofton me atë që kanë punuar, pse Allahu ka mbajtur ato shënime, edhe pse ata i kanë harruar. Allahu është Ai që çdo send e sheh dhe e përcjell.”*** (El-Muxhadele: 6)

Muslimani i vërtetë e çmon shumë lart kohën, sepse koha është jeta e tij. Sikur ai të lejojë të humbet koha e tij kot dhe t’ua lërë ndryshimeve të ndryshme kohore t’ia rrëmbejnë atë, do të bënte vetëvrasje në këtë mënyrë kaq banale.

Njeriu ngutet për te Zoti, dhe çdo rrotullim i tokës agon me dhembjet e një mëngjesi të ri, i cili nuk është tjetër veçse një periudhë prej periudhave të rrugës në të cilën nuk ka ndalje asnjëherë. A nuk është mençuri që njeriu ta kuptojë këtë reali-tet, dhe ta ketë çdoherë parasysh, duke e shpaluar atë që ka pas dhe para vetes, sepse mashtrim është që njeriu ta konside-rojë veten të stopuar, kur koha ecën! Ky është mashtrim i shiki-mit, siç udhëtarit me tren i duket se sendet në natyrë ecin e ai rri në vend. Realiteti është se koha ecën edhe me vetë njeriun në vendqëndrimin e tij të përhershëm.

Islami është fe e cila e njeh vlerën e kohës dhe e vlerëson rrezikun e saj; ai konfirmon fjalën e shtrenjtë populllore: “Koha është si shpata, nëse ti nuk e pret atë, ajo të pret ty.” Të kupt-uarit e këtij realiteti dhe veprimi në bazë të tij konsiderohen fakte të cilat argumentojnë besimin dhe simptomizojnë devot-shmëri: ***“Në ndërrimin e natës e të ditës, dhe në çka krijoi Allahu në qiej e në tokë, vërtetë ka fakte për njerëzit që kanë droje.”*** (Junus: 6); ***“Ata që nuk presin takimin Tonë, që janë të kënaqur me jetën e dunjasë dhe kanë gjetur prehje***

në të, dhe ata që janë indiferentë ndaj argumenteve tona. Vendi për të tillët është zjarri, për shkak të asaj që punuan.” (Junus: 7-8)

Islami ka bërë ndarjen e adhurimeve të mëdha në tërë pjesët e ditës dhe stinët e vitit. Pesë namazet mbërthejnë tërë ditën, përderisa kohët e tij janë në kontinuitet me rrjedhën e saj. Në jurisprudencën islame është konfirmuar se Xhibrili [alejhis-selam], në bazë të urdhrit të Allahut, bëri përcaktimin e fillimit të kohës së namazeve dhe mbarimin e tyre, për të rezultuar nga kjo një ligj, sistem i përkryer dhe preciz, i cili do ta rregullonte jetën islame dhe maste atë me minutë, prej agimit, e derisa të humbë e kuqërremta e perëndimit të Diellit: ***“Atëherë, Allahun lartësonie kur të vijë mbrëmja dhe kur të agojë mëngjesi. Falënderimi i takon vetëm Atij prej gjithçka ka në qiej e në tokë, edhe në mbrëmje edhe ditën.”*** (Er-Rum: 17-18)

Ndërsa vrojtuesi i thjeshtë nuk sheh në kohën diç tjetër, përveçse gjurmë të kufizuara dhe dukuri konkrete, andaj edhe thotë: “Vallë, a mos u rrit fëmija dhe u zhduk plaku, vetëm se me kalimin e mëngjeseve dhe mbrëmjeve?” Po ashtu ai thotë: “Njeriu gëzohet me kalimin e netëve, e shkuarja e tyre është edhe shkuarje e tij!” Ndërkaq, sa i përket kohës e cila ta rrudhë ballin, mbështjell exhelet, shkatërron civilizimet, dhe pranë çudirave të së cilës mbesin njerëzit të magjepsur, kjo kohë, në realitet, është rast i cili i motivon të zgjuarit që të shpejtojnë në veprimin e të mirave, në afrimin e të dobishmeve dhe në deponimin e të vlefshmeve. Allahu i Madhërishëm thotë: ***“I madhërishëm është Ai që krijoi yje në qiell dhe vendosi në të dritë (diell) e hënë që ndriçon. Ai është që bëri natë e ditën zëvendësuese të njëra-tjetrës, dhe për atë që dëshiron të mendojë apo të falënderojë, argument.”*** (El-Furkan: 61-62)

Nata e zëvendëson ditën, ndërsa dita, me lëvizje të sferave qiellore, të cilat pandërprerë janë në rrjedhë, zëvendëson natën, e Zoti i botëve nuk i krijoi këto pa ndonjë qëllim. Do të ishte turp për njerëzit që jetën e tyre në këtë hapësirë ta konsiderojnë të ngjashme me kotësitë. Në realitet, koha është një shesh që është përgatitur për gara maratonike, gara në të cilat inkuadrohen veç ata që e njohin Zotin e tyre, ata që përkujtojnë të mirat e Tij, që falënderojnë dhuntitë e Tij, dhe ata të

cilët vazhdimësisë së viteve ia bashkangjesin mundin-palodhshmërinë, për të arritur deri te pushimi i pandërprerë. E sa u përket të eturve pas intereseve të tyre të ngushta, ata s'janë tjetër gjë veçse të marrë, të cilët nuk këshillohen me urtësi dhe nuk përfitojnë nga leksionet: ***“A nuk e shohin ata se për çdo vit sprovohen një herë apo dy herë, e përsëri nuk pendohen e as nuk marrin mësim.”*** (Et-Teube: 126)

Në të vërtetë, jeta jote është kapitali yt i madh dhe, pa dyshim, së shpejti do të pyetesh si ke vepruar me të dhe si e ke shpenzuar. I Dërguari i Allahut [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] ka thënë: ***“Në Ditën e Gjykimit nuk do të lëvizë këmba e bijve të Ademit, përderisa nuk përgjigjen për pesë gjëra: Si e kanë kaluar jetën? Si e kanë harxhuar rininë? Si e kanë fituar dhe shpenzuar pasurinë? Dhe çka kanë punuar me diturinë e tyre?”*** /Transmeton Tirmidhiu/

Islami shikoi në vlerën e kohës në shumë prej urdhrave dhe ndalesave të tij. Ai ishte i përkryer në luftën kundër grupeve të përtacëve, të cilët njëri-tjetrin e thërrasin: “Ejani ta mbysim kohën me gjëra të kota.” Të gjetur nuk kuptuan se ajo është lojë me jetën, dhe se mbytja e kohës është shkatërrim për individin dhe humbje për bashkësinë.

Prej urtësive, të cilat shpeshherë humbin nga vëmendja e popullatës së gjerë, është edhe kjo: “Obligimet janë më tepër se koha.” Koha assesi nuk qëndron e përmbajtur: ajo ose do të jetë mik i dashur, ose armik i rreptë.

Një thënie e Hasan El-Basriut thotë: “Nuk ka ditë që agon agimi, e një thirrës nga qielli të mos thërrasë: O biri i Ademit, unë jam një krijesë e re për veprat e tua dëshmuese, shfrytëzomë mua që të përgatitesh me vepra të mira, ngase unë kurrë më nuk kthehem deri në Ditën e Gjykimit.”

Këto urtësi burojnë nga shpirti islam dhe nga të kuptuarit e instruksioneve të larta të cilat të bëjnë të përfitosh nga jeta e kësaj bote për të mirën e jetës së amshueshme. Në të vërtetë, inspirimi i njeriut për të shfrytëzuar çdo orë nga jeta e tij në vepra të mira është meritë e Allahut dhe fakt për përkrahjen e Tij: ***“Po mëshira e Tij, u bëri juve natën dhe ditën për të pushuar në të dhe për të përfituar nga begatitë e Tij, prandaj, të jini mirënjohës!”*** (El-Kasas: 73)

Është pikëlluese ajo që masa e gjerë nuk ngurrojnë nga humbja e kohës së tyre për së koti, por, më tragjike është se këtij krimi ia bashkangjesin agresionin ndaj kohës së të tjerëve, për t'ua çuar atë huq. Në shumë raste ata u imponohen biznesmenëve, kur ata janë përqendruar në çështje serioze, për t'i preokupuar me çështje të imëta.

I Dërguari i Allahut [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] ka thënë: *“Në dy begati shumica e njerëzve janë të papërfillshëm; ato janë: shëndeti dhe koha e lirë.”* /Transmetojnë Buhariu dhe Muslimi/

Nga metodat më efikase për shfrytëzimin e kohës është edhe inkurajimi në kontinuitet të veprës, po edhe nëse ajo është e paktë, dhe përbuzja e të shumtës së ndërprerë, për atë se vazhdimësia e veprës së paktë në kontinuitetin e kohës dhe rrjedhën e pandërprerë e shndërron atë nga e imëta dhe e lig-shta, në peshë të kodrave, prej nga edhe vetë individi nuk do ta vërejë.

Islami, gjithsesi, urren që njeriu të bie në afekt, që do ta shtynte që ta shtojë dhe teprojë, e pas pak kohe ta kaplojë bezdisja dhe ta ndërpresë veprën. Në një hadith qëndron: *“O ju njerëz, merruni me vepra të bazë të mundësive, ngase Allahu nuk bezdiset derisa nuk të bezdiseni, veprat më të dashura tek Allahu janë ato që vazhdojnë, po edhe nëse janë të pakta.”*

Transmetohet nga Aishja [radijAllahu anha], se i Dërguari [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem] hyri te dhoma e saj, ku kishte qenë një grua nga Beni Esed, dhe tha: *“Kush është kjo?”* Ajo iu përgjigj: *“Kjo është filanja, e cila nuk fle natën.”* Tha: *“Ngadalë, preokupohuni me punë në bazë të mundësive të juaja.”* Ai i pëlqente veprat fetare në të cilat ishte kontinuitiv pronari i tyre. /Transmeton Buhariu/

Gjëja e cila flet mbi kujdesin e Islamit ndaj kohës, është nxitja për zgjim herët dhe inkurajimi që besimtari të fillojë ditën herët, i freskët, shpirtmirë, me plot vendosmëri, ngase kujdesi për të përfituar prej orëve të hershme të ditës tërheq në vete vullnetin e fortë, që mos të humbë kot e tërë dita.

Sistemi islam parasheh fillimin e ditës prej mëngjesit; ai e obligon zgjuarjen e plotë para lindjes së Diellit, dhe e urren ndejnë në orët e natës, ndejë e cila do ta vononte namazin e

agimit nga koha e tij e përcaktuar. Në një hadith thuhet: “O *Zoti im, bekoja umetit tim kohën e hershme.*” /Transmeton Ebu Davudi/

Do të ishte moskujdes dhe privim nga e mira që disa t’i adaptohen gjumit deri në orët e vona të mëngjesit, dhe të lindë Dielli derisa ata kridhen në gjumë, përderisa të tjerëve në ato çaste u agon dita, që janë të zhytur në kontribut për të lulëzuar këtë botë dhe për t’u përgatitur për vendkthimin e tyre.

Transmetohet nga Fatimja [radijAllahu anha], e bija e Muhammedit [sal-lAllahu alejhi ve sel-lem], se kishte thënë: “Kaloi pranë meje i Dërguari i Allahut, përderisa unë isha e shtrirë në mëngjes, e ai më lëkundi me këmbë, e pastaj tha: “*Oj bija ime, zgjohu dhe dëshmo furnizimin e Allahut, dhe mos u bë nga indiferentët, ngase Allahu i ndan furnizimet e njerëzve në mes agimit dhe lindjes së Diellit.*” /Transmeton Bejhe-kiu/

Nga fakti se seriozët dhe përtacët dallohen në këtë kohë, dhe secilit prej tyre u jepet nga të mirat e kësaj dhe botës së ardhme në bazë të përgatitjes së tyre.

Koha, ashtu siç i përfshin obligimet me të cilat janë të ngarkuara supet e robërve, i përfshin edhe përcaktimet të cilat ua dërgon Allahu njerëzve, nga të mirat apo të këqijat. Përcaktime përplot leksione të gjalla dhe mësimet të vyeshme për ata që u kushtojnë kujdes. “***Allahu bën rrotullimin e natës e të ditës dhe në të gjitha këto ka fakte për ata që kanë të parit të shëndoshë.***” (En-Nur: 44)

Njerëzit i vërejnë ndodhitë, por janë indiferent ndaj Dërguesit të tyre; ata i shijojnë të mirat dhe të këqijat, por janë injorantë ndaj Atij që ua shijon ato. E kur t’u ndodhë ndonjë trazirë, ata fillojnë t’i mallkojnë ditët të cilat bartin tmerr. Kjo, pa dyshim, është një lloj injorance ndaj Zotit dhe indiferencë ndaj përcaktimeve të Allahut në robërit e Tij. I Dërguari i Allahut tha: “***Thotë Allahu i Lartësuar: “Më fyen biri i Ademit, e shan kohën, e unë jam koha, në duart e Mia janë të gjitha çështjet, e ndërroj ditën dhe natën.***” /Transmeton Ebu Davudi/

Do të thotë se koha nuk u shkakton njerëzve të mira apo të këqija, për të cilat ata do të gëzoheshin apo do të dëshpërohe-

shin, por ato i sjell Zoti i kohës dhe i vendit: **“Çdo krijesë do ta shijojë vdekjen, e Ne, në shenjë sprove ju sprovojmë me vështirësi e kënaqësi, dhe ju ktheheni te Ne.”** (El-Enbija: 35) Allahu i Madhërishëm nuk u sjell situata të ndryshme njerëzve për diç tjetër përveçse për urtësi, të cilat do t’i kuptonin të dijshmit, dhe me këtë t’u shtohet edhe më tepër besimi në Atë dhe bindja në takimin me Të: **“... Ai rregullon çështjen (e gjithësisë), sqaron argumentet, që të jeni të bindur për takimin (pas ringjalljes) me Zotin tuaj.”** (Er-Rra’d: 2) Ndërsa mendjelehtëve u kalojnë situata të mira dhe të këqija, e ata nga ato nuk përfitojnë asgjë. Në një hadith thuhet: **“Dyfytyrëshi, kur të sëmuret, e pastaj të shërohet, është i ngjashëm me devenë, të cilën e lidh pronari, e pas pak e lëshon; ajo as nuk kupton përse e kanë lidhur, e as përse e kanë lëshuar.”** /Transmeton Ebu Davudi/

Është e vërtetë se nuk është besimtar i vërtetë ai të cilin nuk e gdhendin përvojat dhe nuk e drejtojnë ditët. Dhembjet u ekspozohen njerëzve për t’u mësuar injorantët, për t’u zgjuar neglizhentët dhe për t’u afruar tek Allahu ata që janë larg Tij. Allahu i Madhërishëm thotë: **“Ne kemi dërguar (pejgamberë) edhe te popujt para teje (e derisa nuk dëgjuan), i dënuam me skamje e mjerim, ashtu që të përulen. E pse të mos përulen shin kur ju erdhi atyre dënimi Ynë?...”** (El-En’am: 42-43)

Është natyrë e njerëzve që ta njohin Zotin e tyre në momentet e vështirësive dhe të kërkojnë strehim tek Ai në momentet kur përforcohen krizat. Njeriu i mençur, që goditet nga një vështirësi, e cila i vendos lidhjet me Krijuesin e tij, do të ishte e patjetërsueshme për të që, pas kalimit të vështirësisë dhe rikthimit të shëndetit, atë lidhshmëri ta forcojë dhe kultivojë nga-se, mohimi i të mirave të Allahut dhe supozimi në pavarësi nga Ai, do të ishte turp i paparë.

Ndërsa, të prishurit, të cilët nuk i njohin vlerat dhe nuk u kushtojnë vëmendje gjërave të ndryshme që i godasin, e as që nxjerrin mësim nga ndodhitë, ata në momentet e vështirësive i betohen Zotit, ndërsa në momente të sigurisë ikin nga Ai: **“E kur njeriun e godet dëmi, ai na lut qoftë shtrirë, ulur ose në këmbë, e kur Ne ia largojmë të keqen atij, ai vazhdon, sikurse të mos na ishte ulur fare për dëmin që e pat goditur.”**

Kështu kriminelëve u duket mirë ajo që veprojnë.” (Junus: 12)

Këtë sjellje të matufosur nuk bën ta ndjekë njeriu i ndershëm me Dhuruesin e dhuntive të tij.

Nga mënyrat e të përfiturit nga koha është edhe të studiuarit e historisë së përgjithshme, përcjellja e fakteve të Allahut në horizonte dhe meditimi rreth gjendjeve të popujve: Si ngrihen dhe si dështojnë? Si i ndërrojnë pozicionet, nga faza e lulëzimit në fazë të dekadencës? Allahu i Madhërishëm kërkon prej njerëzve që t’i përcjellin këto ndryshime-situata suksesive dhe të kenë vetëdije solide, e cila do t’i udhëzonte kah përfitimi prej tyre: ***“A nuk udhëtuan ata nëpër tokë e të kenë zemra me të cilat do të kuptojnë, dhe veshë me të cilat do të dëgjojnë? Pse në të vërtetë sytë nuk verbërohen, por verbërohen zemrat në kraharrorë.”*** (El-Haxh: 46)

Njeriu është në mes dy gjendjeve: të zotërojë përvoja të tij të posaçme, të cilat i shfrytëzon në përmirësimin e ideve dhe forcimin e besimit, apo të mos zotërojë dituri, e në atë rast le të dëgjojë të tjerët për të përfitur nga njohuritë dhe përvojat e tyre. Sa i përket hapjes së syve kah kjo jetë, e cila valëzon me ndodhi madhore, pa medituari, pa studiuar dhe pa marrë leksione nga ato, ajo do të ishte verbërim dhe errësirë, gjë e cila nuk i takon një besimtari. Jeta është e shkurtër, ndërsa mjedisi në të cilin jeton njeriu është i ngushtë, dhe mendja nuk përfiton ekzistencë, shkëlqim dhe dinamizëm nga ngurrimi dhe paaftësia. Është e patjetërsueshme që njeriu të tejkalojë vendin e tij dhe të arrijë në hapësirat e gjëra, të tejkalojë kohën e tij derisa të arrijë në kohët e ndryshme të jetës së gjatë. Dhe nga të shkuarit rreth e rrotull, aty e këtu, me qëllime hulumtimi, ai kthehet me një thesar të madh nga idetë, rrëfimet, mendimet dhe ndodhitë, të cilat ia shtojnë përvojën rreth botës dhe ia përforcojnë njohurinë për Zotin e botëve. Islami, pa dyshim, e ngre besimin e fortë në shtyllat e konsoliduara nga meditimi, mosnëgjtja, hulumtimi dhe vëzhgimi. Nisur nga kjo, ai i thirri bijtë e vet që të bëjnë udhëtime të gjata dhe turizëm të gjerë, dhe ua dashuroi atyre ecjen në anët e ndryshme të tokës; Dhe nuk e bëri këtë për tallje dhe lojë, por për dobi dhe dituri; as për argëtim dhe kalim të kohës, por për të hulumtuar, mësuar dhe përfitur leksion nga të gjallët dhe të vdekurit:

“Përpara jush kanë kaluar popujt ndaj të cilëve janë zbatuar ligjet, ndaj, udhëtoni nëpër tokë dhe shikoni si qe përfundimi i atyre që përgenjeshtruan. Ky (Kur’ani) është sqarim për njerëzit, është udhëzim dhe këshillë për të devotshmit.” (Ali Imran: 137-138)

“A nuk udhëtuan ata nëpër tokë të shohin se si ishte përfundimi i atyre që patën qenë para tyre? Ata ishin edhe më të fuqishëm se këta, e edhe lanë më shumë gjurmë në tokë, po Allahu i dënoi për shkak të mëkateve të tyre dhe nuk patë ndonjë që t’i mbrojë prej dënimit të Allahut.” (Gafir: 21)

Kur’ani Famëlartë, poashtu, thërret që të studijohen civilizimet e zhdukura dhe shkaqet e zhdukjes së tyre, për të arritur gjeneratat e reja që t’i tejkalojnë vendështimet të cilat ishin shkak për shkatërrimin e të parëve. Sa çudira na shfaq historia përmes shfletimit të faqeve të saj:

Netët e kohës janë shtatzënë,

Të rënda dhe lindin çdo çudi.

Atë që e njohim nga koha janë vetëm gjurmët të cilat ajo i lë në materie, e kush e di se ndoshta fshehtësia e amshueshmërisë dhe zhdukjes është e përmbledhur në të, gjë të cilën nuk e di kush përveç të Informuarit mirë për gjërat e dukshme dhe të padukshme: ***“Dhe Ai është që ju krijoi ju në tokë dhe vetëm te Ai do të tuboheni. Dhe Ai është që jep jetë dhe vdekje dhe vetëm Ai bën ndryshimin e natës e të ditës; si nuk e kuptoni?”*** (El-Mu’minun: 79-80)

Ajo që duhet kuptuar është se jeta jonë nuk është shkel e shko, dhe se Allahu është i pastër nga vepra e tillë. Nëse nga kalimi i kohës përfitojmë sa më shumë, vetes sonë i kemi regjistruar amshueshmëri, të cilën nuk do ta rrëmbejë koha, as me vjetërim e as me kalbje. E, atë e gjejmë te shoqëria e lartë!

PËRFUNDIM

Në këtë libër nuk i kam përmbledhur të gjitha elementet e karakterit fisnik dhe shenjat e sjelljes së bukur, që duhet të ketë një besimtar. Më mjaftoi që të shënoj atë që m'u dha mundësia, pas një përsëritje të shkurtër në burimet e para të Islamit. E pashë të arsyeshme që mos t'i përsëris disa virtyte dhe gjëra të tjera, të cilat duhet t'i ketë një besimtar, rreth të cilave kam folur në raste të tjera.

Diturisë së përqendruar, nëpërmjet të së cilës fitohen të ardhurat dhe realizohet e drejta e jetës si karakter, shpresoj se ia kam dhënë hakun e duhur në studimin rreth pasurisë dhe mënyrave të fitimit dhe shpenzimit të saj.¹⁰ Rreth xhihadi të urdhërimit në të mirë dhe pengimit nga e keqja, si dhe xhihadi me faktor të ndryshëm për të ngritur Fjalën e Allahut lart si karakter, kam bërë një sqarim të gjerë gjatë bisedës rreth politikës islame brenda dhe jashtë.¹¹

Po ashtu, edhe rreth virtyteve të ndihmimit të ndërsjellë, respektimit të fqinjëve dhe mysafirëve, si dhe afrimit të të dobishmeve dhe qetësisë të gjithë njerëzve.

Të përkujtuarit e Allahut, pendimin tek Ai, të larguarit nga mëkatet, përkryerja e adhurimit dhe përmirësimi i veprave si natyrë e bukur, të gjitha këto ia kam bashkangjitur bisedës rreth doctrine gjatë bisedës rreth saj.¹²

Gradualizimi në studimin e karakterit, gjatë shërimit të çdo tematike islame, assesi nuk llogaritet largim nga tema, ngase karakteri përfaqëson faktorin kompetent të Islamit dhe bazën e tij. Le të jetë ky libër shoqërues për vëllezërit e mi në thirrje për të mirë dhe të dobishme. Nga Allahu kërkoj ndihmë dhe vetëm Ai udhëzon në të drejtë. Amin!

¹⁰ Konsultoji librat tona: "Islami dhe gjendjet ekonomike", "Islami dhe sistemet socialiste", "Islami, të cilit i është bërë shpifje".

¹¹ "Islami dhe despotizmi politik", "Lufta ..."

¹² "Besimi i muslimanit"

PËRMBAJTJA

HYRJE	3
SHTYLLAT E ISLAMIT DHE PARIMET E MORALIT	7
DOBËSIA E KARAKTERIT, ARGUMENT PËR DOBËSINË E BESIMIT	11
DREJT NJË BOTE MË TË VYESHME	15
NJERIU NDËRMJET TË MIRËS DHE TË KEQES	25
NDËSHKIMET PËR KRIMET ETIKE	33
RRAFSHI I MORALIT I PËRFSHIN TË GJITHA	37
KORREKTËSIA	41
BESNIKËRIA	53
ZBATIMI I PREMTIMIT	63
SINQERITETI	79
KULTURA E TË BISEDUARIT	91
SIGURIA NGA SHPIRTLIGËSIA (URREJTJA)	101
FUQIA	117
BUTËSIA DHE FALJA	127
BUJARIA DHE FISNIKËRIA	139
DURIMI	155
MATURIA DHE NDERSHMËRIA	167
PASTËRTIA, ZBUKURIMI DHE SHËNDETI	179
TURPI	191
VËLLAZËRIMI	199
UNITETI	211
ZGJEDHJA E SHOQËRISË	223
KRENARIA	235
MËSHIRA	247
DITURIA DHE MENDJA	259
SHFRYTËZIMI I KOHËS DHE MARRJA MËSIM PREJ SAJ	269
PËRFUNDIM	278